



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 29 korrik 2024  
Nr. ref.: AGJ 2501/24

## **AKTGJYKIM**

në

**rastin KO46/23**

parashtrues

**Abelard Tahiri dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

### **Parashtruesit e kërkesës**

1. Kërkesa KO46/23 është dorëzuar nga Abelard Tahiri, Isak Shabani, Eliza Hoxha, Hajdar Beqa, Mërgim Lushtaku, Ferat Shala, Bekim Haxhiu, Enver Hoxhaj, Floretë Zejnullahu dhe Hisen Berisha, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK), të cilët i përfaqëson Faton Fetahu, avokat në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

## **Ligji i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i kontestuar), dhe në mënyrë specifike kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve: 2 (Fushëveprimi), 4 (Themelimi), 9 (Statusi dhe Pavarësia), 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) dhe 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) të tij, miratuar me Vendimin [Nr.08-V-478] e 9 shkurtit 2023 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet: 3 [Barazia para Ligjit] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenet 2 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejta e Njeriut dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejta e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 46 [Mbrojtja e Pronës], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] dhe 142 [Agiencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
4. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme, për të pezulluar *ex lege* hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Ligjit të kontestuar, deri në vendosjen përfundimtare për kërkesën nga Gjykata.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës së Gjykatës, Nr.01/2023 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
6. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr.01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## Procedura në Gjykatë

7. Më 20 shkurt 2023, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Më 21 shkurt 2023, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja); (ii) Kryetarin e Kuvendit, të cilit iu kërkua që të njoftojë deputetët se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve, nëse kanë, deri më 8 mars 2023; (iii) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, të cilit iu kërkua që të marrin parasysh kërkesat e paragrafit 2 të nenit 43 (Afatet) të Ligjit, që përcakton: *“Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*. Gjykata, bazuar në dispozitën e lartcekur të Ligjit dhe praktikën e saj gjyqësore, rikujtoi se kjo dispozitë nënkupton që Ligji i kontestuar, nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, ose të prodhojë efekte ligjore deri në vendimin final të Gjykatës, lidhur me çështjen e ngritur pranë saj. Po ashtu, në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës edhe: (i) parashtruesin e kërkesës; (ii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (iii) Institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Avokati i Popullit); dhe (iv) Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ministria e Drejtësisë), të cilëve iu kërkua që të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve, nëse kanë, deri më 8 mars 2023.
9. Më 22 shkurt 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimeve [Nr. GJR. KO46/23] dhe [Nr. KSH. KO 46/23] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
10. Më 3 mars 2023, Kuvendi i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin si në vijim:
  - (i) Projektligjin Nr. 08/L-21 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme të proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) më 17 janar 2022 në Kuvend;
  - (ii) Raportin e 3 shkurtit 2022 të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Nr. 08/L-121;
  - (iii) Vendimin e 24 shkurtit 2023 të Kuvendit për dërgimin për opinion të Projektligjit në Komisionin e Venecias;
  - (iv) Pjesë nga transkripti i Seancës Plenare të Kuvendit për shqyrtimin e parë të Projektligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, të mbajtur më 23 dhe 24 shkurt 2022;
  - (v) Opinionin e Komisionit të Venecias për Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, të miratuar më 20 qershor 2022;
  - (vi) Vendimin [nr.08-V-326] e 14 korrikut 2022 të Kuvendit për miratimin në parim të Projektligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme;
  - (vii) Procesverbalin e Seancës plenare të Kuvendit, të 7 dhe 14 korrikut 2022;

- (viii) Pjesë nga transkripti i Seancës Plenare të Kuvendit, të 14 korrikut 2022 në lidhje me votimin në parim të Projektligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme;
  - (ix) Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të 30 janarit 2023 që ndërlidhet me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Nr. 08/L-121;
  - (x) Vendimin e Kuvendit të 9 shkurtit 2023 për miratimin e Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme;
  - (xi) Pjesë nga transkripti i Seancës Plenare të Kuvendit të 9 shkurtit 2023 që ndërlidhet me shqyrtimin e dytë të Projektligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme; dhe
  - (xii) Tekstin e Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme (Ligjit të kontestuar).
11. Më 8 mars 2023, Ministria e Drejtësisë dhe Avokati i Popullit dorëzuan komentet e tyre përkitazi me Ligjin e kontestuar.
  12. Në të njëjtën ditë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, përmes deputetit Adnan Rustemi, dorëzoi komentet e tij përkitazi me Ligjin e kontestuar.
  13. Më 24 mars 2023, Ministria e Drejtësisë dorëzoi Informatën përcjellëse të Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni i Venecias), të 14 marsit 2023 përkitazi me Opinionin e Dytë.
  14. Më 28 mars 2023, Gjykata njoftoi: (i) parashtruesin e kërkesës; (ii) Presidenten; (iii) Kryetarin e Kuvendit; (iv) Kryeministrin; (v) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit; (vi) Avokatin e Popullit; si dhe (vii) Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me pranimin e komenteve për kërkesën KO46/23, dhe të njëjtëve iu kërkoi që të dorëzojnë përgjigjet e tyre në lidhje me komentet e pranuar, nëse kanë, deri më 12 prill 2023.
  15. Më 12 prill 2023, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata afat shtesë për dorëzimin e përgjigjeve në lidhje me komentet e pranuar.
  16. Në të njëjtën ditë, Ministria e Drejtësisë dorëzoi përgjigjen ndaj komenteve të palëve të interesuara.
  17. Më 13 prill 2023, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për miratimin e kërkesës për dhënien e afatit shtesë për dorëzimin e përgjigjeve ndaj komenteve, gjegjësisht deri më 20 prill 2023.
  18. Më 24 prill 2023, parashtruesit e kërkesës dorëzuan përgjigjet e tyre në lidhje me komentet e pranuar nga Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit dhe Grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!.
  19. Më 27 prill 2023, Gjykata njoftoi (i) parashtruesin e kërkesës; (ii) Presidenten; (iii) Kryetarin e Kuvendit; (iv) Kryeministrin; (v) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit; (vi) Avokatin e Popullit; si dhe (vii) Ministrinë e Drejtësisë për pranimin e përgjigjeve nga Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit dhe Grupi parlamentar i Lëvizjes

VETËVENDOSJE!. lidhur me kërkesën KO46/23, duke iu dorëzuar të njëjtëve edhe nga një kopje të këtyre përgjigjeve.

20. Më 27 dhjetor 2023, Gjykata pasi shqyrtoi Raportin e gjyqtarit raportues njëzëri vendosi për pranueshmërinë e kërkesës.
21. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
22. Më 17 prill 2024, Gjykata pasi shqyrtoi Raportin e gjyqtarit raportues njëzëri vendosi që shqyrtimin e tij ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
23. Më 20 qershor 2024, Gjykata vendosi që: (i) njëzëri, të deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, të konstatojë se pika 2.1 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 2 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, të konstatojë se pika 2.2 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 3 të nenit 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (iv) me gjashtë (6) vota për dhe tre (3) kundër, të konstatojë se pika 1.1 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me nenin 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës; (v) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, të konstatojë se pika 1.2 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës; (vi) me gjashtë (6) vota për dhe tre (3) kundër, të konstatojë se pika 1.4 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe paragrafin 3 të nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; (vii) me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, të shpallë të pavlefshëm, në tërësinë e tij, Ligjin nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme; si dhe (viii) njëzëri, të refuzojë kërkesën për masën e përkohshme.

### **Përmbledhja e fakteve**

24. Më 13 prill 2021, bazuar në propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Qeveria përmes Vendimit [Nr. 01/06] miratoi Koncept-dokumentin për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, përmes të cilit propozohej nxjerrja e një ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme.
25. Më 29 dhjetor 2021, Qeveria përmes Vendimit [Nr. 06/52] miratoi Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

26. Më 17 janar 2021, Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme iu shpërnda deputetëve të Kuvendit për shqyrtim.
27. Më 2 shkurt 2022, Komisioni i përhershëm për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Legjislacion), miratoi raportin e tij përkitazi me Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, duke i propozuar Kuvendit miratim e tij në parim.
28. Më 24 shkurt 2022, Kuvendi përmes Vendimit [Nr. 08-V-236], vendosi që miratimi në parim i Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme të shtyhet deri në pranimin e opinionit nga Komisioni i Venecias.
29. Më 4 mars 2022, Kryetari i Kuvendit, iu drejtua Komisionit të Venecias me kërkesën për dhënie të opinionit nëse Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme është hartuar konform standardeve evropiane dhe atyre ndërkombëtare. Komisioni i Venecias kërkesën për Opinionin e regjistroi me numër [CDL-AD\(2022\)014](#).
30. Më 20 qershor 2022, Komisioni i Venecias në mbledhjen plenare të 131-të miratoi Opinionin Nr. 1083/2022, [CDL-AD\(2022\)014](#) për Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme (në tekstin e mëtejshëm: **Opinionin e tij të parë** i Komisionit të Venecias).
31. Komisioni i Venecias në **Opinionin e tij të parë**, në parim, vlerësoi se Projektligji mund të rezultonte në shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, e cila përfshin zbatimin e drejtpërdrejtë të KEDNJ-së dhe merr parasysh standardet evropiane në lidhje me sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Bazuar në këtë vlerësim, Komisioni i Venecias ofroi vlerësimet e tij shpesh dhe rekomandimet në lidhje me Projektligjin, ndër tjerash, si në vijim:

(i) nuk është e sigurtë nëse “*krijimi i një organi të ri, siç është Byroja do ta bënte luftën kundër korrupsionit me të vërtetë më efektive – apo nëse do ta ndërlikonte më tepër të gjithë sistemin që tashmë përfshin një sërë organesh si Policia, Prokuroria, autoritetet doganore të Kosovës dhe Agjencia Kundër Korrupsionit.*” Sipas Komisionit të Venecias: “*Në çdo rast, duket qartë se sistemi i ri i verifikimit dhe konfiskimit duhet të kombinohet në një farë mënyre me sistemin ekzistues të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, i cili është në duart e Agjencisë Kundër Korrupsionit.*” (shih paragrafin 72 të Opinionit të parë);

(ii) një legjislacion i tillë i ndjeshëm ndaj të drejtave të njeriut, siç propozohet në projektligj, është i pranueshëm vetëm “*nëse ndërtohet mbi një mekanizëm të pavarur me të gjitha kompetencat dhe burimet e nevojshme për të luftuar efektivisht korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar.*” Në vijim të kësaj, Komisioni i Venecias gjeti se dispozitat aktuale të këtij Projektligji “*janë të pamjaftueshme në këtë drejtim*” (shih paragrafin 73 të Opinionit të parë);

(iii) projektligji, në formulimin e tij aktual, paraqet një numër të caktuar të mangësive dhe zbatimi i tij mund të rezultojë në shkelje të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe KEDNJ-në. Në vijim të këtij vlerësimi, Komisioni i Venecias ofroi rekomandimet thelbësore si në vijim:

- 1) të përkufizohet/formulohet interesi i përgjithshëm publik, synimi dhe qëllimit i ligjit të ri në mënyrë të saktë dhe shteruese;
  - 2) të shqyrtohet nevoja dhe dobia e themelimit të një organi të ri, Byrosë, dhe në rastet se vazhdohet me këtë qasje a) të sigurohen garanci të forta të pavarësisë së Byrosë dhe b) t'i sigurohet Byrosë një numër i mjaftueshëm i personelit të specializuar dhe me kompetenca adekuate;
  - 3) të përcaktohet saktë a) se sipas cilave kushte dhe mbi bazën e të cilave kritere Byroja duhet të mbledhë informata sipas detyrës zyrtare para fillimit të procedurës zyrtare të verifikimit; b) sipas cilave kushte mund dhe duhet të iniciohet procedura e verifikimit; dhe c) prioritetet për punën e Byrosë, duke siguruar që Byroja të fokusohet në rastet e profilit të lartë;
  - 4) të qartësohet se barra e provës i kalon palës në procedurë vetëm pasi organi kompetent (sipas projektligjit aktual, Byroja), të ketë paraqitur një propozim të arsyetuar dhe prova që tregojnë se ekziston të paktën gjasa për përvetësim të paligjshëm të pasurisë, në bazë të standardit civil të provës të vlerësimit të gjasave; dhe të përcaktohet më saktë standardi civil i provës i “*vlerësimit të gjasave*”, i cili sipas projektligjit aktual duhet të zbatohet nga gjykata;
  - 5) të vendosen garanci më të forta për të drejtat e njeriut të palës dhe të personave të tjerë, ndër të tjera; duke:
    - a) specifikuar se vendimi për iniciimin e procedurës së verifikimit të paktën t'i komunikohet palës në procedurë dhe t'i nënshtrohet mjetit juridik;
    - b) siguruar që deklaratat e bëra dhe dokumentet e detyrueshme të ofruara nga pala në procedurë civile nuk mund të përdoren kundër tij apo saj në një procedurë penale;
    - c) bërë të qartë se familjarët e palës targetohen vetëm si “*persona të tretë*”;
    - d) rishqyrtuar dispozitën që personat fizikë dhe juridikë mund të detyrohen nga gjykata të bashkëpunojnë me Byronë;
    - e) rregulluar si të bëhet identifikimi i “*palëve të treta që kanë interes juridik*” dhe cilat janë të drejtat e tyre në procedurën e verifikimit dhe konfiskimit;
    - f) të sigurohet që personat e përfshirë në konfiskim të mos privohen nga e gjithë pasuria; dhe
    - g) të garantohet kompensimin e dëmeve të pësuar nga pala në rast se procedura e konfiskimit përfundimisht rezulton e pasuksesshme;
  - 6) të vendoset një prag adekuat i provave për masat e përkohshme të sigurimit, duke bërë të qartë se masat e tilla mund të ndërmerren në procedurë civile edhe nëse është iniciuar hetim penal (shih paragrafi 74 i Opinionit të parë).
32. Më 14 korrik 2022, Kuvendi, pas miratimit të Opinionit të parë të Komisionit të Venecias dhe pas procedurës së **leximit të parë**, në prezencë të 61 (gjashtëdhjetë e një) deputetëve, me 58 (pesëdhjetë e tetë) vota për, asnjë kundër dhe 3 (tri) abstenime, e miratoi, në parim, Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Kuvendi në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit dërgoi Projektligjin për shqyrtim në Komisionin për Legjislacion. Ky komision themeloi një grup punues, i cili u ngarkua me përgatitjen e versionit të ri të Projektligjit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe në pajtim me rekomandimet e Opinionit të Parë të Komisionit të Venecias, të 20 qershorit 2022. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Ministria e Drejtësisë, në proces të hartimit të versionit të ri të projektligjit ishin përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, të Këshillit të Evropës, OSBE-së, UNDP-së dhe organizatave tjera.
33. Në të njëjtën datë, Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Integrim Evropian dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat

e Komuniteteve dhe Kthim (në tekstin e mëtejme: Komisionet e përhershme të Kuvendit), që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, të shqyrtojnë Projektligjin për Byronë Shtetërore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

34. Më 18 nëntor 2022, pas një procesi të rishikimit të Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme nga Kuvendi, për të adresuar gjetjet, vërejtjet dhe rekomandimet e Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, Kryetari i Kuvendit, iu drejtua sërish Komisionit të Venecias, për të marrë opinion pasues nëse Projektligji në fjalë ishte hartuar konform Opinionit të parë të Komisionit të Venecias.
35. Më 19 dhjetor 2022, Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij plenare të 133-të miratoi Opinionin Pasues Nr. 1113/2022, [CDL-AD\(2022\)052](#) (në tekstin e mëtejme: **Opinion i dytë i Komisionit të Venecias**) për Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.
36. Komisioni i Venecias arriti në përfundimin se Projektligji i rishikuar nga Kuvendi paraqet “një përmirësim të ndjeshëm në krahasim me tekstin e mëparshëm.” Sipas Komisionit të Venecias: “Shumica e problemeve më serioze të identifikuar në opinionin e Komisionit të Venecias [Opinionin e parë] ishin adresuar, ndër të tjera, (i) paraqitja e garancive për pavarësinë e Byrosë, dhe plotësimin e saj me një numër të mjaftueshëm të punonjësve të specializuar dhe me kompetenca të duhura; (ii) përcaktimin më të saktë të parakushteve për inicimin e procedurës së verifikimit; (iii) përcaktimin më të qartë të dispozitave lidhur me barrën e provës; (iv) përmirësimin e garancive të të drejtave të njeriut të atyre që janë të përfshirë në procedurë; dhe (v) paraqitjen e një pragu të përshtatshëm të të provuarit për masat e përkohshme të sigurisë.
37. Megjithatë, Komisioni i Venecias në **Opinionin e tij të dytë**, vuri në dukje se “ende kishte vend për përmirësime” dhe u rekomandoi autoriteteve të Republikës së Kosovës, që të shqyrtojnë disa çështje specifike gjatë hartimit të versionit përfundimtar të këtij Projektligji. Në Opinionin e tij të dytë, Komisioni i Venecias ofroi rekomandimet si në vijim:
  - a) të përfshihet në tekst se “pasuri e pajustificueshme” janë ato pasuri që “nuk janë në përputhje me të ardhurat e ligjshme dhe origjina e të cilave nuk provohet si e ligjshme”;
  - b) të sqarohet nëse “institucionet apo ndërmarrjet publike” përfshijnë edhe institucionet e ndërmarrjet e huaja apo vetëm ato kosovare;
  - c) të sigurojë një mekanizëm kundër-blokim për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë;
  - d) të sigurohet një standard i provave për ta arsyetuar fillimin e procedurës;
  - e) të qartësojë mekanizmin që garanton që deklaratat e bëra dhe dokumentet e ofruara detyrimisht nga pala në procedurë civile nuk mund të përdoren kundër tyre në procedurë penale; dhe
  - f) të konsiderojë shtimin e një dispozite që do të mbulonte situatat kur procedurat nga Byroja rezultojnë të pabazuara, duke paraparë mundësinë e shkurtimit të çështjes duke tërhequr rastin (paragrafi 34 i Opinionit të dytë).
38. Më 23 dhjetor 2022, Komisioni për Legjislacion i Kuvendit, miratoi raportin e tij përkitazi me Projektligjin për Byronë Shtetërore, duke i propozuar Kuvendit dhe Komisioneve të përhershme, 35 (tridhjetë e pesë) amendamente për Projektligjin për Byronë Shtetërore. Amendamentet e propozuara, ndër të tjera, përfshijnë ndryshimet si në vijim:



(i) **Amendamenti 1** (një) zëvendësoi shprehjen e “pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme” me termin “pasurisë së pajustificueshme”;

(ii) **Amendamenti 2** (dy) në nenin 2 të Projektligjit për Byronë Shtetërore eliminoi nga fushëveprimi i ligjit “personat e ekspozuar politikisht dhe anëtarët e tyre të familjes”;

(iii) **Amendamenti 3** (tre) në nenin 3 të Projektligjit për Byronë Shtetërore ndryshoi përkufizimet si në vijim:

a. “Komisioni mbikëqyrës” - nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen Agjencisë kundër Korrupsionit i Kuvendit, në “Komisionin përkatës të themeluar sipas nenit 10 të këtij ligji” që nënkupton komisionin me përbërjen si në vijim: (i) një gjyqtar i Gjykatës Supreme, në cilësinë e kryesuesit; (ii) një zëvendës të Avokatit të Popullit, të caktuar nga ai; (iii) Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; (iv) Auditori i Përgjithshëm; dhe (v) Drejtori i Njësisë për Inteligjencë Financiare;

b. “Vlerësimi i gjasave” nga përkufizimi si “standard i të provuarit kur diçka është e mundshme, ose që ka më shumë gjasa të jetë e mundshme sesa jo” në përkufizimin “standard i të provuarit kur gjykata bazuar në prova, beson se një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur se sa jo;

c. “Person zyrtar” – eliminimin e anëtarëve të familjes dhe personave të ekspozuar politikisht (**Amendamenti dymbëdhjetë** po ashtu eliminon referencën në anëtarët e familjes në nenin 17 të Ligjit për Byronë Shtetërore);

d. “Palët e treta” – nga përkufizimi “personat tek të cilët pasuria e personit është bartur në çfarëdo forme” në përkufizimin “çdo person fizik apo juridik tek të cilët pasuria e personit zyrtar është bartur, apo që ka ose mund të ketë interes juridik mbi pasurinë e palëve në procedurë”;

(iv) **Amendamenti 4** (katër) në nenin 6 të Projektligjit për Byronë Shtetërore specifikoi strukturën organizative të Byrosë Shtetërore, e cila përderisa me versionin paraprak të projektligjit ishte objekt i organizimit të brendshëm përmes një rregulloreje të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, përmes këtij amendamenti u përcaktuan të paktën katër (4) njësi të domosdoshme të Byrosë Shtetërore, e cila strukturë organizative mbeti të definohet më detajisht përmes rregullores së miratuar nga Komisioni Mbikëqyrës;

(v) **Amendamenti 5** (pesë) në nenin 8 të Projektligjit për Byronë Shtetërore riformuloi disa nga kompetencat e Byrosë Shtetërore, por në esencë mbetën të njëjtat, si dhe u shtua kompetenca e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;

(vi) **Amendamenti 6** (gjashtë) ndryshoi nenin 15 të Projektligjit për Byronë Shtetërore dhe e rinumëroi në nenin 10, ku e specifikoi përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës me anëtarë nga 5 (pesë) institucione shtetërore, shtoi kompetencat e tij dhe mënyrën e vendimmarrjes dhe kuorumin në këtë komision;

(vii) **Amendamenti 7** (shtatë) ndryshoi nenin 10 të Projektligjit për Byronë Shtetërore duke e rritur mandatin e Drejtorit të Përgjithshëm nga 5 (pesë) në 7 (shtatë) vjet, por pa të drejtë të rizgjedhjes, në raport me versionin paraprak kur kishte të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat, si dhe u shtuan: (i) ndalesa e mos ngrirjes së ndonjë pozite në sektorin publik; dhe (ii) e drejta e përfitimit në një pagë ekuivalente me pagën e fundit deri në 2 (dy) vite pas përfundimit të mandatit me kusht që në të njëjtën kohë nuk përfiton pagë nga sektori publik apo privat;

(viii) **Amendamenti 8** (tetë) ndryshoi nenin 12 të Projektligjit për Byronë Shtetërore, i cili përcakton procedurën e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm, ashtu që në rast të dështimit të procedurës së përzgjedhjes së kësaj pozite nga Kuvendi në dy raunde radhazi, atëherë Komisioni Mbikëqyrës shpallë konkursin dhe zhvillon procedurat sipas këtij neni me përjashtimin e vetëm se vetë Komisioni Mbikëqyrës në fund të procesit e përzgjedh kandidatin me më së shumti pikë si Drejtor të Përgjithshëm;

- (ix) **Amendamenti 9** (nëntë) në nenin 14 të Projektligjit për Byronë Shtetërore përcaktoi kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm;
- (x) **Amendamenti 10** (dhjetë) në nenin 13 të Projektligjit për Byronë Shtetërore për dallim nga versioni paraprak i ligjit ku përcaktohej se Drejtori i Përgjithshëm mund të shkarkohet me shumicën e votave të gjithë deputetëve nga Kuvendi, ky amendament specifikoi rastet se Komisioni mbikëqyrës mund të iniciojë procedurën e shkarkimit të tij, gjë e cila ndodhë njësoj si propozimi i mëhershëm me shumicën e votave të të gjithë deputetëve;
- (xi) **Amendamenti 11** (njëmbëdhjetë) në nenin 16 të Projektligjit për Byronë Shtetërore specifikoi institucionet por pa u kufizuar në: Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencinë Tatimore të Kosovës, Doganën e Kosovës, Bankën Qendrore të Kosovës, Njësinë për Inteligjencë Financiare, Noterët dhe Përmbaruesit Privat, të cilat janë të obliguara që t'i ofrojnë informata Byrosë Shtetërore me rastin e inicimit të procedurës, gjë e cila mungonte në versionin paraprak të ligjit, si dhe nuk e kufizoi pranimin e informatave për inicimin e procedurës së verifikimit të pasurisë vetëm sipas detyrës zyrtare dhe informatave të fizikë dhe juridikë që ushtrojnë autorizime publike vendore dhe ndërkombëtare, por mundëson edhe pranimin e informatave nga personat fizikë dhe juridik nga burime të ndryshme;
- (xii) **Amendamenti 13** (trembëdhjetë) në nenin 18 të Projektligjit për Byronë Shtetërore shtoi se detyrimi për bashkëpunim i personave fizikë dhe juridik shtrihet deri në atë masë që sa nuk cenohet e drejta në privatësi dhe e drejta për mos inkriminim, dispozitë që mungonte në versionin paraprak të projektligjit;
- (xiii) **Amendamenti 14** (katërbëdhjetë) në nenin 19 të Projektligjit për Byronë Shtetërore hoqi të drejtën e përfaqësimit për palët e treta;
- (xiv) **Amendamenti 15** (pesëmbëdhjetë) pas nenit 19 të Projektligjit për Byronë Shtetërore shtoi një nen të ri për periudhën e verifikimit të pasurisë, i cili përcakton se verifikimi i pasurisë bëhet për pasurinë e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar, dhe përjashtimisht kjo mund të zgjerohet edhe për periudhën që personi zyrtar nuk ushtron funksion publik por periudhë e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 5 (pesë) vite pas përfundimit të këtij funksioni;
- (xv) **Amendamenti 16** (gjashtëmbëdhjetë) në nenin 20 të Ligjit për Byronë Shtetërore zgjati afatin kohor prej 30 (tridhjetë) në 60 (gjashtëdhjetë) ditë kur pala ka të drejtë që pas listimit të pasurisë në procedurën e verifikimit, që të ofrojë të dhëna dhe prova për të justifikuar pasurinë e listuar;
- (xvi) **Amendamenti 17** (shtatëmbëdhjetë) në nenin 21 të Projektligjit për Byronë Shtetërore shtoi standardin për caktimin e masës së sigurisë bazuar “*në prova të mbledhura në procedurën e verifikimit*”, e cila mungonte në versionin paraprak të projektligjit;
- (xvii) **Amendamenti 18** (tetëmbëdhjetë) në nenin 22 të Projektligjit për Byronë Shtetërore zgjati afatin kohor nga 24 (njëzet e katër) në 72 (shtatëdhjetë e dy) orë për gjykatën që nga pranimi i propozimit për masë të sigurisë, si dhe zgjati afatin prej 24 (njëzet e katër) në 48 (dyzet e tetë) orë për zyrtarin e Byrosë Shtetërore kundër aktvendimit të gjykatës kompetente për refuzimin e masës së sigurisë;
- (xviii) **Amendamenti 19** (nëntëmbëdhjetë) në nenin 23 të Projektligjit për Byronë Shtetërore zgjati afatin kohor nga 5 (pesë) në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për kundërshtimin e masës së përkohshme personit që i është caktuar ajo masë;
- (xix) **Amendamenti 20** (njëzet) në nenin 24 të Projektligjit për Byronë Shtetërore zëvendëson disa fjalë në versionin e gjuhës angleze;
- (xx) **Amendamenti 21** (njëzet e një) në nenin 25 të Projektligjit për Byronë Shtetërore zgjati afatet kohore për parashtrimin e ankesës ndaj aktvendimit për vendosjen e masës së përkohshme, respektivisht parashtrimin e përgjigjes në ankesë, nga 5 (pesë) në 15

(pesëmbëdhjetë) ditë për palën e pakënaqur, gjegjësisht palën kundërshtare, si dhe afatin e gjykatës së shkallës së parë për vendosjen sipas ankesës nga 5 (pesë) në 7 (shtatë) ditë prej ditës së arritjes së përgjigjes në ankesë;

(xxi) **Amendamenti 22** (njëzet e dy) harmonizoi versionet gjuhësore të nenit 27 të Projektligjit për Byronë Shtetërore me gjuhën shqipe;

(xxii) **Amendamenti 23** (njëzet e tre) në nenin 28 të Projektligjit për Byronë Shtetërore zgjati afatin kohor për parashtrimin e kundërshtimit ndaj propozimit për konfiskim në gjykatën e shkallës së parë prej 15 (pesëmbëdhjetë) në 30 (tridhjetë) ditë, si dhe riformuloi por pa i kufizuar arsyet e parashtrimit të këtij propozimi nga 6 (gjashtë) arsye sa ishin në versionin paraprak në 3 (tre) të tilla. Ky amendament po ashtu zgjati edhe afatin kohor të Byrosë Shtetërore për t'iu përgjigjur kundërshtimit në fjalë prej 3 (tri) ditëve në 7 (shtatë) ditë, afat i cili u ndryshua edhe për parashtrimin e përgjigjes në ankesë kundër aktvendimit për propozim të konfiskimit në gjykatën e shkallës së dytë, si dhe afatin kohor të vetë gjykatës për të vendosur sipas kundërshtimit së lartcekur prej 7 (shtatë) në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë;

(xxiii) **Amendamenti 24** (njëzet e katër) në nenin 30 të Projektligjit për Byronë, ndryshoi bazat për përjashtimin e publikut, të cilat ishin kufizuar vetëm kur përmenden rrethanat nga jeta intime private e palëve, në bazat si në vijim: *“rrethanat e posaçme që përfshijnë por nuk kufizohen në sigurinë kombëtare, jetën private, dhe kur këto rrethana janë më të rëndësishme se interesi publik”*;

(xxiv) **Amendamenti 25** (njëzet e pesë) në nenin 31 të Projektligjit për Byronë ndryshoi standardin e vlerësimit të gjasave nga *“standardi që personi në procedurë duhet të justifikojë pasurinë e tij pas paraqitjes së propozimit në gjykatë”* në *“standardin që së pari Byroja i paraqet gjykatës provat për përmbushjen e standardit civil të vlerësimit të gjasave se pasuria që është objekt i propozimit ka prejardhje të pajustificuar dhe se pas këtij propozimi, pala në procedurë ka barrën e provës që të justifikojë pasurinë e tij”*;

(xxv) **Amendamenti 26** (njëzet e gjashtë) në nenin 36 të Projektligjit për Byronë, paragrafin ku u përcaktua që ndaj aktvendimit të gjykatës për tërheqjen e propozimit nuk është e lejuar ankesa, e ndryshoi duke përcaktuar se në rast të tërheqjes nga propozimi, rasti konsiderohet çështje e gjykuar, dhe si rezultat i kësaj, **amendamenti 27** (njëzet e shtatë) fshiu dispozitën ligjore (nenin 37) ku ishin përcaktuar dy rrethanat e vetme që lejonin parashtrimin e serishëm të propozimit të tërhequr;

(xxvi) **Amendamenti 28** (njëzet e tetë) riformuloi disa fjalë në nenin 39 të Projektligjit për Byronë duke përcaktuar që të mos kufizohen shkaqet për refuzimin e propozimit për konfiskim;

(xxvii) **Amendamenti 29** (njëzet e nëntë) në nenin 40 të Projektligjit për Byronë adreson çështjen pasurisë zëvendësuese në rastet kur nuk është e mundur të konfiskohet pasuria e propozuar për konfiskim;

(xxviii) **Amendamenti 30** (tridhjetë) në nenin 43 të Projektligjit për Byronë Shtetërore zgjati afatet kohore për ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nga 15 (pesëmbëdhjetë) në 30 (tridhjetë) ditë, respektivisht përgjigjen në ankesë prej 7 (shtatë) në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë;

(xxix) **Amendamenti 31** (tridhjetë e një) në nenin 45 të Projektligjit për Byronë Shtetërore shton fjalën *“përkatës”* pas fjalës *“ligj”*;

(xxx) **Amendamenti 32** (tridhjetë e dy) në nenin 58 të Projektligjit për Byronë Shtetërore adreson të drejtat e palëve me interes juridik dhe specifikon procedurën e përfshirjes së tyre në rastin kur ata e kanë interesin e tillë;

(xxxi) **Amendamenti 33** (tridhjetë e tre) në nenin 60 të Projektligjit për Byronë Shtetërore përcakton efektet e procedurave tjera në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, respektivisht qartëson rastet e pezullimit të procedurës së konfiskimit nga gjykata në rast të zhvillimit të një procedure penale;

(xxxii) **Amendamenti 34** (tridhjetë e katër) në nenin 61 të Projektligjit për Byronë Shtetërore qartëson se çështja e kompensimit të palëve në rast të pezullimit të pasuksesshëm të procedurës së konfiskimit, kjo rregullohet nga Ligji përkatës për Marrëdhëniet e Detyrimeve;

(xxxiii) **Amendamenti 35** (tridhjetë e pesë) pas nenit 65 të Projektligjit për Byronë Shtetërore përcakton dispozitat kalimtare për funksionalizimin e këtij institucioni, ku ndër të tjera, përcakton se jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Kryetari i Gjykatës Themelore cakton një nga gjyqtarët e kësaj gjykatë kryesues të Komisionit Mbikëqyrës, i cili brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit, e konstituton Komisionin, i cili më pas jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga konstituimi fillon procedurën e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm, i cili brenda 6 (gjashtë) muajve nga zgjedhja e tij kompletton stafin dhe funksionalizon Byronë Shtetërore, rolin e së cilës do ta ushtrojë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit deri në funksionalizimin e saj.

39. Në të njëjtën ditë, Komisioni për Integrim Evropian i Kuvendit shqyrtoi Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe amendamentet e propozuara dhe vlerësoi se të njëjtat *“nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian”*.
40. Më 27 janar 2023, Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrtoi Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe vlerësoi se (i) i njëjti përmban kosto shtesë buxhetore por të përbalueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës; dhe se (ii) amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
41. Më 31 janar 2023, raporti përfundimtar i Komisionit për Legjislacion, së bashku me 35 (tridhjetepesë) amendamentet e propozuara iu shpërnda të gjithë deputetëve të Kuvendit, me rekomandimin që të miratohet Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, me amendamentet e propozuara.
42. Kuvendi, pasi pranoi raportin përfundimtar nga Komisioni për Legjislacion, njoftoi dhe ftoi deputetët për seancën plenare të radhës, ku ndër të tjera, si pikë e rendit të ditës ishte edhe leximi i dytë i Projektligjit për Byronë Shtetërore.
43. Më 9 shkurt 2023, Kuvendi, **pas leximit të dytë**, me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, gjegjësisht, Ligjin e kontestuar.
44. Më 14 mars 2023, Komisioni i Venecias, publikoi Informatën përcjellëse të Opinionit pasues Nr. 1113/2022, [CDL-AD\(2022\)052](#), të miratuar në mbledhjen plenare të 134-të (në tekstin e mëtejshëm: Informata përcjellëse) në lidhje me Ligjin e kontestuar.
45. Në Informatën e tij të lartcekur përcjellëse, Komisioni i Venecias vlerësoi se versioni i fundit, i plotësuar dhe ndryshuar ka adresuar rekomandimet e Komisionit në Opinionin tij të e dytë, të cilat përfshijnë:  
*“(i) duke përcaktuar se “pasuri e pajustificueshme” është ajo e cila “nuk është në përputhje me të ardhurat e ligjshme dhe origjina e së cilës nuk dëshmohet si e ligjshme”;*  
*(ii) duke sqaruar se “institucionet apo ndërmarrjet publike” përfshijnë vetëm institucionet dhe ndërmarrjet kosovare;*

- (iii) duke paraparë një mekanizëm kundër bllokimit për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë;
- (iv) krijimin e një standardi provues për të justifikuar fillimin e procedurës;
- (v) qartësimin e mekanizmit që siguron se deklaratat e dhëna dhe dokumentet e siguruar detyrimisht nga pala në procedurë civile nuk mund të përdoren kundër tyre në procedurë penale; dhe
- (vi) i ofron mundësi Byrosë që të shkurtojë procedurën gjyqësore duke tërhequr rastin në situata të caktuara.”

## **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

46. Parashtruesit e kërkesës, kontestojnë Ligjin e kontestuar dhe në mënyrë specifike pretendojnë se nenet: 2 (Fushëveprimi), 4 (Themelimi), 9 (Statusi dhe Pavarësia), 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm), 18 (Inicimi i procedurës) 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit), 20 (Detyrimi për bashkëpunim) dhe 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me nenet: 4 [Ndarja e pushteteve]; 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 46 [Mbrojtja e Pronës], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës; si dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 12 të KEDNJ-së dhe nenet 2 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
47. Parashtruesit e kërkesës, në thelb pretendojnë mospërputhshmërinë:
- (i) e neneve: 2 (Fushëveprimi) dhe 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) të Ligjit të kontestuar me nenet: 3, 7 dhe 24 të Kushtetutës;
  - (ii) e neneve: 4 (Themelimi) dhe 9 (Statusi dhe Pavarësia) të Ligjit të kontestuar me nenet: 4 dhe 142 të Kushtetutës;
  - (iii) nenit 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar me parimin e sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit të garantuara me nenet: 3 dhe 7 të Kushtetutës;
  - (iv) neneve: 18 (Inicimi i procedurës), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) dhe 20 (Detyrimi për bashkëpunim) të Ligjit të kontestuar me nenet: 46 dhe 55 të Kushtetutës;
  - (v) e nenit 69 (Funksionalizimi i Byrosë) të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me funksionalizimin e plotë të Byrosë Shtetërore, me nenin 142 të Kushtetutës;
48. Në vijim, parashtruesit e kërkesës ofrojnë argumentet e tyre mbështetëse në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës dhe kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme.
49. Gjykata në vijim do të paraqes pretendimet e parashtruesve të kërkesës, që ndërlidhen me dispozitat e lartcekura të Ligjit të kontestuar, për të cilat ata pretendojnë se janë në mospërputhshmëri me dispozitat e Kushtetutës, përkatësisht: (i) pretendimin për mospërputhshmërinë e neneve **2 dhe 22** të Ligjit të kontestuar me nenet 3, 7 dhe 24 të Kushtetutës; (ii) pretendimet për mospërputhshmërinë e neneve **4 dhe 9** të Ligjit të kontestuar me nenet 4 dhe 142 të Kushtetutës; (iii) pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit **15** të Ligjit të kontestuar me parimin e sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit; (iv) pretendimet për mospërputhshmërinë e neneve **18, 19 dhe 20** të Ligjit të kontestuar me nenet 46 dhe 55 të Kushtetutës; dhe (v) pretendimet tjera në lidhje me Ligjin e kontestuar;

(vi) pretendimet në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës; dhe (vii) kërkesën për masë të përkohshme.

(i) *Pretendimet për mospërputhshmërinë e neneve 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar me nenet 3, 7 dhe 24 të Kushtetutës*

50. Në lidhje me nenet 2 (Fushëveprimi) dhe 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës ngritin pretendime të cilat ndërlidhen me (i) parimin e sundimit të ligjit, që përfshinë çështjen e ligjshmërisë, sigurisë juridike, ndalimit të arbitraritetit dhe mosdiskriminimit; (ii) çështjen e barrës së provës; (iii) parimin e ndalimit të retroaktivitetit; (iv) kolizion ligjor; dhe (v) barazinë para ligjit.
51. Në lidhje me të parën, përkatësisht pretendimet që ndërlidhen me **parimin e sundimit të ligjit** të përcaktuar me nenin 7 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se parimi i sundimit të ligjit dhe elementet konstituive të tij, janë të përcaktuara në Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit, të miratuar nga Komisioni i Venecias (shih, Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, [CDL-AD \(2016\)007-e](#), i miratuar më 18 mars 2016) dhe që përfshijnë parimet që ndërlidhen me (i) ligjshmërinë; (ii) sigurinë juridike; (iii) ndalimin e arbitraritetit; (iv) qasjen në drejtësi para gjykatave të pavarura dhe të paanshme; (v) respektimin e të drejtave të njeriut; dhe (vi) mosdiskriminim dhe barazinë para ligjit.
52. Në lidhje me ligjshmërinë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “[...] e para, **elementi i ligjshmërisë** - i cili përfshin edhe procesin paraprak të miratimit të ligjit, në rrethanat e rastit konkret, nuk është zbatuar, për arsye se procedura që i ka paraprirë miratimit të tij ka qenë jotransparente, e papërgjegjshme dhe jodemokratike.”
53. Parashtruesit e kërkesës pretendimin e tyre për cenim të sigurisë juridike, e ndërlidhin edhe me nenin 19 të Ligjit të kontestuar, duke specifikuar se: “**Ligji kontestues, cenon sigurinë juridike**, si njëri nga elementet kyç të sundimit të ligjit sepse nuk parashikon kushtet konkrete për iniciimin e procedurës (neni 19), vërejtje e cila ishte dhënë edhe në opinionet e Venecias dhe nuk ishte adresuar.”
54. Në vijim, parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se Ligji i kontestuar: “[...] përligj një **procedurë arbitrare** e cila ka për pasojë cenimin e të drejtave themelore kushtetuese të subjekteve që iu drejtohet, duke iu pamundësuar të njëjtëve qasjen në drejtësi – në fazën e procedurës së shqyrtimit administrativ (në Byro), meqë nuk iu ka dhënë asnjë mundësi ankese në këtë institucion ndaj vendimeve dhe veprimeve të tij, të cilat prekin interesin juridik të tyre.
55. Në lidhje me të dytën, përkatësisht pretendimin e tyre që ndërlidhet me **barrën e provës**, parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, theksojnë se: “**Ligji i kontestuar, pavarësisht titullit për “verifikimin” në thelb duke iu referuar përgjegjësi të këtij institucioni, paraqet një ligj për “hetimin” dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme në procedurë civile dhe zbatohet vetëm ndaj zyrtarëve publik dhe palëve të treta (lidhur me zyrtarët publik)**”. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës vënë në pah se: “[...] pasuria e cila i nënshtrohet verifikimit është e pajustificueshme deri sa nuk provohet nga ana palës se e njëjta është e ligjshme dhe barra për të provuar ligjshmërinë e fitimit të pasurisë - objekt i verifikimit, i takon vetëm palës - subjektit - kundër të cilit zhvillohet procedura”.

56. Në lidhje me të tretën, përkatësisht pretendimin që ndërlihet me **parimin e retroaktivitetit**, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“Ligji kontestues, zbatohet në mënyrë retroaktive duke rënë ndesh edhe me praktikën e Opinionit të Venecias (par. 62 i Listës së Kontrollit), sipas të cilës, përveç ndalimit të retroaktivitetit të legjislacionit penal, edhe në fushën e të drejtës civile dhe administrative, veprimi retroaktiv i ligjit ndikon negativisht në të drejtat dhe interesat ligjore të subjektit në procedurë.”*
57. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se: *“[...] në dispozitat e nenit 2 të tij, në mënyrë tërësisht arbitrare ka vendosur veprimin retroaktiv kohor - 17 shkurt 2008, si një periudhë kohore nga e cila do të zbatohet verifikimi i pasurisë së personave zyrtarë, duke mos e përcaktuar asnjë kriter se pse nuk zbatohet ndaj zyrtarëve publik që kanë shërbyer para kësaj periudhe, duke mos vendosur asnjë qartësi juridike për kategorinë e zyrtarëve të cilët kanë punuar para kësaj periudhe dhe kanë vazhduar punën pas 17 shkurt 2008, për kushtet dhe rrethanat se si do të bëhet vlerësimi dhe verifikimi i pasurisë, duke mos vënë asnjë kriter ligjor se pse, nga njëra anë, do të zbatohet konfiskimi në procedure civile dhe nga ana tjetër, do të zbatohet "vlerësimi i gjasave" si standard i të provuarit, i cili nuk është i aplikueshëm në procedurën civile”.*
58. Në lidhje me të katërtën, përkatësisht pretendimin që ndërlihet me **kolizionin ligjor**, parashtruesit e kërkesës theksojnë se bazuar në paragrafin 2 të nenit 2 të Ligjit të kontestuar, ky ligj zbatohet ndaj pasurisë së pajustificueshme të fituar: (i) përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjekteve nga paragrafi 1 i këtij neni, nga data 17 shkurt 2008; dhe (ii) brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni pushojnë së ushtruar funksionin e tyre, ndërsa në bazë të paragrafit 3 të nenit 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar, periudha e verifikimit nuk mund të jetë më gjatë se pesë (5) vite pas përfundimit të funksionit publik të personit zyrtar, andaj, të njëjtit pretendojnë se ka kolizion ligjor në mes të paragrafit 2 të nenit 2 dhe paragrafit 3 të nenit 22 të Ligjit të kontestuar, i cili *“[...] ka për pasojë cenimin e sigurisë juridike dhe cenimit e parimit të ligjshmërisë në procedurë”.*
59. Në lidhje me të pestën, përkatësisht pretendimin që ndërlihet me **barazinë para ligjit**, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se neni 2 i Ligjit të kontestuar bie ndesh edhe me nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës për shkak se: *“Duke u zbatuar vetëm ndaj një pjesë të caktuar të qytetarëve (zyrtarëve publik), dhe jo ndaj të gjithë qytetarëve pa dallim, përbën shkelje edhe të nenit 24 (Barazia para Ligjit) të Kushtetutës dhe instrumenteve të detyrueshme ndërkombëtare [...]”,* gjegjësisht, neneve 2 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenit 14 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së, të cilat dispozita edhe i citojnë në kërkesën e tyre.
60. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu konsiderojnë se: *“Derisa ligji i kontestuar "mëton" të paraqes një mjet të ri në "luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit", kufizohet vetëm në nivel të zyrtarëve publik, duke paraqyktuar se këto dukuri ndodhin "vetëm" nga këta të fundit dhe vetëm në "terrenin e funksioneve publike", dhe jo nga personat e tjerë, duke mundësuar kështu, amnisti të plotë ndaj personave të tjerë jozyrtarë që të mos jenë subjekt i "verifikimit të pasurisë", edhe nëse të njëjtën e kanë qartazi të pajustificueshme, si dhe të ofroj po ashtu, amnisti për [cilindo] zyrtar publik nga fushëveprimi i tij, nëse shpërputhja mes të hyrave dhe pasurisë së tij nuk e tejkalon vlerën prej njëzet e pesë mijë (25,000) euro, pa ofruar asnjë standard ligjor se mbi cilët indikatorë shkencor, profesional dhe objektiv, do të "matet" përkatësisht vlerësohet masa pasurore e subjektit në verifikim.”*

61. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës nënvizojnë se: *“[...] pasuria e subjektit në procedurë, do të vlerësohet në bazë të vlerës së tregut në kohën e verifikimit, pavarësisht nëse pasuria e subjektit është në pronësi të tij, nga një periudhë e mëhershme në të cilën vlera e saj ishte shumëfish me e vogël. Një trajtim i tillë, qartazi është i pabazuar, i papranueshëm dhe paraqet mundësi arbitrareteti të pakufizuar për institucionin që e zhvillon këtë procedure.”*
- (ii) *Pretendimet për mospërputhshmërinë e neneve 4 dhe 9 të Ligjit të kontestuar me nenet 4 dhe 142 të Kushtetutës*
62. Përkitazi me nenin 4 (Themelimi) të Ligjit të kontestuar, i cili parasheh themelimin e Byrosë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificuar (në tekstin e mëtejme: Byroja Shtetërore), parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“[...] ky institucion themelohet si një organ i pavarur (neni 4), publik dhe i specializuar, mirëpo si i tillë nuk i përmbahet kriterëve të nenit 142 të Kushtetutës”*. Për më tepër, të njëjtit konsiderojnë se bie në kundërshtim edhe me nenin 38 (Themelimi i agjencive të pavarura) të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (në tekstin e mëtejme: Ligji për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura) sepse, sipas tyre, *“[...] Agjencitë e pavarura themelohen me ligj në bazë të nenit 142 të Kushtetutës dhe nuk janë pjesë e kompetencave të pushtetit ekzekutiv të Qeverisë dhe i shërbejnë Kuvendit për ushtrimin e mbikëqyrjes/kontrollit parlamentar të specializuar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative”*.
63. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se Byroja Shtetërore: *“[...] nuk është një institucion që i shërben Kuvendit për ushtrimin e mbikëqyrjes/kontrollit parlamentar. Si i tillë as nuk mund të hyj në kuadrin e institucioneve të pavarura nga neni 142 i Kushtetutës, e as nuk është pjesë e institucioneve të drejtësisë nga kapitulli VII i Kushtetutës (Sistemi i drejtësisë)”*. Lidhur me këtë, parashtruesit theksojnë se Byroja Shtetërore *“[...] ka funksion prokurorial sepse heton dhe verifikon pasurinë e personave zyrtar”* dhe se pavarësisht përkufizimit në nenin 4 të Ligjit të kontestuar si një *“organ i pavarur dhe i specializuar”*, në asnjë dispozitë të tij nuk përmban kushtet, kriteret dhe kualifikimet e zyrtarëve që punojnë në të. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se nuk është përfillur rekomandimi i Komisionit të Venecias për rëndësinë e rregullimit të statusit dhe kualifikimeve të personelit të këtij institucioni, i cili *“[...] domosdoshmërisht duhet të jetë i specializuar”*.
64. Përkitazi me nenin 9 (Statusi dhe Pavarësia) të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se zyrtarët e Byrosë Shtetërore konsiderohen zyrtarë publik në pajtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“[...] ky është përkufizimi i parë dhe i vetëm lidhur me personelin e këtij institucioni, përkufizim i cili qartazi është i pamjaftueshëm, duke lënë mundësi arbitrareteti në punësimin e tyre dhe duke mos përcaktuar asnjë standard dhe kriter minimal të kualifikimit dhe përvojës së tyre profesionale”*.
65. Për pasojë, parashtruesit konsiderojnë se nenet 4 dhe 9 të Ligjit të kontestuar cenojnë edhe nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, pasi që këtyre zyrtarëve sipas paragrafit 3 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar *“[...] iu është njohur (pavarësia e plotë dhe mbrojtja) gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare.”* Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës theksojnë se sipas Kushtetutës, vetëm bartësit e institucioneve qendrore të qeverisjes, anëtarët e institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve tjera kushtetuese gëzojnë imunitet, andaj, sipas tyre, *“[...] mospërmbushja e standardeve kushtetuese nga neni 142 i Kushtetutës nga ana e këtij institucioni të themeluar me ligjin e kontestuar,*



*nënkupton pamundësi kushtetuese dhe ligjore që t'iu ofrohet imunitet funksional zyrtarëve të këtij institucioni.”*

*(iii) Pretendimet për mospërputhshmërinë e **nenit 15** të Ligjit të kontestuar me parimin e sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit*

66. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përmbajtja e nenit 15 (Procedura e Zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton procedurën e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, është: “[...] *kontradiktore dhe cenon garancionet kushtetuese të Kuvendit*” sepse, nga njëra anë, autorizon Komisionin Mbikëqyrës nga neni 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) i Ligjit të kontestuar që të zhvillojë procedurën e rekrutimit për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm dhe t'i propozojë Kuvendit kandidatët e suksesshëm, ndërsa në anën tjetër, në rast të dështimit të këtij procesi, paragrafi 16 i nenit 15 të Ligjit të kontestuar, autorizon Komisionin që të shpallë konkursin dhe të zhvillojë procedurat, duke përfshirë, zgjedhjen e kandidatit për Drejtorin e Përgjithshëm.
67. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kjo zgjidhje juridike përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, sundimit të ligjit dhe kompetencës zgjedhore të Kuvendit për këtë pozitë. Në këtë drejtim, të njëjtit konsiderojnë se “[...] *një zgjidhje e tillë, në një situatë hipotetike, paraqet rast ideal për të abuzuar dhe tallur institucionin ligjvënës përballë propozimit nga Komisioni të kandidaturave jo serioze, jo kredibile dhe jo profesionale, me qëllimin e dështimit të procedurës në Kuvend dhe arritjen e situatës kur Komisioni rekruton dhe vendos përfundimisht për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm.*” Në këtë kontekst, parashtruesit theksojnë se neni 17 (Përfundimi i mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm) i Ligjit të kontestuar, i cili parasheh procedurën e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm, fare nuk e parashikon mundësinë e shkarkimit në rast të emërimit në këtë lloj procedure.

*(iv) Pretendimet për mospërputhshmërinë e neneve **18, 19 dhe 20** të Ligjit të kontestuar me nenet 46 dhe 55 të Kushtetutës*

68. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nenet 18 (Inicimi i procedurës), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) dhe 20 (Detyrimi për bashkëpunim) të Ligjit të kontestuar, i cili parasheh mbledhjen e informatave me qëllim të verifikimit, nuk ka përcaktuar mënyrën e mbledhjes së këtyre informatave përkundër vërejtjeve të përsëritura të Komisionit të Venecias, dhe se informatat nga nënparagrafi 1.1 deri te paragrafi i 1.12 i paragrafit 1 të nenit 19 të Ligjit të kontestuar cenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën në pronë, të garantuar me nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, në ndërlidhje nenin 1 (E Drejta e Pronës) i Protokollit 1 të KEDNJ-së.
69. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se neni 46 i Kushtetutës, respektivisht, e drejta e pronës mund të jetë objekt i kufizimit mirëpo në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës, dhe për të sqaruar kufizimin sipas këtij neni, parashtruesit citojnë Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO54/20 në lidhje me katër kushtet sipas të cilave të drejtat dhe liritë themelore mund të kufizohen (shih, rastin e Gjykatës, [KO54/20](#), me parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020, Aktgjykim i 6 prillit 2020, paragrafët 191-192). Në këtë kontekst, parashtruesit përsërisin testin e nenit 55 të Kushtetutës, gjegjësisht, kushtet të cilat, sipas Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës, duhet t'i përgjigjen pyetjeve si në vijim: “(i) *A ka qenë kufizimi i një të drejte apo lirie të garantuar me Kushtetutë “i përcaktuar me ligj”?*; (ii) *A*

ka ndjekur kufizimi i një të drejte apo lirie të caktuar një qëllim legjitim, respektivisht përmes kufizimit në fjalë, a përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi?; (iii) A ka qenë kufizimi i një të drejte apo lirie të caktuar proporcional, respektivisht, a është bërë kufizimi vetëm deri në masën sa ka qenë e domosdoshme?; dhe (iv) A është kufizimi i bërë i nevojshëm në një shoqëri të hapur dhe demokratike? (Shih rastin e Gjykatës KO54/20, i cituar më lart, paragrafi 197)”. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se Ligji i kontestuar kufizon në mënyrë arbitrare të drejtën në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, sepse sipas tyre, “[...] pavarësisht ky kufizim bëhet me ligj, i njëjti nuk është i domosdoshëm, është jo proporcional dhe nuk është i nevojshëm në shoqërinë demokratike në të cilën organizohet dhe funksionon shoqëria jonë”.

70. Përkitazi me nenin 18 (Inicimi i procedurës) dhe nenin 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) në lidhje me nenin 20 (Detyrimi për bashkëpunim) të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se këto dispozita jo vetëm që cenojnë në mënyrë arbitrare të drejtën në pronë nga neni 46 i Kushtetutës, por në thelb, edhe nenin 31 [E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.] të Kushtetutës, sepse e privon subjektin e verifikimit nga e drejta për qasje në kohë në dokumente dhe dosjen përkatëse, e privon nga e drejta për t’u dëgjuar, si dhe e privon nga e drejta për të heshtur dhe mos inkriminuar veten dhe anëtarët e familjes. Në këtë kuptim, parashtruesit shtojnë se këto të drejta: “[...] cenohen edhe në raport me përfaqësues të institucioneve të cilat obligohen për bashkëpunim me Byronë, si dhe personat e tjerë fizik dhe juridik kundër të cilëve Byroja, në bazë të par. 5 të nenit 20, parashtron kallëzim penal te Prokurori i shtetit për veprën penale "mosekzekutim të vendimeve gjyqësore", nëse të njëjtit kanë zgjedhur të drejtën për të heshtur edhe nëse ka një vendim të gjykatës për marrjen e informacionit apo dokumentit të caktuar”.

(v) *Pretendimet e tjera për mospërputhshmërinë e Ligjit të Kontestuar me Kushtetutën*

71. Tutje, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji i kontestuar bie në kundërtënie me vet koncept-dokumentin që i ka paraprirë miratimit të tij, sepse: “[...] fare nuk ka marrë në konsideratë praktikën e vendeve demokratike, pjesa më e madhe e të cilave, “konfiskim civil”, nuk aplikojnë fare, e në rastin e kundërt, këtë e bëjnë ndërmjet institucioneve të drejtësisë si Prokuroria dhe institucionet ligj zbatuese por asesi ndonjë institucion jashtë orbitës së institucioneve të zakonshme që kanë për detyrë hetimin e dukurive të tilla si krimi i organizuar, korrupsioni, shpërlarja e parave etj.” Të njëjtit po ashtu, theksojnë se Republika e Kosovës nuk mund të krahasohet me shtetet që kanë përqaftuar sistemin e konfiskimit civil për shkak të problemeve me ekonominë joformale, qasjes në prona, gjegjësisht, mosdefinimit të pronësisë, remitencave të mëdha të mërgatës dhe pamundësisë së regjistrimit të tyre, praktikës së gjerë të kontratave joformale në marrëdhëniet ekonomike, dhe që në këtë kuptim, nxjerrja e Ligjit të kontestuar përbën masë jo proporcionale dhe të panevojshme, dhe do të kishte për pasojë shkeljen e të drejtave themelore të njeriut në frymën e nenit 21 të Kushtetutës dhe garancioneve kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor.
72. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës sqarojnë para Gjykatës se “janë të vetëdijshëm se nuk është detyrë e Gjykatës që të vlerësojë nëse një ligj i caktuar përmban një politikë publike të mirë ose jo, mirëpo mirëpresin rolin e saj që në mënyrë të hollësishme të vlerësojë nëse përmes tij janë shkelur apo cenuar në të drejtat dhe liritë kushtetuese, parimet e organizimit të ndarjes dhe kontrollit reciprok të pushteteve dhe të vlerësojë nëse procedura ligjore e propozuar përmes tij siguron garancionet e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës, duke përfshirë por pa u kufizuar në vlerësimin nëse standardi “vlerësimi i

*gjasave” është i mjaftueshëm dhe i pranueshëm për ta arsyetuar fillimin dhe zhvillimin e procedurës së konfiskimit.”*

73. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë edhe vlerësimin e Gjykatës përkitazi me mospërputhshmërinë e paragrafit 13 të nenit 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar me Kushtetutën në çështjen e konfiskimit civil-përmes procedurës civile dhe në shpërputhje me parimet e procedurës kontestimore, si dhe mospërputhshmërinë e paragrafit 7 të nenit 69 (Funksionalizimi i Byrosë) të Ligjit të kontestuar me nenin 142 të Kushtetutës për shkak se është propozuar që *“[...] deri në funksionalizimin e Byrosë, funksionin administrativ e ushtron Agjencia për Parandalim të Korrupsionit, të cilës i ndahen mjete buxhetore shtesë për kryerjen e këtij funksioni”*.

74. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata si në vijim:

*“57. Për sa me sipër, nën dritën e fakteve dhe mbrojtjes se garancioneve kushtetuese, garancione këto te shkelura me ligjin kontestues, kërkojmë nga Gjykata si institucion kushtetues e i pavarur i mbrojtjes se kushtetutshmërisë që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, të vlerësoj kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar dhe ta shfuqizoj në tërësi atë, si te papajtueshëm me Kushtetutën.*

*58. Si parashtrues të kërkesës, jemi të bindur se ligji kontestues, nuk ka bazë kushtetuese e ligjore, është në kundërshtim me parimet e rendit demokratik, të shtetit të Republikës së Kosovës, cenon të drejtat e njeriut, cenon dhe minon pavarësinë e institucioneve të pavarura të drejtësisë dhe është në kundërshtim edhe me dy opinionet e Komisionit të Venecias, për sa i përket çështjeve të ngritura në këtë kërkesë.”*

*(vi) Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës*

75. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se e njëjta është parashtruar në pajtim me nenin 112 dhe paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, brenda afatit të rregullt kohor dhe në lidhje me këtë shprehen si në vijim: *“[...] mirëpresim rolin aktiv të kësaj Gjykate në mbrojtjen e garancioneve kushtetuese të përcaktuara në nenin 7 [Vlerat], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës të cenuara me ligjin kontestues të Kuvendit, dhe ta pranojë këtë kërkesë, për shqyrtim dhe vendosje in meritum.”*

*(vii) Kërkesa për masë të përkohshme*

76. Në kontekst të masës së përkohshme, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: *“[...] që pa paragjykim ndaj pranueshmërisë ose meritave të kërkesës, të informojë palët e përfshira që ligji kontestues i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, pezullohet ex-lege në mënyrë që të mos dërgohet për dekretim dhe publikim në Gazetën Zyrtare deri në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar.”*

77. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të shpallë dispozitat e Ligjit të kontestuar, në tërësi, në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

## Komentet dhe përgjigjet ndaj komenteve në lidhje me kërkesën

78. Ashtu siç është specifikuar te pjesa e procedurës para Gjykatës të këtij Aktgjykimi, komente ndaj kërkesës kanë dorëzuar: (i) Avokati i Popullit; (ii) Ministria e Drejtësisë; dhe (iii) deputeti i Kuvendit, z. Adnan Rustemi në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Përderisa përgjigje ndaj komenteve kanë dorëzuar Ministria e Drejtësisë dhe parashtruesit e kërkesës. Komentet dhe përgjigjet e komenteve të palëve të interesuara që i referohen Ligjit të kontestuar, i cili është objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata, do të paraqiten në vijim.

### **(i) Komentet e Avokatit të Popullit, të dorëzuara më 8 mars 2023**

79. Më 8 mars 2023, Avokati i Popullit dorëzoi komentet e tij ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, ku fillimisht theksoi se ka analizuar Ligjin e kontestuar në dritën e “Opinionit nr. 1083/2022 të Komisionit të Venecias, të 20 qershorit 2022” dhe “Opinionit nr. 1113/2022 të Komisionit të Venecias të 19 dhjetorit 2022”, përkitazi me çështjen në fjalë.
80. Avokati i Popullit konsideron se Gjykata duhet të vlerësojë nëse dispozitat e Ligjit të kontestuar: “[...] cenojnë të drejtën e pronës, sigurinë juridike, të drejtën për mjete juridike si dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejta këto të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.
81. Përkitazi me nënparagrafin 4 të paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, ku përcaktohet që në Komisionin Mbikëqyrës për procedurën e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, në cilësinë e anëtarit të caktohet njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata që të vlerësojë përputhshmërinë e kësaj dispozite me dispozitat që garantojnë pavarësinë e Avokatit të Popullit sipas nenit 132 të Kushtetutës. Në këtë rrjedhë, Avokati i Popullit konsideron se: “[...] as Kushtetuta e Republikës së Kosovës e as Ligji nr. 05/L-0 19 për Avokatin e Popullit nuk ia japin një kompetencë të tillë Avokatit të Popullit, sipas të cilave, Avokati i Popullit mund të caktojë anëtar në autoritetet e pavarura”, dhe si rezultat i këtyre përcaktimeve Avokati i Popullit e vlerëson shumë të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë kushtetutshmërinë e përcaktimit të kompetencës së Avokatit të Popullit në caktimin e një zëvendësi të Avokatit të Popullit si anëtar të Komisionit Mbikëqyrës së Byrosë, në aspekt të cenimit të pavarësisë së tij, që garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
82. Përkitazi me procedurën e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, të përcaktuar me paragrafin 16 të nenit 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata që të vlerësojë nëse kompetenca e Komisionit Mbikëqyrës pas dështimit të procedurës së zgjedhjes nga Kuvendi të kandidatit për këtë pozitë, bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që përcaktojnë kompetencat e Kuvendit, gjegjësisht nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Avokati i Popullit konsideron se sipas përcaktimeve të nenit 65 të Kushtetutës dhe nenit 45 (Formimi i Komisionit *ad-hoc*) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, “[...] as Kushtetuta e Republikës së Kosovës e as Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk i japin kompetencë komisioneve të Kuvendit që të nxjerrin vendim me të cilin do të mundë të zgjidhnin Drejtor të Përgjithshëm të autoriteteve të pavarura të themeluara me ligj”. Për më tepër, Avokati i Popullit krahason procedurën e zgjedhjes së Drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, i cili sipas ligjit respektiv, zgjidhet me shumicën e votave të

deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, të cilën procedurë e konsideron se “[...] duhet të aplikohet edhe te rasti i zgjedhjes së Byrosë”.

### **(ii) Komentet e dorëzuara nga Ministria e Drejtësisë, më 8 mars 2023**

83. Më 8 mars 2023, Ministria e Drejtësisë, dorëzoi në Gjykatë komentet e saj ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, si dhe bashkëngjiti dokumentet në vijim në gjuhën angleze dhe shqipe: (i) Opinionin e parë të Komisionit të Venecias; dhe (ii) Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias. Më 24 mars 2023, Ministria e Drejtësisë gjithashtu dorëzoi Informatën përcjellëse të Komisionit të Venecias përkitazi me Ligjin e kontestuar.
84. Fillimisht, në komentet e saj, Ministria e Drejtësisë përshkroi hapat procedural për miratimin e Ligjit të kontestuar, duke përfshirë edhe fazën e zhvillimit të koncept dokumentit, i cili i ka paraprirë hartimit të ligjit. E njëjta theksoi përbërjen grupit punues për hartimin e Ligjit të kontestuar dhe procedurën e miratimit në Qeveri dhe Kuvend, si dhe procedurën për marrjen e opinioneve të Komisionit të Venecias dhe adresimin e rekomandimeve të tyre.
85. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e Ministrisë së Drejtësisë përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe Ligjin e kontestuar, duke përfshirë ato që ndërlidhen me (i) nenet 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar; (ii) nenet 4 dhe 9 të Ligjit të kontestuar; (iii) nenin 15 të Ligjit të kontestuar; dhe (iv) nenin 19 të Ligjit të kontestuar.
- (i) *Përkitazi me pretendimet për nenet 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar*
86. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës që nenet 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar bien në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit bazuar në Listën Kontrolluese të Komisionit të Venecias, konkretisht, ligjshmërisë si element i saj, Ministria e Drejtësisë, ndër tjerash, thekson se: *“Lidhur me elementin e ligjshmërisë, kontestimi bazohet në procesin paraprak të miratimit duke e cilësuar si jotransparente, të papërgjegjshme dhe jodemokratike, mirëpo, në asnjë pikë është elaboruar se çfarë e ka bërë këtë proces të tillë. Gjithsesi, ne do të ofrojmë argumente dhe prova që e dëshmojnë se procedura e ligjbërjes sipas Komisionit të Venecias është zbatuar në tërësi. Gjatë periudhës së hartimit të projektligjit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, i gjithë procesi ka qene transparent, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi lidhur me hartimin dhe konsultimet e akteve ligjore. Përveç respektimit të procedurës ligjore, grupet punuese në nivel të Ministrisë dhe Kuvendit kanë përfshirë përfaqësues nga sistemi i drejtësisë (gjyqtarë nga Gjykata Supreme dhe e Apelit, prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit), partnerëve ndërkombëtar (Zyra e Bashkimit Evropian, Ambasada e SHBA-ve, OPDAT, OSBE, UNDP), ekspertëve të pavarur ndërkombëtar si dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile. Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar konsultimet paraprake dhe publike ndërsa Kuvendi po ashtu ka organizuar edhe dëgjim publik më 23.09.2022 me qëllim të informimit të palëve të interesuara lidhur me përmbajtjen e projektligjit.”*
87. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për retroaktivitetin e ligjit, Ministria e Drejtësisë, ndër tjerash, thekson se: *“[...] retroaktiviteti është i lejuar në fushën civile dhe administrative”,* dhe për këtë citon standardet e vendosura nga Komisioni i Venecias si në vijim: *“[...] një prapaveprim i të drejtave të individëve ose vendosja e detyrave të reja mund të lejohet, por vetëm nëse është në interesin publik dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit”.* Në lidhje me këtë, Ministria e Drejtësisë thekson edhe: *“[...] faktin që*

projektligji në tërësi i është nënshtruar dy herë kontrollit Komisioni i Venecias dhe në të dy opinionet e lëshuara për këtë Ligj nuk është gjetur ndonjë e metë për sa i përket retroaktivitetit. Për më tepër, Ligji nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë parasheh mundësinë e retroaktivitetit në periudhë kohore prej dhjetë (10) vite”.

88. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për kolizion ligjor në mes të paragrafit 2 të nenit 2 dhe paragrafit 3 të nenit 22 të Ligjit të kontestuar, Ministria e Drejtësisë sqaron se: “[...] nenit 2 (2) i Ligjit përcakton fushëveprimin e Ligjit lidhur me atë se kush nga personat zyrtarë i nënshtrohet dispozitave të tij, respektivisht afatin kohor brenda të cilit i) subjekti i nënshtrohet verifikimit ka filluar ushtrimin e funksionit publik (nën-paragrafi 2.1) dhe ii) periudha pas së cilës subjekti që i nënshtrohet verifikimit ka pushuar së ushtruar funksionin publik (nën-paragrafi 2.2). Ndërsa, sipas nenit 22 përcaktohet periudha e verifikimit të pasurisë së subjektit që i nënshtrohet verifikimit e që kufizohet në periudhën sa ai/ajo ka ushtruar funksion publik. Ky nen specifikon edhe një përjashtim nga ky rregull e që është se kur Byroja vlerëson apo konstaton se pasuria e personit zyrtar e fituar pas periudhës së ushtrimit të funksionit publik është në masë të madhe më e lartë se të hyrat e ligjshme apo pasuria e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar, verifikimi i pasurisë mund të bëhet edhe pas përfundimit të funksionit publik në periudhë jo më të gjatë se pesë (5) vite. Prandaj, këto dy nene nuk kanë kolizion në mes vete, e që rrjedhimisht as nuk përbën cenim të parimit të sigurisë juridike”.
89. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës së neni 2 i Ligjit të kontestuar bie në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës, për shkak se i njëjti zbatohet vetëm ndaj zyrtarëve publik dhe jo të gjithë qytetarëve pa dallim, e për këtë përbën shkelje të parimit të barazisë para ligjit, Ministria e Drejtësisë thekson se parashtruesit e kërkesës përdorin termin “zyrtarë publik”, ndonëse subjekte të këtij ligji janë personat zyrtar dhe se “[...] zgjidhjet e ngjashme juridike e kanë kaluar testin e jo-cenueshmërisë së të drejtave të personave zyrtarë në raport me qytetarët e tjerë edhe përmes standardeve të vendosura ndërkombëtare. Për më tepër, duke u nisur edhe nga fakti tjetër se personat zyrtarë, bazuar në përgjegjësitë që bartin kanë pasur mundësinë të ushtrojnë ndikimin e tyre për të përfutur në mënyrë të paligjshme nga buxheti publik i shtetit, Ligji ka për qëllim të mbrojtë qytetarët e vet duke e ri-marrë pasurinë e tjetërsuar nga buxheti i shtetit dhe duke ua kthyer atë pasuri prapë në dobi të qytetarëve. Përveç tjerash, siç dihet nga konceptet e pranuar juridike, ligjet çrregullojnë marrëdhënie të caktuara shoqërore dhe ky Ligj përbën një të tillë”.
90. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës që e cilësojnë si “arbitrare” vendosjen e datës 17 shkurt 2008 për zhvillimin e procedurës së verifikimit, Ministria e Drejtësisë, nënvizon se: “[...] bazuar në parimin e sigurisë juridike duhet të përcaktohet një afat i zbatimit të ligjeve dhe në rastin e kundërt, kur një afat i tillë nuk do të vendosej, do të përbënte qartazi arbitraritet. Në rastin konkret, data e caktuar në Ligj përveç ndërlidhjes me simbolikën e formalizimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, ndërlidhet edhe me faktin se nga ajo kohë është materializuar kërkesa që çdo qarkullim juridik i pronës të bëhet nëpërmjet transaksioneve bankare, e që për qëllimet e këtij ligji është parë si provë vendimtare për qëllim të verifikimit të pasurisë.”.
91. Po ashtu, sa i përket kontestimit të standardit të “vlerësimit të gjasave” nga ana e parashtruesve të kërkesës, Ministria e Drejtësisë potencoi se: “Ky standard është konfirmuar edhe nga Komisioni i Venecias si standard i të provuarit në procedurë civile në paragrafët 13 dhe 57 të Opinionit të parë për Projektligjin për Byronë. Ndërkaq, edhe

*në Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias për Projektligjin për Byronë në paragrafin 11 është rikonfirmuar standardi i vlerësimit të gjasave [...]”, respektivisht, e njëjta citon paragrafin 25 të Opinionit të Dytë si në vijim “Në këndvështrimin e Komisionit të Venecias, çështja e barrës së provës është rregulluar në mënyrë të kënaqshme në versionin e ri të Projektligjit”.*

92. Ndërsa, përkitazi me kontestimin e kushtetutshmërisë së vlerës së përcaktuar në nenin 2 të Ligjit të kontestuar nga ana e parashtruesve të kërkesës, Ministria e Drejtësisë konsideron se: *“[...] Ligji medoemos duhet të përcaktojë një vlerë mbi të cilën duhet të bëhet verifikimi i pasurisë dhe vlera e përcaktuar në ligj është përcaktuar si një vlerë indikative e të hyrave vjetore të personave zyrtarë. Në të kundërtën, mos caktimi i një vlere monetare mbi bazën e së cilës do të bëhet verifikimi i pasurisë, do të mund të kualifikohet si mundësi arbitrare dhe cenim i sigurisë juridike. Për më tepër, gjatë hartimit të politikës për konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurisë së justifikueshme, janë marrë në konsideratë një numër i madh i praktikave të shteteve tjera, të cilat në ligjet e tyre relevante për konfiskim, kanë paraparë vlerën monetare mbi bazën e së cilës është bërë verifikimi i pasurisë.”.*

*(ii) Përkitazi me pretendimet për nenet 4 dhe 9 të Ligjit të kontestuar*

93. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për mospërputhshmërinë e neneve 4 dhe 9 të Ligjit të kontestuar me nenin 142 të Kushtetutës, Ministria e Drejtësisë thekson se Ligji i kontestuar: *“[...] themelon Byronë si organ i pavarur dhe specializuar për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme. Byroja si organ i themeluar nga Kuvendi në nenin 4 dhe 9 nuk cenon nenin 142 të Kushtetutës pasi që përmbushen katër (4) elementet bazë të këtij neni, e të cilat janë: i) themelimi me Ligj nga Kuvendi, ii) realizimi i funksionit të tyre të pavarur dhe pa ndikim, iii) garantimi i pavarësisë së tyre përmes buxhetit të veçantë, dhe iv) garancionin kushtetues që organet tjera shtetërore duhet të bashkëpunojnë dhe t’u përgjigjen kërkesave të këtyre institucioneve.”* Kjo, sipas Ministrisë së Drejtësisë është pranuar edhe në paragrafin 20 të Opinionit të dytë të Komisionit të Venecias.
94. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se nuk është adresuar rekomandimi i Opinionit të parë të Komisionit të Venecias lidhur me rregullimin e statusit dhe kualifikimeve të zyrtarëve që do të punojnë në Byronë Shtetërore, Ministria e Drejtësisë citon Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, që sipas tyre, *“[...] lidhur me kapacitetin institucional të Byrosë për të përmbushur në mënyrë adekuate detyrën e saj, Komisioni i Venecias vë në dukje se tani Byroja përmban të paktën katër njësi [...]”.*
95. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Byroja Shtetërore në aspektin e kompetencave ka funksion prokurorial, Ministria e Drejtësisë konsideron se: *“[...] nuk qëndron për faktin se institucioni i Prokurorit të Shtetit ka kompetencat kushtetuese të hetimit të veprave penale dhe kryerësve të veprave penale, siç, përcaktohet në nenin 109 të Kushtetutës. Ndërsa, Byroja bënë verifikimin e pasurisë në aspektin civil, pa ndërhyrë në aspektin e hetimit penal. Madje, sipas Ligjit për Byronë në rast se Byroja ka informata ndaj pasurisë që është duke u verifikuar është duke u zhvilluar procedurë penale atëherë Byroja pezullon verifikimin deri në përfundim të procedurës”.*

(iii) Përkitazi me pretendimet për nenin 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar

96. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për cenimin e garancioneve kushtetuese të Kuvendit në momentin e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm që sipas tyre cenohet parimi i sundimit të ligjit, i sigurisë juridike dhe kompetencës zgjedhore të Kuvendit, Ministria e Drejtësisë, konsideron se: “[...] ka qenë rekomandim i veçantë i Komisionit të Venecias në lidhje me mënyrën e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm. Sipas rekomandimeve, depolitizimi i procesit të përzgjedhjes do të garantohej nga një komision i jashtëm dhe jo nga një komision parlamentar, në përbërje të së cilës do të ishin deputetët e pozitës dhe opozitës. Pavarësia e komisionit mbikëqyrës të Byrosë siguron edhe pavarësinë e Byrosë. Komisioni Mbikëqyrës ka kompetencën e përzgjedhjes së kandidatëve dhe propozimit të tyre në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi më pas do të ketë mundësinë e votimit të një kandidati për Drejtor të përgjithshëm. Komisioni i Venecias në opinionin e dyte ka rekomanduar një situatë deblllokimi për përzgjedhjen e Drejtorit të përgjithshëm. Kësisoj, Ligji ka paraparë një kompetencë shtesë Komisionit Mbikëqyrës në rast se Kuvendi do të dështojë dy herë në përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, kompetenca e tillë i kalon Komisionit Mbikëqyrës. Kjo qartazi saktëson se me këtë dispozitë ligjore nuk është cenuar kompetenca zgjedhore Kushtetuese e Kuvendit të Kosovës për faktin se me Kushtetutë nuk parashihet zgjedhja e Drejtorit të ndonjë Agjencie. Për më tepër, nuk kemi as cenim të sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike pasi që përmes ligjit është përcaktuar kompetenca zgjedhore e Kuvendit dhe nuk është shkelur kompetenca ligjore e Kuvendit për ta zgjedhur Drejtorin e Përgjithshëm, pasi që Ligji ka paraparë që Kuvendi në dy raste me shumicën e paraparë në nenin 80 të Kushtetutës të përzgjedhë Drejtorin e Përgjithshëm.”

(iv) Përkitazi me pretendimet për nenin 19 të Ligjit të kontestuar

97. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për mospërputhshmërinë e nenit 19 (Mbledhja e Informatave me qëllim të verifikimit) të Ligjit të kontestuar me nenin 46 të Kushtetutës, Ministria e Drejtësisë, thekson se: “Informatat e mbledhura nga Byroja nuk mund të konsiderohen si ndërhyrje në të drejtën në pronë, pasi që Byroja mbledh vetëm informatat për qëllim të verifikimit, ndërsa sipas Ligjit vetëm gjykata është autoriteti i vetëm që vendos përfundimisht lidhur me të drejtën në pronë sipas procedurave të caktuara dhe në përputhje me Ligjin dhe Kushtetutën”. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), ku theksohet se “[...] masat që përbëjnë ndërhyrje ndaj pronës mund të inicohen, një nocion që në vetvete përfshin verifikimin dhe propozimin për konfiskim, edhe nga autoritete që nuk kanë karakter gjyqësor ose prokurorial”. Në këtë kontekst, Ministria e Drejtësisë përmend rastin e GJEDNJ-së, [Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 18465/91, Aktgjykim i 5 majit 1995, ku “[...] të gjitha masat që kishin të bënin me verifikimin, paralajmërimin, hetimin, manje në atë rast sekuestrimin e pasurisë (avion i kompanisë), u kryen nga Oficerët e Doganave dhe Tatimeve në Mbretërinë e Madhe.” Në këtë kontekst, Ministria e Drejtësisë i referohet edhe rasteve të GJEDNJ-së, [AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 9118/80, Aktgjykim i 24 tetorit 1986 dhe [Karahasanoglu kundër Turqisë](#), nr. 21392/08, Aktgjykim i 16 qershorit 2021.
98. Ministria e Drejtësisë po ashtu thekson se: “Në rastet e lartcekura në pikën e mësipërme, institucionet jo gjyqësore dhe jo prokuroriale kanë mbledhur prova dhe kanë konfiskuar pasuritë, ndërsa në rastin e Byrosë vetëm mbledhë dhe verifikon informacione sipas procedurës së paraparë me Ligj. Mbledhja dhe verifikimi i të dhënave lidhur me pasurinë



*nuk është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës, pasi që në Republikën e Kosovës ka institucione tjera siç janë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Dogana e Kosovës, Njësi për Inteligjencë Financiare dhe Administrata Tatimore e Kosovë dhe të tjera të cilat në bazë të informacioneve dhe të dhënave të tjera që mbledhin gjatë punës së tyre, iniciojnë dhe/ose sekuestrojnë përkohësisht pasuri. Kurse, në rastin konkret, Byroja vetëm verifikon dhe mbledh informacione lidhur me pasurinë e subjekteve që janë palë në procedurë, dhe vendimi përfundimtar lidhur me pasurinë merret gjykata”.*

99. Në lidhje me pretendimin se e drejta e pronës kufizohet në kundërshtim me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, Ministria e Drejtësisë nënvizon se *“[...] e drejta e pronës nuk kufizohet sipas këtij Ligji që është objekt kontesti, pasi që Gjykata ka rolin përfundimtar në lidhje me vendimin mbi të drejtat pronësore dhe procedurale për palët [...] Për më shumë, as Komisioni i Venecias nuk ka kontestuar të drejtën e Byrosë në mbledhjen e informatave apo verifikimin, duke mos kontestuar që një Ligj i tillë cenon të drejtën e pronës”.*
100. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se përmes neneve 18 dhe 19 në lidhje me nenin 20 të Ligjit të kontestuar, jo vetëm që cenohet neni 46 [Mbrotjtja e Pronës] i Kushtetutës por edhe në thelb cenohen garancionet e nenit 31 të Kushtetutës, pasi privohet subjekti nga qasja në kohë në dokumente, e drejta për t’u dëgjuar si dhe e drejta për të heshtur dhe mos inkriminuar vetën dhe anëtarët e familjes, Ministria e Drejtësisë, shprehet si në vijim: *“Një pretendim i tillë i palës parashtruese është i pabazuar dhe të paqëndrueshëm juridikisht për shkak se neni 18, paragrafi 18 [i Ligjit të kontestuar] përcakton saktë se “Të gjitha informacionet do të jenë të qasshme për palën e cila është subjekt i procedurës së verifikimit, përveç në rastet kur këto informacione do të rrezikojnë procedurën e verifikimit, do t’i dëmtonin provat, si dhe mund ta cenonin interesin publik.”* Në këtë drejtim, Ministria e Drejtësisë thekson se edhe paragrafi 5 i nenit 62 të Ligjit të kontestuar përcakton se: *“[...] deklaratat e dhëna si dhe dokumentet e ofruara nga kushdo në kuadër të procedurës së verifikimit dhe konfiskimit sipas këtij ligji, të njëjtat nuk mund të përdoren si prova në procedurë penale”.*
101. Tutje, Ministria e Drejtësisë konsideron se kërkesa e parashtruesve të kërkesës për vlerësim të Ligjit të kontestuar me aktet e tjera ligjore (kontroll horizontal i ligjeve) është e *“[...] paprecedentë dhe në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese”*, ndërsa pretendimi se përmes paragrafit 7 të nenit 69 të Ligjit të kontestuar është cenuar neni 142 i Kushtetutës pa ofruar argumente se si është cenuar, vlerëson se në përputhje me rastin e Gjykatës [KI168/21](#), me parashtrues *Petrit Dushi*, Aktgjykim i 7 shkurtit 2022, *“[...] ngritja e pretendimit në vetvete nuk është e mjaftueshme për të konstatuar shkelje të neneve kushtetuese”.*
102. Përkitazi me kërkesën për masën e përkohshme, Ministria e Drejtësisë thekson se: *“[...] bazuar në nenin 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, e bën te panevojshme kërkesën për masë të përkohshme të paraqitur nga ana e parashtruesit, pasi që Ligji nuk mund të shpallet nga Presidentja dhe të publikohet në Gazetën Zyrtare dhe si rrjedhojë nuk do të mund të gjejë zbatim deri në vendimin përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.”*
103. Në fund, Ministria e Drejtësisë thekson në komentet e saj se Ligji i kontestuar është në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, përfshirë KEDNJ-në dhe i propozojnë Gjykatës që të nxjerrin Aktgjykim me të cilin konstatohet se ky ligj është në përputhje me Kushtetutën.

**(iii) Komentet e dorëzuara nga deputeti i Kuvendit, z. Adnan Rustemi, të dorëzuara më 8 mars 2023**

104. Më 8 mars 2023, z. Adnan Rustemi, në cilësinë deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETEVENDOSJE!, dorëzoi në Gjykatë komentet e tij në lidhje me rastin KO46/23.
105. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e deputetit Adnan Rustemi përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe Ligjin e kontestuar, duke përfshirë ato që ndërlidhen me: (i) nenet 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar; (ii) nenin 15 të Ligjit të kontestuar; dhe (iii) nenet 18, 19 dhe 20 të Ligjit të kontestuar.

*(i) Përkitazi me pretendimet për nenet 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar*

106. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për mospërputhshmërinë e neneve 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar me nenin 7 të Kushtetutës, që garanton parimin e sundimit të ligjit, përkatësisht elementeve të tij, përfshirë atë të ligjshmërisë ku përfshihet procesi paraprak i miratimit të ligjit me procedurë siç është cilësuar nga parashtruesit e kërkesës si “jo transparente, e papërgjegjshme dhe jo demokratike”, deputeti Adnan Rustemi njofton Gjykatën se “[...] Në cilësi të Kryesuesit të grupit punues të formuar në kuadër të Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Republikës së Kosovës, [...], ky grup punues ka qenë përbërë nga deputetë të Republikës së Kosovës, përfaqësues nga sistemi i drejtësisë (gjyqtarë e prokurorë), partnerëve ndërkombëtar, ekspertëve të pavarur ndërkombëtar si dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile. Njëkohësisht, ky grup punues, ka organizuar dëgjim publik me datë 23.09.2022 me të gjitha palët e interesit, dhe po ashtu ka mbajtur 4 punëtori (të mbështetura nga UNDP, Këshilli i Evropës dhe KDI) dhe deri në finalizimin e Projektligjit është konsultuar dy herë Komisioni i Venecias”. Në këto rrethana, deputeti Adnan Rustemi specifikon se të gjithë palët janë ftuar në mënyrë të rregullt në takimet e grupeve punuese, gjithashtu kanë pasur në dispozicion platforma të ndryshme për adresimin e mendimeve dhe rekomandimeve të tyre.
107. Ndërsa, përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se pragu prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro ofron amnisti për cilindo zyrtar publik nga fushëveprimi i tij nëse vlera e shpërputhjes është më e ulët, deputeti Adnan Rustemi sqaron se ka qenë dakordim i grupit punues që zyrtarët publik që ballafaqohen me shpërputhje më të larta, të kenë përparësi dhe kjo reflektohet në paragrafin 6 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, dhe se: “Ligji për cakton prag minimal, por fokusin e ka tek rastet e profilit të lartë e që kjo dispozitë merr vlerësim pozitiv me rekomandimin nr. 21 të Opinioneve të Komisionit të Venecias nr. 1113/2022 i datës 19 dhjetor 2022”.

*(ii) Përkitazi me pretendimet për nenin 15 të Ligjit të kontestuar*

108. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për kontestimin e nenit 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, ku rregullohet procedura e zgjedhjes së Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, deputeti Adnan Rustemi thekson se ky nen ka adresuar në tërësi dy opinionet e lartcekura të Komisionit të Venecias, gjegjësisht, Opinioni i parë kishte rekomanduar në paragrafin 39 të tij “[...] garanci të forta rreth pavarësisë së Byrosë në mënyrë që t’i rezistojë çdo presioni të mundshëm politik, do të ishte e preferueshme që të parashikohet përzgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm nga një votim i shumicës së kualifikuar të Kuvendit, me një mekanizëm kundër bllokimit të procedurës”, dhe në këtë kontekst kjo pozitë të zgjidhet nga një Komision i jashtëm, i përbërë nga ekspertë

të pavarur, apo që kandidatët të zgjidhen nga ky komision e t'ia propozojnë Kuvendit për votim, ndërsa, Opinioni i dytë, në paragrafin 34 të tij, kërkon nga ligjvënësi që të “[...] sigurojë një mekanizëm kundër-blokim për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë”.

109. Për më tepër, deputeti Adnan Rustemi pretendon se mekanizmi kundër bllokues për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, “[...] ka për qëllim sigurimin e garancive të forta rreth pavarësisë së Byrosë në mënyrë që t'i rezistojë çdo presioni të mundshëm politik.”

(iii) Përkitazi me pretendimet për 18, 19 dhe 20 të Ligjit të kontestuar

110. Përkitazi me pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 19 (Mbledhja e Informatave me qëllim të verifikimit) të Ligjit të kontestuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, respektivisht, që mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën në pronë, deputeti Adnan Rustemi thekson se Ligji i kontestuar dhe legjislacioni përkatës në fuqi, jep garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e pronës, dhe se institucionet ligj-zbatuese siç janë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Administrata Tatimore e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Njësi për Inteligjencë Financiare, Noterët dhe Përmbauesit Privat, obligohen që sipas kërkesës nga Byroja Shtetërore, në mënyrë aktive, pa vonesë, të ofrojnë informatat e kërkuara, që shërbejnë vetëm për qëllim të verifikimit dhe se është gjykata, autoriteti përfundimtar që vendos për të drejtën në pronë sipas procedurave të përcaktuara dhe në pajtim me Ligjin dhe Kushtetutën.
111. Lidhur me këtë, deputeti Adnan Rustemi, pohon se: “Byroja në asnjë mënyrë nuk ka kompetenca ligjore të konfiskimit dhe mohimit të së drejtës në pronë. E njëjta është institucion me mandat të verifikimit të pasurisë dhe informatat e mbledhura nga kjo procedurë i dërgon në gjykatë për të u vlerësuar tutje në procedurë ligjore, të përcaktuara me ligj”, andaj, sipas tij, vlerësimi se neni 19 i Ligjit të kontestuar cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën në pronë, nuk qëndron.
112. Në fund, deputeti Adnan Rustemi vë në pah vlerësimin e Opinioni të dytë të Komisionit të Venecias, cili thekson se: “Projektligji i ri paraqet një sistem të zbatueshëm të konfiskimit të pasurisë pa dënim në Kosovë”, dhe se Komisioni për Legjislacion, pas pranimin të këtij opinionin ka adresuar edhe tri vërejtjet e fundit të tij. I njëjti vlerëson se: “[...] procesi i shqyrtimi të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme është shembulli më i mirë në procedurat parlamentare se si adresohen një nga një të gjitha vërejtjet e adresuara nga Komisioni i Venecias, duke shërbyer si udhërrëfyes në procesin e ndryshimeve.”

**(iv) Përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë ndaj komenteve, të dorëzuara më 12 prill 2023**

113. Më 12 prill 2023, Ministria e Drejtësisë, dorëzoi në Gjykatë përgjigjen e saj ndaj komenteve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETEVENDOSJE! dhe Avokatit të Popullit lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, si dhe bashkëngjiti Informatën përcjellëse të Opinioni të dytë të Komisionit të Venecias përkitazi me Ligjin e kontestuar, në gjuhën angleze dhe frënge.

114. Në lidhje me komentet e deputetit Adnan Rustemi të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Ministria e Drejtësisë specifikoi se: "1. [...] *Konsiderojmë që të njëjtat i janë përgjigjur në mënyrë të saktë pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për vlerësimin e Ligjit dhe rrjedhimisht të njëjtat i mbështesim.*"

115. Ndërsa lidhur me komentet e Avokatit të Popullit, Ministria e Drejtësisë theksoi se:

*"[...] vërejmë se janë ngritur tri (3) çështje kryesore për vlerësim nga Gjykata Kushtetuese: a) kompetenca e Avokatit të Popullit për caktimin e një zëvendësi si anëtar të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë; b) kompetenca e Komisionit për zhvillimin e procedurave dhe përzgjedhjen e Drejtorit në rast të dështimit për përzgjedhjen e Drejtorit të Byrosë nga Kuvendi; dhe c) cenimi i te drejtës së pronës, sigurisë juridike, të drejtës për mjete juridike dhe të drejtës për gjykim të drejte dhe të paanshëm.*

*3. Fillimisht duhet të theksohet se dy çështjet e para të komentuara nga Avokati i Popullit lidhur me kompetencën e Avokatit të Popullit për caktimin e një zëvendësi si anëtar të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë dhe kompetencën e Komisionit për zhvillimin e procedurave dhe përzgjedhjen e Drejtorit në rast të dështimit për përzgjedhjen e Drejtorit të Byrosë nga Kuvendi janë jashtë fushëveprimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit për Byronë Shtetërore parashtruar nga [parashtruesit e kërkesës]. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë në cilësinë e propozueses së Ligjit, do të ofrojë pikëpamjet e saj mbi këto komente dhe qëllimin e këtyre dispozitave të Ligjit.*

*4. Në linjë me çështjen e pare të ngritur nga Avokati i Popullit lidhur me kompetencën e Avokatit të Popullit për caktimin e një zëvendësi si anëtar të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë, duhet medoemos t'i referohemi dispozitave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë kompetencat e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.*

*5. Siç dihet, Kushtetuta përcakton rolin e Avokatit të Popullit që [...] mbikëqyr dhe mbron te drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe te parregullta të autoriteteve publike". Veç kësaj, Kushtetuta përcakton edhe disa rregullime tjera lidhur me Avokatin e Popullit siç janë zgjedhja, kualifikimi, shkarkimi, buxheti dhe raportimi i Avokatit të Popullit. Në vijim, është Ligji për Avokatin e Popullit i cili ka përcaktuar edhe me tej rolin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit duke zbërthyer me tutje dispozitat e asaj që është rregulluar me Kushtetutë.*

*6. Në këtë mënyrë, Ligji për Avokatin e Popullit përcakton një numër kompetencash për Avokatin e Popullit që përfshijnë hetimin e ankesave nga personat fizik ose juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera; paraqitjen në cilësinë e mikut të gjykatës, dhe ushtrimin e kompetencave të ndërmjetësimit dhe pajtimit, nder tjerash. Përveç këtyre kompetencave, sipas paragrafit 13 të nenit 16, "Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për barazi gjinore dhe legjislacionin tjetër në fuqi. "*

*7. Posaçërisht, paragrafi 13 i nenit 16 i jep bazë të qartë ligjore edhe zbatimit të nenit 10 të ligjit për Byronë sepse sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera që përcaktohen me ligj, që në rastin konkret kemi ligjin për Byronë.*

*8. Në rregullimin aktual ligjor, Avokati i Popullit është i përfaqësuar ex-officio edhe në organe tjera shtetërore. Rast konkret është Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidateve për emërim në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë rast, Avokati i Popullit është anëtar i këtij Komisioni ex-officio i cili përgatit dhe i paraqet Kuvendit listën e ngushtë të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.*

*9. Gjithashtu duhet të theksohet se lidhur me zëvendësit e Avokatit të Popullit, Kushtetuta rregullon në mënyrë koncize, çështjet si ne vijim: "Avokati i Popullit ka një (1) ose me shume zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. " Është e rëndësishme të theksohet se zëvendësit e Avokatit të*

Popullit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës andaj edhe caktimi i një zëvendësi në këtë Komision Mbikëqyrës i jep edhe me tepër legjitimitet dhe arsyeshmëri nenit 10 të Ligjit për Byronë dhe përfshirjes së Avokatit të Popullit në këtë Komision. Caktimi i një zëvendësi nga Avokati i Popullit duhet të kuptohet si ushtrim i veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit ngase zëvendësi do të shërbejë ex-officio në këtë Komision Mbikëqyrës.

10. Pra, të gjithë anëtarët e caktuar nga institucionet respektive të Republikës së Kosovës, përfshirë edhe zëvendësin e Avokatit të Popullit shërbejnë ex-officio në cilësinë e anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës që funksionon në kuadër të Byrosë dhe nuk kemi të bëjmë me zgjedhje të drejtpërdrejt të ndonjë anëtari në institucione që janë kategori kushtetuese e të cilat zgjedhën në bazë të dispozitave kushtetuese. Madje, raste të shërbimit ex-officio të Avokatit të Popullit ka edhe në shtetet tjera, si për shembull në Estoni ku Avokati i Popullit (në Estoni quhet Chancellor of Justice) është anëtar ex-officio i Këshillit Gjyqësor të Estonisë.

11. Kushtetuta e Kosovës përcakton në nenin 134 (3) që "Avokati i Popullit dhe zëvendësit e saj/tij nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike, as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale dhe as të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare ". Kjo ndalesë ka të bëjë me punët dhe veprimtaritë personale të Avokatit të Popullit apo zëvendësve të tij dhe jo me shërbimin ex-officio në një institucion tjetër. Kjo konfirmohet edhe nga Komentari i Kushtetutës së Kosovës për nenin 134 (3): "Së pari, sipas paragrafit në fjalë, efekti i rregullave të papajtueshmërisë jetësohet që nga momenti i pranimit zyrtar të funksionit të Avokatit të Popullit dhe/apo zëvendësit/ve të tij, dhe mbaron/ndërpritet pas përfundimit kushtetues ose ligjor të mandatit të këtyre të fundit. Së dyti, norma kushtetuese në fjalë përcakton rregullat e papajtueshmërisë së funksionit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij me funksionet tjera personale dhe politike. Thënë shkurt, rregullat e papajtueshmërisë përcaktojnë karakterin e punëve dhe të veprimtarive personale të cilat janë të ndaluara të ushtrohen gjatë gjithë periudhës kohore që mandati i Avokatit të Popullit dhe/apo zëvendësve të tij/saj.

12. Gjithashtu, parimet e Komisionit të Venecias për mbrojtjen dhe promovimin e institucionit të Avokatit të Popullit theksojnë që "Avokati i Popullit nuk duhet gjatë mandatit të tij/saj të angazhohet në aktivitete politike, administrative apo profesionale në papajtueshmëri me pavarësinë dhe paanësinë e tij/saj ". Pra, elementi esencial në këtë drejtim sipas Komisionit të Venecias është ruajtja e pavarësisë dhe paanësisë së Avokatit të Popullit zëvendësve të tij/saj gjegjësisht, me ndalimin e veprimtarive që mund të cenojnë pavarësinë apo paanësinë e institucionit.

13. Kjo gjithësi duhet të shihet në spektrin e veprimtarisë personale dhe jo në shërbimin ex officio në një institucion tjetër. Për shembull: një situatë e cila mund të cenojë pavarësinë ose paanësinë e Avokatit të Popullit është konflikti i interesit. Sipas Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik konflikti i interesit përkufizohet si në vijim "Konflikti i interesit lind nga një rrethane në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare". Konflikti i interesit është pra konflikt i interesit privat me atë publik. Shërbimi i zëvendës avokatit të Popullit në Komisionin Mbikëqyrës nuk është veprimtari private ose personale e tij, por shërbim ex-officio siç është cekur më lartë në kuptim të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit.

14. Si rrjedhojë nuk mund të konkludohet në përgjithësi, pa shqyrtuar veprimet personale që lidhen me interesin privat të individëve, se shërbimi edhe në pozitën e zëvendësit të Avokatit të Popullit por edhe në rolin e anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës së Byrosë është konflikt i interesit me të cilin do të cenohet pavarësia dhe paanësia e Avokatit të Popullit. Në rastet kur zëvendësi i Avokatit të Popullit mund të ketë konflikt të interesit privat me atë publik atëherë ekzistojnë të gjitha garancitë ligjore për të eliminuar këtë konflikt të

interesit ose marrjen e masave tjera adekuate. Gjithashtu, duhet të vlerësohet fakti që një nga pesë zëvendësit e Avokatit të Popullit sipas ligjit e që shërben si anëtar i Komisionit Mbikëqyrës, nuk është autoritet vendimmarrës individual në kuadër të institucionit të Avokatit të Popullit dhe si rrjedhojë nuk mund të marrë vendime ose ndikojë drejtpërdrejt në realizimin e kompetencës së Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut.

15. Gjykata duhet ta ketë parasysh edhe vlerësimin e përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë nga Komisioni i Venecias, i cili duke reflektuar mbi këtë përbërje konkludon se: "Sipas këndvështrimit të Komisionit të Venecias, organi i ri i propozuar në Projektligj ofron një garanci më të mirë për pavarësinë pasi të gjithë anëtarët e Komisionit vijnë nga jashtë sferës politike".

16. Andaj, duke u bazuar në këtë qasje sistematike të normave juridike, nuk ka asnjë cenim të dispozitave kushtetuese me rastin e caktimit të një zëvendësi të Avokatit të Popullit si anëtar të Komisionit Mbikëqyrës së Byrosë.

17. Përkitazi me çështjen e dytë të ngritur nga Avokati i Popullit që lidhet me kompetencën e Komisionit për zhvillimin e procedurave dhe përzgjedhjen e Drejtorit në rast të dështimit për përzgjedhjen e Drejtorit të Byrosë nga Kuvendi, vërehet se mund të jetë bërë një keqkuptim i dispozitave të ligjit të Byrosë. Nga komentet e Avokatit të Popullit kuptohet se ky Komision që zhvillon procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë dhe përjashtimisht edhe zgjedh Drejtorin në rastin kur pas dy votimesh dhe një përsëritje të konkursit është interpretuar si Komision ad-hoc i Kuvendit. Ligji për Byrosë këtë ia ka përcaktuar për kompetencë Komisionit Mbikëqyrës së Byrosë dhe jo një Komisioni ad-hoc të Kuvendit, siç është parashtruar në paragrafët 13 dhe 14 të komenteve të Avokatit të Popullit.

18. Gjithsesi, për të sqaruar në saktësi, theksojmë se vendosja e këtij mekanizmi kundër bllokues për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm rrjedh si rekomandim nga Opinioni i Komisionit të Venecias, i cili në përfundime ka rekomanduar që Ligji ndër tjerash: "të sigurojë një mekanizëm kundër-blokim për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë"

19. Në Opinioni i Komisionit të Venecias po ashtu është theksuar se: "Në çdo rast, Komisioni rekomandon vendosjen e konsultimit të detyrueshëm të eksperteve të pavarur në këtë proces. Do të ishte e këshillueshme që Drejtori i Përgjithshëm ose të zgjidhet nga një komision i jashtëm i përbërë nga institucione dhe eksperte të pavarur, ose që kandidatet të përzgjidhen nga një komision i tillë i pavarur dhe t'i propozohen Kuvendit për votim. Krijimi i një organi drejtues kolegjal dhe pluralist Byrosë anëtarë të të cilit mund të delegohen nga institucione të pavarura, mund të jetë një alternative tjetër", Komisioni i Venecias ka theksuar se Anëtarët e komisionit mund të emërohen p.sh. nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryeprokurori i Shtetit, Kryetari i Komisionit për Legjislacionin i Kuvendit, Avokati i Popullit, Dekani i Fakultetit Juridik etj .

20. Një procedure e tillë kundër bllokuese për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë nuk cenon kompetencat e Kuvendit sipas nenit 65 të Kushtetutës për faktin se kjo procedure mund të vie në shprehje vetëm në rastet e jashtëzakonshme pas dështimit për përzgjedhjen e Drejtorit në dy raunde dhe përsëritjes së konkursit edhe me dy raunde tjera. Duke u bazuar në rolin dhe rëndësinë e autoritetit të Byrosë në rastet e tilla të mos përzgjedhjes së Drejtorit mund të dëmtonin dhe rrezikonin mirëfunksionimin e Byrosë.

21. Referuar analogjisë së përdorur me procedurën e përzgjedhjes së Drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në pikat 15-18 të komenteve të Avokatit të Popullit, konfirmojnë se një procedure e tillë është aplikuar edhe në rastin e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë, shtuar këtu edhe mekanizmin kundër-blokues si përmbushje e rekomandimeve nga Opinioni i Komisionit të Venecias.

22. Përkitazi me çështjen e tretë të ngritur nga Avokati i Popullit lidhur me vlerësimin për cenimin e të drejtës së pronës, sigurisë juridike, të drejtës për mjete juridike dhe të drejtës për gjykim të drejte dhe të paanshëm, të njëjtat nuk janë elaboruar në komente nga ana e Avokatit të Popullit se si mund të jene cenuar, por vetëm e ka ngritur si çështje për vëmendjen e Gjykatës.

23. Ministria e Drejtësisë në detaje ka sqaruar se si Ligji për Byronë nuk ka cenuar asnjë nga të drejtat kushtetuese të sipër theksuara në përgjigjen tonë të datës 08.03.2023 ndaj kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë nga parashtruesit dhe për qellim të mos përsëritjes, i referohemi argumenteve në përgjigjen tonë të datës 08.03.2023.

24. Madje, Komisioni i Venecias nëpërmjet një opinionioni përcjellës me 14.03.2023 ka konstatuar se Ligji për Byronë ka përmirësuar garancitë e të drejtave të njeriut për subjektet në procedure që përfshijnë këtu të drejtën e pronës, sigurisë juridike, të drejtën për mjete juridike dhe të drejtën për gjykim të drejte dhe të paanshëm.

25. Në këtë Opinion përcjelljes, Komisioni i Venecias po ashtu ka theksuar se Ligji për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme i miratuar në Kuvend ka adresuar të gjitha komentet e Komisionit duke përfshirë nder tjerash: garancitë për pavarësinë e Byrosë, përcaktimin e saktë të procedurës së verifikimit, dhe përmirësimin e garancive të të drejtave të njeriut për subjektet në procedurë.

26. Përfundimisht, ashtu siç u argumentua me lartë, Ministria e Drejtësisë vlerëson se Ligji për Byronë për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare.

27. Andaj, duke u bazuar në argumentet e ofruara nga Ministria e Drejtësisë, i propozojmë Gjykatës Kushtetuese të nxjerrë AKTGJYKIM me të cilin konstatohet se Ligji për Byronë për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.”

#### **(v) Përgjigjet e parashtruesve të kërkesës ndaj komenteve të Avokatit të Popullit, Ministrisë së Drejtësisë dhe deputetit të Kuvendit**

116. Më 24 prill 2023, si rezultat i komenteve të dorëzuara nga Avokati i Popullit, deputeti Adnan Rustemi dhe Ministria e Drejtësisë, respektivisht, parashtruesit e kërkesës në përgjigjen e tyre ndaj komenteve të palëve të lartcekura u përgjigjën si në vijim:
117. Në lidhje me komentet e deputetit Adnan Rustemit nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!., parashtruesit e kërkesës specifikojnë se:

“1. Edhe ashtu siç pritej, këto komente nuk adresojnë fare pretendimet tona për sa i përket cenimit të të drejtës në pronë, mënyrës absurde dhe të pashembullt të zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë, trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues që ligji kontestues ka vendosur në raport me zyrtarët publik, duke përfshirë edhe mundësinë e përjashtimit të tyre si subjekte në këtë procedurë nëse jo përputhshmëria e pasurisë së tyre është nën vlerën 25000 euro.

2. Po ashtu, në këto komente fare nuk trajtohet pretendimi ynë për rregullimin jokushtetues të çështjes së ushtrimit të funksionit të Byrosë - deri në funksionalizimin e saj (1 vit) - nga ana e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

3. Parashtruesit e komenteve, po ashtu, kanë dështuar t'i përgjigjen pretendimeve tona lidhur me cenimin e privatësisë - si një e drejte kushtetuese, me rastin e marrjes/mbledhjes së informatave për qëllime të verifikimit të pasurisë, aseteve, të ardhurave, shpenzimeve, detyrimeve, etj.

4. Për sa më sipër, konsiderojmë se këto komente nuk meritojnë vëmendje të veçantë, për arsye se të njëjtat, në thelb paraqesin përpjekje të pa argumentuar për të justifikuar

*ngritjen e një sistemi dual të konfiskimit të pasurisë nga një institucion jashtë institucioneve që përcaktohen në kapitullin VII të Kushtetutës.”*

118. Në lidhje me komentet e Avokatit të Popullit, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës specifikon se:

*“5. Në përgjithësi, konsiderojmë se të gjitha komentet e parashtruara nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit janë të bazuara dhe të njëjtat meritojnë vlerësim serioz të efekteve që mund të prodhohen. Shtu këtu faktin se tashme, pas publikimit të Aktgjykimit (24 marsit 2023, publikuar me 5 prill 2023) KO 100/22, me parashtrues: Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputete të tjerë dhe KO 101/22, me parashtrues: Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputete të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në dispozitivin II të të cilit shprehimisht konstatohet jo kushtetues propozimi që një anëtar i KPK-së të caktohet nga ana e Avokatit të Popullit, vlerësojmë se edhe ligji kontestues, duhet të shpallet nul, përveç tjerash, edhe për përcaktimin afërsisht të ngjashëm që, në përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë, të jetë anëtar, një zëvendës i Avokatit të Popullit i caktuar nga Avokati i Popullit.*

*6. Për sa me sipër, ju lutem referojuni, nenit 10, paragrafi 1.4 të ligjit të kontestuar. Ndërkaq, arsyetimi se një propozim i tillë është në kundërshtim me nenin 132 të Kushtetutës, lehtësisht argumentohet përmes arsyetimit të aktgjykimit KO 100/22, dhe KO 101122, respektivisht nga pika 239 deri në 267.”*

119. Në lidhje me komentet e Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës specifikon se:

*“7. Përkitazi me komentet e Ministrisë së Drejtësisë, konsiderojmë se të njëjtat kanë dështuar të argumentojnë pretendimet tona të paraqitura në kërkesë, veçanërisht lidhur me fushëveprimin e zbatimit kohor të ligjit, fushëveprimin e zbatimit të ligjit ndaj zyrtareve të lartë, duke u orvatur që ta arsyetojnë se ligji i kontestuar do të zbatohet ekskluzivisht ndaj nivelit të lartë të zyrtareve si: politik bërësit, bartësit e funksioneve të larta publike, duke përfshirë gjyqtaret, prokuroret, etj, pa argumentuar se mbi çfarë premisa juridike këta persona zyrtarë duhet të trajtohen në mënyrë të pabarabarte dhe diskriminuese në raport me zyrtaret tjerë publik nga njëra anë dhe qytetaret e tjerë, nga ana tjetër.*

*8. Parashtruesja e komenteve, ka dështuar të kundër-argumentoj pretendimin tonë për sa i përket pamundësisë objektive dhe ligjore të zbatimit të sistemit të konfiskimit të propozuar në ligj, për shkak të rrethanave të veprimit të ekonomisë kosovare, e cila zyrtarisht karakterizohet në një mase të madhe nga ekonomia joformale nga njëra anë dhe nga remitancat e mëdha, nga ana tjetër. Për rrjedhojë, regjistrimi juridik i qarkullimit ekonomik në Kosovë përballet me sfida elementare, të cilat, si të tilla, sistemin e konfiskimit civil të pasurisë e bëjnë të pa aplikueshëm tërësisht edhe nën supozime se i njëjti do të zbatohet nga institucionet kompetente të drejtësisë (Prokuroria e Shtetit).*

*9. Për sa i përket çështjeve tjera të ngritura në formë të pretendimeve në kërkesën tonë pranë kësaj gjykate, konsiderojmë se parashtruesja e komenteve përsëri ka dështuar të argumentojë elementet themelore jokushtetuese të ligjit, siç janë: dështimi për të zbatuar standardet dhe parimet e të provuarit në procedurë civile, të cilat aplikohen në bazë të Ligjit në fuqi për Procedurën Kontestimore, etj, si dhe ka dështuar të jap përgjigje mbi pretendimin se përcaktimi i ushtrimit të funksionit të Byrosë - deri në funksionalizimin e saj (1 vit) - nga ana e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, është jokushtetues, si dhe ka dështuar të kundër-argumentoj se mbi çfarë baze është propozuar që drejtori i Byrosë*



të zgjedhjet nga Komisioni Mbikëqyrës në rast të dështimit të Kuvendit për ta zgjedhur te njëjtin.

10. Për sa më sipër, komentet e dhëna nga [parashtruesit e kërkesës], vlerësojmë se nuk justifikojnë dot një sistem konfiskimi të tillë dhe as nuk argumentojnë pse pretendimet tona janë të pabazuara.”

## **Dispozitat kushtetuese dhe ligjore dhe dokumentet relevante**

120. Në vijim, Gjykata do të paraqes: (I) Dispozitat relevante të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (II) Dispozitat relevante të Deklaratës Universale për të Drejta e Njeriut dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (III) Dispozitat relevante të ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, që përfshijnë dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Të Pavarura; Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit; Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës; Ligjit Nr. 05/L-96 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit; Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës; Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar; Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit; (IV) Opinionet dhe *Amicus Curiae* të Komisionit të Venecias që ndërlidhen me konfiskimin e pasurisë; dhe (V) Opinionet e Komisionit të Venecias për Kosovën; dhe (VI) Dispozitat e kontestuar dhe ato relevante të Ligjit të kontestuar.

## **I.DISPOZITAT RELEVANTE TË KUSHTETUTËS**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 3 [Barazia para Ligjit]**

“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.  
[...]

#### **Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]**

- “1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.  
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.  
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.  
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.  
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.  
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.”

#### **Neni 7 [Vlerat]**

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.  
[...]

#### **Neni 21 [Parimet e përgjithshme]**

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.  
2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.  
3. Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.  
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

#### **Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]**

“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:  
(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;  
(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;  
[...]

#### **Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.  
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.  
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

**Neni 31**  
**[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.”

**Neni 32**  
**[E Drejta për Mjete Juridike]**

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”

**Neni 46**  
**[Mbrojtja e Pronës]**

- “1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.”

**Neni 55**  
**[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]**

*“1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*

*2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*

*3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*

*4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*

*5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar”*

**Neni 65**  
**[Kompetencat e Kuvendit]**

*“Kuvendi i Republikës së Kosovës:*

*(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;*

*[...]*

*(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;*

*[...]*

*(14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.*

*[...]”*

**Neni 102**  
**[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]**

*“1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.*

*2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.*

*3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*

*4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*

*5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankesë.”*

**Neni 103**  
**[Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave]**

*“[...]*

*2. Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor.”*

**Neni 106**  
**[Papajtueshmëria]**

*“1. Gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj.*

*2. Gjyqtarëve nuk u lejohe të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit.”*

**Kapitulli XII**  
**[Institucionet e Pavarura]**

**Neni 132**  
**[Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]**

*“1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*

*2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.*

*3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*

**Neni 133**  
**[Zyra e Avokatit të Popullit]**

*“1. Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj.*

*2. Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Të paktën një (1) nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.”*

**Neni 134**  
**[Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit]**

*“1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.*

*2. Avokat i Popullit ka të drejtë të zgjidhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, me arsim të lartë, me karakter e moral të lartë, i ndershëm, me eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut.*

*3. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e saj/tij nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike, as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale dhe as të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.  
[...]*

**Neni 135**  
**[Raportimi i Avokatit të Popullit]**

“[...]

3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore  
[...]

**Neni 136**  
**[Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]**

“1. Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar.

2. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përcaktohen me Kushtetutën dhe me ligj.

3. Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës.

4. Kuvendi vendos për shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij, në bazë të propozimit të Presidentit ose me nismën e një të tretës (1/3) së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. 5. Mandati i Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës është pesë (5) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandate”

**Neni 137**  
**[Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]**

“Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon:

(1) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë;

(2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;

(3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.”

**Neni 142**  
**[Agjencitë e Pavarura]**

“1. Agjencitë pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.

2. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.

3. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t’u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.”

## **II. DISPOZITAT RELEVANTE TË DEKLARATËS UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

### **DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

#### **Neni 2 (pa titull)**

*“Secilit i përkasin të gjitha të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë pa kurrfarë dallimesh në pikëpamje të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, mendimit politik ose çdo mendimi tjetër, të prejardhjes kombëtare a shoqërore, të pasurisë, të lindjes apo të ndonjë gjendje tjetër juridike. Përveç kësaj, nuk do të bëhen kurrfarë dallimesh në bazë të statusit politik, juridik apo ndërkombëtar të vendit ose territorit të cilit i përket ndonjë individ, qoftë kur ky vend ose territor është i pavarur, apo kur ndodhet nën kujdestari ose është i jetëqeverisës a nën çfarëdo kufizimi tjetër të sovranitetit.”*

#### **Neni 7 (pa titull)**

*“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë që, pa kurrfarë diskriminimi, të mbrohen njësoj nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për mbrojtje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë, dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.”*

### **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

#### **Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)**

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

*2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*

*3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

- a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*
- b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
- c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*
- d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët*

*e akuzës; e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.”*

**Neni 8**  
**(E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)**

*“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*

*2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”*

**Neni 13**  
**(E drejta për zgjidhje efektive)**

*“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*

**Neni 14**  
**(Ndalimi i diskriminimit)**

*“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër..”*

**PROTOKOLLI NR. 1 I KEDNJ-SË**

**Neni 1**  
**(Mbrojtja e pronës)**

*“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”*

**PROTOKOLLI NR. 12 I KEDNJ-SË**

**Neni 1**  
**(Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit)**

*“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.*



2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

### **III. DISPOZITAT RELEVANTE TË LEGJISLACIONIT NË FUQI**

**LIGJI NR. 06/L -113 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E  
ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE TË AGJENCIVE TË PAVARURA**  
**(i publikuar në Gazetën Zyrtare më 1 mars 2019)**

**KAPITULLI III  
AGJENCITË E PAVARURA**

**NËNKAPITULLI 1  
THEMELIMI DHE STATUSI I AGJENCIVE TË PAVARURA**

**Neni 38  
(Themelimi i agjencive të pavarura)**

- “1. Agjencitë e pavarura themelohen me ligj në bazë të nenit 142 të Kushtetutës.  
2. Një agjenci e pavarur mund të themelohet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, për të kryer kompetenca, që plotësojnë së bashku këto kushte:  
2.1. nuk janë pjesë e kompetencave të pushtetit ekzekutiv të Qeverisë sipas Kushtetutës, dhe  
2.2. i shërbejnë Kuvendit për ushtrimin e mbikëqyrjes/kontrollit parlamentar të specializuar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative.  
3. Ligji për themelimin e një agjencie të pavarur rregullon organizimin, funksionimin dhe kompetencat e agjencisë së pavarur.”

**Neni 39  
(Iniciativa ligjore për themelimin e një agjencie të pavarur)**

- “1. Propozimi i një projektligji për themelimin e një agjencie të pavarur ushtrohet sipas Kushtetutës.  
2. Propozuesi, së bashku me projektligjin dhe deklaratat e tjera shoqëruese të kërkuara sipas ligjit, duhet të paraqesë në Kuvend edhe deklaratën, që arsyeton plotësimin e kushteve të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 48 të këtij ligji dhe opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.  
3. Në rastin kur propozimi i projektligjit nuk paraqitet nga Qeveria, Kuvendi kërkon detyrimisht edhe mendimin e Qeverisë.  
4. Kapitulli IV i këtij ligji zbatohet duke u përshtatur me përmbajtjen e projektligjit dhe të memorandumit shpjegues.  
5. Kuvendi nuk merr në shqyrtim asnjë propozim, përveç nëse parashikohet ndryshe në Kushtetutë, që nuk është në pajtim me paragrafët 2 deri 4 të këtij neni.”

**Neni 40  
(Pavarësia dhe statusi i agjencive të pavarura)**

- “1. Agjencitë e pavarura gëzojnë pavarësi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre funksionale, organizative dhe në administrimin financiar në pajtim me ligjin.  
2. Agjencitë e pavarura gëzojnë personalitet juridik.”

### **NËNKAPITULLI 3**

#### **RAPORTIMI, MBIKËQYRJA DHE TRANSPARENCA E AGJENCIVE TË PAVARURA**

##### **Neni 43** **(Mbikëqyrja dhe performanca e agjencive të pavarura)**

- “1. Përveç kur parashihet ndryshe me ligj, agjencitë e pavarura i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.*
- 2. Veprimtaria e agjencisë së pavarur mbikëqyret në mënyrë të përhershme nga një komisioni i Kuvendit, që e mbulon fushën e përgjegjësisë përkatëse (në vijim: komisioni përgjegjës).*
- 3. Çdo agjenci e pavarur harton dhe i propozon komisionit përgjegjës planin vjetor të performancës për vitin e ardhshëm deri më 30 nëntor. Dispozitat e nenit 30 të këtij ligji për përmbajtjen e planit vjetor të performancës zbatohen edhe në këtë rast.*
- 4. Plani vjetor i performancës miratohet në bazë të një procesi-dialogu nga komisioni përgjegjës deri më datën 31 dhjetor.*
- 5. Çdo agjenci i paraqet komisionit përgjegjës raportin vjetor të performancës deri më datën 31 mars të vitit të pasardhës. Raporti vjetor i performancës përfshin informacion të detajuar për arritjen e objektivave, produkteve dhe rezultateve të përcaktuara në planin vjetor të performancës.*
- 6. Përveç raportit vjetor sipas paragrafit 5 të këtij neni, agjencia paraqet, gjithashtu, raporte për periudha më afatshkurtra apo raporte për çështje të posaçme, nëse kërkohet nga komisioni përgjegjës.*
- 7. Raporti vjetor i performancës shqyrtohet nga komisioni përgjegjës në dialog me agjencinë përkatëse. Komisioni përgjegjës, bazuar në rezultatet e mbikëqyrjes së përhershme dhe në shqyrtimin e raportit të paraqitur, përgatit një raport vlerësimi të performancës dhe një projektrezolutë, që përfshin vlerësimin e punës të agjencisë.*
- 8. Përmbledhja e raportit të performancës të agjencisë prezantohet në mbledhjen e Kuvendit nga titullari i tij apo përfaqësuesi i organit drejtues kolegjal. Në të njëjtën mbledhje prezantohet edhe raporti i vlerësimit të performancës të komisionit përgjegjës.*
- 9. Pas prezantimit në mbledhjen e Kuvendit, raporti i vlerësimit të performancës dhe projektrezoluta e hartuar nga komisioni përgjegjës votohen.*
- 10. Plani vjetor i performancës, raporti vjetor i performancës, si dhe raporti i vlerësimit të performancës dhe rezoluta e miratuar nga Kuvendi, bëhen publike nga administrata e Kuvendit, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme.”*

### **NËNKAPITULLI 4**

#### **EMËRIMI DHE LIRIMI I TITULLARIT APO ANËTARIT TË ORGANIT DREJTUES TË AGJENCISË SË PAVARUR**

##### **Neni 46** **(Kushtet dhe procedura për emërimin e titullarit apo anëtarit të organit drejtues)**

- “1. Kushtet për emërimin e titullarit apo anëtarit të organit drejtues të një agjencie të pavarur, përcaktohen me ligjin e themelimit të agjencisë.*
- 2. Procedura e zgjedhjes, miratimit apo dhënies së pëlqimit për titullarin dhe anëtarin e organit drejtues përcaktohet me ligjin e themelimit dhe Rregulloren e Kuvendit.”*

**Neni 47**  
**(Procedura e shkarkimit të titullarit dhe anëtarit të organit drejtues)**

*“Procedura e shkarkimit të titullarit dhe anëtarit të organit drejtues përcaktohet me ligjin e themelimit dhe Rregulloren e Kuvendit.”*

**RREGULLORE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**(E publikuar në Gazetën Zyrtare më 9 gusht 2022)**

**Neni 98**  
**(Procedurat e veçanta të raportimit të organeve të pavarura)**

*“1. Kuvendi në pajtim me ligje të veçanta dhe me ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, mbikëqyr punën e organeve të pavarura.*

*2. Raportin vjetor të punës së organit të pavarur e shqyrton Komisioni përgjegjës-raportues.*

*3. Komisioni përgjegjës-raportues shqyrton raportin vjetor të organit të pavarur dhe i paraqet raport me rekomandime Kuvendit, pasi që raporti financiar dhe i auditimit të atij organi të jetë shqyrtuar nga komisionet përkatëse dhe t'i jenë proceduar Komisionit funksional.*

*4. Raporti me rekomandime përmban:*

*4.1. Vlerësimin e punës së organit të pavarur;*

*4.2. Vlerësimin për raportin vjetor dhe*

*4.3. Rekomandimet.*

*5. Shqyrtimi i raportit vjetor në seancën plenare të Kuvendit fillon me paraqitjen e raportit nga Komisioni përgjegjës-raportues. Pas paraqitjes së raportit, të drejtë për të diskutuar, sipas radhës, e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe deputetët.*

*6. Kur raporti nuk miratohet nga Kuvendi, Komisioni përgjegjës-raportues mund të rekomandojë masat e përgjegjësisë për drejtuesit e organit të pavarur në përputhje me ligjin përkatës.*

*7. Përgjashtimisht nga paragrafi 5 i këtij neni, me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit, në seancë plenare mund t'i jepet fjala edhe drejtuesit të organit të pavarur.*

*8. Raporti vjetor i punës dhe ai financiar i institucionit të pavarur kushtetues diskutohen në seancë plenare, dhe i nënshtrohen votimit, me përjashtim të rekomandimeve të dhëna nga këto institucione për institucionet e tjera publike.”*

**LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR GJYKATAT**  
**(i publikuar në Gazetën Zyrtare më 18 dhjetor 2018)**

**Neni 4**  
**(Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatave)**

*“1. Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.*

*2. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.”*

## **Neni 38 (Veprimtaritë profesionale)**

- “1. Gjyqtaret me aprovimin paraprak të Këshillit, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve.
2. Gjyqtarët me aprovimin e Kryetarëve të Gjykatave dhe Kryetarët me aprovim të Këshillit, vetëm jashtë orarit të punës, mund të marrin pjesë në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe Sjelljen profesionale të gjyqtarëve.
3. Në pajtim me dispozitat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve, gjyqtarët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve gjyqësore gjatë apo pas përfundimit të funksionit gjyqësor, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor, të lëshuar nga Këshilli.
4. Gjyqtarët, për aktivitetet e parapara në këtë nen pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej njëzetepesë (25%) për qind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim Gjyqtaret e njoftojnë Kryetarin e Gjykatës kurse Kryetarët e Gjykatave e njoftojnë Këshillin.”

## **LIGJI Nr. 05/L -019 PËR AVOKATIN E POPULLIT (i publikuar në Gazetën Zyrtare më 26 qershor 2015)**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 (Qëllimi)**

- “1. Ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: autoritetet publike), si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.
2. Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi.”

### **KAPITULLI III KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË POPULLIT**

#### **Neni 16 (Kompetencat)**

- “1. Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.

2. *Kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.*
3. *Në ushtrimin e funksioneve të tij, Avokati i Popullit mund t'u ofrojë shërbime të mira të gjithë banorëve të Republikës së Kosovës si dhe personave të tjerë që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës.*
4. *Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.*
5. *Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve.*
6. *Nëse Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë apo ndonjë person tjetër në emër të të dëmtuarit i drejtohet me parashtrësë Avokatit të Popullit për ngritjen e procedurës, është i nevojshëm pëlqimi nga personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut. Përgjatimisht, nëse personi i dëmtuar ka vdekur apo nuk është në gjendje të jap pëlqimin për ndonjë arsye tjetër, ky pëlqim duhet të kërkohet nga të afërmit e ngushtë dhe nëse të afërmit e tillë nuk ekzistojnë apo nuk mund të kontaktohen, pëlqimi nuk është i nevojshëm.*
7. *Kur Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 6 i këtij neni.*
8. *Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.*
9. *Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.*
10. *Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.*
11. *Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe me anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit.*
12. *Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas.*
13. *Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për barazi gjinore dhe legjislacionin tjetër në fuqi.*
14. *Mbledh të dhëna statistikore në lidhje me çështjet e diskriminimit dhe barazisë të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe i publikon ato.*
15. *Publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë.*
16. *Bashkëpunon me partnerët social dhe organizatat jo-qeveritare që merren me çështje të barazisë dhe jo-diskriminimit, si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtare me Avokatin e Popullit.”*

## **Neni 18 (Përgjegjësitë)**

“1. *Avokati i Popullit ka këto përgjegjësi:*

- 1.1. *të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre;*

- 1.2. të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;
- 1.3. të hartojë dhe miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët, si dhe krijimin e një ekipi të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe një programi të përhershëm që fëmijët të bëhen të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre;
- 1.4. të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave;
- 1.5. të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit;
- 1.6. t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta;
- 1.7. të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës;
- 1.8. të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës;
- 1.9. t'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv;
- 1.10. të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;
- 1.11. Avokati i Popullit, zëvendësit dhe personeli i tij duhet ruajtur fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 1.12. obligimi për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare vlen edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës.
2. Avokati i Popullit mund t'i ofrojë këshilla dhe t'i japë rekomandime çdo personi fizik dhe juridik lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore me standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.
3. Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës.
4. Avokati i Popullit i ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas paragrafit 1 të nenit 16 të këtij ligji, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme të caktuar nga Avokati i Popullit. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e ankesës së parashtruar sipas paragrafit 1 të nenit 16 të këtij ligji, nga autoritetet kompetente kërkohet të përgjigjen me nguti.
5. Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.
6. Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet, të çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, duke përfshirë dosjet mjekësore për personat e privuar nga liria, në pajtim

me ligj, dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.

7. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të kufizuar të lëvizjes dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet.

8. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij, sipas detyrës zyrtare, mund të hyjnë në të gjitha hapësirat zyrtare të të gjitha autoriteteve.”

**LIGJI NR. 05/L-055 PËR AUDITORIN E PËRGJITHSHËM DHE ZYRËN  
KOMBËTARE TË AUDITIMIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**(i publikuar në Gazetën Zyrtare më 10 qershor 2016)**

**Neni 4  
(Auditori i Përgjithshëm)**

“[...]

6. Pozita e Auditorit të Përgjithshëm është punë me orar të plotë dhe nuk mund të jetë i punësuar me pagesë në ndonjë vend tjetër pune gjatë kohës gjersa shërben si Auditor i Përgjithshëm.

[...]”

**Neni 9  
(Menaxhmenti)**

“[...]

5. Auditori i Përgjithshëm dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm nuk mund të marrin pjesë në, apo të marrin ndonjë vendim për, auditimin e institucionit në të cilin kanë qenë anëtarë të menaxhmentit gjatë tre (3) viteve të mëparshme.

[...]”

**Neni 17  
(Mospërputhshmëritë)**

“1. Punonjësit nuk ushtrojnë funksione apo aktivitete, ose mbajnë pozita, të cilat përbëjnë konflikt interesi me detyrat e zyrtare dhe:

1.1. nuk mban ndonjë funksion tjetër në cilindo nivel të sektorit publik;

1.2. nuk është anëtar i bordeve drejtuese ose bordeve të tjera të kompanive publike ose private;

1.3 nuk mban ndonjë funksion në një parti politike dhe nuk ndjek udhëzimet e partive politike; dhe

1.4. nuk ushtron aktivitete tjera i cili kompensohet, përveç nëse është i autorizuar paraprakisht nga Auditori i Përgjithshëm.”

**KODI 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE**  
**(i publikuar në Gazetën Zyrtare më 17 gusht 2022)**

**Neni 269**  
**(Konfiskimi)**

*“1. Pas dënimit të të pandehurit për veprë penale, gjykata konfiskon të gjitha pasuritë e specifikuar të përcaktuara në aktakuzë ose në njoftim sipas nenit 278 paragrafi 5 të këtij Kodi.*

*2. Nëse ndonjë pasuri e specifikuar, tërësisht ose pjesërisht, nuk është në dispozicion për t’u konfiskuar për çfarëdo arsye, gjykata përcakton vlerën monetare të pasurisë së tillë të specifikuar dhe vepron në pajtim me dispozitat e nenit 273 të këtij Kodi.*

*3. Vlera monetare e pasurisë së specifikuar është vlera më e madhe e përcaktuar ose në kohën e dënimit ose kur është marrë së pari nga i pandehuri ose pala e tretë.”*

**Neni 274**  
**(Procedura e konfiskimit gjatë shqyrtimit gjyqësor)**

*“1. Prokurori i shtetit, i pandehuri dhe pala e tretë që pretendon interes juridik mbi pasurinë e specifikuar ka mundësinë që në shqyrtim gjyqësor të:*

*1.1. bëj parashtrësia dhe të paraqesë prova në gjykatë;*

*1.2. të merr në pyetje dëshmitarë dhe të paraqesë prova në mbështetje apo në kundërshtim të ndonjë kërkesë që mund të bëhet sipas këtij Kapitulli; dhe*

*1.3. të paraqesë prova në gjykatë nga eksperti i kualifikuar financiar lidhur me konstatimet faktike që gjykata duhet t’i bëj sipas këtij Kapitulli.*

*2. Aktgjykimi përmban arsyetimin nëse prokurori i shtetit ka vërtetuar se çdo send nga pasuria e përshkruar në aktakuzë ose në njoftim sipas nenit 278 paragrafi 5 të këtij Kodi është pasuri e specifikuar që i nënshtrohet konfiskimit.*

*3. Nëse gjykata ka bërë përcaktim në bazë të nenit 273 të këtij Kodi, aktgjykimi përmban gjithashtu arsyetimin nëse është vërtetuar se:*

*3.1. pasuria e specifikuar, tërësisht ose pjesërisht, nuk është në dispozicion për konfiskim në tërësi ose pjesërisht për çfarëdo arsye; dhe*

*3.2. i pandehuri dhe/ose pala e tretë kanë pasuri tjera me vlerë të barabartë me shumën e vlerës monetare të përcaktuar në nenin 269 të këtij Kodi.*

*4. Çdo send i pasurisë së specifikuar i përshkruar në aktakuzë ose në njoftim sipas nenit 278 paragrafi 5 të këtij Kodi që i nënshtrohet konfiskimit, trajtohet veçmas në aktgjykimin e gjykatës.*

*5. Për të përcaktuar ndonjë çështje faktike të ngritur në këtë Kapitull, gjykata mund të caktojë ekspertë.”*

**Neni 275**  
**(Konfiskimi i pasurive shtesë pasi që aktgjykimi të jetë përfundimtar)**

*“1. Ky nen zbatohet nëse plotësohen kushtet në vijim:*

*1.1. gjykata e ka dënuar të pandehurin për veprë penale;*

*1.2. gjykata ka konstatuar se i pandehuri ka marrë dobi pasurore nga vepra penale ose ka bërë dhuratë të njollosur;*

*1.3. dobia pasurore ose dhurata e njollosur, tërësisht ose pjesërisht, nuk është në dispozicion për t’u konfiskuar për çfarëdo arsye.*

*2. Nëse përmbushen kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, prokurori i shtetit mundet, në çdo kohë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të kërkojë nga gjykata e cila e ka nxjerr*



aktgjykimin e plotfuqishëm konfiskimin e çfarëdo pasurie shtesë të të pandehurit apo palës së tretë, deri në vlerën monetare të dobisë pasurore apo dhuratës së njollosur të përcaktuar nga gjykata sipas nenit 269 të këtij Kodi.”

### **Neni 278 (Hetimi për konfiskimin)**

“1. Nëse prokurori i shtetit ka dyshim të arsyeshëm se mund të bëhet kërkesë për konfiskim, prokurori i shtetit mund të fillojë hetimin për konfiskim:

1.1. në çdo fazë të hetimit penal;

1.2. pas ngritjes së aktakuzës;

1.3. para shqyrtimit gjyqësor

1.4. gjatë shqyrtimit gjyqësor; dhe

1.5. pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, nëse kërkesa bëhet në bazë të nenit 275 të këtij Kodi.

2. Hetimi i konfiskimit është hetim për pasurinë e specifikuar që mund t’i nënshtrohet kërkesës për konfiskim sipas nenit 269 të këtij Kodi.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, prokurori i shtetit mund të përdorë të gjitha kompetencat dhe veprimet hetimore të përmendura në këtë Kod për fazat para-hetimore dhe hetimore.

4. Gjukata themelore kompetente cakton një gjyqtar për procedurat e hetimit të konfiskimit nëse ky Kod kërkon vendim që lëshohet nga Gjukata.

5. Nëse hetimi i konfiskimit rezulton në zbulimin e ndonjë pasurie të re të specifikuar që nuk dihet në kohën e ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit njofton me shkrim gjykatën dhe palët në procedurë.”

## **LIGJI Nr. 06/L-087 PËR KOMPETENCAT E ZGJERUARA PËR KONFISKIMIN E PASURISË**

**(I publikuar në Gazetën Zyrtare më 16 dhjetor 2018)**

### **Neni 1 (Qëllimi)**

“1. Ky Ligj përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë atëherë kur procedurat e detajuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës nuk janë të mjaftueshme.

2. Ky ligj, po ashtu implementon Direktivën 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 3 prill 2014 mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian.”

### **Neni 2 (Fushëveprimi)**

“1. Konfiskimi i zgjeruar siç parashihet me këtë Ligj zbatohet për pasurinë e personave të dënuar për ndonjë nga veprat penale të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera, si në vijim

1.1. veprat penale kundër krimit të organizuar;

1.2. veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale të ndërlidhura me detyrën zyrtare;

1.3. veprat penale kundër shëndetit publik;

1.4. veprat penale të trafikimit me njerëz, skllavërisë dhe rrëmbimit;

- 1.5. veprat penale seksuale;
  - 1.6. veprat penale lidhur me konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit;
  - 1.7. veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
  - 1.8. veprat penale lidhur me terrorizmin;
  - 1.9. veprat penale lidhur me drogat;
  - 1.10. veprat penale lidhur me armët;
  - 1.11. veprat penale kibernetike;
  - 1.12. veprat penale kundër ekonomisë;
  - 1.13. veprat penale kundër pasurisë;
  - 1.14. veprat penale kundër ambientit;
  - 1.15. tentimi, shtytja, ndihma dhe marrëveshja për të kryer ndonjërin nga veprat penale të përcaktuara nga nënparagrafi 1.1 deri në 1.14 të këtij neni; ose
  - 1.16. çdo vepër penale që ka sjell përfitime materiale që tejkalojnë dhjetë mijë (10,000) euro.
2. Përveç paragrafit 1 të këtij neni, fushëveprimi i këtij ligji përfshin edhe konfiskimin e përfitimit material ose të mjeteve për kryerjen e një vepre penale siç është përcaktuar në Kapitullin IV të këtij ligji (Dispozitat në lidhje me Konfiskimin e Përfitimit Material ose të Mjeteve për Kryerjen e një Vepre Penale).”

### **Neni 3 (Përkufizimet)**

“1. Shprehjet e përdorura në këtë ligji, do të kenë këto kuptime:

- 1.1. **Konfiskim** – konfiskimi i përhershëm i pasurisë, i urdhëruar me një vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente në përputhje me këtë ligj.
- 1.2. **Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit** – masat për konfiskimin e pasurisë sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj.
- 1.3. **I pandehuri** – personi, përfshirë këtu edhe personin juridik, siç është përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Për qëllim të këtij ligji, kjo shprehje përfshin gjithashtu personin e dënuar.
- 1.4. **Blerësi Bona fide** – personi i cili e ka blerë pasurinë e të pandehurit dhe për atë pasuri ka paguar çmimin, i cili nuk është në mënyrë domethënëse më i ulët sesa çmimi i tregut. Blerës bona fide nuk konsiderohet personi i cili pavarësisht çmimit të paguar, e ka ditur ose është dashur të dijë se pasuria e blerë, është shitur me qëllim të evitimit të konfiskimit përmes transferimit ose përvetësimit të saj apo nëse pasuria e transferuar ose e përvetësuar është përfituar nga një vepër penale
- 1.5. **Pasuria e të pandehurit** – çdo lloj prone, substanciale ose jo - substanciale, e luajtshme ose e paluajtshme, e prekshme ose e paprekshme, si dhe dokumente apo instrumente ligjore siç përcaktohet në paragrafin 2 dhe nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të nenit 8 të këtij ligji, që dëshmojnë pasurinë ose interes ndaj pasurive të tilla, e të cilat:
  - 1.5.1. i pandehuri i ka fituar brenda dhjetë (10) viteve para ditës kur është iniciuar faza hetimore për një vepër penale të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji; ose
  - 1.5.2. janë në pronësi ose në posedim të një pale të tretë për llogari ose përfitim të të pandehurit; ose
  - 1.5.3. i pandehuri i ka transferuar tek një palë e tretë e cila nuk ishte një blerës bona fide, ose që më pas janë transferuar në vazhdimësi tek palët e tjera të treta të cilat nuk ishin blerës bona fide, brenda 10 viteve para ditës kur është iniciuar faza hetimore për një vepër penale të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji (në tekstin e mëtejshëm: Pasuria e transferuar).

[...]”

## **KAPITULLI II KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT**

### **Neni 4 (Kërkesa për Verifikim të Pasurisë së të Pandehurit të Dënuar)**

- “1. Pasi një i pandehur shpallet fajtor për një vepër penale të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Prokurori i shtetit, me një kërkesë të veçantë (në tekstin e mëtejme: kërkesë për verifikim të pasurisë) në gjykatën, e cila e ka nxjerrë aktgjykimin, mund të kërkojë verifikimin e pasurisë brenda periudhës pesë (5) vjeçare pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, siç është përcaktuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.*
- 2. Në kërkesën për verifikim të pasurisë, Prokurori i Shtetit do të:*
- 2.1. paraqes të gjitha pasuritë që janë objekt i verifikimit të pasurisë;*
  - 2.2. identifikojë në mënyrë të qartë çdo pasuri;*
  - 2.3. ofrojë prova që secila pjesë e pasurisë është pronë e të pandehurit, siç përcaktohet në nenin 3 nën-paragrafi 1.5 të këtij ligji.*
- 3. Prokurori i shtetit do ju dorëzojë nga një kopje të kërkesës për verifikim të pasurisë të pandehurit dhe të gjitha palëve të treta të njohura, të cilat mund të kenë një interes ligjor në pasurinë që është objekt i kërkesës.  
[...]*”

### **Neni 17 (Hetimi për Konfiskim)**

- “1. Nëse prokurori i Shtetit ka dyshimin e arsyeshëm se mund të bëhet një kërkesë për verifikim të pasurisë sipas nenit 4 të këtij ligji, mund të iniciojë një hetim për konfiskim:*
- 1.1. në çfarëdo faze të hetimit penal;*
  - 1.2. pasi është ngritur aktakuza;*
  - 1.3. para shqyrtimin kryesor;*
  - 1.4. gjatë shqyrtimin kryesor; dhe*
  - 1.5. pas përmbylljes së shqyrtimin kryesor dhe brenda kufizimit kohor të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji.*
- 2. Një hetim për konfiskim është një hetim mbi pasurinë e cila mund t'i nënshtrohet një kërkesë për verifikim të pasurisë nga neni 4 i këtij ligji.*
- 3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, Prokuror i Shtetit mund të përdorë të gjitha kompetencat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës për hetim dhe veprime gjatë fazave para-hetimore dhe hetimore.*
- 4. Gjykata Themelore kompetente cakton një gjyqtar për procedurat e hetimit për konfiskim nëse Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës kërkon që të nxirret një vendim nga Gjykata.”*

### **Neni 18 (Urdhër për Zbulim të Informacionit)**

- “1. Prokurori i Shtetit mund të kërkojë urdhër për zbulim të informacionit, si pjesë e hetimit të konfiskimit.*
- 2. Urdhëri për zbulim të informacionit e autorizon Prokurorin e Shtetit që t'i dorëzojë një njoftim me shkrim çdo personi që ai/ajo ka dyshimin e arsyeshëm që ka informata relevante për hetimin për konfiskim, duke i kërkuar atij/asaj të ndërmarrë cilindo apo të gjitha, veprimet si në vijim:*
- 2.1. përgjigjur pyetjeve menjëherë ose në një kohë dhe vend të specifikuar në njoftim;*

- 2.2. dhënien e informacionit të specifikuar në njoftim në një kohë dhe mënyrë të specifikuar po aty;
- 2.3. sigurimin e dokumenteve ose dokumenteve përshkruese të specifikuara në njoftim, ose në kohën e specifikuar ose deri në kohën e specifikuar ose menjëherë, si dhe në mënyrën e specifikuar.
3. Informacioni relevant është informacion (në përmbajtjen e një dokumenti ose jo) në lidhje me të cilin prokurori i shtetit e ka dyshimin e arsyeshëm të jetë relevant për hetimin për konfiskim.
4. Kërkesa për një urdhër për zbulim të informacionit, në mes tjerash, duhet të përshkruaj se:
- 4.1. personi i caktuar në kërkesë është subjekt i një hetimi për konfiskim i cili po zhvillohet nga prokurori i shtetit;
- 4.2. urdhri kërkohet për qëllimet e hetimit; dhe
- 4.3. informatat të cilat mund të sigurohen në pajtueshmëri me një kusht të imponuar në urdhër ka gjasa që të jetë me vlerë domethënëse (nga vet informacioni ose jo) për hetimin për qëllim të së cilit është nxjerrë urdhri.
5. Një person kryen veprë penale nëse pa justifikim të arsyeshëm ai ose ajo dështon të veprojë në përputhje me një kusht të imponuar atij/asaj në një urdhër për zbulim të informacionit.
6. Një person i shpallur fajtor për një veprë penale nga paragrafi 5 i këtij neni, dhe është dënuar me;
- 6.1. dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) muaj;
- 6.2. gjobë prej pesë mijë (5,000) euro; ose 6.3. që të dyja së bashku.
7. Një person kryen veprë penale nëse, duke pretenduar se vepron në përputhje me një kusht të imponuar, atij ose asaj, në bazë të një urdhri për zbulim të informacionit, ai ose ajo bën një deklaratë të cilën ai ose ajo e di, ose ka arsye të dyshojë, se është e rreme ose keq-informuese në një të dhënë materiale.
8. Një person fajtor për një veprë penale nga paragrafi 7 i këtij neni është përgjegjës për dënim me:
- 8.1. burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite;
- 8.2. gjobë prej pesëdhjetë mijë (50.000) euro;
- 8.3. të dyja së bashku.
9. Një person nuk mund të refuzojë zbatimin e një urdhri për dhënien e informacioneve shpjeguese, me arsyetimin se pajtueshmëria do ta inkriminonte atë person në kryerjen e një veprë penale. Çdo informacion ose material i siguruar nga personi, në pajtim me urdhrin për dhënien e informacioneve, nuk do të jetë i pranueshëm në asnjë procedurë penale kundër atij personi, përveç nëse informacioni i dhënë tejkalon qëllimin e urdhrin për dhënien e informacionit.
- [...]
18. Një kopje e urdhrin të lëshuar nga Gjykata për zbulim të informacionit do t'i shërbehet të pandehurit dhe çdo pale të emërtuar në urdhër.
19. Një kërkesë për të anuluar ose ndryshuar një urdhër për zbulim të informacionit mund të bëhet në Gjykatë nga prokurori i shtetit, ose çdo person i prekur nga urdhri.
20. Gjyqtari mund ta anulojë ose ndryshojë urdhrin.”

**LIGJI Nr. 05/L -096 PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE  
LUFTIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT**  
**(i publikuar në Gazetën Zyrtare më 15 qershor 2016)**

**Neni 1**  
**(Qëllimi dhe Fushëveprimi)**

*“1. Ky ligj përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.  
2. Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre si dhe për të gjithë subjektet jo publike që i nënshtrohen aktiviteve që mund të ndërlidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, sipas dispozitave të këtij ligji.  
3. Ky ligj ka për qëllim implementimin e Direktivës së BE-së 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren e BE-së Nr. 648/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/EC.”*

**Neni 4**  
**(Statusi i Njësisë për Inteligjencë Financiare)**

*“1. NjIF-K është institucioni qendror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave, përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.  
2. NjIF-K ka buxhetin e vet i cili sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit. NjIF-K vendosë në mënyrë të pavarur për shfrytëzim të buxhetit, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.  
3. Staf i profesional i NjIF-K nuk janë nëpunës civil. Megjithatë legjislacioni që rregullon çështjet e shërbimit civil zbatohet ndaj stafit të NjIF-K, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore të cilat do të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore të shërbimit civil.  
4. Aktet nënligjore për organizimin e brendshëm administrativ dhe çështje tjera administrative të NjIF-K propozohen nga drejtori i NjIF-K dhe aprovohen nga ana e Bordit të NjIF-K.”*

**Neni 14**  
**(Detyrat dhe kompetencat e NjIF-K)**

*“1. NjIF-K është e autorizuar:*

- 1.1. të marrë dhe analizojë raportet dhe informacionet:*
  - 1.1.1. të bëra dhe të ruajtura sipas neneve 16 deri në 33 të këtij ligji;*
  - 1.1.2. që i janë ofruar NjIF-K-së nga NjIF-të e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, nga gjykatat ose nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare e ndërkombëtare, organet publike ose qeveritare; dhe*
  - 1.1.3. që i janë ofruar vullnetarisht NjIF-K-së në lidhje me dyshimet për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe/ose financimit të terrorizmit.*

- 1.2. të grumbullojë informacione që kanë lidhje me aktivitetet e pastrimit të parave dhe veprave të ndërlidhura penale ose financimin e aktiviteteve terroriste dhe që është në dispozicion publik, përfshirë bazën e të dhënave komerciale në dispozicion;
- 1.3. të kryejë analiza strategjike të informatave që i grumbullon dhe pranon, për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit;
- 1.4. të kërkojë nga subjektet raportuese të dhëna, dokumente dhe informata që i duhen me qëllim që të ushtrojë detyrat që dalin nga ky ligj. Të dhënat, dokumentet dhe informatat duhet t'i ofrohen brenda afatit kohor të përcaktuar nga NjIF-K;
- 1.5. të kërkojë nga organet publike ose qeveritare të dhëna, dokumente dhe informata që i duhen me qëllim që të ushtrojë detyrat që dalin nga ky ligj dhe qasje në bazat e të dhënave të cilat mbahen nga këto organe. Informatat e tilla duhet t'i ofrohen pa vonesë;
- 1.6. të krijojë dhe mirëmbajë bazën e të dhënave për të gjitha informacionet e mbledhura ose të pranuar në lidhje me dyshimin për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale ose financimin e terrorizmit si dhe materiale të tjera të ngjashme relevante për punën e NjIF-K;
- 1.7. të përpilojë informata, statistika, raporte dhe, duke u bazuar në ato, t'u bëjë rekomandime Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës dhe personave apo organeve të tjera relevante, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit;
- 1.8. t'i bëjë publike raportet që do të ndihmojnë në kryerjen e detyrave të saj;
- 1.9. të organizojë dhe kryejë trajnime të rregullta, përfshirë vetëdijësim dhe sensibilizim në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit si dhe detyrimet e subjekteve raportuese;
- 1.10. të shpërndajë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, rezultatet që dalin nga analizat dhe çdo raport apo informacion të nevojshëm për autoritetet përkatëse;
- 1.11. të miratojë akte nënligjore, të lëshojë urdhra dhe udhëzues mbi çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin ose promovimin e pajtueshmërisë me këtë ligj, duke përfshirë por jo kufizuar në:
- 1.11.1. përdorimin e formave të standardizuara raportuese;
- 1.11.2. aktet ose transaksionet e dyshimta, përfshirë natyrën e akteve ose transaksioneve të dyshimta për qëllime të këtij ligji, si dhe hartimin e listave të indikatorëve të këtyre akteve dhe transaksioneve;
- 1.11.3. lirin e personave ose subjekteve, apo grup personash ose subjektesh, nga obligimet e raportimit sipas këtij ligji, si dhe metodat për të raportuar lirime të tilla.
- 1.12. të lëshojë urdhër për moskryerjen e transaksionit në pajtim me këtë ligj apo të kërkojë nga subjektet raportuese të monitorojë llogaritë apo marrëdhënien e biznesit për një periudhë kohore deri në tre (3) muaj; apo për një periudhë shtesë siç përcaktohet nga NjIF-K;
- 1.13. të mbikëqyrë dhe monitorojë subjektet raportuese për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj si dhe me akte nënligjore, urdhrat dhe urdhëresat, që rrjedhin dhe parashihen me këtë ligj, qoftë në terren qoftë në distance;
- 1.14. të merr pjesë në organizime për bashkëpunim ndërkombëtarë në fushën e parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit;
- 1.15. të kryejë funksione të tjera në pajtim me këtë ligj.
2. Staf i NjIF-K-së ruan dhe nuk zbulon asnjë informacion të marrë në kuadër të fushëveprimit të detyrave të tyre, madje edhe pas ndërprerjes së detyrave të tyre

brenda NjIF-K. Informacione të tilla mund të përdoren vetëm për qëllimet e ofruara në pajtim me këtë ligj.

3. NjIF-K dhe institucionet e tjera në Kosovë bashkëpunojnë në mënyrë reciproke, ndihmojnë njëra-tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe koordinojnë aktivitetet në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e zbatueshme. Për këtë qëllim, NjIF-K mund të nënshkruajë marrëveshje apo memorandume mirëkuptimi.”

## **Neni 16 (Subjektet Raportuese)**

“1. Subjekte raportuese për qëllime të këtij ligji janë:

- 1.1. bankat;
- 1.2. institucionet financiare;
- 1.3. kazinotë, përfshirë ato në internet dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit;
- 1.4. agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme;
- 1.5. personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë;
- 1.6. avokatët dhe noterët kur përgatiten, kryejnë ose përfshihen në transaksione për klientët e tyre rreth aktiviteteve të mëposhtme:
  - 1.6.1. blerjen dhe shitjen e pasurive të patundshme;
  - 1.6.2. menaxhimin e parave, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientit;
  - 1.6.3. menaxhimin e llogarive bankare, kursimeve ose të letrave me vlerë;
  - 1.6.4. organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive; dhe
  - 1.6.5. krijimin, funksionimin ose menaxhimin e personave ose marrëveshjeve juridike dhe blerjen e shitjen e subjekteve afariste.
- 1.7. kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët tatimor;
- 1.8. trusti dhe ofruesit e shërbimeve që nuk përfshihen në këtë ligj, të cilët i ofrojnë shërbimet e mëposhtme palëve të treta në baza komerciale:
  - 1.8.1. duke vepruar si agjent formimi i personave juridikë;
  - 1.8.2. duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprorë si një drejtor ose sekretar i një kompanie, një partner i një partneriteti, apo një pozitë të ngjashme në lidhje me persona të tjerë juridikë;
  - 1.8.3. duke siguruar një zyrë të regjistruar, akomodim ose adresë për biznesin, adresë zyrtare ose me korrespondencë për një kompani, partneritet ose ndonjë person a marrëveshje tjetër juridike;
  - 1.8.4. duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprorë si administrator i besuar i një trusti të caktuar;
  - 1.8.5. duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprorë si një aksionar i emëruar për një person tjetër.
- 1.9. OJQ-të; dhe
- 1.10. shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar.”

## **Neni 49 (Procedura e ndëshkimeve administrative)**

“1. NjIF-K, BQK si dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial, pasi të kenë konstatuar se ekziston shkelje e dispozitave të këtij ligji, marrin vendimin për shqiptimin e ndëshkimit administrativ për shkeljet për të cilat i është dhënë kompetencë sipas këtij ligji.

2. Gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ sipas këtij ligji merren në konsideratë të gjitha rrethanat relevante, duke përfshirë edhe shkallën dhe kohëzgjatjen e mos-përputhshmërisë, shkallën e përgjegjësisë, fuqinë financiare të subjektit raportues, humbjet e shkaktuar si pasojë e shkeljes, shkeljet e mëparshme si dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit raportues.
3. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial, për shkeljet në kuadër të kompetencave të dhëna me këtë ligj, njoftojnë subjektin raportues për dështimin për të qenë në përputhje me obligimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, duke dërguar vendimin për shqiptimin e ndëshkimit administrativ. Njoftimi për shqiptimin e ndëshkimit administrativ bëhet, përmes dorëzimit të vendimit në mënyrë të verifikueshme te subjekti raportues në përputhje me kërkesat e Ligjit për Procedurën Administrative.
4. Menjëherë pas pranimit të vendimit për shqiptimin e ndëshkimit administrativ subjekti raportues ndërmerr veprime për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj. Subjekti raportues i ndërmerr këto masa brenda afatit kohor të caktuar në vendim.
5. Pajtueshmëria e subjektit raportues me dispozitat e këtij ligji verifikohet dhe për këtë qëllim NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial mund të bëjnë inspektive në vend gjatë periudhës kohore të përcaktuar në vendimin për ndëshkimin administrativ apo duke u bazuar në kërkesën e subjektit raportues.
6. Nëse subjekti raportues të cilit i është shqiptuar ndëshkimi administrativ sipas këtij neni nuk ka ndërmarrë veprime pajtueshmërie brenda periudhës kohore të definuar në vendimin për ndëshkim administrativ, atëherë NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial, mund të shqiptojnë gjobë monetare në baza ditore për çdo ditë që shkelja vazhdon derisa të përcaktohet se pajtueshmëria e kërkuar është arritur. Procedura e njëjtë e ndëshkimit administrativ dhe njoftimeve të definuar sipas këtij neni aplikohen në këtë rast.
7. Për çdo ditë të mos-pajtueshmërisë, prej periudhës kohore të përcaktuar në vendimin e NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësve tjerë sektorial, subjekti raportues i nënshtrohet gjobës ditore prej pesëqind (500) euro.
8. Për ndëshkimin administrativ sipas paragrafit 6. të këtij neni, ku shqiptohet gjoba monetare në baza ditore, NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial marrin vendim që përcakton numrin e ditëve gjatë së cilave subjekti raportues nuk ka qenë në pajtueshmëri me këtë ligj brenda periudhës kohore të definuar në vendim, siç përcaktohet në paragrafin 4. të këtij neni. Vendimi me shkrim për gjobë monetare në baza ditore përcakton ekzistencën e dështimit për të ndërmarrë veprime pajtueshmërie sipas vendimit për ndëshkim dhe dispozitave të këtij ligji, si dhe shqiptimin e gjobës sipas numrit të ditëve të mos-pajtueshmërisë.
9. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nuk do të marrin vendime për ndëshkime administrative për të njëjtat mos-pajtueshmëri të subjekteve raportuese pasi që shkelja e përsëritur konsiderohet siç është definuar në nenin 41 dhe në nenin 43 të këtij ligji.
10. Për subjektet raportuese të cilët veprojnë duke u bazuar në licencë apo autorizim tjetër, NjIF-K informon autoritetin kompetent licencues apo autorizues, për dështimin për të iu përmbajtur ligjit siç definohet në nenin 42 të këtij ligji. NjIF-K mundet gjithashtu t'i rekomandoj autoritetit licencues apo autorizues që të nisë procesin për përcaktimin se a duhet të pezullohet apo tërhiqet licenca e punës apo autorizimi.”



**Neni 51**  
**(Ankesa administrative tek BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial)**

- “1. Subjekti raportues mund të ankohet kundër vendimit mbi ndëshkimin administrativ të vendosur sipas këtij ligji nga BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial nëse kjo kompetencë i është dhënë në pajtim me këtë ligj, duke dërguar ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit mbi ndëshkimin administrativ nga BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial, për shkak të mos-pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji.*
- 2. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nxjerrin akte nënligjore për sektorët nën fushëveprimin e tyre mbikëqyrës në pajtim me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji, lidhur me procedurën e trajtimit të ankesës sipas këtij ligji.”*

**Neni 55**  
**(Publikimi i Vendimeve mbi ndëshkimet administrative)**

- “1. NjIF-K, BQK, si dhe mbikëqyrësit tjerë sektorial nëse kjo kompetencë i është dhënë me këtë ligj, publikojnë në ueb-faqen zyrtare vendimet finale të ekzekutueshme përkitazi me ndëshkimin administrative, duke deklaruar llojin dhe natyrën e dështimit për pajtueshmëri, identitetin e subjektit raportues dhe ndëshkimin administrativ.*
- 2. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial mund të vendosin që të mos bëjnë publik ndëshkimin administrativ, të vonojë publikimin apo të publikojë ndëshkimin administrativ në mënyrë që subjekti raportues apo personi fizik i ndëshkuar të mos jetë i identifikueshëm, nëse publikimi i definuar në paragrafin 1. të këtij neni:*
- 2.1. është jo-proporcional me seriozitetin e dështimit për pajtueshmëri;*
  - 2.2. mund të rrezikojë stabilitetin e tregut financiar; apo*
  - 2.3. mund të rrezikojë hetimet penale në vijim e sipër.*
- 3. NjIF-K dhe BQK mbajnë informatat e publikuara në pajtim me paragrafin 1., të këtij neni për të paktën pesë (5) vite.”*

**LIGJI Nr. 05/L-049 PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR**  
**DHE TË KONFISKUAR**

**(i publikuar në Gazetën Zyrtare më 14 prill 2016, ndërsa është ndryshuar dhe plotësuar me LIGJIN NR.08/L-034, i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare 22 mars 2022)**

**Neni 4**  
**(Funksonet e Agjencisë)**

- “1. Në kuadër të drejtave dhe detyrave të parapara me ligj, Agjencia ushtron funksionet si në vijim:*
- 1.1. administron me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar të përdorura për, apo të përfituara nga vepra penale, përfshirë pasurinë e terrorizmit, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore;*
  - 1.2. ekzekuton urdhrin e gjykatës për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi;*
  - 1.3. ekzekuton aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës, sipas legjislacionit në fuqi, mund të bëjë shitjen e sendeve duke derdhur të ardhurat e grumbulluara nga shitja në buxhetin e Kosovës ose dorëzimin e pasurive për shfrytëzim nga Qeveria;*

- 1.4. bën vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, si dhe përcakton mënyrën e ruajtjes së kësaj pasurie;
- 1.5. mbanë evidencat për pasurinë të cilën e administron dhe për vendimet gjyqësore në të cilat është vendosur për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar;
- 1.6. përcakton mënyrën e ruajtjes së vlerës së pasurisë nën administrim;
- 1.7. merr pjesë në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare për të gjitha rastet që përfshijnë pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke administruar pasurinë e sekuestruar apo konfiskuar në bazë të kërkesës së bërë nga një shtet tjetër;
- 1.8. merr pjesë në hartimin e programit të aftësimin të nëpunësve shtetëror lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë të përfituar me vepër penale;
- 1.9. sipas nevojës, ndihmon në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë;
- 1.10. mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, sipas vendimit të gjykatës kompetente;
- 1.11. administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik;
- 1.12. ofron këshilla për Prokurorinë, Gjykatën dhe institucionet tjera mbi natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, me qëllim të ofrimit të ndihmës për planifikimin sekuestrimeve, apo konfiskimeve të mundshme;
- 1.13. lidhë Memorandume të Bashkëpunimit me organet partnere dhe institucionet relevante për t'u dakorduar për marrëdhëniet dhe përgjegjësitë, si dhe për të rritur performancën, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- 1.14. kryen edhe punë të tjera të besuara me ligj.”

## **LIGJI NR.08/L-017 PËR AGJENCINË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**(i publikuar në Gazetën Zyrtare më 21 korrik 2022)**

### **Neni 2 (Fushëveprimi)**

- “1. Ky ligj parasheh statusin dhe kompetencat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me shqiptimin e masave dhe sanksioneve, me synim parandalimin e korrupsionit, forcimin e integritetit dhe transparencës institucionale në Republikën e Kosovës, si dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë shtetërore.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave publikë dhe privat, në parandalimin e korrupsionit, konfliktin e interesit, mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave.”

### **Neni 17 (Fillimi i hetimeve administrative)**

- “1. Agjencia zhvillon procedurën e hetimit administrativ në rastet që bien në mandatin e saj;
2. Hetimi administrativ fillohet:
  - 2.1. Sipas detyrës zyrtare;
  - 2.2. Sipas informacioneve të pranuar nga personat fizik apo juridik;
    - 2.2.1. Sipas informatave anonime;
    - 2.2.2. Sipas informatave nga publiku;

- 2.2.3. Dështimi i ndonjë personi për të respektuar ndonjë kërkesë ligjore të paraparë në ligjet që bien në fushëveprimin e Agjencisë.
3. Dosja e hetimit administrativ duhet të përmbajë:
- 3.1. Arsyetimin për fillimit të hetimit;
  - 3.2. Datën e fillimit të hetimit administrativ;
  - 3.3. Përmbledhje të hollësishme të të gjitha veprimeve dhe hetimeve të mbledhura gjatë hetimeve administrative; dhe
  - 3.4. Rezultatet e hetimit administrativ, përfshirë datën kur hetimi administrativ ka përfunduar.
4. Gjatë hetimit administrativ, Agjencia mund t'i ndër marrë këto veprime:
- 4.1. kërkon, mbledh, hulumton dhe analizon dokumentacionin dhe informacionet tjera relevante për rastin;
  - 4.2. kërkon informacione relevante nga çdo person apo institucion relevant;
  - 4.3. Interviston çdo person i cili mund të ketë informata relevante për hetimet administrative; dhe
  - 4.4. Shqyrton çfarëdo rrethane në lidhje me rastin.
5. Në rast se gjatë hetimit administrativ arrihet deri tek dyshimi i arsyeshëm se personat të cilët kanë qenë subjekte të hetimit administrativ kanë kryer vepër penale, Agjencia i ndërpre në të gjitha veprimet hetimore dhe përpilon kallëzim penal i cili i referohet prokurorisë përkatëse.
6. Në rast se gjatë hetimit administrativ sipas dispozitave të këtij neni, arrihet deri tek dyshimi se personat të cilët kanë qenë subjekte të hetimit administrativ kanë kryer shkelje apo sjellje të pahijshme disiplinore, Agjencia ia dorëzon rastin organit administrativ kompetent me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore.
7. Në rast se gjatë hetimit administrativ dyshohet për kundërvajtje, Agjencia inicion dhe zhvillon vet procedurën kundërvajtëse ose e referon atë në gjykatën kompetente në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
8. Referimi i rasteve nga paragrafët 5-7 të këtij neni e pezullojnë çdo parashkrim të paraparë në nenin 22 të këtij ligji.
9. Agjencia e miraton rregulloren për procedurën e hetimeve administrative. Kjo rregullore I përcakton rregullat e procedurës, mënyrën e pranimit dhe regjistrimit të rasteve, shpërndarjen e brendshme dhe raportimin, menaxhimin e rastit, dhe arkivimin. Rregullorja është e qasshme për të gjithë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe përmes faqes së internetit të Agjencisë.”

### **Neni 18** **(Rastet e hetimeve që i referohen organeve të tjera)**

- “1. Prokuroria, së paku është e obliguar që ta njoftoj Agjencinë në rast të:
- 1.1. hudhjes së kallëzimit penal;
  - 1.2. ndjekjes penale të suksesshme; dhe;
  - 1.3. ndjekjes penale të pasuksesshme.
2. Në rast të hudhjes së kallëzimit penal, pushimit të hetimeve, apo ndjekjes penale të pasuksesshme, Agjencia e rihapë dhe e përfundon procedurën e hetimit administrativ.
3. Çdo institucion që e pranon rastin e referuar nga Agjencia kërkohet që ta njoftoj Agjencinë rreth përfundimit të hetimit administrativ nga ana e tyre dhe çdo veprim të ndër marr si rezultat i atij hetimi.
4. Në rast se ndonjë institucion nuk ndërmerr asnjë veprim si rezultat i rastit të referuar nga Agjencia, kjo e fundit e rihapë dhe përfundon procedurën e hetimit administrativ.”

## **Neni 19 (Raportimi i rasteve)**

“1. Kushdo që dyshon se ka pasur shkelje të ligjeve që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë mund të raportojë rastin e tillë në Agjenci. Raportimi mund të bëhet edhe në mënyrë anonime.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk përjashton mundësinë e personit për t'i raportuar rastet drejtpërdrejt tek institucionet e tjera kompetente.”

### **IV. DOKUMENTET RELEVANTE TË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE**

#### **A. Në nivel të Kombeve të Bashkuara**

[Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit \(UNCAC\);](#)  
[Rekomandimet e vitit 2012 të Task Forcës së Veprimit Financiar \(Rekomandimet e FATF\).](#)

#### **B. Në nivel të Bashkimit Evropian**

[Vendimi Kornizë i Këshillit të BE-së \[2005/212/JHA\], i 24 shkurtit 2005, për Konfiskimin e të Ardhurave, Dobive dhe Pasurive që lidhen me Krimin;](#)  
[Direktiva \[2014/42/BE\] e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e 3 prillit 2014, mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit në Bashkimin Evropian.](#)

#### **B. Në nivel të Këshillit të Evropës**

##### **(i) Konventat**

[Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimin e Terrorizmit \(ETS 198\)](#)

##### **(ii) Opinonet, *Amicus Curiae* dhe Raportet e Komisionit të Venecias**

###### **(a) Rasti i Bullgarisë (Katër Opinione)**

[Opinion i ndërmjetëm \[CDL-AD\[2010\]010\] i Komisionit të Venecias për projekt-aktin për konfiskim në favor të shtetit të pasurive të blera në mënyrë të paligjshme të Bullgarisë, miratuar më 12-14 mars 2010;](#)

[Opinion i dytë i ndërmjetëm nr. 563/2009 mbi projekt aktin për konfiskim në favor të shtetit të aseteve kriminale të Bullgarisë, miratuar nga Komisioni i Venecias, 4 qershor 2010 \[CDL-AD\[2010\]019\];](#)

[Opinion përfundimtar \[CDL-AD\[2010\]030\] i Komisionit të Venecias mbi projekt-aktin e tretë të rishikuar për konfiskim në favor të gjendjes së aseteve të fituara me veprimtari të paligjshme të Bullgarisë, miratuar më 15-16 tetor 2010;](#)

[Opinion \[CDL-AD\[2011\]0123\] i Komisionit të Venecias mbi projekt-aktin e gjashtë të rishikuar për konfiskimin e aseteve të fituara nga veprimtari kriminale ose shkelje administrative të Bullgarisë, miratuar më 17-18 qershor 2011.](#)

(b) Rasti i Moldavisë

[Parashtrësia e përbashkët \*Amicus Curiae\* \[CDL-AD\(2022\)029\] e Komisionit të Venecias, Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit dhe Zyrës e OSBE-së për Veprat e Pasurimit të Paligjshëm, miratuar më 21-22 tetor 2022](#)

(c) Rasti i Armenisë

[Përgjigja \*Amicus Curiae\* CDL-AD\(2022\)048 e Komisionit të Venecias për Gjykatën Kushtetuese të Armenisë për disa çështje në lidhje me Ligjin për konfiskimin e pasurive me origjinë të paligjshme \[Opinion nr. 1108/2022\], miratuar më 16-17 dhjetor 2022](#)

(d) Rasti i Malit të Zi

[Opinion urgjent \[CDL-PI\(2024\)010\] i Komisionit të Venecias për draft-Amendamentet e Ligjit për Sekuestrimin dhe Konfiskimin e dobive materiale me origjinë nga aktivitetet kriminale, i nxjerrë dhe i publikuar më 22 maj 2022 bazuar në nenin 14a të Rregullores së ndryshuar të Komisionit të Venecias](#)

## **V. Opinionet e Komisionit të Venecias për Kosovën në lidhje me Ligjin e kontestuar**

[Opinion i parë: Opinion \[ CDL-AD\(2022\)014\] i Komisionit të Venecias për Projektligjin nr.08/L-121 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, i aprovuar më 17-18 qershor 2022;](#)

[Opinion i dytë: Opinion pasues CDL-AD\(2022\)052 i Komisionit të Venecias për Projektligjin nr.08/L-121 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, i aprovuar më 16-17 dhjetor 2022;](#)

[Informacion përcjellës i Komisionit të Venecias për Kosovën për Projektligjin N°08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme i paraqitur në Mbledhjen Plenare të 134-të \(më 10-11 mars 2023\).](#)

## **VI. DISPOZITAT E KONTESTUARA DHE ATO RELEVANTE TË LIGJIT NR. 08/L-121 PËR BYRONË SHETËRORE PËR VERIFIKIMIN DHE KONFISKIMIN E PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME (LIGJIT TË KONTESTUAR)**

### **Neni 1 (Qëllimi)**

*“Qëllimi i këtij ligji është themelimi, organizimi dhe përcaktimi i kompetencave të Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, si dhe përcaktimi i procedurës për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.”*

## **Neni 2 (Fushëveprimi)**

- “1. Ky ligj zbatohet ndaj pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme, qoftë drejtpërdrejtë ose të tërthorët nga personat zyrtarë dhe palët e treta.
2. Ky ligj zbatohet ndaj pasurisë së pajustificueshme të fituar:
- 2.1. përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjekteve nga paragrafi 1 i këtij neni, nga data 17 shkurt 2008; dhe
- 2.2. brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni pushojnë së ushtruari funksionin e tyre.”

## **Neni 3 (Përkufizimet)**

- “1. Për qëllime të këtij ligji termet e përdorura kane këtë kuptim:
- 1.1. **Byroja** - Byroja Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme;
- 1.2. **Gjykata/Gjykata e shkallës së parë** - Divizioni për konfiskim civil, në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore të Prishtinës, me juridiksion për tërë territorin e Kosovës;
- 1.3. **Gjykata e shkallës së dytë** - Gjykata e Apelit, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil;
- 1.4. **Komisioni Mbikëqyrës** - Komisioni përkatës i themeluar sipas nenit 10 të këtij ligji;
- 1.5. **Deklarimi i pasurisë** - Deklarimi në lidhje me gjendjen e pasurisë të zyrtarëve publik të obliguar të deklarojnë pasurinë dhe anëtareve të tyre të familjes, në përputhje me ligjin përkatës për deklarimin e pasurisë;
- 1.6. **Konfiskim** - marrja e përhershme e pasurisë e urdhëruar me një vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 1.7. **Verifikim i pasurisë** - vlerësimi i masës pasurore në raport me të hyrat e ligjshme;
- 1.8. **Vlerësimi i gjasave** - standard i të provuarit kur gjykata bazuar në prova, beson se një gjë ka me shume mundësi të jetë apo të ketë ndodhur se sa jo;
- 1.9. **Pasuria** - i referohet çdo gjëje me vlerë, të çdo forme, qoftë kjo trupore ose jotrupore, e luajtshme ose e paluajtshme, pavarësisht ku gjendet, përfshirë por pa u kufizuar:
- 1.9.1. toka, ndërtesat, apartamentet, shtëpitë, valutat, kriptovalutat, stolitë, metalet e çmueshme, llogaritë bankare, automjetet e çdo forme, avionët, stoqet, aksionet, letrat me vlerë, bonot, borxhet, pasuritë intelektuale të çdo forme, instrumentet monetare përfshirë këtu paratë e gatshme, çeqet e udhëtarëve, çeqet personale, kreditë bankare, çeqet bankare të porosive për para, urdhërpagesa, porosi për para, çeqe të arkës të çdo përshkrimi, letra kredie, dhe/ose letra me vlerë investimi ose instrumente të negociueshme, në formën e titullarit ose përndryshe në forme të tillë që personi bëhet titullar në momentin e dorëzimit, çdo interes, dividendë ose tjetër e ardhur nga pasuria ose vlera që rrjedh apo gjenerohet nga pasuria e tillë;
- 1.9.2. instrumente ligjore që evidentojnë interes në çfarëdo prone, përfshirë, por jo të kufizuar në titull, aktin e pronësisë, hipoteke, servitute ose interes në një prone dhe të drejta për të përdorur pasuritë në pronësi shoqërore, pronësi publike dhe shtetërore;
- 1.10. **Pasuri e pajustificueshme** - pjesa e pasurisë së personit në procedurë, e cila nuk është në përputhje me të hyrat e ligjshme dhe prejardhja e se cilës nuk provohet si e ligjshme;

1.11. **Vlera zëvendësuese** - vlerë pasurore zëvendësuese që i korrespondon vlerës së pasurisë së pajustificueshme e cila nuk është në dispozicion për konfiskim;

1.12. **Person zyrtar** - Personi i zgjedhur apo i emëruar e i cili për punën, veprimtarinë apo angazhimin e tij ka pranuar ose pranon të hyra në formë të pagës apo çfarëdo lloj kompensimi nga buxheti i Kosovës apo në forma tjera nga institucionet apo ndërmarrjet publike të Republikës së Kosovës. Person zyrtar konsiderohet edhe personi që bartë autorizime publike si dhe personi i emëruar, pavarësisht nëse për punën e tij ka pranuar apo jo kompensim;

1.13. **Blerësi me mirëbesim** - personi i cili e ka blere pasurinë nga subjektet në nenin 2 të këtij ligji dhe për atë pasuri ka paguar çmimin, i cili nuk është në mënyrë domethënëse me i ulët apo me i lartë sesa çmimi i tregut. Blerës me mirëbesim nuk konsiderohet personi i cili pavarësisht çmimit të paguar, e ka ditur ose është dashur të dijë se pasuria e blerë është e pajustificueshme;

1.14. **Pala në procedurë** - Personi zyrtar apo pala e tretë, pasuria e te cilit është nën verifikim nga Byroja gjatë procedurës në Byro, përkatësisht personi, pasuria e te cilit propozohet të konfiskohet gjatë procedurës në gjykatë;

1.15. **Palë të treta** - çdo person fizik apo juridik tek te cilët pasuria e personit zyrtar është bartur, apo që ka ose mund të ketë interes juridik mbi pasurinë e palëve në procedurë.”

#### **Neni 4 (Themelimi)**

“Me këtë ligj themelohet Byroja Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme si organ i pavarur dhe i specializuar për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme.”

#### **Neni 6 (Statusi juridik dhe struktura organizative)**

“1. Byroja është institucion publik i pavarur që ka statusin e personit juridik me seli në Prishtinë.

2. Struktura organizative e Byrosë përcaktohet me rregulloren për organizimin e brendshëm, të cilën e miraton Komisioni Mbikëqyrës dhe përmban së paku njësitë si në vijim:

2.1. Departamenti ligjor;

2.2. Departamenti i analizës së riskut;

2.3. Departamenti i verifikimit dhe kontabilitetit forenzik; dhe

2.4. Departamenti për financa dhe shërbime të përgjithshme.”

#### **Neni 7 (Buxheti)**

“1. Byroja harton buxhetin vjetor në pajtim me Ligjin përkatës për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë.

2. Byroja vendosë në mënyrë të pavarur për përdorimin e buxhetit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.”

## **Neni 8 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Byrosë)**

1. Byroja ka kompetencat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:
  - 1.1. Fillon dhe zhvillon procedurën për verifikimin e pasurisë, për përcaktimin nëse pasuria e personit zyrtar është pasuri e pajustificueshme;
  - 1.2. Parashtron propozimin për konfiskim të pasurisë në Gjykatë;
  - 1.3. Kërkon, ndihmë, informacion dhe dokumente relevante, nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe të huaja, personat fizikë apo juridikë që ushtrojnë autorizime publike, si dhe nga personat tjerë fizikë dhe juridikë, vendorë dhe të huaj;
  - 1.4. Analizon dhe vlerëson informacionin dhe materialin e pranuar;
  - 1.5. Publikon në faqen zyrtare të Byrosë të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet lidhur me procedurat gjyqësore në zbatim të këtij ligji, pa u kufizuar në plotfuqishmërinë e tyre, në përputhje me rregullat e publikimit të tyre;
  - 1.6. Mbledh, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhënat të tjera në lidhje me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme;
  - 1.7. I raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës njëherë në vit për punë e Byrosë. Kuvendi mund të kërkojë raporte edhe më të shpeshta nga Byroja;
  - 1.8. Bashkëpunon me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.
  - 1.9. Kryen detyra të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 9 (Statusi dhe Pavarësia)**

- “1. Zyrtarët e Byrosë konsiderohen zyrtarë publik në pajtim me Ligjin përkatës për Zyrtarët Publik.
2. Për zyrtarët e Byrosë hartohet kod i veçantë i mirësjelljes i cili miratohet nga Drejtori i përgjithshëm.
3. Zyrtarët e Byrosë, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, gëzojnë pavarësi të plotë dhe mbrojtje, si dhe nuk mund t’ju imponohet asnjë presion nga jashtë për shkak të detyrës së tyre, apo kur ndërmarrin veprime të caktuara konkrete, në pajtim me këtë ligj apo me legjislacionin tjetër në fuqi.”

## **Neni 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi)**

- “1. Komisioni për Mbikëqyrjen e Byrosë (në tekstin e mëtejme: Komisioni) përbëhet nga pesë (5) anëtar me përbërjen si vijon:
  - 1.1. Një Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës i caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, i cili është edhe kryesues i Komisionit;
  - 1.2. Auditori i Përgjithshëm, anëtar;
  - 1.3. Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, anëtar;
  - 1.4. Një zëvendës i Avokatit të Popullit i caktuar nga Avokati i Popullit, anëtar;
  - 1.5. Drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare, anëtar.
2. Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë në kompensimin për angazhimin e tyre mujor, lartësia e të cilit caktohet me rregullore të brendshme por lartësia e kompensimit nuk mund të tejkalojë pragun prej pesë përqind (5%) të pagës bazë të Kryesuesit të Komisionit.”



**Neni 11**  
**(Mbledhja, kuorumi dhe vendimmarrja në Komision)**

- “1. Mbledhjen e thërret dhe e kryeson Kryesuesi I Komisionit. Në mungesë të Kryesuesit apo refuzimi për thirrjen e mbledhjes, mbledhjen mund ta thërrasin tre (3) anëtarë të Komisionit.*
- 2. Kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes është katër (4) anëtarë.*
- 3. Komisioni merr vendim me shumicën e të gjithë anëtarëve të Komisionit.*
- 4. Çështjet të tjera procedurale për thirrjen dhe mbarëvajtjen e punës së Komisionit rregullohet me akt nënligjor.”*

**Neni 12**  
**(Kompetencat e Komisionit)**

- “1. Kompetencat e Komisionit Mbikëqyrës janë si në vijim:*
- 1.1. Mbikëqyrë punën dhe veprimtarinë e Byrosë;*
- 1.2. Zhvillon procedurën dhe i propozon Kuvendit emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm;*
- 1.3. Bën vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm;*
- 1.4. Miraton aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm;*
- 1.5. Shqyrton raportet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm;*
- 1.6. Kryen punë të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.*
- 2. Komisioni nuk ka të drejtë të ndërhyjë në rastet të cilat gjenden në procedurën e verifikimit në Byro.”*

**KAPITULLI IV**  
**ZGJEDHJA, MANDATI DHE PËRGJEGJËSITË E DREJTORIT TË**  
**PËRGJITHSHËM TË BYROSË**

**Neni 13**  
**(Drejtori i Përgjithshëm)**

- “1. Byroja udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm.*
- 2. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet për një mandat shtatë (7) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.*
- 3. Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të ngrijë pozitën në sektorin publik, si dhe nuk ushtron asnjë funksion tjetër.*
- 4. Pas përfundimit të rregullt të mandatit, Drejtori i Përgjithshëm gëzon të drejtën e pagës ekuivalente me pagën e fundit, në periudhë dy (2) vjeçare, me kusht që nuk përfiton pagë qoftë as nga sektori publik as nga sektori privat.”*

**Neni 15**  
**(Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm)**

- “1. Procedura për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm bazohet në parimet e konkurrencës, mosdiskriminimit, transparencës, integritetit dhe objektivitetit.*
- 2. Procedura për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm fillon gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të rregullt të Drejtorit të Përgjithshëm.*

3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, kur mandati përfundon para kohës, siç përcaktohet me këtë ligj, procedura për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm fillon brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e lirit të pozitës.

4. Komisioni e shpall konkursin për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, në media të shkruara dhe elektronike në gjuhët zyrtare. Afati i kohëzgjatjes së konkursit nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë, e as më i gjatë se njëzet (20) ditë.

5. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, Komisioni, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për emërim.

6. Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili i plotëson kushtet për t'u zgjedhur Drejtor i përgjithshëm.

7. Në intervistë vlerësohen integriteti, kompetenca, vizioni dhe aftësitë menaxheriale të kandidatëve për të qenë Drejtor të përgjithshëm. Për këtë qëllim, çdo kandidat përgatitë një koncept me të dhëna dhe shembuj praktik, sipas strukturës së konceptit që publikohet së bashku me konkursin, për të dëshmuar plotësimin e këtyre kushteve. Ky koncept dorëzohet tek Komisioni së bashku me aplikacionin për t'u bërë Drejtor i Përgjithshëm. Konceptet e kandidateve publikohen në faqen zyrtare të Byrosë.

8. Procedura është e vlefshëm vetëm nëse marrin pjesë jo më pak se shumica e anëtarëve të Komisionit. Anëtarët e Komisionit që fillojnë me intervistimin e kandidatëve nuk mund të ndryshohen gjatë procesit.

9. Anëtarët e Komisionit që marrin pjesë në intervistim vlerësojnë kandidatin e intervistuar me pikë të ndara për integritetin deri në dhjetë (10) pikë, kompetencën deri në dhjetë (10) pikë dhe aftësinë menaxheriale të kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

10. Pikët nga çdo anëtar i Komisionit mbledhen dhe pjesëtohen me numrin e anëtarëve të Komisionit që kanë marr pjesë në intervistim, nga i cili del rezultati përfundimtar i kandidatëve.

Kandidatët që kalojnë pragun prej së paku pesëdhjetë për qind (50%) të pikëve nga secila fushë që vlerësohet në paragrafin 9 të këtij Neni, vendosen në listën e ngushtë si propozim për Kuvendin.

11. Lista e ngushtë nga paragrafi 10 i këtij Neni, nuk mund të përmbaj më pak se dy (2) e më tepër se pesë (5) kandidatë për pozitën, me ç'rast kandidatët që rangohen me pikë më të larta vendosen në listë.

12. Propozimi i Komisionit përmban arsyetim përse Komisioni ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.

13. Kuvendi me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë deputeteve të pranishëm dhe që votojnë, zgjedhin Drejtorin e përgjithshëm.

14. Nëse në rrethin e parë, Kuvendi nuk zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm, atëherë zhvillohet raundi i dytë i votimit, me dy (2) kandidatët që kanë marr më së shumti vota.

15. Nëse Drejtori i Përgjithshëm nuk zgjidhet as në raundin e dytë të votimit nga Kuvendi, konkursi për Drejtor të Përgjithshëm përsëritet. Komisioni brenda shtatë (7) ditësh shpallë konkursin e ri. Procesi i përzgjedhjes dhe procedurat zhvillohen sipas këtij neni.

16. Në rast se edhe pas përsëritjes së konkursit, Kuvendi dështon në zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm në dy raunde, atëherë Komisioni, shpallë konkursin dhe zhvillon procedurat sipas këtij neni me përjashtimin e vetëm se Komisioni në fund të procesit zgjedh kandidatin me më së shumti pikë si Drejtor të përgjithshëm.”

## **Neni 16**

### **(Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm)**

“1. Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

1.1. udhëheqë dhe organizon punën e Byrosë;

- 1.2. mbikëqyr punën e zyrtarëve të Byrosë;
  - 1.3. përfaqëson Byronë brenda dhe jashtë vendit;
  - 1.4. menaxhon buxhetin e Byrosë dhe është përgjegjës për mënyrën e shpenzimit të tij, në pajtim me legjislacionin përkatës;
  - 1.5. nxjerr vendime konform mandatit dhe kompetencave të Byrosë;
  - 1.6. harton dhe miraton planin vjetor të punës brenda mandatit të Byrosë;
  - 1.7. lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
  - 1.8. për rastet specifike dhe kur ka mungesë të ekspertizës brenda Byrosë, vendos për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
  - 1.9. ushtron edhe detyra të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. Drejtori i Përgjithshëm mund t'u delegojë detyrat e përcaktuara vartësve të tij të drejtpërdrejtë. Në këtë rast, ai mbetet përgjegjës për mbikëqyrjen e detyrave të deleguara.
3. Drejtori i Përgjithshëm autorizon me shkrim njërin nga vartësit e drejtpërdrejtë për ta zëvendësuar në rast të mungesës së përkohshme. I autorizuari kryen të gjitha funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm për periudhën për të cilën është autorizuar.”

### **Neni 17 (Përfundimi i Mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm)**

“1. Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm përfundon:

- 1.1. me kalimin mandatit të paraparë me këtë ligj;
  - 1.2. me dorëheqje;
  - 1.3. me humbjen e përhershme të zotësisë së veprimit;
  - 1.4. nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar për veprë penale, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;
  - 1.5. nëse ushtron funksione që janë në papajtueshmëri me funksionin e tij sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.6. me shkarkim nga Kuvendi sipas propozimit të Komisionit;
  - 1.7. në rast të vdekjes.
2. Nëse ngritët aktakuzë ndaj Drejtorit të Përgjithshëm, ai suspendohet siç, parashihet me legjislacionin në fuqi. Njëri nga Drejtorët e Departamenteve caktohet nga Komisioni si zëvendësues, deri në përfundim të procesit. Zëvendësuesi kryen të gjitha funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Komisioni mund të iniciojë procedurën e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm sipas nënparagrafit 1.6 të këtij neni, për arsye si ne vijim:
- 3.1. Për shkak të mos përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive të punës të përcaktuar me legjislacion;
  - 3.2. Për shkak të vlerësimit të dobët të performancës;
  - 3.3. Për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave të punës, sipas legjislacionit në fuqi; ose
  - 3.4. Për shkak të cenimi i integritetit personal apo të institucionit.
4. Pas propozimit nga Komisioni, Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputeteve që janë të pranishëm dhe që votojnë.
5. Në çdo rast kur pozita e Drejtorit të Përgjithshëm mbetet e lire, njëri nga Drejtorët e Departamenteve caktohet nga Komisioni si zëvendësues, për një periudhë jo më të gjatë së gjashtë (6) muaj. Zëvendësuesi kryen të gjitha funksionet e Drejtorit të përgjithshëm.”

## **Neni 18 (Inicimi i procedurës)**

*“1. Byroja inicion procedurën e verifikimit mbi bazën e informatave kredibile dhe besueshme lidhur me pasurinë e pajustificueshme në rastet kur:*

*1.1. Pranon informacion, dokument, provë, dëshmi apo të dhëna nga burime të ndryshme, përfshirë personat fizik dhe juridik;*

*1.2. Pranon informacion, dokument, provë, dëshmi apo të dhëna nga institucionet e Republikës së Kosovës ose të huaja, si dhe;*

*1.3. Ka informacion, dokument, provë, dëshmi apo të dhëna por që nuk i pranon zyrtarisht, dhe të njëjtat janë publike ose të qasshme në çfarëdo forme.*

*2. Institucionet në vijim duke përfshirë por pa u kufizuar: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Njësi për Inteligjencë Financiare, Noterët dhe Përmbaruesit Privat sipas kërkesës nga Byroja në mënyrë aktive obligohen t'i ofrojnë pa vonesë informatat e kërkuara.*

*3. Kurdo që institucionet e Republikës së Kosovës posedojnë ose bien në posedim të çfarëdo informacioni, dokumenti, provë, dëshmie ose të dhëne që përmban informata kredibile dhe të besueshme në lidhje me pasurinë e pajustificueshme, i përcjellin tek Byroja pa vonesë. Këto informata i shërbejnë Byrosë për ta përmbushur standardin e probabilitetit të gjasave mbi bazën e te cilave inicohet procedura.*

*4. Byroja shqyrton informatat nga paragrafi 1 i këtij neni për të përcaktuar nëse këto informata i referohen personit zyrtar që është subjekt i këtij ligji dhe nëse informatat janë të besueshme.*

*5. Për qëllim të këtij neni informatë kredibile dhe e besueshme nënkupton çdo informacion, dokument, provë, dëshmi apo e dhënë, e cila lë të kuptojë që ka mospërputhje në mes të hyrave të ligjshme dhe pasurisë së krijuar.*

*6. Drejtori i Përgjithshëm vlerëson në pamje të parë lartësinë e shpërputhjes së pasurisë me të hyrat e ligjshme duke i dhënë prioritet rasteve nga vlera me e lartë e shpërputhjes deri tek pragu i përcaktuar me këtë ligj.*

*7. Pas shqyrtimit nga paragrafët 3 dhe 4 i këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm nxjerr vendim të arsyetuar për fillimin e procedurës së verifikimit.*

*8. Ne secilin rast kur Drejtori i Përgjithshëm gjen se nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafët 3 ose 4 i këtij neni, atë herë vendos për mos fillimin e procedurës.*

*9. Përbashimisht nga paragrafi 7 i këtij neni, nëse më vonë Byroja vije deri tek informatat e reja mbi atë subjekt dhe/ose pasuri, Drejtori i Përgjithshëm vendos sipas procedurës të këtij neni.*

*10. Të gjitha informacionet e pranuar dhe te trajtuara nga Byroja, do të jenë të qasshme për palën e cila është subjekt i procedurës së verifikimit, përveç në rastet kur këto informacione do ta rrezikonin procedurën e verifikimit, do t'i dëmtonin provat, si dhe mund ta cenonin interesin publik. Kufizimin e dokumenteve Byroja duhet ta kërkoj zyrtarisht në Gjykatë, për të cilën kërkesë Gjykata nxjerr vendim me shkrim.”*

## **Neni 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit)**

*“1. Byroja, gjatë procedurës së verifikimit, mbledh informatat si në vijim, por pa u kufizuar në:*

*1.1. pasurinë, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerën;*

*1.2. vlerën e pasurisë në kohën e përfitimit;*

*1.3. vlera e përfituar nga pasuria me rastin e transaksionit;*

- 1.4. transformimin e pasurisë;
  - 1.5. te ardhurat e rregullta dhe jo te rregullta të palës në procedurë;
  - 1.6. shpenzimet për mbajtjen e personit fizik dhe te anëtarëve të familjes së palës në procedurë;
  - 1.7. shpenzime të tjera;
  - 1.8. detyrimet monetare;
  - 1.9. transaksionet me pasurinë te personat fizikë apo juridikë;
  - 1.10. transaksionet në pasurinë e palës në procedure;
  - 1.11. shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit nga pasuria e palës në procedurë;
  - 1.12. masat e përkohshme dhe ngarkesat e vendosura ndaj pasurisë si dhe detyrimet e marra përsipër të natyrës civilo-juridike nga pala ne procedure.
2. Të dhënat personale do te trajtohen dhe përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

## **Neni 20 (Detyrimi për bashkëpunim)**

- “1. Institucionet e Republikës së Kosovës, personat fizikë apo juridikë vendorë që ushtrojnë autorizime publike, si dhe nga personat e tjerë fizikë dhe juridikë vendore, detyrohen të bashkëpunojnë me Byronë me qëllim të mbledhjes së informatave nga neni 19 i këtij ligji. Detyrimi për bashkëpunim për persona fizik dhe juridik vendor shtrihet deri ne atë mase sa nuk cenohet e drejta në privatësi dhe të drejtën për mos inkriminim.
2. Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni, i sigurojnë Byrosë ndihmën, informacionin dhe dokumentet e kërkuara sa më shpejte qe është e mundur, por jo me vone se tridhjete (30) ditë nga dita e kërkesës, me përjashtim të informacionit që sigurohet sipas një procedure të veçantë.
3. Ne rast se subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni nuk i përgjigjen kërkesës së Byrosë, Byroja mund t'i kërkojë Gjykatës, që ndaj atij subjekti të marre aktvendim për dorëzimin e informacionit dhe dokumenteve sipas kërkesës së Byrosë.
4. Në rast se Gjykata vlerëson nga përgjigja e subjektit se informatat apo dokumentet e kërkuara, nuk janë të disponueshme për ndonjë institucion tjetër, atëherë do të marrë aktvendim për nxjerrjen e informatave dhe dokumenteve deri në masën që nuk cenojnë sigurinë e vendit apo nuk shkelin drejtpërdrejt një të drejte kushtetuese te njeriut, me qëllim për të mundësuar verifikimin e pasurisë. Me këtë aktvendim, Byroja do të detyrohet që informatat dhe dokumentet e tilla të mos publikohen dhe askush të mos ketë qasje në to në asnjë mënyrë, përveç në procedurën gjyqësore.
5. Udhëheqësi i subjektit nga paragrafi 1 i këtij neni, obligohet ta zbatojë aktvendimin e marrë nga gjykata sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, jo më larg se pesë (5) dite nga pranimi i aktvendimit. Në rast të mos zbatimit të aktvendimit të gjykatës nga udhëheqësi, Byroja paraqet kallëzim penal te Prokurori i Shtetit për veprën penale të mos ekzekutimit te vendimeve gjyqësore.
6. Gjykata nuk do të marrë aktvendim për nxjerrjen e informatave dhe dokumenteve sipas kërkesës së Byrosë, kur ajo kërkesë i është dërguar Prokurorit te Shtetit dhe kur Prokurori i Shtetit njofton se ofrimi i informatave dhe dokumenteve të tilla do të cenonte hetimin e çështjeve penale që janë në procedurë.
7. Kur personat tjerë fizike dhe juridike vendore nuk i përgjigjen kërkesës së Byrosë brenda afatit nga paragrafi 2 i këtij neni, Byroja mund t'i kërkojë Gjykatës, që ndaj atij subjekti të marre aktvendim për dorëzimin e informacionit dhe dokumenteve sipas kërkesës së Byrosë.
8. Gjykata merr aktvendim për dorëzimin e dokumentit dhe informacionit nëse vlerëson se kërkesa e Byrosë është e bazuar dhe arsyetuar.

9. Personi nga paragrafi 7 i këtij neni, obligohet ta zbatojë aktvendimin e marrë nga gjykata sipas paragrafit 8 të këtij neni, jo me larg se pesë (5) ditë nga pranimi i aktvendimit. Në rast të mos zbatimit të aktvendimit të gjykatës nga personi ndaj të cilit është marre aktvendimi, Byroja paraqet kallëzim penal te Prokurori i Shtetit për veprën penale të mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

10. Informacioni i klasifikuar sigurohet në përputhje me ligjin përkatës për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.

11. Të dhënat personale do të trajtohen dhe përpunohen në përputhje me ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.”

## **Neni 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë)**

“1. Verifikimi i pasurisë bëhet për pasurinë e fituar gjate periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar.

2. Përjashtimisht, kur Byroja vlerëson apo konstaton se pasuria e personit zyrtar e fituar pas periudhës së ushtrimit të funksionit publik është në masë të madhe më e lartë se të hyrat e ligjshme apo pasuria e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar, Byroja mund të zgjerojë verifikimin edhe për periudhën pasi që zyrtari publik nuk ushtron me funksionin publik.

3. Periudha e cekur në paragrafin 2 të këtij neni nuk mund të jetë me gjatë se pesë (5) vite pas përfundimit të funksionit publik të personit zyrtar.

4. Në rastet kur personi zyrtar ka pasur ndërprerje kohore në ushtrimin e funksionit publik, periudha e verifikimit përfshin kohën prej emërimit të parë deri në pushimin e funksionit të fundit publik.”

## **Neni 23 (Procedura në Byro)**

“1. Kur Drejtori i Përgjithshëm vendosë për fillimin e procedurës sipas nenit 18, të këtij ligji, Byroja fillon procedurën e verifikimit dhe:

1.1. kërkon, mbledhë, hulumton dhe analizon dokumentacionin dhe informatat tjera relevante për rastin, në përputhje me nenin 19 të këtij ligji dhe përgjatë ndërmarrjes së këtyre veprimeve apo kurdo që është e nevojshme kërkon ndihmë nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.2. kërkon informatat nga pala në procedure dhe subjektet nga neni 20 i këtij ligji;

1.3. ekzaminon rrethanat që kanë lidhje me rastin;

1.4. mund të ftojë palën në procedurë për të dhënë dëshmi, me qëllim të identifikimit të pasurive tjera apo sqarimit të dyshimeve mbi pasurinë në verifikim.

2. Procedura e verifikimit zhvillohet nga zyrtari i Byrosë të cilit i caktohet lënda me vendim të Drejtorit të përgjithshëm.

3. Te gjitha informatat, dokumentet, faktet, provat, dëshmitë, që mblidhen nga zyrtari i Byrosë, duhet të mblidhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Nëse gjate procedurës së verifikimit, vërehet se pasuria është bartur tek ndonjë palë e tretë, atëherë zyrtari i Byrosë do të kërkojë nga Drejtori i Përgjithshëm që vendimi për verifikim të pasurisë të zgjerohet edhe tek ato palë të treta.

5. Nga të dhënat e mbledhura sipas paragrafit 1 të këtij neni, Byroja liston pasurinë e palës në procedure.

6. Pas listimit të pasurisë, pala në procedurë ftohet të ofroje prova dhe të dhëna për të justifikuar prejardhjen e pasurisë së listuar, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.

7. Në rast se nga të dhënat e mbledhura nga procedura e verifikimit dhe të dhënat, provat dhe dëshmitë e ofruara nga pala në procedurë, zyrtari i Byrosë vëren se nuk ka shpërputhje në mes të të hyrave dhe pasurisë, apo shpërputhja në mes të të hyrave dhe pasurisë nuk tejkalon vlerën prej njëzetepesëmijë (25.000) euro, atëherë zyrtari i Byrosë propozon mbylljen e rastit. Propozimi i arsyetuar për mbylljen e rastit i dorëzohet Drejtorit të Përgjithshëm, i cili me pas nxjerr vendim për mbylljen e rastit.
8. Në rast se nga të dhënat e mbledhura nga procedura e verifikimit, provat dhe dëshmitë e ofruara nga pala në procedurë, zyrtari i Byrosë vëren se arrihet të përmbushet standardi civil i vlerësimit të gjasave dhe se ka shpërputhje në mes të të hyrave dhe pasurisë që tejkalon vlerën prej njëzetepesëmijë (25.000) euro, atëherë zyrtari i Byrosë propozon dërgimin e çështjes në Gjykatë për konfiskim. Propozimi i arsyetuar për dërgimin e çështjes në Gjykatë për konfiskim, i dorëzohet Drejtorit të Përgjithshëm, i cili më pas parashtron propozim për konfiskim.
9. Në rast se pala në procedurë nuk i përgjigjet ftesës së Byrosë dhe vlera e pasurisë së listuar është më e lartë se njëzetepesëmijë (25.000) euro, si dhe është përmbushur standardi sipas paragrafit 8 të këtij neni, atëherë supozohet se pasuria e listuar është fituar në mënyrë të pajustificueshme. Zyrtari i Byrosë propozon dërgimin e çështjes në Gjykatë për konfiskim. Propozimi i arsyetuar për dërgimin e çështjes në Gjykatë për konfiskim, i dorëzohet Drejtorit të Përgjithshëm, i cili më pas parashtron propozim për konfiskim.
10. Bashkë me propozimin për konfiskim, Byroja i përcjell Gjykatës listën e pasurive, provat materiale që ka në dosjen e lëndës dhe provat e ofruara nga pala në procedurë, nëse ka të tilla.
11. Kurdo gjatë procedurës së verifikimit, Byroja mund të paraqes para Gjykatës kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë në verifikim, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.
12. Në rast se Byroja merr vendim për mbylljen e rastit dhe pushimin e procedurës së verifikimit, menjëherë e njofton Gjykatën kur ka masë të përkohshme të sigurimit të pasurisë në verifikim.
13. Në rast se kurdo gjatë procedurës së verifikimit, pala në procedurë humbë zotësinë e veprimit ose vdes, Byroja i kërkon Gjykatës caktimin e një përfaqësuesi të përkohshëm të pasurisë së palës.
14. Byroja duhet të zhvillojë procedurën e verifikimit të pasurisë brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni.
15. Në rast se çështja është e komplikuar, atëherë zyrtari i Byrosë duhet të kërkojë nga Drejtori i Përgjithshëm zgjatjen e afatit nga paragrafi 14 i këtij neni për një periudhë shtesë jo më të gjatë se dyzetepesë (45) ditësh. Drejtori i Përgjithshëm vendosë për pranimin apo refuzimin e kërkesës, pasi që të analizojë kompleksitetin e çështjes. Refuzimi i kërkesës për afat shtesë, nënkupton për zyrtarin e Byrosë përfundimin e procedurës së verifikimit brenda afatit nga paragrafi 14 i këtij neni.
16. Përjashtimisht nga paragrafi 14 dhe 15 i këtij neni, procedura e verifikimit të pasurisë mund të zgjasë deri në një (1) vit kur procedura është e varur nga kërkesa për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.
17. Procedura e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme përcaktohet me akt nënligjor.”

## KAPITULLI VI MASA E PËRKOHSHME DHE E SIGURIMIT

### Neni 24 (Masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë)

*“1. Kurdo përpara ose pas paraqitjes së propozimit për konfiskim, me propozimin e zyrtarit të Byrosë, Gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë, pa njoftim dhe dëgjim paraprak të palës në procedurë, po që se Byroja e bënë të besueshëm pretendimin për ekzistimin e pasurisë së pajustificueshme dhe se masa e përkohshme është e bazuar në prova të mbledhura në procedurën e verifikimit dhe është urgjente dhe se me veprim ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personi.*

*2. Masat e përkohshme dhe të sigurimit të pasurisë që mund të urdhërohen nga Gjykata janë, por nuk kufizohen në:*

*2.1. ndalimin e tjetërsimit të pasurisë;*

*2.2. ndalimin e përdorimit të sendit të konsumueshëm;*

*2.3. ndalimin e disponimit me mjete monetare që gjinden në llogarinë bankare apo në para të gatshme. Kur mjetet monetare gjinden në para të gatshme, Gjykata urdhëron që mjetet e tilla të deponohen në një llogari bankare që e menaxhon Byroja, pa të drejtë të shfrytëzimit.*

*3. Propozimi për caktimin e masës së përkohshme duhet të përmbajë:*

*3.1. të dhënat e Byrosë;*

*3.2. të dhënat e Gjykatës që i drejtohet;*

*3.3. identifikimin e palës në procedurë;*

*3.4. specifikimin e pasurisë ndaj të cilës kërkohet lëshimi i masës së përkohshme;*

*3.5. arsyetimin e rrethanave që e bëjnë të besueshëm pretendimin se pasuria e tillë mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personi.”*

### Neni 25 (Vendimi për masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë)

*“1. Gjykata duhet të vendosë lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë brenda shtatëdhjetë e dy (72) orësh nga pranimi i propozimit:*

*1.1. Gjykata e miraton propozimin për caktimin e masës së përkohshme dhe me aktvendim cakton masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë, kur konstaton se masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo formë nuk do të jetë në dispozicion të atij personit;*

*1.2. Gjykata me aktvendim e refuzon propozimin për caktimin e masës së përkohshme kur vlerëson se rrethanat e paraqitura në propozimin për caktimin e masës së përkohshme nuk e bëjnë të besueshëm pretendimin se pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo formë të mos jetë në dispozicion të personit.*

*2. Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2. i këtij neni, zyrtari i Byrosë ka të drejtë të parashtojë ankesë brenda dyzet e tetë (48) orësh nga pranimi i aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së shkallës së dytë nëpërmjet Gjykatës së shkallës së parë. Ankesa nuk ka efekt pezullues. Gjykata e shkallës së dytë vendos lidhur me ankesën brenda njëzet e katër (24) orësh nga pranimi i ankesës.*

*3. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës, ka të drejtë ta refuzojë*



ankesën apo ta ndryshojë aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë. Në rast se e ndryshon aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë, atëherë Gjykata e shkallës së dytë urdhëron masën e sigurimit të pasurisë, duke lëshuar aktvendim sipas paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 të këtij neni.

4. Vendimi i lëshuar nga Gjykata e shkallës së parë apo Gjykata e shkallës së dytë sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni, i dërgohet menjëherë organit kompetent që mban regjistrin përkatës për atë pasuri, si Agjencisë Kadastrale, Odës së Noterëve, Odës së Përmbauesve, Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve, Bankës Qendrore të Kosovës, apo çdo institucioni tjetër kompetent, i cili detyrohen ta zbatojë urdhrin e tillë.

5. Aktvendimin nga paragrafi 1 i këtij neni Gjykata, ia dërgon menjëherë personit ndaj pasurisë së të cilit është caktuar masa e përkohshme e sigurimit.”

#### **Neni 26**

#### **(Kundërshtimi i masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë)**

“1. Personi ndaj pasurisë së të cilit është caktuar masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë, mund të kundërshtojë caktimin kësaj mase brenda pesëmbëdhjete (15) ditësh nga pranimi i vendimit. Kundërshtimi duhet të jetë i arsyetuar.

2. Kur personi ndaj pasurisë së të cilit është caktuar masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë nuk ka kundërshtuar caktimin e kësaj mase, aktvendimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë mbetet në fuqi deri në marrjen e një vendimi tjetër mbi pasurinë.

3. Kur paraqitet kundërshtim, Gjykata duhet të caktojë seance dëgjimore brenda shtatë (7) ditësh nga pranimi i kundërshtimit.

4. Gjykata në seancën për të vendosur lidhur me kundërshtimin, fton: zyrtarin e Byrosë, kundërshtuesin e masës së përkohshme dhe palët e treta. Palët mund të ftohen personalisht ose përmes përfaqësuesve të tyre.

5. Në seancën për të vendosur lidhur me kundërshtimin, fillimisht, i kërkohet parashtruesit të kundërshtimit të masës së përkohshme, si dhe palës së tretë, të argumentojë pretendimet e paraqitura në kundërshtim, përmes paraqitjes së provave sa i përket besueshmërisë dhe mungesës se rrezikut për pasurinë.

6. Byroja mund të ofrojë prova dhe argumente shtesë për të bërë të besueshme se masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personit.”

#### **Neni 34**

#### **(Shqyrtimi në shkallën e parë)**

“1. Sipas nenit 30 të këtij ligji, Byroja i paraqet provat para Gjykatës lidhur me përmbushjen e standardit civil të vlerësimit të gjasave, se pasuria që është objekt shqyrtimi është e pajustificueshme.

2. Pas paraqitjes së propozimit në Gjykatë, pala në procedurë në seancën e shqyrtimit, duhet të provojë se pasuria që është objekt i propozimi, ka prejardhje të justificueshme.”

**Neni 35**  
**(Seanca e shqyrtimit)**

“[...]

2. Kur zyrtari i Byrosë nuk paraqitet në seancën e shqyrtimit edhe pse është thirrur rregullisht, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë, konsiderohet se e ka tërhequr propozimin për konfiskim.

3. Po që se në seance e shqyrtimit nuk paraqitet personi pasuria e te cilit propozohet për konfiskim edhe pse është thirrur rregullisht, atëherë seanca e shqyrtimi mbahet pa praninë e tij.

[...]”

**Neni 36**  
**(Administrimi i provave)**

“[...]

2. Fillimisht administrohen prova e propozuara nga Byroja, ndërsa personi, pasuria e se cilit propozohet të konfiskohet apo përfaqësuesi i tij, kanë të drejtë që të kundërshtojë çdo provë që administrohet, sa i përket:

- 2.1. vërtetësisë së provës;
- 2.2. pranueshmërisë së provës; apo
- 2.3. besueshmërisë së provës.

[...]

6. Fillimisht, pala që ka propozuar dëgjimin e dëshmitarit parashtron pyetje dhe kërkon sqarime nga dëshmitari, dhe me pas pala tjetër shtron pyetje dhe kërkon sqarime nga dëshmitari. Kur palët deklarojnë se nuk kane pyetje tjera ndaj dëshmitarit, gjyqtari mund të parashtojë pyetje dhe të kërkojë sqarime ndaj dëshmitarit.

7. Dëshmitari mund të thirret në të drejtën e tij për të refuzuar dhënien e dëshmisë në përputhje me ligjin përkatës për procedurën kontestimore.

[...]”

**Neni 37**  
**(Marrja në pyetje e palës, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet)**

“[...]

2. Pala, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, ka të drejtë që të mos përgjigjet në pyetjet e parashtruara. Nëse zgjedh që të përgjigjet në pyetje, atëherë ai mund të jap dëshminë e tij për pasurinë që është objekt i shqyrtimit të propozimit për konfiskim.

[...]”

**Neni 38**  
**(Deklarimi përfundimtar)**

“1. Pas marrjes në pyetje të personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, Gjykata kalon në dëgjimin e deklaramit përfundimtar të palëve, në renditjen si vijon:

- 1.1. Fillimisht deklarimi përfundimtar jepet nga zyrtari i Byrosë, i cili argumenton se sipas vlerësimit të gjasave, pasuria ka prejardhje të pajustificueshme dhe duhet të konfiskohet;
- 1.2. Deklarimin përfundimtar e jep me pas përfaqësuesi i personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, i cili argumenton se propozimi për konfiskim është i pabazuar;

1.3. Deklarimin përfundimtar e jep me pas pala e tretë nëse ka të tillë, e cila argumenton se ka ardhur në posedim ose pronësi të pasurisë që propozohet të konfiskohet me mirëbesim dhe se kjo është vërtetuar në seancën e shqyrtimit.

1.4. Pastaj, deklarin përfundimtar e jep personi, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, i cili argumenton se pasuria është justifikuar dhe se e njëjta nuk ka bazë që të konfiskohet;

2. Në deklarin përfundimtar, palët mund t'i referohen aspekteve ligjore, provave që janë shqyrtuar në gjykatë dhe rrethanave të tjera që vërtetojnë pajustificueshmërinë apo justifikueshmërinë e pasurisë.

3. Në deklarin përfundimtar, palët mund t'u referohen provave të administruara në shqyrtim gjatë procedurës gjyqësore.”

#### **Neni 41 (Llojet e vendimeve)**

“1. Gjykata vendosë me aktgjykim lidhur me propozimin për konfiskimin e pasurisë. Për të gjitha çështjet tjera gjykata vendos me anë të aktvendimit.

2. Kur gjykata, sipas vlerësimit të gjasave, vlerëson se propozimi për konfiskimin e pasurisë është i bazuar dhe se pasuria është e pajustificueshme, ajo me aktgjykim konstaton se pasuria nuk justifikohet dhe urdhëron konfiskimin e saj.

3. Kur gjykata, sipas vlerësimit të gjasave, vlerëson se propozimi për konfiskimin e pasurisë është pjesërisht i bazuar, ajo me aktgjykim miraton pjesërisht propozimin, konstaton se ajo pjesë e pasurisë nuk justifikohet dhe urdhëron konfiskimin e saj. Për pjesën tjetër të pasurisë e refuzon propozimin si të pabazuar dhe konstaton se ajo pjesë e pasurisë është e justifikueshme.

4. Kur gjykata, sipas vlerësimit të gjasave, vlerëson se propozimi për konfiskimin e pasurisë është i pabazuar, ajo me aktgjykim refuzon propozimin për konfiskim dhe konstaton se pasuria është e justifikueshme.

5. Kur Gjykata konstaton se propozimi për konfiskim është i pa afatshëm, gjykata hedhë poshtë propozimin si të palejuar.

6. Shkaqet e refuzimit të propozimit për konfiskim përfshijnë por pa u kufizuar në:

6.1. propozimi për konfiskim përfshinë pasurinë verifikimi i se cilës nuk lejohet sipas ligjit;

6.2. propozimin të parashtruar pas kalimit të afatit ligjor, kur me dispozita është paraparë afati ligjor;

6.3. pasuria nuk tejkalon vlerën e përcaktuar sipas nenit 23, paragrafi 8 dhe 9 të këtij ligji;

6.4. provat që janë shqyrtuar në seancën e shqyrtimit, justifikojnë prejardhjen e pasurisë;

6.5. provat që janë shqyrtuar në seancën e shqyrtimit, provoje se pasuria është fituar me mirëbesim nga pala e tretë;

6.6. pasuria e pajustificueshme për konfiskim do të përfshijë pasurinë që është në pronësi, posedim, apo mbi të cilën pala në procedure ushtron formë tjetër të kontrollit, apo nga e cila pala në procedure ka ndonjë dobi.

6.7. propozim për konfiskim do të përfshijë pasurinë e cila nuk ka qenë në pronësi, posedim apo në formë tjetër të kontrollit nga pala në procedure.”

**Neni 53**  
**(Ankesa kundër aktvendimit)**

*“1. Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankimi, në qoftë se në këtë ligj nuk është përcaktuar që ankimi nuk lejohet.  
[...]*”

**Neni 61**  
**(Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera)**

*“Për çështjet procedurale gjyqësore të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat e ligjit përkatës për procedurën kontestimore.”*

**Neni 62**  
**(Efekti i procedurave tjera në zbatimin e dispozitave të këtij ligji)**

*“[...]*  
*5. Deklaratat e dhëna si dhe dokumentet e ofruara nga kushdo në kuadër të procedurës së verifikimit dhe konfiskimit sipas këtij ligji të njëjtat nuk mund të përdoren si prova në procedurë penale.  
[...]*”

**Neni 69**  
**(Funksionalizimi i Byrosë)**

*“1. Kryetari i Gjykatës Supreme cakton gjyqtarin nga radhët e Gjykatës Supreme si anëtar të Komisionit të Byrosë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.  
2. Konstituimi i Komisionit bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.  
3. Komisioni fillon procedurën e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e konstituimit.  
4. Pas konstituimit dhe deri në funksionalizimin e plotë të Byrosë, Komisioni mblidhet rregullisht dhe miraton aktet e nevojshme nënligjore në drejtim të funksionalizimit të plotë të Byrosë.  
5. Vetëm pas funksionalizimit të plotë të Byrosë, por jo më vonë se një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, Byroja fillon së zbatuari dispozitat e këtij Ligji në funksion të verifikimit të pasurisë së pajustificueshme.  
6. Funksionalizimi i Byrosë, sipas paragrafit 5 të këtij neni nënkupton emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm, rekrutimin e stafit dhe pajisjen e zyrës me resurset e nevojshme për punë.  
7. Deri në funksionalizimin e Byrosë, funksionin administrativ e ushtron Agjencia për Parandalim të Korrupsionit, të cilës i ndahen mjete buxhetore shtesë për kryerjen e këtij funksioni.  
8. Drejtori i Përgjithshëm obligohet që në afat prej gjashtë (6) muajsh nga zgjedhja e tij ta kompletojë stafin dhe të funksionalizojë Byronë.”*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

121. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
122. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*
123. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton se:  
  
*“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”*
124. Andaj, bazuar në të lartcekurat, një kërkesë e parashtruar para Gjykatës sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duhet të (i) të parashtrohet nga së paku 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit; (ii) që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, për përmbajtjen dhe/ose për procedurën e ndjekur; si dhe (iii) kërkesa duhet të parashtrohet brenda një afati prej 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit të aktit të kontestuar.
125. Gjykata në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të parë, përkatësisht numrit të nevojshëm të deputetëve të Kuvendit për të parashtruar kërkesën, vëren se kërkesa KI46/23 është parashtruar nga 10 (dhjetë) deputetë, numër ky i cili përmbush kriterin e përcaktuar përmes fjalisë së parë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën.
126. Gjykata gjithashtu në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të dytë, vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë Ligjin Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, të miratuar në Kuvend.
127. Ndërsa sa i përket kriterit të tretë, përkatësisht afatit kohor brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa përkatëse në Gjykatë, kjo e fundit vëren se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 20 shkurt 2023, ndërkohë që Ligji i kontestuar është miratuar nga Kuvendi më 9 shkurt 2023, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
128. Andaj, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës legjitimohen si palë të autorizuara në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të kontestuar kushtetutshmërinë aktit të kontestuar para Gjykatës, si për nga përmbajtja, ashtu dhe për nga procedura e ndjekur, pasi në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës, që të gjithë janë deputetë të legjislaturës së VIII-të të Kuvendit, andaj të njëjtit konsiderohen palë të autorizuara dhe rrjedhimisht, kanë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi.

129. Përveç kriterëve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42  
(Saktësimi i kërkesës)

*“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*

- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”*

130. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72  
(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

*[...]*

*(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:*

- (a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendi i Republikës së Kosovës;*
- (b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- (c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.*
- (4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”*

131. Në kontekst të dy dispozitave të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës: (i) shënuan emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesat e tyre përkatëse; (ii) specifikuan Ligjin e kontestuar të Kuvendit të 9 shkurtit 2023; (iii) iu referuan neneve specifike të Kushtetutës, për të cilat ata pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri; dhe (iv) dorëzuan prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre.
132. Rrjedhimisht, marrë parasysh plotësimin e kriterëve kushtetuese dhe ligjore përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata deklaroi kërkesën e parashtruesve të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e kërkesës.

## Meritat e kërkesës

### I. Hyrje

133. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës, respektivisht dhjetë (10) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, kontestojnë Ligjin e kontestuar në tërësinë e tij. Ndërkaq, më saktësisht, pretendojnë se nenet 2 (Fushëveprimi), 4 (Themelimi), 9 (Statusi dhe Pavarësia), 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi), 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit), 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) dhe 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar, janë në kundërshtim me nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
134. Siç është sqaruar në pjesën e këtij Aktgjykimi që ndërlidhet me pretendimet dhe kundërargumentet përkatëse, parashtruesit e kërkesës, në esencë, pretendojnë që Ligji i kontestuar, është në kundërshtim me (i) parimet e sundimit të ligjit dhe parimin e sigurisë juridike si vlera thelbësore të rendit kushtetues; dhe (ii) të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, përfshirë instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare. Më saktësisht, parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se: (i) në kuptim të fushëveprimit të tij, Ligji i kontestuar, përmes neneve 2 (Fushëveprimi) dhe 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) të tij, cenon parimin e sundimit të ligjit të mishëruar në nenet 3 [Barazia para Ligjit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, përfshirë parimin e barazisë para ligjit, të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, si dhe shkel të drejtën në pronë, të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e pronës] të Kushtetutës; (ii) themelimi dhe statusi i Byrosë, i përcaktuar sipas neneve 4 (Themelimi), 9 (Statusi dhe Pavarësia) dhe 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, është gjithashtu në kundërshtim me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës sepse cenon autoritetin mbikëqyrës të Kuvendit të Kosovës; (iii) procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë, e përcaktuar sipas nenit 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar “*përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, sundimit të ligjit dhe kompetencës zgjedhore të Kuvendit për këtë pozitë*”; (iv) nenet 18 (Inicimi i procedurës) dhe 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) në lidhje me nenin 20 (Detyrimi për bashkëpunim) të Ligjit të kontestuar, cenojnë në mënyrë arbitrare të drejtën në pronë të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, ndër tjerash, “*sepse e privon subjektin e verifikimit nga e drejta për qasje në kohë në dokumente dhe dosjen përkatëse, e privon nga e drejta për t’u dëgjuar*”.
135. Në parim, Avokati i Popullit, mbështet-pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës dhe përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë, në thelb, kërkon që Gjykata të vlerësojë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar në kuptim të “*të drejtës në pronë, sigurisë juridike, të drejtës për mjete juridike si dhe të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me Kushtetutë*”. Në mënyrë specifike, Avokati i Popullit konteston caktimin e një zëvendësi të Avokatit të Popullit si anëtar të Komisionit për Mbikëqyrjen e Byrosë, përmes nënparagrafit 4 të paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, që sipas tij, është në kundërshtim me pavarësinë e

Avokatit të Popullit, të përcaktuar me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës.

136. Pretendimet e lartcekura të parashtruesve të kërkesës kundërshtohen nga Ministria e Drejtësisë dhe deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Adnan Rrustemi, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETEVENDOSJE!, - duke theksuar që (i) Ligji i kontestuar ngërthen garanci të mjaftueshme procedurale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe - përmbajtja e të njëjtit është vlerësuar pozitivisht edhe nga Opinionet e Komisionit të Venecias; (ii) dallimi në mes personave zyrtarë dhe qytetarëve të tjerë të Republikës së Kosovës, ndjek një qëllim legjitim të luftimit të korrupsionit në sektorin publik, për më tepër që, aplikimi retroaktiv i ligjit nuk është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike; ndërsa (iii) sqarojnë që data 17 shkurt 2008, ndërlidhet edhe me “*qarkullimin juridik të pronës nëpërmjet transaksioneve bankare*”, e që për qëllime të këtij ligji, përbën provë vendimtare sa i përket verifikimit të pasurisë; dhe (iv) themelimi i Komisionit Mbikëqyrës nuk cenon kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit, për më tepër që, kalimi i kompetencës për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm nga Kuvendi në Komisionin Mbikëqyrës, si mekanizëm deblokimi në rast se procedura e zgjedhjes së Drejtorit dështon në Kuvend, është zgjidhje në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.
137. Gjykata, duke marrë për bazë pretendimet e lartcekura të parashtruesve të kërkesës, por edhe kundër-argumentet përkatëse, vë në dukje që esenca e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, ndërlidhet me: (i) fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, të përcaktuar me nenin 2 (Fushëveprimi) të tij dhe që ndërlidhet me nenin 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) por edhe barrën e provës të saktësuar përmes nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar dhe që i referohet (a) barazisë së personave zyrtarë dhe palëve të treta; (b) standardit të vlerësimit të gjasave; (c) proporcionalitetit të aplikimit retroaktiv të Ligjit të kontestuar; dhe (d) kolizionit ligjor në Ligjin e kontestuar; (ii) procedurën e zhvilluar nga Byroja, të përcaktuar me nenet 18 (Inicimi i Procedurës), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit), 20 (Detyrimi për Bashkëpunim) dhe 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar dhe që i referohet (a) detyrimit për bashkëpunim në raport me të drejtën për t’u mos vetëinkriminuar; (b) barazinë e armëve; (c) mjeteve juridike/mbrojtjes gjyqësore dhe (d) sigurisë juridike; (iii) statusin e Byrosë, të përcaktuar me nenet 4 (Themelimi), 9 (Statusi dhe Pavarësia) të Ligjit të kontestuar, por të cilat gjithashtu i referohen (a) përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës të përcaktuar në nenin 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar; dhe (b) zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm, të përcaktuar në nenin 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm); si dhe (iv) funksionalizimin e Byrosë, të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 69 (Funksionalizimi i Byrosë) të Ligjit të kontestuar.
138. Marrë parasysh argumentet dhe kundërargumentet e parashtruara para Gjykatës, kjo e fundit, me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar, fillimisht do të përmbledhë: (i) parimet e përgjithshme ndërlidhur me konceptin e konfiskimit civil të pasurisë së pajustificueshme sipas praktikës ndërkombëtare; (ii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së që ndërlidhet me konfiskimin e pasurisë, ndërhyrjes në të drejtën e pronës, barazinë para ligjit dhe të drejtën në privatësi; (iii) dokumentet relevante, të miratuara në nivel të Kombeve të Bashkuara, të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, përfshirë Opinionet e Komisionit të Venecias dhe përgjigjen *Amicus Curiae* në lidhje me konfiskimin civil të pasurisë në rastet e Bullgarisë dhe Armenisë, respektivisht; (iv) dy (2) Opinionet e Komisionit të Venecias për Kosovën përkitazi me Ligjin e kontestuar; (v) Opinionin urgjent të Komisionit të Venecias për Malin e Zi përkitazi me draft-amendamentet e Ligjit për sekuestrimin dhe konfiskimin e dobive materiale me



origjinë nga veprimtaria kriminale; (vi) qëllimin dhe fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, përfshirë ndërlidhjen e tij me ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës; dhe në fund (vi) do t'ia nënshtrojë Ligjin e kontestuar vlerësimit të kushtetutshmërisë bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe argumentet dhe kundërgargumentet e palëve para Gjykatës, duke aplikuar përgjatë këtij vlerësimi parimet e përgjithshme të lartcekura.

## II. Parimet e Përgjithshme

### 1. Parimet e përgjithshme të konfiskimit civil të pasurisë së pajustificueshme sipas instrumenteve ndërkombëtare, rekomandimeve dhe opinioneve të organizatave ndërkombëtare

139. Në kuptim të parimeve të përgjithshme për konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme, Gjykata do t'i referohet edhe instrumenteve ndërkombëtare, rekomandimeve dhe opinioneve të organizatave ndërkombëtare, të cilat, për aq sa ndërlidhen me konceptin e konfiskimit civil, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, do të shërbejnë si burim i interpretimit të dispozitave kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata do t'u referohet: (i) instrumenteve ndërkombëtare të aprovuara në nivel të Kombeve të Bashkuara; (ii) instrumenteve të aprovuara në nivel të Bashkimit Evropian; (iii) instrumenteve dhe rekomandimeve të aprovuara në nivel të Këshillit të Evropës; (iv) praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së; dhe (v) Opinioneve dhe përgjigjeve *Amicus Curiae* të Komisionit të Venecias.
140. Gjykata së pari vë në pah se konfiskimi i pasurisë është i rregulluar si në nivel të Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe në nivel të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, dhe i njëjti është i trajtuar edhe përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: GJDBE). Në nivel të Kombeve të Bashkuara, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 31 tetor 2003, është i vetmi instrument universal ligjërish i detyrueshëm kundër korrupsionit, i cili mbulon pesë (5) fusha kryesore, përkatësisht (i) masat parandaluese; (ii) kriminalizimin dhe zbatimin e ligjit; (iii) bashkëpunimin juridik ndërkombëtar; (iv) rikthimin e aseteve; dhe (v) mbështetjen teknike dhe shkëmbimin e informacionit.
141. Së dyti, në nivel të Bashkimit Evropian, Gjykata i referohet Vendimit Kornizë të Këshillit të BE-së [2005/212/JHA] për Konfiskimin e të Ardhurave, Dobive dhe Pasurive që lidhen me Krimin, i miratuar më 24 shkurt 2005, i cili përcakton standardet ndërkombëtare për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Gjykata vë re se sipas këtij vendimi, çdo shtet anëtar do të marrë masat e nevojshme për të mundësuar konfiskimin, tërësisht ose pjesërisht, të instrumenteve dhe të ardhurave nga veprat penale të dënueshme me heqje lirie mbi një (1) vit, ose të pasurisë, vlera e së cilës korrespondon me këto produkte. Për më tepër, Direktiva [2014/42/BE] e Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit, e miratuar më 3 prill 2014, vendos standardet minimale për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit në procedurë penale në Bashkimin Evropian, duke përfshirë konfiskimin e zgjeruar dhe konfiskimin nga palët e treta, dhe prezanton një formë të kufizuar të konfiskimit pa dënim të formës së prerë në procedura penale në rastet “kur i dyshuari është i sëmurë përgjithmonë ose është arratisur”. Direktiva e lartcekur mbulon 'eurokrimet' e përcaktuara në nenin 83 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme: TFEU), por megjithatë, konfiskimi ka një shtrirje më të gjerë për të gjitha veprat e dënueshme me burgim me të paktën një (1) vit. Më saktësisht, sa i përket ngrirjes dhe konfiskimit, kjo Direktivë parasheh se Zyrat Kombëtare të Rikthimit të Aseteve, të

themeluara me Vendimin e Këshillit [2007/845/JHA](#) për Zyrat Kombëtare të Rikthimit të Aseteve, mund të marrin masa të përkohshme urgjente ngrirjeje derisa të lëshohet një urdhër ngrirjeje. Propozimi parashikon konfiskimin standard dhe me vlerë, pas një dënimi penal të formës së prerë, përfshirë konfiskimin ndaj palës së tretë, konfiskimin e zgjeruar dhe zgjeron mundësitë për konfiskimin pa dënim të formës së prerë, në situata të tilla si vdekja e personit të dyshuar ose të akuzuar, imuniteti ose amnistia, ose afatet kohore të skaduara në legjislacionin kombëtar (për veprat me burgim prej të paktën katër (4) vjetësh). Direktiva e lartcekur gjithashtu lejon konfiskimin e pasurive të ngrira kur gjykata është e bindur se ato rrjedhin nga veprimtari kriminale, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, përfshirë pasurinë e pajustificueshme, për veprat e dënueshme me 4 (katër) vjet burg (neni 5 i Direktivës).

142. Së treti, në nivel të Këshillit të Evropës, [Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit](#), e miratuar më 16 maj 2005, mbulon si parandalimin, ashtu edhe kontrollin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Pika (d) e nenit 1 (Përdorimi i termave) të kësaj Konvente, përkufizon konfiskimin si në vijim: *“një dënim ose masë të urdhëruar nga një gjykatë pas një procedimi, lidhur me një ose disa vepra penale, dënim ose masë që përfundon me privimin e përhershëm të pasurisë”*. Po ashtu, në nivel të Këshillit Evropës, në vitin 1989, nga Ministrat e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, është themeluar [Task Forca e Veprimit Financiar](#) (në tekstin e mëtejshëm: FATF), mandati të cilës është që të vendosë standarde dhe të promovojë zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullatore dhe operacionale për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes, si dhe kërcënime të tjera të lidhura me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar. Në vitin 2012, kjo Task Forcë miratoi 40 (dyzet) rekomandime që ndahen në 7 (shtatë) fushat si në vijim: (i) politikat dhe koordinimi i luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; (ii) pastrimi dhe konfiskimi i parave; (iii) financimi i terrorizmit dhe financimi i përhapjes; (iv) masat parandaluese; (v) transparencja dhe pronësia përfituese e personave juridikë dhe marrëveshjeve; (vi) kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente dhe masat e tjera institucionale; dhe (vii) bashkëpunimi ndërkombëtar. Gjykata vë në pah se versioni i fundit i [rekomandimeve të FATF](#) në lidhje me konfiskimin, të përditësuara në shkurt të vitit 2023, përcaktojnë si në vijim: *“Vendet duhet të miratojnë masa të ngjashme me ato të përcaktuara në Konventën e Vjenës, Konventën e Palermos dhe Konventën e Financimit të Terrorizmit, duke përfshirë masat legjislative, për t'u mundësuar autoriteteve të tyre kompetente, që pa paragjykuar të drejtat e palëve të treta në mirëbesim “bona fide”, të ngrijnë ose sekuestrojnë dhe konfiskojnë sa vijon: (a) pronën e pastruar/shpërlarë, (b) të ardhurat nga, ose instrumentet e përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në pastrimin e parave ose veprat kryesore, (c) pasuria që është e ardhur nga, ose e përdorur në, ose e destinuar ose e ndarë për përdorim në, financimin e terrorizmit, akteve terroriste ose organizatave terroriste, ose (d) pronës me vlerë korresponduese”*.
143. Në anën tjetër dhe në kontekst të modeleve të konfiskimit civil të pasurisë së pajustificuar, Gjykata vëren se tradicionalisht, në fushën e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, fokusi ka qenë te *“konfiskimi pas një aktgjykimi të plotfuqishëm dënues për veprë penale”*, nëpërmjet urdhrit të gjykatës, pasi vetë vepra penale është vërtetuar në një gjykatë sipas standardeve të procedurës penale. Megjithatë, ndër vite, sistemi i konfiskimit të pasurisë që nuk është i ndërlidhur me procedurën penale, ka filluar që të shfaqet në disa shtete, respektivisht, si (i) konfiskim i pasurisë, i cili ka lidhje me ndonjë procedurë penale, por që nuk varet nga aktgjykimi dënues i asaj procedure; dhe (ii) paditë që janë ngritur kundër vetë pronës, pavarësisht nga çfarëdo procedure penale.

144. Gjykata nënvizon se modeli i parë i konfiskimit civil targeton pasurinë me origjinë nga veprimtaria e paligjshme, model ky i njohur në terminologjinë juridike si konfiskim “*in rem*”. Sipas këtij modeli, në rastet kur prokurori apo organet e tjera të autorizuar kanë dyshime se pasuria e personave të caktuar është fituar përmes veprimtarisë së paligjshme, atëherë ata mund të bëjnë kërkesë për konfiskimin e pasurisë edhe në rastet kur ndaj personave të tillë nuk ekziston një aktgjykim dënues. Pra, sipas këtij modeli, lejohet konfiskimi i pasurisë me origjinë të paligjshme, edhe pse nuk është dëshmuar paraprakisht se është kryer vepra penale përmes së cilës është përfituar pasuria në fjalë. Fushëveprimi i këtij modeli, në parim, shtrihet mbi të gjithë qytetarët, pa kufizime në kategori të caktuara. Shtetet që e kanë përfshirë këtë model të konfiskimit në sistemet e tyre juridike përfshijnë Italinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Filipinet, Australinë, Kanadanë dhe Kolumbinë. Në anën tjetër, Gjykata vë në pah edhe modelin e dytë të konfiskimit civil, i cili bënë krahasimin e pasurisë aktuale të personave/zyrtarëve të caktuar me të ardhurat e deklaruar me qëllim të identifikimit të mospërputhjes mes tyre. Edhe për këtë model konfiskimi, për t’i hapur rrugën konfiskimit civil, nuk është i nevojshëm vërtetimi se pasuria e pajustificueshme është fituar përmes kryerjes së veprës penale. Shtetet që e kanë përfshirë këtë model të konfiskimit në sistemin e tyre juridik përfshijnë Bullgarinë dhe Gjeorgjinë.
145. Përderisa sipas sqarimeve më lart, numri i sistemeve juridike që aplikojnë konceptin e konfiskimit civil të pasurisë së pajustificueshme është i kufizuar dhe rrjedhimisht, standardet e aplikueshme në këtë kontekst nuk janë të konsoliduara, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, përcaktojnë disa nga parimet e aplikueshme në këtë kontekst, me theks në balancimin në mes të mekanizmave që ndërlidhen me konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme dhe të drejtave dhe lirive themelore. Për pasojë dhe në vijim, Gjykata do të paraqesë: (i) praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së; (ii) konstatimet që burojnë nga analiza e Këshillit të Evropës në lidhje me sistemin civil të konfiskimit të pasurisë; (iii) Opinionet relevante të Komisionit të Venecias ndërlidhur me sistemin civil të konfiskimit të pasurisë; dhe (iv) Opinionet e Komisionit të Venecias për Kosovë, ndërlidhur me Ligjin e kontestuar.
- (i) *praktika relevante gjyqësore e GJEDNJ-së*
146. Gjykata fillimisht thekson se bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kjo e fundit fillimisht në kuptim të aplikueshmërisë së nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, theksoi se kur një masë konfiskimi është vendosur në mënyrë të pavarur nga ekzistenca e një dënimi penal, si rezultat i një procedure të veçantë “*civile*”, e që synon rikuperimin e pasurive që konsiderohen se janë fituar në mënyrë të paligjshme, përbën “*kontroll të përdorimit të pronës*” në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih rastin [Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë](#), nr. 36862/05, Aktgjykim i 12 gushtit 2015, paragrafi 94). Në vijim të këtij konstatimi, duhet vlerësuar nëse “*ndërhyrja*” në të drejtën e pronës (i) është e “*përcaktuar me ligj*”; (ii) ndjek një “*qëllim legjitim*”; dhe (iii) është “*proporcionale*” me qëllimin e ndjekur. përfshirë në kontekst të nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
147. Thënë këtë dhe më saktësisht, në kontekst të vlerësimit të “*ndërhyrjes*” në të drejtat pronësore si rezultat konfiskimit të pasurisë në procedurë civile, në vijim, Gjykata, i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në rastet (i) [Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë](#); (ii) [Todorov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#); (iii) [Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#); dhe (iv) [Bozadzheva dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#). Në dy rastet e para,

GJEDNJ-ja nuk kishte konstatuar shkelje të nenit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, ndërsa në dy të fundit, kishte konstatuar shkeljen përkatëse.

148. Më saktësisht, rasti *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, ndërlihet me një parashtrues, i cili në vitin 2004, si ish-ministër i Qeverisë, ishte akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Zyra e Prokurorit Publik të Gjeorgjisë kishte iniciuar procedurën për konfiskimin e pasurisë së tij dhe të parashtruesve të tjerë, që të gjithë të afërm të tij, për shkak të përfitimit në mënyrë të paligjshme dhe të pajustificueshme të pasurisë, duke u bazuar në Kodin përkatës penal dhe Kodin e Procedurës Administrative, të amendamentuar, më 13 shkurt 2004. Në shtator të vitit 2004, Gjykata e Lartë, në procedurë administrative dhe bazuar në Kodin e Procedurës Administrative, të amendamentuar më 13 shkurt 2004, kishte urdhëruar konfiskimin e gjashtë (6) pronave. Në janar të vitit 2005, pas ankesës së paraqitur nga parashtruesit, Gjykata e Lartë e Gjeorgjisë anuloi konfiskimin e njërës prej pronave dhe la në fuqi urdhrat e konfiskimit për pronat tjera. Parashtruesi i parë kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Gjeorgjisë, duke kundërshtuar kushtetutshmërinë e dispozitave që rregullonin procedurat administrative të konfiskimit sipas Kodit të Procedurës Administrative. Gjykata Kushtetuese e Gjeorgjisë kishte konfirmuar vendimet e gjykatave më të ulëta, duke konstatuar se legjislacioni në fuqi, i miratuar në shkurt të vitit 2004, i cili parashihte konfiskimin civil, i shërbente interesit publik, përkatësisht intensifikimit të luftës kundër korrupsionit. Parashtruesit e kërkesës, para GJEDNJ-së, ndër tjerash, pretenduan se: (i) konfiskimi i pasurisë së tyre përbënte shkelje të nenit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr.1. të KEDNJ-së; (ii) konfiskimi i pronave të tyre kishte qenë arbitrar dhe se autoritetet kishin pretenduar se pronat ishin përfituar si rezultat i aktivitetit kriminal të parashtruesit të parë, pa dënim përfundimtar ndaj tij; (iii) barra e provës në procedurë të konfiskimit kishte kaluar tek ta, duke argumentuar se në bazë të parimeve të përgjithshme të procedurës penale, prokurori duhet të bartë barrën e vërtetimit se një i pandehur është fajtor përtej dyshimit të bazuar; (iv) konfiskimi i pronave të tyre nuk ishte një masë e përkohshme, por përkundrazi, një akt i pakthyeshëm, i cili nuk mund të karakterizohet si kontroll i përdorimit të pronës brenda kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, por duhet të trajtohet si shpronësim *de facto* i pronës së tyre; (v) Kodi i Procedurës Administrative, i amendamentuar më 13 shkurt 2004, ishte aplikuar retroaktivisht në rastin e tyre, pasi pasuria e tyre ishte fituar në periudhën nëntor i vitit 1997 dhe maj i vitit 2004.
149. Në trajtimin e këtij rasti, GJEDNJ-ja, fillimisht në kuptim të aplikueshmërisë së nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, theksoi se kur një masë konfiskimi është vendosur në mënyrë të pavarur nga ekzistenca e një dënimi penal, si rezultat i një procedure të veçantë "*civile*", e që synon rikuperimin e pasurive që konsiderohen se janë fituar në mënyrë të paligjshme, përbën "*kontroll të përdorimit të pronës*" në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (paragrafi 94 i Aktgjykimit). Në vijim të konstatimit të saj, se konfiskimi i pasurisë së parashtruesve të kërkesës përbënte "*ndërhyrje*", GJEDNJ-ja vazhdoi me vlerësimin e asaj nëse "*ndërhyrja*" në të drejtën e parashtruesve (i) ishte e "*parashikuar me ligj*"; (ii) ndiqte një "*qëllim legjitim*"; dhe (iii) ishte "*proporcionale*" me qëllimin e ndjekur.
150. GJEDNJ-ja, (i) në kuptim të ligjshmërisë së "*ndërhyrjes*" në të drejtën e pronës, fillimisht theksoi se ligji i zbatuar në rastin konkret, nuk ishte legjislacioni i parë në vend që kërkonte që zyrtarët publikë të mbaheshin përgjegjës për origjinën e pajustificueshme të pasurisë së tyre dhe se duke filluar nga viti 1997, Ligji për Konfliktin e Interesit dhe Korrupsionin në Shërbimin Publik, kishte trajtuar tashmë çështje të tilla si veprat penale të korrupsionit dhe detyrimin e zyrtarëve publikë për të deklaruar dhe justifikuar burimin e pasurisë së tyre dhe

të rrethit të tyre të ngushtë, duke i bërë kështu subjekte ndaj përgjegjësisë së mundshme penale, administrative ose disiplinore, natyra e saktë e së cilës do të rregullohej me ligje të veçanta që rregullonin shkeljet e këtyre kërkesave kundër korrupsionit. Duke qenë kështu, sipas GJEDNJ-së, ishte e qartë se amendamenti i 13 shkurtit 2004, thjeshtë rregulloi nga e para aspektet monetare të standardeve ekzistuese ligjore kundër korrupsionit dhe se për këtë, GJEDNJ-ja konsideroi se kërkesa e "ligjshmërisë" e përfshirë në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si rregull, nuk mund të interpretohet si pengesë e pushtetit legjislativ që të kontrollojë përdorimin e pronës ose të "ndërrhyjë" në të drejtat pronësore nëpërmjet dispozitave të reja prapavepruese që rregullonin situatat faktike ose marrëdhëniet juridike. Si rrjedhojë, GJEDNJ-ja konstatoi se: (i) konfiskimi i pasurisë së parashtruesit përkatës, ishte kryer në përputhje me kriterin e "ligjshmërisë" në kuptim të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së (shih, paragrafët 98-100 të Aktgjykimit); (ii) në kuptim të "qëllimit legjitim", GJEDNJ-ja, ndër tjerash, vuri në dukje se konfiskimi ishte pjesë esenciale e një pakoje të madhe legjislativ kundër korrupsionit dhe në shërbimin publik dhe se marrë për bazë kornizën ligjore vendore, ishte evidente se arsyetimi që qëllimi për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe asaj të pajustificueshme të personave të akuzuar për vepra të rënda të kryera gjatë funksioneve publike, nga anëtarët e tyre të familjes dhe të afërmit e ngushtë ishte i dyfishtë, përkatësisht kishte një qëllim kompensues dhe parandalues. Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja konstatoi se masa e konfiskimit ishte kryer në përputhje me interesin e përgjithshëm për të siguruar që përdorimi i pronës në fjalë nuk ka rezultuar në përparësi për parashtruesin në dëm të komunitetit (paragrafët 102 dhe 103 të Aktgjykimit); ndërsa (iii) në kuptim të asaj nëse "ndërrhyrja" ishte "proporcionale" me "qëllimin legjitim", GJEDNJ-ja, ndër tjerash, konstatoi se procedura *in rem* nuk mund të konsiderohet si arbitrare për shkak se ishte e arsyeshme të pritej që të tre parashtruesit, njëri prej të cilëve ishte akuzuar drejtpërdrejtë për korrupsion në një grup të veçantë procedurash penale, ndërsa dy të tjerët supozoheshin si familjarë të të akuzuarit, të kenë përfituar në mënyrë të padrejtë nga të ardhurat e krimit të tij. Prandaj, barra e provës për të vërtetuar origjinën e pasurive të tyre si të paligjshme, kishte kaluar te prokurori. Për më tepër, procedura civile ndërlidhur me konfiskimin ishte qartësisht pjesë e një politike që synonte parandalimin dhe çrrënjosjen e korrupsionit në shërbimin publik. Prandaj, në zbatimin e politikave të tilla, shteteve duhet t'u jepet një hapësirë e gjerë vlerësimi në lidhje me atë që përbën mjetin e duhur për zbatimin e masave për të kontrolluar përdorimin e pasurisë si konfiskimi i të gjitha llojeve të produkteve të krimit (shih, paragrafin 108 të Aktgjykimit). Në vijim, GJEDNJ-ja theksoi se procedura civile *in rem* për konfiskimin e pasurisë së parashtruesve, nuk ishte në kundërshtim me ekuilibrin e drejtë të nevojshëm dhe rrjedhimisht, konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1. të KEDNJ-së (paragrafët 111-115 të Aktgjykimit).

151. Po ashtu, edhe në rastin *Todorov dhe të tjerët kundër Bullgarisë* [nr. 50705/11, Aktgjykim i 13 tetorit 2021], të gjithë parashtruesve të kërkesës iu konfiskuan pasuritë si të ardhura me origjinë nga krimi, bazuar në Ligjin për Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi të vitit 2005. Shtatë (7) kërkesat që ndërlidheshin me rrethanat e konfiskimit të pasurisë bazuar në Ligjin e lartcekur të Bullgarisë, GJEDNJ-ja i kishte bashkuar dhe përmes Aktgjykimit të saj të 13 tetorit 2021, (i) në lidhje me katër (4) nga kërkesat, përkatësisht kërkesa nr. 50705/11, (*Todorov kundër Bullgarisë*); kërkesa nr. [11340/12](#) (*Gaich kundër Bullgarisë*); kërkesa nr. [26221/12](#) (*Barov kundër Bullgarisë*); kërkesa nr. [71694/12](#) (*Zhekovi kundër Bullgarisë*), kishte konstatuar shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (ii) përderisa në lidhje me tri (3) kërkesat tjera, përkatësisht kërkesa nr. [44845/15](#) (*Rusev kundër Bullgarisë*); kërkesa nr. [17238/16](#) (*Katsarov kundër Bullgarisë*); dhe kërkesa nr. [63214/16](#) (*Dimitrov kundër Bullgarisë*), kishte konstatuar se konfiskimi i pasurive të parashtruesve, nuk përbënte shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

152. Më saktësisht, rasti *Todorov dhe të tjerët* [nr. 50705/11], ndërlidhej me atë se parashtruesi i parë, në vitin 2004, ishte dënuar, ndër të tjera, për tentim-zhvatje të kryer në vitin 1993 dhe mbi këtë bazë, në vitin 2007, Komisioni përkatës në Bullgari, kishte filluar procedurat e konfiskimit të pasurive të tij dhe të parashtruesit të dytë. Procedurat e zhvilluara kishin rezultuar në konfiskimin e pasurive të katër (4) parashtruesve në vlerë prej 896,300 (tetëqindënëntëdhjetegjashtë mijë e treqind) euro, shumica dërrmuese e të cilave ishin blerë midis viteve 2000 dhe 2005. GJEDNJ-ja konstatoi se “ndërhyrja” në të drejtat e parashtruesve sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ, ishte e “përcaktuar me ligj” dhe se ligji i vitit 2005, ndoqi “qëllime legjitime” të interesit publik. Megjithatë, në kuptim të vlerësimit të asaj nëse “ndërhyrja” në pronë ishte “proporcionale” me qëllimin legjitim, GJEDNJ-ja theksoi se parashtruesi i parë ishte dënuar për tentim-zhvatjeje të kryer më 1993. Prandaj, sipas GJEDNJ-së, nuk ishte plotësisht e qartë se si për një vepër penale, të mbetur në tentative dhe të kryer më 1993, në rrethana kur ky parashtrues nuk ishte përfshirë në ndonjë veprimtari tjetër kriminale, atij i ishin konfiskuar pasuri në vlerë të konsiderueshme, të cilat për më tepër, ishin përfitur në një periudhë pas dënimit penal të vitit 1993. GJEDNJ-ja, ndër tjerash, theksoi se “*megjithatë, edhe pse sipas fakteve të çështjes, ekzistenca e një lidhjeje shkakore midis veprës penale të vitit 1993, të kryer nga parashtruesi i parë dhe pasurive të fituara nga parashtruesit, zakonisht shumë më vonë, nuk ishte aspak e dukshme, siç u elaborua më sipër, gjykatat vendore që shqyrtonin kërkesën për konfiskim, nuk bënë asnjë përpjekje për të justifikuar një lidhje të tillë. Gjykatat vendore theksuan mospërputhjen, siç u konstatua prej tyre, midis të ardhurave dhe shpenzimeve të parashtruesit të parë dhe të dytë, pa dhënë asnjë arsye tjetër dhe hodhën poshtë kundërshtimet e parashtruesit të parë dhe të dytë në lidhje me këtë. Për më tepër, ata nuk arritën të tregonin nëse vlera e pasurisë që do të konfiskohej, ishte e barabartë me mospërputhjen e konstatuar ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të parashtruesve. Gjykatat vendore, siç u përmend, nuk u përpoqën as që të arsyetonin se parashtruesi i parë ishte përfshirë në ndonjë aktivitet tjetër kriminal.*” (shih, paragrafin 221 të Aktgjykimit). Rrjedhimisht, GJEDNJ-ja vlerësoi se nuk ishte vërtetuar se “ndërhyrja” në të drejtat e parashtruesve në kuptim të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së ishte “proporcionale” dhe për pasojë, konstatoi se kishte pasur shkelje të së drejtës në pronë sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KENDJ-së (paragrafët 222 dhe 223 të Aktgjykimit).
153. Përmes Aktgjykimit të njëjtë në këto kërkesa të bashkuara, referuar kërkesës nr. 63214/16 [Dimitrov kundër Bullgarisë](#), GJEDNJ-ja konstatoi se “ndërhyrja” në të drejtat pronësore të njërit nga parashtruesit, nuk ishte joproporcionale me qëllimet legjitime të Ligjit për Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi (shih, paragrafët 262- 267 të Aktgjykimit). Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja konstatoi se “ndërhyrja” në të drejtat e parashtruesit ishte e “përcaktuar me ligj” dhe ndiqte një “qëllim legjitim”, përkatësisht atë të interesit publik (shih, paragrafët 273-275 të Aktgjykimit). Tutje, GJEDNJ-ja vlerësoi se gjykata vendore e cila urdhëroi konfiskimin e asetëve të parashtruesit, ka shpjeguar në detaje se pse i konsideronte të njëjtat si të ardhura nga krimi, si dhe arriti në përfundimin se ekzistonte një lidhje shkakore në mes të veprave të kryera nga parashtruesi dhe asetëve të konfiskuara, konstatime këto të cilat GJEDNJ-ja nuk i vlerësoi si arbitrare apo qartazi të paarsyeshme. Si rrjedhojë, GJEDNJ-ja konstatoi se “ndërhyrja” në pronën e parashtruesit, nuk ishte joproporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe rrjedhimisht, erdhi në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së (shih paragrafët 273- 280 të Aktgjykimit).
154. Në fund, rasti i GJEDNJ-së, [Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#) [nr. 265/17 dhe nr.26473/18, Aktgjykim i 26 shtatorit 2023, paragrafi 132], ndërlidhet me zbatimin e

legjislacionit të miratuar në vitin 2012, i cili përcaktonte konfiskimin nga ana e shtetit të pasurisë së “fituar në mënyrë të paligjshme”. Pasuritë e të gjithë parashtruesve ishin konfiskuar si rezultat i dënimit për vepra penale dhe administrative edhe pse nuk ishte vendosur lidhja shkakore mes veprës(ve) dhe pasurive në fjalë.

155. Më saktësisht, në rastin *Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, parashtruesi i parë ishte dënuar për vepër penale, gjegjësisht shmangie nga tatimi, ku vepra në vetvete nuk i kishte sjellë asnjë përfitim financiar, megjithëse tatimin e kishte paguar me vonesë. Në këtë rast, edhe pse gjykatat vendore përpara tyre kishin të dhëna se i njëjti ishte përfshirë në aktivitetet kriminale, kishin vendosur që mos t'i përdornin të njëjtat, duke konsideruar se në dijeninë e tyre, parashtruesi nuk ishte i akuzuar e as i dënuar. Qeveria, në vitin 2008, kishte paraqitur argumentin rreth dënimit të parashtruesit në Belgjikë, duke pretenduar se kishte qenë i përfshirë në veprimtari kriminale. Përveç këtij dënimi, gjykatat vendore nuk kishin të dhëna të mëtejshme për ndonjë aktivitet kriminal. Megjithatë, të njëjtat konstatuan se parashtruesi, në rrethanat e rastit konkret, ka dështuar të provojë ekzistencën e ndonjë të ardhure të ligjshme për të justifikuar blerjen e aseteve, për të cilat kërkohej konfiskimi. GJEDNJ-ja, duke aplikuar parimet e vendosura përmes rastit të lartcekur *Todorov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, konstatoi se ekuilibri i drejtë i kërkuar sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, nuk ishte arritur dhe se “ndërrhyrja” në “pasuritë” e parashtruesit nuk ishte proporcionale me ndonjë qëllim legjitim. Rrjedhimisht, GJEDNJ-ja gjeti se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së (shih, paragrafin 132 të Aktgjykimit në rastin *Todorov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*). Më saktësisht, GJEDNJ-ja vlerësoi se nuk kishte asnjë arsye për të dyshuar se përfundimi i gjykatave vendore ishte arbitrar apo i pabazuar, kjo pasi këto të fundit, kishin dhënë arsye të mjaftueshme kur hodhën poshtë pretendimin se parashtruesi dhe gruaja e tij kishin fituar të ardhura të ligjshme nga burime të ndryshme. Megjithatë, GJEDNJ-ja konstatoi se një përfundim i tillë ishte i pamjaftueshëm për të justifikuar konfiskimin e pasurive të parashtruesit, pasi bazuar në nenin 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së, autoritetet vendore duhej të jepnin gjithashtu disa detaje në lidhje me veprat penale ose administrative që pretendoheshin se kishin rezultuar në blerjen e aseteve të kontestuara, si dhe të tregonin një lidhje midis çdo aktiviteti të tillë dhe pasurive në fjalë. Sipas GJEDNJ-së, vepra për të cilën ishte dënuar parashtruesi, përveç që shërbeu si bazë që e lejonte fillimin e procedurës së konfiskimit nga Komisioni përkatës në Bullgari, nuk kishte rezultuar në përfitim financiar, prandaj nuk ishte aspak e rëndësishme sa i përkiste vendimeve të gjykatave për të urdhëruar konfiskimin (shih, paragrafët 126-130 të Aktgjykimit). Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se në rastin e parashtruesit *Yordanov*, kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.
156. Tutje, rastin *Bozadzhieva dhe të tjerët kundër Bullgarisë* [kërkesa nr. 26473/18], GJEDNJ-ja e kishte bashkuar me rastin e lartcekur, përkatësisht *Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, i cili rast ndërlidhej me atë se parashtruesi i parë në këtë rast, ishte dënuar për shmangie nga tatimi dhe marrje të kundërligjshme të ndihmës për fëmijë. GJEDNJ-ja, përmes të njëjtit Aktgjykim, po ashtu konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. GJEDNJ-ja, ndër të tjerash, vlerësoi se asnjëherë nuk ishte pretenduar se veprat e kryera nga parashtruesi i parë – i vetmi aktivitet i ndaluar për të cilin kishin vendosur gjykatat vendore – kishte qenë burimi i pasurive që i nënshtroheshin konfiskimit. Sipas GJEDNJ-së, gjykatat vendore që urdhëruan konfiskimin, nuk kishin arritur që të krijojnë një lidhje midis pasurive dhe veprave penale kryesore, duke gjetur se një gjë e tillë, nuk ishte kërkesë e Ligjit të vitit 2012. Sipas GJEDNJ-së, nuk ishte dëshmuar nëse “ndërrhyrja” në pronë e parashtruesve, edhe nëse ndiqte një qëllim legjitim në interesin e përgjithshëm, ishte në “proporcion” me qëllimin e ndjekur (shih, paragrafët 136-139 të

Aktgjykimit) dhe për pasojë, konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

*(ii) Analiza e Këshillit të Evropës lidhur me Konfiskimin Civil*

157. Gjykata në vijim do t'i referohet analizës së mbështetur nga Këshilli i Evropës në lidhje me sistemin e konfiskimit të pasurisë pa aktgjykim dënues, i cili ndryshe njihet me emrin konfiskim civil apo konfiskim *in rem* (shih, për me shumë, Studimin e Këshillit të Evropës për Konfiskimin Civil, Këshilli i Evropës, 2013).
158. Sipas kësaj analize, konfiskimi civil *in rem* është një veprim kundër pasurisë dhe jo personit dhe është mekanizmi me të cilin, në mungesë të procedurës penale, të ardhurat e veprimtarisë kriminale, mund të konfiskohen në mënyrë që të privohet një person nga përfitimet e paligjshme (shih, f. 13-15 të Studimit për Konfiskimin Civil). Bazuar në këtë analizë, Gjykata vëren se ekzistojnë dy arsye themelore për të ndërmarrë politika publike në lidhje me konfiskimin civil: (i) së pari, përfitimet nga veprimtaria e paligjshme nuk duhet të bien në duart e atyre që kryejnë veprimtari të paligjshme; si dhe (ii) së dyti, shteti synon që të dekurajojë kushtet që çojnë në veprimtari të paligjshme. Shembuj të legjislacionit *in rem* mund të gjenden në juridiksione të ndryshme si Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Filipinet, Australia, Kanadaja dhe Kolumbia. Megjithëse shumica e shteteve të përmendura më sipër kanë një traditë të së drejtës anglo-saksone ("*common law*"), duhet theksuar se konfiskimi civil është treguar të jetë po aq efektiv edhe në juridiksionet e së drejtës civile-kontinentale (shih f. 15-16 të Studimit për Konfiskimin Civil). Pavarësisht kësaj, Gjykata thekson të gjeturat e analizës së mësipërme sipas të cilave, konfiskimi civil nuk duhet të përdoret si një mjet parësor kur ka prova të qarta të kriminalitetit dhe kur i dyshuari mund të ndiqet penalisht (shih, 17-18 si dhe 30 të Studimit).
159. Në këtë drejtim dhe më tej, Gjykata, duke u bazuar në raportin e lartcekur, do të shtjellojë disa nga përparësitë e këtij lloji të konfiskimit, përfshirë faktin që (i) dënimi penal nuk është kusht paraprak për konfiskimin e pasurisë; (ii) nuk pengohet nga imunitetet; (iii) funksionon edhe në pamundësi të ekstradimit apo kur i dyshuari është i paarritshëm dhe provat janë të pamjaftueshme për të arritur standardin e të provuarit në procedurë penale; (iv) konfiskimi i pasurisë mund të bëhet edhe në rast të vdekjes apo mungesës së të dyshuarit; (v) zbatohet edhe kur i dyshuari lirohet në mungesë të provave fajësuese në procedurë penale; si dhe (vi) funksionon në vendet ku ka ndërhyrje politike ose nivel të lartë të korrupsionit në sistemin e drejtësisë penale për shkak të vështirësisë së sabotimit të standardit më të ulët civil të të provuarit. Ndërsa, në anën tjetër, Gjykata gjithashtu do të shtjellojë në vijim disa nga mangësitë e këtij sistemi, përfshirë faktin që: (i) mund të bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë; dhe (ii) personi të cilit i konfiskohet pasuria, mund të perceptohet si kriminel dhe për pasojë, t'i afektohen të drejtat dhe liritë themelore. Nga kjo e fundit rezulton se si sfida kushtetuese, paraqiten dilemat në lidhje me pyetjet nëse procedura e konfiskimit civil: (a) është, në fakt, procedurë penale për shkak të natyrës ndëshkuese të saj; si dhe nëse (b) shkel të drejtën kushtetuese për mbrojtjen e pronës.
160. Sa i përket dilemës (a), përkatësisht nëse procedura e konfiskimit civil, është në fakt, procedurë penale, Gjykata vë në pah analizën në fjalë, e cila citon praktikën gjyqësore të disa vendeve siç janë Irlanda dhe Kanadaja. Nga kjo praktikë gjyqësore, rrjedhë se nëse legjislacioni që rregullon këtë fushë do të ishte penal dhe do të shqiptonte dënim, në fakt, ato kompetenca do të ishin "*ultra vires*" dhe procedura e tillë, në realitet, do të duhej të ishte civile dhe të mos parashihte dënim. Në këtë kontekst, për më tepër, praktika gjyqësore e SHBA-së, ka sqaruar se procedura e konfiskimit civil nuk bie ndesh as me parimin "*ne bis*



*in idem*”, sepse e njëjta nuk nënkupton ndjekje penale për së dyti dhe se konfiskimi civil nuk nënkupton as dënim, për shkak se të privon nga një e drejtë që nuk të takon. Megjithatë, në këtë aspekt, siç është cekur më lart, ngrihet edhe dilema e parimit të prezumimit të pafajësisë, parim ky i garantuar në paragrafin 2 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së. Këtë dilemë e ka sqaruar praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, ndër të tjera, në rastin [Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar](#) [Nr. 41661/98, Vendim në lidhje me pranueshmërinë i 27 qershorit 2002], ku kishte konstatuar se në rastin përkatës, konfiskimi kishte natyrë parandaluese dhe jo ndëshkuese dhe nuk përbën sanksion penal. Rrjedhimisht, as ky parim i procedurës penale nuk mund të zbatohet në procedurë civile. GJEDNJ-ja më konkretisht ka sqaruar në praktikën e saj se nëse natyra e procedurës nuk është përcaktuese dhe nuk ekziston një lidhje e ngushtë midis procedurës penale dhe asaj civile, por kur vendimi i gjykatës vendore ka efektin e “përcaktimit të përgjgjësisë penale të [parashtruesit], ai në vetvete do të jetë i mjaftueshëm për të krijuar lidhjen e nevojshme që neni 6 (2) i Konventës të zbatohet në këto procedura” (shih, Studimin për Konfiskimin Civil, f. 30-31 dhe 35-41).

161. Sa i përket dilemës (b), përkatësisht nëse konfiskimi civil përbën shkelje të së drejtës së pronës të garantuar sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, analiza e lartcekur përmend se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, siç është shtjelluar edhe më sipër, ka sqaruar se e drejta e pronës nuk është e drejtë absolute dhe se e njëjta mund të kufizohet nëse masa e “ndërhyrjes”: (i) është e “përcaktuar me ligj”; (ii) ndjek një “qëllim legjitim”; si dhe (iii) është “proporcionale” me qëllimin e lartcekur. Si rregull i përgjithshëm, ligjet e konfiskimit përgjithësisht konsiderohen proporcionale, mirëpo kur ato i imponojnë një barrë të tepruar të të provuarit qytetarit ose kur pasuritë me vlerë të lartë janë objekt i një urdhri që ka një lidhje sado të dobët me sjelljen kriminale, gjykatat kanë konstatuar se një konfiskim i tillë është joproporcional dhe për pasojë, përbën shkelje të të drejtave përkatëse. Në kuptim të efektit retroaktiv të konfiskimit civil, praktika e GJEDNJ-së në rastin [Walsh kundër Mbretërisë së Bashkuar](#) [nr. 43384/05, Vendim në lidhje me pranueshmërinë i 21 nëntorit 2006], ka sqaruar se parimi i ndalimit të retroaktivitetit, cenohet kur ndodhë konfiskimi civil për vepra që nuk kanë përbërë vepër penale në kohën kur është përfituar pasuria. Megjithatë, nëse vepra konsiderohet penale në kohën kur pasuria është përfituar, por nuk ka autoritet përmbarues për ta kryer konfiskimin, atëherë kur shteti krijon një organ të tillë ose autorizon një organ për të ndërmarrë një veprim të tillë, kjo është thjeshtë çështje procedurale dhe nuk shërben më si justifikim se ekzekutimi nuk mund të mos ndodhë më (shih f. 32-34 dhe 41-44 të Studimit).

(iii) *Opinionet e Komisionit të Venecias*

162. Komisioni i Venecias, ndër vite, ka miratuar opinione sipas kërkesave të vendeve anëtare të tij për shqyrtimin e iniciativave ligjore në lidhje me konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme, me ç’rast janë publikuar 4 (katër) opinione për versionet e ndryshme të projektligjit përkatës të Bullgarisë për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, respektivisht: (i) Opinioni i ndërmjetëm nr. 563/2009 për projekt-aktin për konfiskim në dobi të shtetit të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme të Bullgarisë, miratuar nga Komisioni i Venecias, më 12-14 mars 2010 [CDL-AD[2010]010]; (ii) Opinioni i dytë i ndërmjetëm nr. 563/2009 mbi projekt-aktin për konfiskim në dobi të shtetit të aseteve kriminale të Bullgarisë, miratuar nga Komisioni i Venecias, 4 qershor 2010 [CDL-AD[2010]019]; (iii) Opinioni përfundimtar nr. 563/2009 mbi projekt-aktin e tretë të rishikuar për konfiskim në dobi të gjendjes së aseteve të fituara me veprimtari të paligjshme të Bullgarisë, miratuar nga Komisioni i Venecias, më 15-16 tetor 2010 [CDL-AD[2010]030]; dhe (iv) Opinioni nr. 563/2009 mbi projekt-aktin e gjashtë të rishikuar për konfiskimin e

aseteve të fituara nga veprimtaria kriminale ose shkeljet administrative të Bullgarisë, miratuar nga Komisioni i Venecias, më 17-18 qershor 2011 [CDL-AD[2011]0123].

163. Për më tepër, Komisioni i Venecias në lidhje me konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme në procedurë civile, miratoi edhe: (i) përgjigjen *Amicus Curiae* për Gjykatën Kushtetuese të Armenisë për disa çështje në lidhje me Ligjin për konfiskimin e pasurive me origjinë të paligjshme, miratuar më 16-17 dhjetor 2022, [CDL-AD(2022)048]; (ii) parashtrësën e përbashkët *Amicus Curiae* me Zyrën e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në lidhje me veprën e pasurimit të paligjshëm në rastin e Moldavisë, miratuar më 21-22 tetor 2022 [CDL-AD(2022)029]; si dhe (iii) në rastin e Malit të Zi, Opinionin urgjent për draft-amendamentet e Ligjit për sekuestrimin dhe konfiskimin e dobive materiale me origjinë nga veprimtaria kriminale, i nxjerrë dhe i publikuar më 22 maj 2024, në zbatim të nenit 14a të Rregullores së ndryshuar të Punës të Komisionit të Venecias, [CDL-PI(2024)010]; dhe (iv) në rastin e Kosovës, dy (2) opinione të njëpasnjëshme në lidhje me vlerësimin e Projektligjit për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.
164. Opinionet e lartcekura të Komisionit të Venecias lidhur me shtetet tjera, gjithnjë në rrethanat dhe specifikat e shteteve përkatëse dhe ligjeve të analizuara, kanë trajtuar disa aspekte që janë relevante për rrethanat e rastit konkret. Në vijim, do të paraqiten të gjeturat kryesore dhe relevante që burojnë nga Opinionet e Komisionit të Venecias, dhe që ndërlidhen me (i) rregullimet dhe garancitë institucionale për Komisionet/Agjencitë përgjegjëse për konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme; (ii) çështjet që ndërlidhen me barrën e provës; dhe (iii) retroaktivitetin.
165. Së pari dhe në kontekst të strukturës, përkatësisht rregullimeve e **garancive institucionale**, përfshirë procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit përkatës, në Opinionin e katërt për Bullgarinë, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, trajtoi çështjet si: (i) shumica e nevojshme për zgjedhjen e anëtarëve të atij Komisioni; dhe (ii) mekanizmat mbikëqyrës. Në kontekst të së parës, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, kundër-argumentoi pretendimin e autoriteteve bullgare se nuk mund të kërkohej që zëvendëskryetari dhe dy anëtarë të tjerë, të zgjidhen me një shumicë të kualifikuar, përkatësisht me dy të tretat (2/3) e Asamblesë Kombëtare, pasi Kushtetuta parashikonte se vendimet e Asamblesë Kombëtare, kanë nevojë vetëm për "një shumicë më shumë se gjysma e anëtarëve të parlamentit të pranishëm, përveç rastit kur një shumicë e kualifikuar kërkohej nga Kushtetuta" dhe që për pasojë, ekzistonte mundësia që Gjykata Kushtetuese të shpallte shumicën e kualifikuar me dy të tretat (2/3) si jokushtetuese. Komisioni i Venecias, në fakt, theksoi se një Gjykatë Kushtetuese kombëtare, ndërhyrë përgjithësisht kur mungon garancia dhe jo kur ligji i zakonshëm paraqet një garanci më të rreptë si kjo në rastin konkret, e cila do të forconte pavarësinë dhe karakterin përfaqësues të Komisionit, ku ishte kërkuar që të parashihet kërkesa për votim me shumicë të kualifikuar, duke shtuar se është e rëndësishme që në kryerjen e veprimtarisë së tij, Komisioni të jetë dhe të shihet si i paanshëm (shih, paragrafët 16-19 të Opinionit). Në anën tjetër, në kontekst të çështjes së dytë, Komisioni i Venecias kishte vlerësuar se aktivitetet e Komisionit përkatës duhet të mbikëqyren nga Asambleja Kombëtare (shih, paragrafët 21-22 të Opinionit).
166. Së dyti dhe në kontekst të **barrës së provës**, Komisioni i Venecias, ka dhënë qëndrimet përkatëse në përgjigjen e tij të përbashkët *Amicus Curiae* në lidhje me veprën e pasurimit të paligjshëm [CDL-AD(2022)029] në rastin e Armenisë, por edhe në Opinionin e katërt për Bullgarinë, si dhe Opinionin urgjent për Malin e Zi [CDL-PI(2024)010]. Përmes Opinioneve të lartcekura, Komisioni i Venecias, ndër të tjerash, ka mbajtur qëndrimin se "standardet

*ndërkombëtare dhe evropiane sugjerojnë se konfiskimi civil mund të jetë një mjet efektiv për të luftuar korrupsionin publik dhe për të parandaluar blerjen e paligjshme të aseteve. Ky përbën një interes publik, i cili mund të justifikojë zbatimin e prezumimit të origjinës së paligjshme të një pasurie të caktuar. Një supozim i tillë e zhvendosë barrën e provës tek pronari i aseteve: autoriteti kompetent ka për detyrë të demonstrojë se asetet mund të jenë me origjinë të paligjshme, ndërsa i padituri mund t'i hedhë poshtë këto pretendime duke paraqitur prova për të kundërtën.”*(shih, paragrafin 60 të përgjigjes *Amicus Curiae* për Armeninë dhe paragrafin 25 të Opinionit Urgjent për Malin e Zi).

167. Në këtë drejtim, përkitazi me çështjen e standardit të të provuarit, Komisioni i Venecias, gjithashtu theksoi se sistemet e konfiskimeve civile që nuk bazohen në aktgjykime dënuese, janë krijuar për të siguruar që çështja qendrore, përkatësisht nëse asetet burojnë nga një aktivitet kriminal ose shkelje administrative, duhet të provohet sipas standardit civil të provës të *“vlerësimit të gjasave”* dhe jo standardit penal *“përtej dyshimit të arsyeshëm”*. Kjo për shkak se një standard më i ulët i të provuarit, duhet t'i mundësojë shtetit që të kryej më lehtë konfiskimin e aseteve përkatëse dhe në këtë mënyrë, të kufizojë financimin e aktiviteteve kriminale (shih, Opinionin e katërt [CDL-AD\(2011\)023](#) të Komisionit të Venecias për Bullgarinë mbi projekt-aktin e gjashtë të rishikuar për konfiskimin e aseteve të fituara nga veprimtaria kriminale ose shkelje administrative të Bullgarisë, miratuar nga Komisioni i Venecias).
168. Sipas Opinionit përkatës, për të dalluar qartë dy fazat e ndryshme në raport me barrën e të provuarit, përkatësisht fazën kur barra bie mbi agjencinë shtetërore/komisionin dhe subjektin që i nënshtrohet kontrollit, duhet të specifikohet se pasi Komisioni të ketë paraqitur çështjen *prima facie*, barra e provës bartet mbi subjektin, i cili mund të përgjigjet me një shpjegim të besueshëm se si ai ose ajo ka ardhur deri te posedimi ose kontrolli i ligjshëm i pronës në fjalë (shih, paragrafin 56 të Opinionit të katërt për Bullgarinë). Sipas Komisionit të Venecias, niveli në të cilin është vendosur pragu sa i përket provave është vendimtar, pasi nëse është i vendosur shumë lartë, agjencia shtetërore/komisioni, mund të ketë vështirësi për të marrë urdhrin e ndalimit dhe të konfiskojë pasurinë, përderisa nëse është vendosur shumë poshtë, mund të vij deri te *“ndërhyrja”* në të drejtat themelore të të pandehurit (shih, paragrafin 57 të Opinionit të katërt për Bullgarinë).
169. Në këtë Opinion, gjithashtu, në parim, sqarohet se (i) nëse një palë nuk mund të ofrojë prova përmes dokumentit të shkruar që i kërkohet, për shkak se i njëjti ka humbur apo është shkatërruar pa fajin e palës, apo nëse (ii) autoritetet kanë njoftuar se koha e detyrueshme për ruajtjen e dokumentit në fjalë veçse ka kaluar dhe ai dokument nuk ruhet më, pala nuk do të ketë nevojë të ofrojë *“provë”* se dokumenti është humbur apo është shkatërruar, përderisa mund të argumentojë *“mosekzistencën”* e dokumentin përkatës. Komisioni i Venecias e vlerësoi këtë si një shembull të mirë, duke pasur parasysh nevojën që gjykatat të lejohen që në bazë të bindjes së lirë, të vlerësojnë provat e parashtruara nga palët (shih, paragrafin 58 të Opinionit të katërt për Bullgarinë).
170. Në rastin e Armenisë, Komisioni i Venecias kishte theksuar se *“megjithatë, ky mjet duhet të zbatohet brenda kufijve të arsyeshëm dhe të shoqërohet me garanci procedurale efektive. Për sa kohë që pronari i pronës ka një mundësi reale për të hedhur poshtë supozimin dhe mund të përcjellë “provat e paqasshme” ose mbrojtjen e pronësisë në mirëbesim, zgjidhja duket proporcionale.”* (shih, paragrafin 61 të përgjigjes *Amicus Curiae* për Armeninë).
171. Përderisa në rastin e Malit të Zi, Komisioni i Venecias kishte specifikuar se draft-amendamentet e Ligjit për sekuestrimin dhe konfiskimin e dobive materiale me origjinë nga

aktivitetet kriminale “nuk përmbajnë asnjë dispozitë përkitazi me standardin e të provuarit me të cilën do të informoheshin gjykatat rreth vendimit të tyre përfundimtar për konfiskimin e asetëve. Duke qenë se kjo çështje në mënyrë strikte ndërlihet me kushtin e konstatimit të lidhjes përmbajtësore në mes të asetëve për të cilat kërkohet konfiskimi si dhe veprës penale, Komisioni i Venecias do të formulojë pikëpamjet dhe rekomandimet e veta në pjesën në vazhdim.” (shih, paragrafin 26 të Opinionit urgjent për Malin e Zi). Ky ligj përmbante dy kategori të konfiskimit, përkatësisht “konfiskimit të zgjeruar” ndaj një personi, i cili ishte dënuar për vepër penale të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, dhe i cili dështon që të prezantohet origjinën e ligjshme të asetëve të tij/saj; dhe (ii) konfiskimin *in rem* apo pa dënim, përkatësisht konfiskimin në mungesë të një dënimi dhe të drejtuar ndaj pasurisë së një personi me orgjinë të paligjshme. Komisioni i Venecias në balancimin e interesit të përgjithshëm të parandalimit të fitimit të paligjshëm të pasurisë përmes aktivitetit kriminal dhe shfrytëzimit të pasurisë së tillë dhe mbrojtjes së pronës bazuar në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, vlerësoi se janë dy faktorë të rëndësishëm që duhet të merren parasysh, përkatësisht: (i) ekzistimi i një lidhjeje përmbajtësore në mes të kriminit dhe asetëve për të cilat është kërkuar konfiskimi; dhe (ii) kufizimet kohore në kuptimin e vlerësimit retroaktiv të ligjshmërisë së të pasuruarit (shih, paragrafin 27 të Opinionit). Në vlerësimin e të parës, Komisioni i Venecias konstatoi se dispozita përkatëse të këtij ligji: “[...] të cilat në mënyrë respektive rregullojnë prezantimin e dëshmitë në procedurë gjyqësore dhe të vendimit përfundimtar për konfiskimin e asetëve, janë të heshtura në lidhje me standardin e të provuarit të cilat shërbejnë si informatë për gjykatat që vendosin në lidhje me konfiskimin e asetëve.” (shih, paragrafin 31 të Opinionit) dhe për pasojë, Komisioni i Venecias rekomandoi që dispozita përkatëse të ligjit të ndryshohen në mënyrë që ligji të identifikojë qartësisht “standardin e të provuarit”.

172. Së treti dhe në kontekst të **retroaktivitetit**, në përgjigjen *Amicus Curiae* për Armeninë, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, kishte theksuar se “për sa i përket efektit prapaveprues të Ligjit, përgjithësisht pranohet se lufta kundër korrupsionit e bën të nevojshëm veprimin jo vetëm pro të ardhmes, por edhe me synimin për fitimin e paligjshëm të pronës në të kaluarën. Zbatimi prapaveprues i ligjit në përgjithësi mund të konsiderohet proporcional dhe në pajtim me Kushtetutën armene e cila siguron mbrojtjen e pronës vetëm kur ajo është fituar në mënyrë të ligjshme. Thënë këtë, detyra për të dhënë shpjegime për origjinën e pronës duhet të mbetet e arsyeshme. Për më tepër, afati kohor për konfiskimin e pronës duhet të jetë i arsyeshëm dhe duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha rastet dhe të mos lihet në diskrecionin e autoriteteve.” (shih, paragrafin 48 të përgjigjes *Amicus Curiae* për Armeninë).
173. Tutje, në përgjigjen *Amicus Curiae* për Armeninë, Komisioni i Venecias, theksoi se: (i) “[...] të bëhet dallimi midis llojeve të ndryshme të retroaktivitetit: ligjet që ndërhyjnë në ngjarjet e kaluara dhe ligjet që ndërhyjnë në situata të vazhdueshme që kanë filluar në të kaluarën, por janë ende në vazhdim. Ndërsa në skenarin e parë ndalimi i retroaktivitetit është më rigoroz, në skenarin e dytë duhet të jetë e mundur një qasje më fleksibile për sa kohë që ndërhyrja nuk është e tepruar.” (paragrafi 45); dhe (ii) “[...] efektet prapavepruese të Ligjit nuk janë në papajtueshmëri me standardet ndërkombëtare, me kusht që detyra e të pandehurve për të dhënë shpjegime për origjinën e pasurisë mbetet e arsyeshme, dhe argumentet e mbrojtjes në këtë drejtim trajtohen në mënyrë të plotë nga gjykatat” (paragrafi 50).
174. Për më tepër, në Opinionin e katërt për Bullgarinë, Komisioni i Venecias, gjithashtu kishte theksuar se “*periudha që i nënshtrohet shqyrtimit*”, duhet të përcaktohet nga Komisioni lidhur me asetet e përfituara përmes aktivitetit kriminal dhe shkeljeve administrative,

megjithatë duke theksuar që periudha që i nënshtrohet shqyrtimit për pesëmbëdhjetë (15) vjet, “mbetet një periudhë mjaft e gjatë për këtë lloj legjislacioni prapaveprues”. Për pasojë, Komisioni i lartcekur bullgar duhet të kufizojë shqyrtimin e tij në një periudhë më të shkurtër kohe, duke marrë parasysh efikasitetin dhe proporcionalitetin e nevojshëm (shih, paragrafin 47 të Opinionit të katërt për Bullgarinë).

175. Opinionet e lartcekura të Komisionit të Venecias, gjithashtu trajtojnë edhe dy çështje relevante për rrethanat e rastit konkret, gjithnjë në kontekst të projekt-ligjeve të shteteve përkatëse, përkatësisht (i) prapun e vlerës e cila mund t’i nënshtrohet kontrollit për pasurinë e pajustificueshme; dhe (ii) detyrimin e subjekteve të kontrollit për bashkëpunim.
176. Në ndërlidhje me prapun e vlerës, në Opinionin e katërt për Bullgarinë, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, kishte theksuar, se një prag vlere prej 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) BGN për shumën e të ardhurave të një shkelje administrative, e cila korrespondon me rreth 75,000 (shtatëdhjetepesë mijë) euro, kërkohet të arrihet përpara se procedurat të mund të fillohen, derisa këtë prag e ka parë si shumë të lartë, veçanërisht kur nuk parashikohet asnjë prag në lidhje me ndonjë nga kategoritë e tjera të shkeljeve sipas të cilave mund të fillohet procedura (shih, paragrafin 32 të Opinionit të katërt për Bullgarinë). Ndërsa, në lidhje me çështjen e dytë, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, kishte theksuar se përdërisa autoritetet shtetërore do të “*ftoj*” personin e interesuar të paraqesë një deklaratë me shkrim, duke pasur parasysh kundërshtimin e provave të paraqitura në kërkesën e Komisionit për urdhër, subjekti nuk është i detyruar të paraqesë një deklaratë të tillë dhe nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi në rast se ai ose ajo vendos të mos e paraqesë atë dhe se mosparaqitja e një deklarate nga ana e subjektit, “*mund të mos jetë bazë për të nxjerrë përfundime kundër personit dhe anëtarëve të familjes së tij ose të saj*” (shih, paragrafin 44 të Opinionit të katërt për Bullgarinë). Për më tepër, Komisioni i Venecias, kishte rekomanduar që të specifikohet se kjo dispozitë zbatohet edhe në mënyrë që të ndalohet përdorimi i deklaratave të dhëna si prova gjatë zhvillimit të procedurës penale kundër personit në fjalë, pasi deklaratat mund të përdoren si provë në procedurat e tjera civile. Një sqarim i tillë do të kontribuonte në një mbrojtje më të mirë të së drejtës për të mos inkriminuar veten, ashtu siç garantohet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Sipas pikëpamjes së Komisionit të Venecias, ky parim duhet të zbatohet edhe në lidhje me procedurën “*kundër bashkëshortit të personit në fjalë.*” (shih, paragrafin 46 të Opinionit të katërt për Bullgarinë).
177. Së fundmi, në rastin e Malit të Zi, Komisioni i Venecias në Opinionin e tij urgjent për Malin e Zi, ndër tjerash, kishte theksuar se: “*Neni 8 i Ligjit nuk përcakton një afat kohor, por gjykatave vendore ua cakton detyrën e të provuarit të “një ndërlidhjeje të përkohshme”. Lejimi i margjinës së vlerësimit në këtë drejtim, për gjykatat, mund të jetë një opsion i pranueshëm, me kushtin që gjykatat të marrin parasysh, si mundësitë reale të personit në fjalë për të provuar origjinën e aseteve pas kalimit të një kohe të gjatë, ashtu edhe stabilitetin e rendit ekonomik. Megjithatë, për hir të qartësisë dhe sigurisë juridike kërkohen afate kohore më specifike, të cilat do t’ia lehtësonin personit në fjalë, barrën e të provuarit të ligjshmërisë së blerjes, dhe parandalimin e ndërhyrjes joproporcionale në të drejtat pronësore të dikujt.*” (shih, paragrafin 34 të Opinionit).

(iv) *Opinionet e Komisionit të Venecias për Kosovën*

178. Gjykata rikujton se më 20 qershor 2022, Komisioni i Venecias miratoi **Opinionin e parë** [\[Nr. 1083/2022, CDL-AD\(2022\)014\]](#) për projektligjin për Byronë, përmes të cilit, në parim, vlerësoi se projektligji nuk ishte në përputhshmëri me standardet e aplikueshme, në

kontekst të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme. Siç është sqaruar më lart, Opinioni përkatës, ndër tjerash, theksoi se (i) Komisioni i Venecias nuk është i sigurt nëse *“krijimi i një organi të ri, siç është Byroja do ta bënte luftën kundër korrupsionit me të vërtetë më efektive – apo nëse do ta ndërlikonte më tepër të gjithë sistemin që tashmë përfshinë një sërë organesh si Policia, Prokuroria, autoritetet doganore të Kosovës dhe Agjencia Kundër Korrupsionit.”* Sipas Komisionit të Venecias *“në çdo rast, duket qartë se sistemi i ri i verifikimit dhe konfiskimit duhet të kombinohet në një farë mënyre me sistemin ekzistues të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, i cili është në duart e Agjencisë Kundër Korrupsionit.”* (shih, paragrafi 72 i Opinionit të parë); dhe (ii) një legjislacion i tillë i ndjeshëm ndaj të drejtave të njeriut, siç propozohet në projektligj, është i pranueshëm vetëm *“nëse ndërtohet mbi një mekanizëm të pavarur me të gjitha kompetencat dhe burimet e nevojshme për të luftuar efektivisht korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar.”*, duke theksuar gjithashtu që dispozitat aktuale të këtij projektligji *“janë të pamjaftueshme në këtë drejtim”* (shih, paragrafi 73 i Opinionit të parë).

179. Për më tepër dhe në lidhje me Komisionin Mbikëqyrës, të propozuar në projektligjin për Byronë, i cili sipas versionit të projektligjit që i ishte nënshtruar analizës nga Komisioni i Venecias me rastin e Opinionit të parë, propozohej që të ishte Komisioni i vetë Kuvendit, përkatësisht Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, theksoi se (i) *“projektligji përfaqëson një shkallë të fortë të kontrollit politik nga politikanët, mbi Byronë.”* (ii) *“[...] Byroja nuk ka gjasa të jetë në gjendje të merret me raste serioze të korrupsionit që përfshijnë politikanë të lartë që gëzojnë – dhe mund të përdorin–ndikim të fortë politik”*; dhe (iii) *“[...] është e diskutueshme nëse roli i rëndësishëm i Komisionit Mbikëqyrës është në përputhje me përkufizimin e Byrosë si organ “i pavarur”. Në vijim të kësaj, Komisioni i Venecias, përmes Opinionit të tij të parë, rekomandoi që “kjo strukturë institucionale të rishikohet”, duke rekomanduar që Byroja, megjithatë, duhet t’i përgjigjet Kuvendit deri në një masë. Përderisa, në lidhje me vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm, Komisioni i Venecias rekomandoi që Komisioni i Kuvendit duhet të përjashtohet nga vlerësimi i tij dhe se “nëse konsiderohet e nevojshme një vlerësim i tillë duhet t’i besohet një komisioni të pavarur ekspertësh.”* (shih, paragrafi 42 i Opinionit të parë).
180. Për më tepër, sipas Opinionit përkatës të Komisionit të Venecias, ndër tjerash, duhet (i) të bëhet formulimi i interesave të përgjithshëm dhe publike, synimit dhe qëllimit të ligjit të ri në mënyrë të saktë dhe shteruese; (ii) të rishqyrtohet nevoja dhe dobia e themelimit të një organi të ri, pra Byrosë dhe në rast se vazhdohet me këtë qasje, (a) të vendosen garanci të forta të pavarësisë së Byrosë; dhe (b) t’i sigurohet Byrosë një numër i mjaftueshëm i personelit të specializuar dhe me kompetenca adekuate; (iii) të përcaktohet saktë (a) se sipas cilave kushte dhe mbi bazën e cilave kritere Byroja duhet të mbledhë informata sipas detyrës zyrtare para fillimit të procedurës zyrtare të verifikimit; (b) sipas cilave kushte mund dhe duhet të iniciohet procedura e verifikimit; dhe (c) prioritetet për punën e Byrosë, duke siguruar që Byroja të fokusohet në rastet e profilit të lartë; (iv) të qartësohet se barra e provës i kalon palës në procedurë vetëm pasi organi kompetent, përkatësisht Byroja, të ketë paraqitur një propozim të arsyetuar dhe prova që tregojnë se ekziston të paktën gjasa për përvetësim të paligjshëm të pasurisë, në bazë të standardit civil të të provuarit të *“vlerësimit të gjasave”* dhe të përkufizohet më saktë standardi civil i të provuarit i *“vlerësimit të gjasave”*, i cili sipas projektligjit aktual duhet të zbatohet nga gjykata; (v) të vendosen garanci më të forta për të drejtat e njeriut të palës dhe të personave të tjerë, ndër të tjera, (a) duke specifikuar se vendimi për iniciimin e procedurës së verifikimit, të paktën t’i komunikohet palës në procedurë dhe t’i nënshtrohen një mjete juridik; (b) duke siguruar që

deklaratat e dhëna dhe dokumentet e detyrueshme të ofruara nga pala në procedurë civile, të mos mund të përdoren kundër vet atij apo asaj në një procedurë penale; (c) duke bërë të qartë se familjarët e palës targetohen vetëm si “*persona të tretë*”; (d) duke rishqyrtuar dispozitën që personat fizikë dhe juridikë mund të detyrohen nga gjykata të bashkëpunojnë me Byronë; (e) duke rregulluar se si të bëhet identifikimi i “*palëve të treta që kanë interes juridik*” dhe cilat janë të drejtat e tyre në procedurën e verifikimit dhe konfiskimit; f) duke siguruar që personat e përfshirë në konfiskim të mos privohen nga e gjithë pasuria; dhe g) duke garantuar kompensimin e dëmeve të pësuar nga pala në rast se procedura e konfiskimit përfundimisht rezulton e pasuksesshme; dhe (vi) të vendoset një prag adekuat i provave për lëshimin e masave të përkohshme të sigurisë, duke bërë të qartë se masat e tilla mundet të merren në procedurë civile edhe në rast se është iniciuar një hetim penal (shih, paragrafi 74 i Opinionit të parë).

181. Opinionit pasues nr.1113/2022, CDL-AD (2022)052, përkatësisht **Opinionit i dytë**, në parim, vlerësoi se pas rekomandimeve të Opinionit të parë, “*përkufizimet e përfshira në projektligjin janë rishikuar në masë të madhe*”, dhe verifikimi i pasurisë përcaktohet si “*vlerësimi i masës pasurore në raport me të hyrat e ligjshme*” dhe se pasuria e pajustificueshme përcaktohet në përputhje me këtë.
182. Ndërlidhur me rolin dhe përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës, të ndryshuar pas rekomandimeve përmes Opinionit të parë, dhe i cili përbëhet me anëtarë *ex lege*, Komisioni i Venecias, e ka konsideruar si “*një zgjidhje të përshtatshme*”, duke theksuar që e njëjta ofron “*një garanci më të mirë për pavarësinë pasi të gjithë anëtarët vijnë jashtë sferës politike*”. Më saktësisht dhe në kontekst të (i) pjesëmarrjes së Auditorit të Përgjithshëm, në cilësi të anëtarit në këtë Komisionit, vlerësohet se “*kjo i përgjigjet vërejtjes së Komisionit të Venecias se Auditori i Përgjithshëm duhet të përfshihet në kontrollin e buxhetit të Byrosë*” (shih, paragrafin 15 të Opinionit); (ii) propozimin për emërim dhe shkarkim të Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë, mandatin shtatë (7) vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje dhe ndalimin për të ushtruar ndonjë funksion tjetër publik, Komisioni i Venecias i sheh si hapa shumë pozitive, duke theksuar gjithashtu se përkitazi me zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, “*zgjidhje më e mirë do të mund të ishte sigurimi i një mekanizmi më të detajuar kundër-bllokim*”, duke theksuar gjithashtu që “*zgjidhje e mundshme mund të jetë shumica e kualifikuar, megjithatë, siç tregohet në opinionet e mëhershme të Komisionit të Venecias, numri i rasteve, në të cilat Kuvendi mund të votojë me shumicë të kualifikuar është shumë i kufizuar bazuar në nenin 65 të Kushtetutës*” (shih, paragrafin 16 të Opinionit); dhe (iii) të kapacitetit institucional të Byrosë për të përmbushur në mënyrë adekuate detyrën, Komisioni i Venecias, vë në dukje se “*tani Byroja përmban të paktën katër njësi*”, duke shtuar se kjo i përgjigjet rekomandimit të tyre (shih, paragrafin 19 të Opinionit).
183. Për më tepër, Opinionit i dytë, gjithashtu thekson se (i) projektligji ende nuk parasheh një prag, se a duhet që dëshmitë të shpijnë në probabilitetin që pasuria është e pajustificueshme apo mjafton ndonjë test siç është dyshimi i arsyeshëm, duke shtuar që kjo çështje duhet të shqyrtohet më tej gjatë përgatitjes së versionit përfundimtar të projektligjit (shih, paragrafin 22 të Opinionit); (ii) çështja e barrës së provës është rregulluar në mënyrë të kënaqshme në versionin e ri të projektligjit (shih, paragrafin 25 të Opinionit); (iii) të drejtat e palëve të treta dhe përfshirja e tyre në procedurë janë sqaruar dhe më nuk paraqesin shqetësime të mëdha (shih, paragrafin 27 të Opinionit); dhe (iv) vazhdimi i periudhës së verifikimit deri në pesë (5) vjet pas përfundimit të detyrës, duhet të ketë një bazë të arsyeshme për dyshim, dhe se për një vazhdim të tillë duhet të vendosë gjykata (shih, paragrafin 28 të Opinionit).

184. Në fund, Opinioni i dytë gjithashtu paraqet edhe rekomandimet shtesë si në vijim: (i) të përfshihet në tekst se *“pasuri e pajustificueshme”* janë ato pasuri që *“nuk janë në përputhje me të ardhurat e ligjshme dhe origjina e të cilave nuk provohet si e ligjshme”*; (ii) të sqarohet nëse *“institucionet apo ndërmarrjet publike”* përfshijnë edhe institucionet e ndërmarrjet e huaja apo vetëm ato kosovare; (iii) të sigurohet një mekanizëm de-blokim për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë; (iv) të sigurohet një standard i provave për ta arsyetuar fillimin e procedurës; (v) të qartësojë mekanizmin që garanton se deklaratat e bëra dhe dokumentet e ofruara detyrimisht nga pala në procedurë civile, nuk mund të përdoren kundër tyre në procedurë penale; dhe (vi) të konsiderojë shtimin e një dispozite që do të mbulonte situatat kur procedurat nga Byroja rezultojnë të pabazuara, duke paraparë mundësinë e shkurtimit të çështjes duke tërhequr rastin.
185. Gjykata rikujton se pas Opinioni të dytë, më 23 dhjetor 2022, Komisioni për Legjislacion i Kuvendit, miratoi raportin e tij përkitazi me projektligjin për Byronë, duke i propozuar Kuvendit dhe Komisioneve të përhershme, tridhjetë e pesë (35) amendamente për Projektligjin për Byronë Shtetërore. Si rrjedhojë, pas kalimit të projektligjit në Komisionet përkatëse, Kuvendi, më 9 shkurt 2023, në lexim të dytë, miratoi Ligjin e kontestuar. Në vijim, Gjykata rikujton se më 14 mars 2023, Komisioni i Venecias, publikoi Informatën përcjellëse të Opinioni pasues Nr. 1113/2022, CDL-AD(2022)052, përmes të cilës vlerësoi se versioni i fundit, i plotësuar dhe ndryshuar, në parim, ka adresuar rekomandimet e Komisionit në Opinionin tij të e dytë: (i) duke përcaktuar se *“pasuri e pajustificueshme”* është ajo e cila *“nuk është në përputhje me të ardhurat e ligjshme dhe origjina e së cilës nuk dëshmohet si e ligjshme”*; (ii) duke sqaruar se *“institucionet apo ndërmarrjet publike”* përfshijnë vetëm institucionet dhe ndërmarrjet kosovare; (iii) duke paraparë një mekanizëm kundër bllokimit për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë; (iv) duke përcaktuar krijimin e një standardi provues për të justifikuar fillimin e procedurës; (v) duke qartësuar mekanizmin që siguron se deklaratat e dhëna dhe dokumentet e siguruara detyrimisht nga pala në procedurë civile, nuk mund të përdoren kundër tyre në procedurë penale; dhe (vi) duke i ofruar mundësi Byrosë që të shkurtojë procedurën gjyqësore duke tërhequr rastin në situata të caktuara.

### **III. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të Kontestuar**

186. Pas sqarimeve të lartcekura dhe marrë parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe përgjigjet dhe kundër-argumentet e palëve të paraqitura para Gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të vlerësojë kushtetutshmërinë e neneve të Ligjit të kontestuar që ndërlidhen me: (i) fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, të përcaktuar me nenin 2 (Fushëveprimi) të tij e që ndërlidhet edhe me nenin 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) dhe 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar (ii) procedurën e zhvilluar nga Byroja, të përcaktuar me nenet 18 (Inicimi i Procedurës), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit), 20 (Detyrimi për Bashkëpunim) dhe 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar; (iii) statusin e Byrosë, të përcaktuar me nenet 4 (Themelimi) dhe 9 (Statusi dhe Pavarësia) por të cilat gjithashtu i referohen (a) përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës të përcaktuar në nenin 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar; dhe (b) zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm, të përcaktuar në nenin 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar; si dhe (iv) funksionalizimit të Byrosë, të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 69 (Funksionalizimi i Byrosë) të Ligjit të kontestuar.



187. Gjykata fillimisht rikujton që Ligji i kontestuar themelon Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, duke e përfshirë në rendin juridik të Republikës së Kosovës, edhe konceptin e konfiskimit civil të pasurisë së pajustificueshme.
188. Ky Ligj është i ndarë në katërbëdhjetë (14) kapituj, përkatësisht (i) Kapitullin I (Dispozita e Përgjithshme); (ii) Kapitullin II (Themelimi, statusi juridik, kompetencat dhe organizimi i Byrosë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme); (iii) Kapitullin III (Mbikëqyrja e Byrosë); (iv) Kapitullin IV (Zgjedhja, mandati dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë); (v) Kapitullin V (Verifikimi i Pasurisë së Pajustificueshme); (vi) Kapitullin VI (Masat e Përkohshme dhe të Sigurimit); (vii) Kapitullin VII (Propozimi për konfiskim); (viii) Kapitullin VIII (Seanca e shqyrtimit të propozimit për konfiskim); (ix) Kapitullin IX (Procedura sipas ankesës); (x) Kapitullin X (Procedura sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike); (xi) Kapitullin XI (Raporti mbi procedurat tjera dhe administrimi); (xii) Kapitullin XII (Ekzekutimi i vendimeve dhe përparësia e përmbushjes së kërkesave); (xiii) Kapitullin XIII (Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar); dhe (xiv) Kapitullin XIV (Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare).
189. Sipas nenit 1 (Qëllimi) të tij, Ligji i kontestuar ka për qëllim (i) krijimin, organizimin dhe përcaktimin e kompetencave të Byrosë; dhe (ii) përcaktimin e procedurës së verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme nga personat zyrtarë dhe palët e treta, në kuadër të procedurës civile. Ndërsa, sipas nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit të kontestuar, i njëjti zbatohet *“ndaj pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme, qoftë drejtpërdrejtë ose të tërthorët nga personat zyrtarë dhe palët e treta”*. Neni i lartcekur, përcakton fushëveprimin kohor të Ligjit, duke përcaktuar që i njëjti zbatohet *“përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjekteve të lartcekura, nga data 17 shkurt 2008; dhe brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur subjektet pushojnë së ushtruar funksionin e tyre.”* Periudha e verifikimit të pasurisë, sqarohet më tej, përmes nenit 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, (i) verifikimi i pasurisë bëhet për pasurinë e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar; por megjithatë, (ii) verifikimi mund të zgjerohet edhe për periudhën pasi zyrtari publik nuk ushtron më funksionin publik, nëse Byroja vlerëson apo konstaton se pasuria e personit zyrtar, e fituar pas periudhës së ushtrimit të funksionit publik, është në masë të madhe më e lartë se të hyrat e ligjshme apo pasuria e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar në fjalë. Ky verifikim i zgjeruar *“nuk mund të jetë me gjatë se pesë (5) vite pas përfundimit të funksionit publik të personit zyrtar”*.
190. Neni 3 (Përkufizimet) i Ligjit të kontestuar, është relevant sepse, ndër tjerash, përcakton përkufizimin e nocionit të (i) konfiskimit të pasurisë, përkatësisht *“marrjes së përhershme të pasurisë e urdhëruar me një vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi”*; (ii) vlerësimit të gjasave, përkatësisht *“standardit të të provuarit kur gjykata bazuar në prova, beson se një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur se sa jo”*; (iii) pasurisë së pajustificueshme, përkatësisht *“pjesës së pasurisë së personit në procedurë, e cila nuk është në përputhje me të hyrat e ligjshme dhe prejardhja e së cilës nuk provohet si e ligjshme”*; dhe (iv) palëve të treta, përkatësisht *“çdo personi fizik apo juridik tek të cilët pasuria e personit zyrtarë është bartur, apo që ka ose mund të ketë interes juridik mbi pasurinë e palëve në procedurë”*.
191. Në kuadër të Kapitullit II (Themelimi, statusi juridik, kompetencat dhe organizimi i Byrosë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme) të Ligjit të kontestuar, përkatësisht sipas përcaktimeve të neneve 4 (Themelimi), 6 (Statusi juridik dhe struktura organizative), 8 (Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Byrosë) dhe 9 (Statusi dhe

Pavarësia), ndër tjerash, përcaktohet themelimi, statusi juridik dhe struktura organizative dhe kompetencat e Byrosë. Më saktësisht, (i) Byroja themelohet si "*organ i pavarur dhe i specializuar për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme*"; (ii) është institucion i pavarur publik me statusin e personit juridik; dhe (iii) ushtron kompetencat që, ndër të tjera, përfshijnë: (a) fillimin dhe zhvillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë; (b) parashtrimin e propozimit për konfiskim të pasurisë në gjykatë; (c) kërkimin e ndihmës, informacionit dhe dokumenteve relevante, nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe të huaja, personat fizikë apo juridikë që ushtrojnë autorizime publike, si dhe nga personat e tjerë fizikë dhe juridikë, vendorë dhe të huaj; (d) analizën dhe vlerësimin e informacionit dhe materialit të pranuar; (e) publikimin në faqen zyrtare të Byrosë të të gjitha aktgjykimeve dhe aktvendimeve lidhur me procedurat gjyqësore në zbatim të këtij ligji, pa u kufizuar në plotfuqishmërinë e tyre, në përputhje me rregullat e publikimit të tyre; (f) publikimin e të dhënave statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme; (g) raportimin e saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe (h) bashkëpunimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

192. Në anën tjetër, në kuadër të Kapitullit III (Mbikëqyrja e Byrosë) të Ligjit të kontestuar, përmes nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të tij, përcaktohet përbërja e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë. Sipas këtij neni, ky Komision përbëhet nga pesë (5) anëtarë me përbërjen si vijon: (i) një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, i caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, i cili është edhe kryesues i Komisionit; (ii) Auditori i Përgjithshëm; (iii) Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; (iv) një zëvendës i Avokatit të Popullit, i caktuar nga Avokati i Popullit; dhe (v) Drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare. Sipas përcaktimeve të nenit 11 (Mbledhja, Kuorumi dhe vendimmarrja në Komision) të Ligjit të kontestuar, kuorumi i nevojshëm është katër (4) anëtarë, ndërsa vendimet merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të Komisionit.
193. Sipas përcaktimeve të nenit 12 (Kompetencat e Komisionit) të Ligji të kontestuar, Komisioni Mbikëqyrës, (i) mbikëqyrë punës dhe veprimtarinë së Byrosë; (ii) zhvillon procedurën dhe propozon Kuvendit emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë; (iii) bën vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm; (iv) miraton akte nënligjore; dhe (v) shqyrton raportin e punës së Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, bazuar në nenin 6 (Statusi juridik dhe struktura organizative) të Ligjit të kontestuar, miraton strukturën organizative të Byrosë.
194. Në kuadër të Kapitullit IV (Zgjedhja, mandati dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë) të Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, përcaktohen (i) mandati i Drejtorit të Përgjithshëm; (ii) kriteret dhe procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm; (iii) kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm; dhe (iv) përfundimi i mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm.
195. Procedura për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm udhëhiqet nga Komisioni Mbikëqyrës, i cili i propozon Kuvendit kandidaturat përkatëse. Kuvendi zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë deputeteve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk merr votat e nevojshme në dy (2) raunde votimi, atëherë konkursi përsëritet dhe kompetenca për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, i kalon vetë Komisionit Mbikëqyrës. Drejtori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Kuvendi pas propozimit të Komisionit Mbikëqyrës, nën kushtet e përcaktuara në Ligjin e kontestuar, me shumicën e votave të të gjithë deputeteve të pranishëm dhe që votojnë.

196. Sipas përcaktimeve të nenit 16 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, Drejtori i Përgjithshëm, ndër tjerash, (i) udhëheqë dhe organizon punën e Byrosë; (ii) mbikëqyrë punën e zyrtarëve të Byrosë; (iii) përfaqëson Byronë brenda dhe jashtë vendit; (iv) menaxhon buxhetin e Byrosë dhe është përgjegjës për mënyrën e shpenzimit të tij, në pajtim me legjislacionin përkatës; (v) nxjerr vendime brenda mandatit dhe kompetencave të Byrosë; (vi) harton dhe miraton planin vjetor të punës brenda mandatit të Byrosë; (vii) lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, në pajtim me legjislacionin në fuqi; dhe (viii) për rastet specifike dhe kur ka mungesë të ekspertizës brenda Byrosë, vendos për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
197. Procedura e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme është e saktësuar në Kapitullin V (Verifikimi i Pasurisë së Pajustificueshme) të Ligjit të kontestuar. Ky kapitull, ndër tjerash, saktëson (i) mënyrën e inicimit të procedurës për verifikimin e pasurisë; (ii) mënyrën e mbledhjes së informacioneve me qëllim të verifikimit; (iii) detyrimin për bashkëpunim dhe pasojat përkatëse; dhe (iv) procedurën që zhvillohet në Byronë Shtetërore.
198. Më tej dhe përmes kapitujve vijues, përkatësisht kapitujve VI-XIV të Ligjit të kontestuar, ndër të tjerash, përcaktohet (i) procedura në ndërlidhje me masat e përkohshme dhe të sigurimit ndërlidhur me, ndër tjerash, ndalimin e tjetërsimit dhe përdorimit të pasurisë; (ii) propozimin për konfiskimin e pasurisë; (iii) zhvillimin e procedurës për konfiskimin e pasurisë dhe mjetet përkatëse juridike; (iv) ekzekutimin e vendimeve, përfshirë ndaj pasurisë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar; dhe (v) funksionalizimin e Byrosë Shtetërore. Në kontekst të kësaj të fundit, neni 69 (Funksionalizimi i Byrosë) i Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, përcakton se (i) vetëm pas funksionalizimit të plotë të Byrosë, por jo më vonë se një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, Byroja fillon së zbatuari dispozitat e këtij Ligji në funksion të verifikimit të pasurisë së pajustificueshme; ndërsa (ii) deri në funksionalizimin e Byrosë, funksionin administrativ, e ushtron Agjencia për Parandalim të Korrupsionit, të cilës i ndahen mjete buxhetore shtesë për kryerjen e këtij funksioni.
199. Gjykata, përtej sqarimeve të dhëna ndërlidhur me përcaktimet kryesore të Ligjit të kontestuar, po ashtu vëren se hetimet administrative në lidhje me pasurinë dhe konfiskimi i pasurisë, është gjithashtu i rregulluar me një numër ligjesh tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Në vijim dhe në mënyrë të përmbledhur, do të paraqiten ligjet e aplikueshme në kontekst të (i) kompetencave hetuese të institucioneve publike në lidhje me pasurinë; dhe (ii) procedurës së konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme.

***(i) kompetencat hetuese të institucioneve publike në lidhje me pasurinë***

200. Gjykata rikujton se ligjet të cilat ndërlidhen me kompetencat hetuese të institucioneve përgjegjëse në fushën e pasurisë së kundërligjshme përfshijnë (i) Ligjin nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit); (ii) Ligjin nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore); (iii) Ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për APK); dhe (iv) Ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Deklarimin e Pasurisë).

201. Gjykata më tej rikujton se në vitin 2010, Kuvendi kishte miratuar Ligjin nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për AKK), përmes të cilit, ndër të tjera, në nenin 5 (Kompetencat e Agjencisë) të tij, kishte përcaktuar kompetencat hetuese të AKK-së, duke i përcaktuar të njëjtës kompetencën që të *“inicion dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjellë kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale; [...]”*. Në anën tjetër, në vitin 2022, Kuvendi kishte miratuar Ligjin për APK-në, duke i ndryshuar disa nga kompetencat e Agjencisë, përfshirë ndryshimin e emërimit nga *“Agjencia kundër Korrupsionit”* në *“Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit”*, si dhe emërtimin e *“hetimeve paraprake”* në *“hetime administrative”*. Ky ligj parasheh statusin dhe kompetencat e Agjencisë lidhur me shqiptimin e masave dhe sanksioneve, me synim të parandalimit të korrupsionit, forcimit të integritetit dhe transparencës institucionale, si dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë shtetërore për luftimin e korrupsionit. Dispozitat e ligjit në fjalë zbatohen ndaj personave publikë dhe privatë në parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit, mbrojtjes së sinjalizuesve, si dhe lidhur me prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave.
202. Për më tepër, neni 5 (Përgjegjësitë e Agjencisë) i Ligjit për APK-në, ka përcaktuar se e njëjta është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që, ndër tjerash, përfshijnë: (i) mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe marrjen e masave të parapara me ligjin e veçantë; (ii) mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive siç parashihet me ligj; (iii) mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj; (iv) dhënien e mendimeve lidhur me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare; dhe (v) mbikëqyrjen dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve.
203. Në lidhje me kompetencën hetuese të këtij institucioni, Ligji për APK-në, në nën paragrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 5 (Përgjegjësitë e Agjencisë) të tij përcakton, ndër të tjera, se: *“1. Agjencia është përgjegjëse për: 1.3. Kryerjen e hetimeve administrative dhe ndërmarrjen e veprimeve në rastet që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë; [...]”*. Në këtë kontekst, Ligji për APK-në, për dallim nga ai i mëparshëm, parasheh dispozita më të detajuara për hetimet administrative, ku në kapitullin e IV [Procedura e hetimeve administrative] të tij, përcakton: (i) fillimin e kësaj procedure; (ii) rastet e hetimeve që i referohen organeve tjera; (iii) raportimin e rasteve; (iv) detyrimin për të dërguar informacione dhe dokumente në APK; (v) kërkimin e informacionit nga individët; (vi) përfundimin e hetimit administrativ; dhe (vii) masat dhe sanksionet, të cilat APK, sipas nenit 23 (Masat dhe sanksionet) të ligjit në fuqi, ka kompetencë që t'i shqiptojë kundër personave fizikë, juridikë si dhe institucioneve në pajtim me legjislacionin përkatës, siç janë: (a) gjoba; (b) qortimi jo-publik; (c) qortimi publik; dhe (d) publikimi i opinionëve. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet edhe paragrafit 3 të nenit 22 (Përfundimi i hetimit administrativ) të Ligjit për APK-në, i cili përcakton se: *“3. Me përfundim të hetimeve administrative, agjencia lëshon vendim për mbylljen e rastit dhe shqipton masat ose sanksionet brenda fushëveprimit të Agjencisë.”*
204. Sa i përket pasojave juridike të procedurës së hetimit administrativ, Gjykata vëren se dispozitat ligjore mbesin në thelb të njëjta në lidhje me (i) referimin e rasteve të prokurori në rast të dyshimit se personat të cilët kanë qenë subjekte të hetimit administrativ, kanë kryer vepra penale; dhe (ii) referimit të organi administrativ në rast të dyshimit se personat të cilët kanë qenë subjekte të hetimit administrativ, kanë kryer shkelje apo sjellje të

pahijshme disiplinore; ndërsa përmes dispozitës së re ligjore, parashihet se (iii) në rast se gjatë hetimit administrativ dyshohet për kundërvajtje, atëherë APK-ja inicion dhe zhvillon vet procedurën kundërvajtëse ose e referon atë në gjykatën kompetente në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

***(ii) legjislacioni i aplikueshëm që ndërlidhet me procedurën e konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme***

205. Gjykata më tej rikujton se dispozitat relevante që ndërlidhen me konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme janë të specifikuar (i) në Kodin nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kodi Penal); (ii) Kodin nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: Kodi i Procedurës Penale); (iii) Ligjin nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë; dhe (iv) Ligjin nr. 03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.
206. Në kontekst të ligjeve të lartcekura, Gjykata së pari vëren se Kodi Penal, përmes nenit 92 (Konfiskimi i mjeteve dhe dobisë pasurore të veprave penale) të tij, rregullon konfiskimin e mjeteve dhe dobisë pasurore, të fituara me vepra penale në Kapitullin VII (Konfiskimi i instrumentalitetit dhe dobisë pasurore të veprave penale) të tij. Më specifikisht, sipas kësaj dispozite, përcaktohet që mjetet dhe dobitë pasurore të përfituara me veprë penale, konfiskohen edhe kur kjo nuk është e mundur, paguhet një shumë e barasvlershme apo konfiskohet çdo pasuri e të pandehurit me vlerë të barasvlershme. Më tej dhe së dyti, Kodi i Procedurës Penale, në Kapitullin XVIII (Ndalimi i Pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit) të tij, rregullon procedurat e konfiskimit të pasurisë. Më saktësisht, bazuar në nenin 269 (Konfiskimi) të Kodit të Procedurës Penale, (i) pas dënimit të të pandehurit për veprë penale, gjykata konfiskon të gjitha pasuritë e specifikuar të përcaktuara në aktakuzë ose në njoftim sipas paragrafit 5 të nenit 278 (Hetimi për konfiskimin ) të Kodit; (ii) nëse ndonjë pasuri e specifikuar, tërësisht ose pjesërisht, nuk është në dispozicion për t'u konfiskuar për çfarëdo arsye, gjykata përcakton vlerën monetare të pasurisë së tillë të specifikuar dhe vepron në pajtim me dispozitat e nenit 273 (Zëvendësimi i vlerës së pasurisë) të Kodit; dhe (iii) vlera monetare e pasurisë së specifikuar, është vlera më e madhe e përcaktuar ose në kohën e dënimit ose kur është marrë së pari nga i pandehuri ose pala e tretë. Në vijim dhe sipas nenit 270 (Konfiskimi i mjetit) të Kodit të Procedurës Penale, (i) para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që ishte mjet i veprës penale, prokurori i shtetit e provon në shqyrtimin kryesor se pasuria ishte mjet i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar; dhe (ii) nëse pasuria që është mjet i veprës penale i takon një pale të tretë, pasuria konfiskohet nëse: (a) pasuria ka qenë dhuratë e njollosur; ose (b) pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si mjet.
207. Në anën tjetër, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, në nenin 1 (Qëllimi) të tij saktëson që ky *“Ligj përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë atëherë kur procedurat e detajuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës nuk janë të mjaftueshme.”* Ky ligj, i cili zbaton edhe Direktivën 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian të 3 prillit 2014, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të lartcekur Procedurës Penale. Ky i fundit, për dallim nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale, po ashtu zbaton Direktivën e lartcekur të Bashkimit Evropian dhe përfshinë dispozita të cilat janë të përcaktuara edhe me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.

208. Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, rregullon një konfiskim kuazi-penal të pasurisë. Më saktësisht, sipas nenit 2 (Fushëveprimi) të tij, (i) *“konfiskimi i zgjeruar siç parashihet me këtë Ligj zbatohet për pasurinë e personave të dënuar për ndonjë nga veprat penale të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera[...]*”; dhe (ii) përfshin edhe konfiskimin e përfitimit material ose të mjeteve për kryerjen e një vepre penale, siç është përcaktuar në Kapitullin IV (Dispozitat në lidhje me Konfiskimin e Përfitimit Material ose të Mjeteve për Kryerjen e një Vepre Penale) të këtij ligji. Në vijim të kësaj, bazuar në nenin 4 (Kërkesa për Verifikim të Pasurisë së të Pandehurit të Dënuar) të këtij Ligji: *“Prokurori i shtetit, me një kërkesë të veçantë në gjykatën, e cila e ka nxjerrë aktgjykimin, mund të kërkoj verifikimin e pasurisë brenda periudhës pesë (5) vjeçare pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, siç është përcaktuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.”* Sipas kësaj të fundit, si parakusht për inicimin e konfiskimit të pasurisë, është aktgjykimi dënues i formës së prerë, ndërsa kërkesa për verifikim të pasurisë së të dënuarit, sipas nenit 3 (Përkufizimet) të Ligjit të lartcekur, përfshinë çdo lloj prone, (i) të cilën i pandehuri e ka fituar brenda dhjetë (10) viteve para ditës kur është iniciuar faza hetimore për një vepër penale; ose që (ii) janë në pronësi ose në posedim të një pale të tretë për llogari ose përfitim të të pandehurit; ose që (iii) i pandehuri e ka transferuar tek një palë e tretë e cila nuk ishte një blerës *bona fide*, ose që më pas janë transferuar në vazhdimësi tek palët e tjera të treta të cilat nuk ishin blerës *bona fide*, brenda dhjetë (10) viteve para ditës kur është iniciuar faza hetimore për një vepër penale sipas përcaktimeve të vet ligjit. Për më tepër, Prokurori i Shtetit, me një kërkesë të veçantë në gjykatën e cila e ka nxjerrë aktgjykimin, mund të kërkojë verifikimin e pasurisë brenda periudhës pesë (5) vjeçare pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, siç është përcaktuar në Kodin Penal.
209. Barra e provës më pas bie mbi të pandehurin i cili duhet të provojë prejardhjen legjitime të pasurisë, e edhe tek palët e treta përkitazi me pretendimet e tyre. Gjykata mund të lëshojë urdhrin për konfiskim nëse i pandehuri, nuk ka arritur të provojë se pasuria është fituar nga ai/a jo nga burimet legjitime që ka pasur në kohën kur e ka fituar pronën dhe/ose nëse pala e tretë, e paraqitur si blerëse, nuk është *bona fide*. Fushëveprimi i këtij ligji përfshin edhe konfiskimin e përfitimit material ose të mjeteve për kryerjen e një vepre penale në rastet kur procedura penale nuk do mund të vazhdohet pasi që i pandehuri ka vdekur, në rast të mungesës, të çrregullimit ose të paaftësive mendore të tij, mirëpo gjykata bazuar në nenin 20 (Kushtet kur pasuria i nënshtrohet konfiskimit në rastet e vdekjes, mungesës, çrregullimit ose paaftësisë mendore të të pandehurit) të këtij Ligji, duhet të vazhdojë procedurën penale me qëllim të konfiskimit në rastet kur vlera e pasurisë që është objekt i konfiskimit të zgjeruar, e kalon vlerën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro dhe kur është në interes të drejtësisë që të vazhdohet me procedurat, duke e caktuar një avokat i cili do të përfaqësonte interesat e palës.
210. Në kontekst të sqarimeve të lartcekura, Gjykata vëren se për dallim nga (i) dispozitat që ndërlidhen me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë dhe të cilat, në parim, konfiskimin e pasurisë së paligjshme, e ndërlidhin me vërtetimin e një vepre penale përmes një vendimi të formës së prerë; dhe (ii) dispozitat që ndërlidhen me kompetencat e APK-së, përfshirë mundësinë e kësaj të fundit që të referojë rastet te prokurori në rast të dyshimit se personat të cilët kanë qenë subjekte të hetimit administrativ, kanë kryer vepër penale, (iii) Ligji i kontestuar, mundëson konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme pas vendimit të gjykatës kompetente, por pa një vendim gjyqësor që vërteton kryerjen e veprës penale, duke u bazuar në standardin e *“vlerësimit të gjasave”* dhe jo *“dyshimit të bazuar”*, të aplikueshëm në procedurën penale, përkatësisht *“standardit të të provuarit kur gjykata bazuar në prova,*

*beson se një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur se sa jo”, sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar.*

211. Thënë këtë, Gjykata rikujton se marrë parasysh numrin e madh të ligjeve të aplikueshme dhe/ose institucioneve me kompetencë për të hetuar dhe/ose konfiskuar pasurinë e paligjshme/pajustificueshme, në Opinionin e parë për Kosovën, Komisioni i Venecias, kishte ngritur dilemën e nevojës së themelimit të Byrosë si organ i ri. Më saktësisht, sipas Komisionit të Venecias, (i) “[...] është e diskutueshme nëse krijimi i një organi te ri - Byrosë – siç parashihet ne projektligj, do ta bënte vërtet me efektive luftën kundër korrupsionit - apo nëse do ta ndërlikonte të gjithë sistemin që tashmë përfshin një sërë organesh si p.sh. policinë, prokurorinë, organet tatimore dhe doganore dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit.”; dhe (ii) “[...] duket qartë se sistemi i ri i verifikimit dhe konfiskimit duhet të kombinohet në një farë mënyre me sistemin ekzistues të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, i cili është në duart e Agjencisë Kundër Korrupsionit do të ishte më e logjishme që këto mjete të lidhura ngushtë t'i besoheshin një organi të vetëm. Nuk mund të ketë arsytim që zyrtarët t'u nënshtrohen dy procedurave të ndryshme të verifikimit për te njëjtat pasuri veçanërisht në një shtet me madhësinë e Kosovës. Kështu siç është, projektligji nuk i referohet Agjencisë Kundër Korrupsionit edhe pse Agjencia do të ketë informacione vitale për punën e Byrosë. Byroja do të duhet të dyfishojë punën e bërë tashmë nga Agjencia ose do të duhet të përdorë frytet e punës për të cilën nuk ka pasur përgjegjësi dhe mbi të cilat nuk ka pasur kontroll. Kjo do të krijojë hapësirë për konfuzion, kompleksitet të panevojshëm ligjor dhe padyshim sfida të mëdha ligjore. Në qoftë se do të ekzistojnë të dy organet, funksionet e të dy organeve do të duhet të përputhen për të shmangur dyfishimin dhe duhet të përcaktohen qartë raportet e sakta mes dy organeve.” (shih, paragrafin 21 të Opinionit të parë të Komisionit të Venecias për Kosovën).
212. Megjithatë dhe përtej sqarimeve të lartcekura, esenca e kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar para Gjykatës, ndërlidhet me tri (3) aspekte thelbësore të tij, përkatësisht: (i) statusin juridik të Byrosë në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, me theks në ndërveprimin e saj me Kuvendin në cilësinë e Agjencisë së Pavarur sipas përcaktimeve të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës; (ii) ndarjes dhe ndërveprimit të pushteteve në Republikën e Kosovës, marrë parasysh përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë dhe përfaqësimit të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara me kapitullin XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës; dhe (iii) cenimin e të drejtave dhe lirive themelore, përfshirë në kontekst të barazisë para ligjit, gjykimin të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës në privatësi si dhe të drejtës në gëzim paqësor të pronës.
213. Më saktësisht, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij, por me theks në nenet 2 (Fushëveprimi), 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi), 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm), 18 (Inicimi i procedurës), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit), 20 (Detyrimi për bashkëpunim), 22 (Periudha e verifikimit të Pasurisë) dhe 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) dhe 69 (Funksionalizimi i Byrosë) të Ligjit të kontestuar. Thënë këtë, marrë parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe argumentet e paraqitura para Gjykatës nga parashtruesit e kërkesës dhe përgjigjet e palëve të interesuara, si dhe ndërlidhjen e neneve respektive me njëri-tjetrin, Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, do të vlerësojë kushtetutshmërinë e: (i) nenit 2 (Fushëveprimi) në ndërlidhje me nenin 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) dhe nenin 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar; (ii) neneve 18 (Inicimi i procedurës), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit), 20 (Detyrimi për bashkëpunim) dhe 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar; (iii) neneve 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi), 15

(Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) dhe 69 (Funksionalizimi i Byrosë) të Ligjit të kontestuar.

214. Gjykata do t'i vlerësojë nenet e lartcekura të Ligjit të kontestuar veç e veç, duke (i) përmbledhur fillimisht pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, argumentet dhe kundër-argumentet e palëve para Gjykatës; dhe (ii) duke aplikuar parimet e përgjithshme të shtjelluara më lart, përkatësisht praktikën gjyqësore të Gjykatës, të GJEDNJ-së dhe parimet relevante që burojnë nga Raportet dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias.

### **1. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 2 (Fushëveprimi) në ndërlidhje me nenin 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) dhe nenin 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar**

#### **A. Thelbi i pretendimeve/argumenteve dhe kundër-argumenteve të palëve**

215. Siç është shtjelluar në pjesën e këtij Aktgjykimi që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, këta të fundit, në esencë, pretendojnë se nenet 2 (Fushëveprimi) dhe 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së. Më saktësisht, parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, pretendojnë (i) cenimin e parimit të barazisë para ligjit në mes të zyrtarëve publikë dhe palëve të treta në raport me qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës, sepse vetëm kategoria e parë i nënshtrohet procesit të verifikimit të pasurisë përmes Byrosë, përfshirë cenimin e këtij parimi ndërlidhur me zyrtarët që kanë ushtruar funksione para dhe pas 17 shkurtit 2008; (ii) aplikimin retroaktiv të Ligjit të kontestuar, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, përkatësisht nga 17 shkurti 2008, duke specifikuar se, përveç ndalimit të retroaktivitetit të legjislacionit penal, edhe në fushën e të drejtës civile dhe administrative, veprimi retroaktiv i ligjit ndikon negativisht në të drejtat dhe interesat ligjore të subjekteve në procedurë; dhe (iii) që në mes të afateve kohore të përcaktuara përmes neneve 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar, përgjatë të cilave subjektet përkatëse mund t' i nënshtrohen kontrollit të pasurisë, ka kundërthënie me pasojën e cenimin e parimit të sigurisë juridike. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë që standardi i të provuarit mbi bazën e "*vlerësimi të gjasave*", nuk është i mjaftueshëm për të arsyetuar fillimin dhe zhvillimin e procedurës së verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë, duke theksuar që procedura nuk ngërthen garanci të mjaftueshme procedurale, përfshirë ato që ndërlidhen me parimin e barazisë së armëve.
216. Ministria e Drejtësisë, në anën tjetër, kundër-argumenton këto pretendime, duke theksuar, në esencë, që (i) Ligji i kontestuar zbatohet ndaj personave zyrtarë dhe palëve të treta pasi që personat zyrtarë, bazuar në përgjegjësitë që bartin, për dallim prej qytetarëve të tjerë, kanë pasur mundësinë të ushtrojnë ndikimin e tyre për të përfituar në mënyrë të paligjshme nga buxheti publik i shtetit; dhe (ii) retroaktiviteti në fushën civile dhe administrative është i mundur nëse është në interesin publik dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, ndërsa sqaron që data 17 shkurt 2008, ndërlidhet edhe me qarkullimin juridik të pronës nëpërmjet transaksioneve bankare, e që për qëllime të këtij ligji, përbën provë vendimtare sa i përket verifikimit të pasurisë; dhe (iii) dallimi në afatet e përcaktuara në nenet 2 dhe 22 të Ligjit të kontestuar respektivisht, ndërlidhet me dallimin në natyrën e verifikimit të pasurisë, përkatësisht të fituar gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit publik. Në kontekst të standardit të të provuarit, Ministria e Drejtësisë, ndër të tjerash, thekson që standardi është



konfirmuar edhe nga Komisioni i Venecias në Opinionet e tij si standard i të provuarit në procedurë civile, ku e vlerësoi rregullimin e çështjes së barrës së provës në mënyrë të kënaqshme.

## **B. Vlerësimi i Gjykatës**

217. Gjykata fillimisht rikujton që neni 2 i Ligjit të kontestuar përcakton fushëveprimin e tij, duke përcaktuar që (i) ligji zbatohet ndaj pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme, qoftë drejtpërdrejt- ose tërthorazi nga personat zyrtarë dhe palët e treta; dhe (ii) ndaj pasurisë së pajustificueshme të fituar përgjatë periudhës së ushtrimit të funksioneve të subjekteve përkatëse, duke filluar nga data 17 shkurt 2008 dhe brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur subjektet përkatëse pushojnë së ushtruar funksionin e tyre. Në anën tjetër, neni 22 i Ligjit të kontestuar gjithashtu saktëson periudhën e verifikimit të pasurisë, duke përcaktuar që (i) verifikimi i pasurisë bëhet për pasurinë e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar; ndërsa (ii) përjashtimisht, edhe për periudhën pasi që zyrtari publik nuk ushtron më funksionin publik, nëse Byroja vlerëson apo konstaton se pasuria e personit zyrtar, e fituar pas periudhës së ushtrimit të funksionit publik, është në masë të madhe më e lartë se të hyrat e ligjshme apo pasuria e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar, dhe që periudha që i nënshtrohet verifikimit të pasurisë në këtë kontekst, nuk mund të jetë më gjatë se pesë (5) vite pas përfundimit të funksionit publik të personit zyrtar. Në anën tjetër, Gjykata rikujton që neni 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) i Ligjit të kontestuar, përcakton që (i) Byroja paraqet provat para gjykatës lidhur me përmbushjen e standardit civil të vlerësimit të gjasave, se pasuria që është objekt shqyrtimi është e pajustificueshme; dhe (ii) pas paraqitjes së propozimit në Gjykatë, pala në procedurë në seancën e shqyrtimit, duhet të provojë se pasuria që është objekt i propozimit, ka prejardhje të justifikueshme. Gjykata gjithashtu thekson që nenet e lartcekura duhet të interpretohen edhe në kontekst të nenit 3 (Përkufizimet) të Ligjit të kontestuar ndërlidhur me përkufizimet dhe të cilat, ndër tjerash, saktësojnë përkufizimin e (i) palëve të treta, ku përfshihen personat tek të cilët është bartur pasuria e personit zyrtar apo që kanë ose mund të kenë interes mbi pasurinë e tillë; (ii) pasurisë së pajustificueshme, përkatësisht pjesës së pasurisë së personit në procedurë, e cila nuk është në përputhje me të hyrat e ligjshme dhe prejardhja e së cilës nuk provohet si e ligjshme; dhe (iii) vlerësimit të gjasave, përkatësisht, standardit të të provuarit kur gjykata bazuar në prova, beson që një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur sesa jo.
218. Gjykata rikujton që pretendimet e parashtruesve të kërkesës në kontekst të neneve të lartcekura, në parim, ndërlidhen me (i) parimin e barazisë para ligjit, përkatësisht trajtimin e pabarabartë në mes të zyrtarëve publikë dhe palëve të treta në raport me qytetarët e tjerë të Republikës përkitazi me verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, si dhe zyrtarëve publikë që kanë ushtruar funksione para dhe pas 17 shkurtit 2008; (ii) cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i aplikimit retroaktiv të ligjit, përfshirë në kontekst të barrës së provës; dhe (iii) cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i kolizionit në mes të dispozitave përkatëse, pretendime këto, të cilat, Gjykata do t' ia nënshtrojë vlerësimit të saj në vijim.

***(i) trajtimi i (pa)barabartë në mes të zyrtarëve publikë dhe palëve të treta në raport me qytetarët tjerë të Republikës përkitazi me verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, përfshirë para dhe pas 17 shkurtit 2008***

219. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata, ashtu siç ka përcaktuar përmes praktikës së saj gjyqësore, fillimisht rikujton se neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, përcakton që të

gjithë janë të barabartë para ligjit dhe që të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore. Mbrojtja kundër diskriminimit e përcaktuar në nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, e ndalon diskriminimin jo vetëm ndaj të drejtave të përcaktuara nga KEDNJ, por edhe ndaj të drejtave të cilat janë të përcaktuara përmes ligjeve të aplikueshme. Për më tepër dhe në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu vë në pah se fushëveprimi i këtij neni është i gjerë dhe shtrihet edhe në garantimin e ndalimit të diskriminimit, jo vetëm sa i përket të drejtave të garantuara me Kushtetutë, por edhe atyre me ligj. Rrjedhimisht, vlerësimi i pretendimeve për cenimin e këtij neni, duhet të bëhet përtej garancive të nenit 14 të KEDNJ-së dhe të përfshijë edhe garancitë e përcaktuara përmes nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së (shih, në lidhje me këtë, rastin e Gjykatës, [KO93/21](#), parashtrues: *Blerta Deliu-Kodra dhe dymbëdhjetë (12) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykimi i 23 dhjetorit 2021, paragrafët 283-293; dhe rastin e Gjykatës [KO79/23](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim, i 26 dhjetorit 2023, paragrafët 353-354).

220. Gjykata më tej, rikujton se parimet përkitazi me barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimin, janë shtjelluar, mes tjerash edhe në tri (3) raste të Gjykatës, përkatësisht, (i) Aktgjykimin [KO93/21](#), lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-R-01, të 6 majit 2021 (shih, paragrafët 283-364 lidhur me parimet e përgjithshme); (ii) Aktgjykimin [KO190/19](#) lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit [Nr.04/L-131](#) për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve (shih, paragrafët 180-230 lidhur me parimet e përgjithshme); dhe (iii) Aktgjykimin [KO79/23](#) lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit [Nr. 08/L-196](#) për Pagat në Sektorin Publik (shih, paragrafët 200-256 lidhur me parimet e përgjithshme).
221. Bazuar në parimet e shtjelluara në Aktgjykimet e lartcekura, është sqaruar që neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës nuk ka një karakter autonom dhe se cenimi i garancive të tij, duhet të ndërlihet me një të drejtë të garantuar me Kushtetutë dhe/ose ligje të aplikueshme. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për cenimin e barazisë para ligjit lidhur me subjektet që i nënshtrohet verifikimit të pasurisë, janë të aplikueshme të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlihdje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
222. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenet e lartcekura, Gjykata rikujton që GJEDNJ ka konstatuar që e drejta pronësore përbëhet nga tri (3) rregulla të ndryshme. Rregulli i parë, i cili përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë dhe i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pronës; rregulli i dytë, në fjalinë e dytë të të njëjtit paragraf, përfshinë privimin nga prona dhe ia nënshton atë kushteve të caktuara; rregulli i tretë, i cili përfshihet në paragrafin e dytë të këtij neni, ua njeh shteteve, ndër tjerash, të drejtën për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, me zbatimin e atyre ligjeve që ato i konsiderojnë të nevojshme për këtë qëllim (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [Sporrong dhe Lonrot kundër Suedisë](#), nr. 7151/75, 7152/75, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 61; rastin e Gjykatës, [KI86/18](#), me parashtrues *Slavica Đorđević*, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, paragrafi 140; dhe [KI185/21](#), me parashtrues *SHPK "Co Cocolina"*, Aktgjykim i 13 marsit 2023, paragrafi 186).

223. Për më tepër dhe në kontekst të konfiskimit të pasurisë, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me konfiskimin e pasurisë në kuadër të pajtueshmërisë së tij me të drejtën e pronës të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, konfiskimi i pasurisë, përgjithësisht konsiderohet si kontroll i shfrytëzimit të pronës sipas paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, pavarësisht faktit të qartë se ai përbën ndërhyrje në të drejtën në pronë (shih, rastet e GJEDNJ-së [Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), kërkesa nr. 91180/80, Aktgjykim, i 24 tetorit 1986, paragrafi 51; [Raimondo kundër Italisë](#), kërkesa nr. 12954/87, Aktgjykim, 22 shkurtit 1994, paragrafi 29; [Riela dhe të tjerët kundër Italisë](#), nr. 52439/99, Vendim, i 4 shtatorit 2001; dhe [Imeri kundër Kroacisë](#), nr. 77668/14, Aktgjykim, i 24 qershorit 2021, paragrafi 66). Megjithatë, kur konfiskimi i një instrumenti të kimit ka të bëjë me pronën e palëve të treta dhe përbën një masë të përhershme, Gjykata vëren se GJEDNJ ka analizuar këto masa në kontekst të “ndërhyrjes” në gëzimin paqësor të pronës (shih, ndër tjerash, rastet [Andonoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), kërkesa nr. 16225/08, Aktgjykim, i 17 shtatorit 2015, paragrafi 36 lidhur me konfiskimin e përhershëm të një makine të përdorur nga një palë e tretë për të kontrabanduar emigrantë; [B.K.M. Lojistik Tasimacilik Ticaret Limited Sirketi kundër Sllovenisë](#), kërkesa nr. 42079/12, Aktgjykim, i 17 janarit 2017, paragrafi 48 lidhur me konfiskimin e përhershëm të kamionit të një kompanie të përdorur nga një palë e tretë për trafik droge; dhe [Yasar kundër Rumanisë](#), kërkesa nr. 64863/13, Aktgjykim, i 26 nëntorit 2019, paragrafi 49, lidhur me konfiskimin e përhershëm të mjetit lundrues të kërkuarit të përdorur nga personi i tretë për peshkim të paligjshëm).
224. Thënë këtë, dhe siç është shtjelluar ndër vite përmes praktikës së lartcekur gjyqësore, të drejtat e garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk janë absolute dhe bazuar në nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, mund t’i nënshtrohen kufizimeve përkatëse, me kushtin që të njëjtat (i) të jenë të “përcaktuara me ligj”; (ii) të ndjekin një “qëllim legjitim”; dhe (iii) të jenë “proporcionale” me qëllimin e ndjekur. Në anën tjetër, për t’u ngritur çështja e trajtimit të pabarabartë sipas përcaktimeve të nenit 24 të Kushtetutës, fillimisht duhet të përcaktohet nëse ka pasur “dallim në trajtim” në mes të personave apo grupit të personave që ndodhen në “situata analoge apo relativisht të ngjashme” (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KO93/21](#) me parashtrues [Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës](#), Vlerësim i kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr.08-R-01, të 6 majit 2021, Aktgjykim, i 28 dhjetorit 2022, paragrafët 301-311; dhe [KO01/17](#), me parashtruese [Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit](#), Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Aktgjykim, i 28 marsit 2017, paragrafi 74).
225. Në rrethanat e dispozitave të kontestuara të Ligjit të kontestuar dhe pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, kontestuese është nëse ka “dallim në trajtim” në mes të (a) personave zyrtarë dhe palëve të treta, të cilët i nënshtrohen verifikimit dhe potencialisht konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme dhe qytetarëve të tjerë të Republikës, të cilët nuk i nënshtrohen një verifikimi të tillë; dhe (b) personave zyrtarë dhe palëve të treta para dhe pas 17 shkurtit 2008, vetëm me kategorinë e fundit të detyruar që t’i nënshtrohet verifikimit të pasurisë nga Byroja. Dallimin në trajtimin në mes kategorive të lartcekura, Gjykata do e trajtojë në vijim.

**(a) (pa)barazia në mes të personave zyrtarë dhe palëve të treta dhe qytetarëve tjerë të Republikës**

226. Në kontekst të kategorisë së parë, përkatësisht (i) personave zyrtarë dhe palëve të treta, përkatësisht personave tek të cilët është bartur pasuria e personit zyrtar apo që kanë ose mund të kenë interes mbi pasurinë e tillë, të cilët i nënshtrohen verifikimit dhe potencialisht konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme; dhe (ii) qytetarëve të tjerë të Republikës, të cilët nuk i nënshtrohen një verifikimi të tillë, Gjykata thekson se në raport me pasurinë e pajustificueshme dhe të drejtën në pronë sipas përcaktimeve të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, kategoria e personave zyrtarë, qëndron në pozitë të “*ngjashme dhe/ose analoge*” me të gjitha kategoritë tjera, duke pasur parasysh se, në parim, edhe qytetarët që nuk kanë ushtruar funksione zyrtare, mund të kenë pasuri të pajustificueshme, përderisa qëllimi i ligjit është që e njëjta të konfiskohet. Marrë parasysh që vetëm njëra kategori i nënshtrohet kontrollit të Byrosë, Gjykata, vlerëson se në mes këtyre dy kategorive, ka “*dallim në trajtim*” dhe për pasojë, sipas sqarimeve të mësipërme, më tej duhet të vlerësohet nëse “*dallimi në trajtim*” është (i) i “*përcaktuar me ligj*”; (ii) ndjek “*një qëllim legjitim*”; dhe (iii) është “*proporcional*” me qëllimin e ndjekur.
227. Në kontekst të kriterit të parë, Gjykata thekson që nuk është kontestuese që “*dallimi në trajtim*” është “*i përcaktuar me ligj*”, përkatësisht nenet 2 dhe 22 dhe paragrafët 1.14 dhe 1.15 të nenit 3 (Përkufizimet) të Ligjit të kontestuar, dhe të cilët përjashtojnë nga fushëveprimi personat që nuk janë persona zyrtarë ose nuk plotësojnë kushtet që të trajtohen si palë të treta për qëllim të Ligjit të kontestuar.
228. Në kontekst të kriterit të dytë, përkatësisht “*qëllimit legjitim*”, Gjykata rikujton se Ministria e Drejtësisë argumenton se Ligji i kontestuar zbatohet ndaj personave zyrtarë dhe palëve të treta pasi (i) personat zyrtarë, bazuar në përgjegjësitë që bartin, për dallim prej qytetarëve të tjerë të Republikës, kanë pasur mundësinë të ushtrojnë ndikimin e tyre për të përfituar në mënyrë të paligjshme nga buxheti publik i shtetit; dhe (ii) Ligji i kontestuar ka për qëllim të mbrojë qytetarët duke e rimarrë pasurinë e tjetërsuar nga buxheti i shtetit dhe duke e kthyer atë pasuri sërish në dobi të qytetarëve. Gjykata vlerëson që ky qëllim është legjitim, pasi personat zyrtarë kanë pasur mundësinë të ushtrojnë ndikimin e tyre për të përfituar në mënyrë të paligjshme nga buxheti publik i shtetit, përkatësisht tatimpaguesit e Republikës së Kosovës, andaj, kthimi i pasurisë së tjetërsuar nga buxheti i shtetit, mund të përbëjë “*qëllim legjitim*” që përkon me interesin publik.
229. Në fund dhe sa i përket kriterit të tretë, Gjykata gjithashtu vlerëson që ky “*dallim në trajtim*” është “*proporcional*” me qëllimin e ndjekur, ndër tjerash, sepse (i) përjashtimi i të gjithë qytetarëve tjerë është bërë në mënyrë që Ligji i kontestuar të jetë sa më pak kufizues në raport me të drejtat e qytetarëve, të cilët nuk kanë menaxhuar me ose përfituar nga buxheti shtetëror, andaj si të tillë, kanë më pak gjasa që të kenë pasuri të pajustificueshme e cila ka mund të jetë si rezultat i keqpërdorimit të buxhetit shtetëror; dhe (ii) ky qëllim, përkatësisht luftimi i korrupsionit përmes mekanizmave të verifikimit dhe/ose konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme, që mund të jetë i ndërlidhur me buxhetin shtetëror të Republikës së Kosovës, nuk ka mundur të arrihet me efikasitetin e duhur përmes masave tjera, duke pasur parasysh që Kodi Penal dhe Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskim të Pasurisë, kërkojnë paraprakisht dënimin për veprat penale sipas përcaktimeve të ligjeve të lartcekura me vendim gjyqësor të formës së prerë.

230. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata rikujton që Komisioni i Venecias ka theksuar se krijimi i sistemit të konfiskimit civil pa dënim penal të formës së prerë, ndër tjerash, synon (i) që të jetë një mjet efektiv për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit; (ii) mund të shërbejë si mjet i rikthimit të të ardhurave nga krimi (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias për Kosovën, paragrafi 15); dhe (iii) përbën një interes publik, i cili mund të justifikojë zbatimin e prezumimit të origjinës së paligjshme të një pasurie të caktuar (shih, Përgjigjen e përbashkët *Amicus Curiae* të Komisionit të Venecias me Zyrën e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në lidhje me veprën e pasurimit të paligjshëm në rastin e Moldavisë [CDL-AD(2022)029], paragrafi 60).

**(b) (pa)barazia në mes të personave zyrtarë dhe palëve të treta para dhe pas 17 shkurtit 2008**

231. Në kontekst të kategorisë së dytë, përkatësisht personave zyrtarë që kanë ushtruar funksione publike para dhe pas 17 shkurtit 2008 dhe palëve të treta të ndërlidhura me to, vetëm me kategorinë e fundit të detyruar që t'i nënshtrohet verifikimit të pasurisë nga Byroja, Gjykata thekson se në raport me pasurinë e pajustificueshme dhe gëzimin paqësor të pronës sipas përcaktimeve të nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, kategoria e personave zyrtarë që kanë ushtruar funksione para dhe pas 17 shkurtit 2008, qëndron në *“situatë analoge apo relativisht të ngjashme”*, duke pasur parasysh se, në parim, të gjithë mund të kenë pasuri të pajustificueshme që buron nga ushtrimi i funksioneve publike. Marrë parasysh që vetëm njëra kategori i nënshtrohet kontrollit të Byrosë, Gjykata, vlerëson që në mes këtyre dy kategorive ka *“dallim në trajtim”* dhe për pasojë, sipas sqarimeve të mësipërme, më tej duhet të vlerësohet nëse *“dallimi në trajtim”* është (i) i *“përcaktuar me ligj”*; (ii) ndjek *“një qëllim legjitim”*; dhe (iii) është *“proporcional”* me qëllimin e ndjekur.
232. Në kontekst të kriterit të parë, Gjykata thekson që nuk është kontestuese që *“dallimi në trajtim”* është i *“përcaktuar me ligj”*, përkatësisht me nenin 2 (Fushëveprimi) dhe nenin 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) të Ligjit të kontestuar, dhe të cilët përjashtojnë nga fushëveprimi personat zyrtarë dhe palët e treta të ndërlidhura me ta dhe të cilët kanë ushtruar funksione publike para 17 shkurtit 2008.
233. Në kontekst të kriterit të dytë, përkatësisht *“qëllimit legjitim”*, Gjykata rikujton që Ministria e Drejtësisë thekson se përveç ndërlidhjes simbolike të formalizmit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, data 17 shkurt 2008, ndërlidhet edhe me faktin se nga kjo kohë është *“materializuar kërkesa që çdo qarkullim juridik i pronës të bëhet nëpërmjet transaksioneve bankare, e që për qëllim të këtij ligji është parë si provë vendimtare për qëllim të verifikimit të pasurisë”*. Gjykata vëren se ky qëllim është legjitim për dallimin përkatës në trajtim, pasi formalizmi i qarkullimit juridik të pronës nëpërmjet transaksioneve bankare, në parim shërben si provë vendimtare për qëllim të verifikimit të pasurisë.
234. Në fund dhe sa i përket kriterit të tretë, Gjykata vlerëson se *“dallimi në trajtim”* në mes të personave zyrtarë që kanë fituar pasurinë para 17 shkurtit 2008 dhe atyre pas 17 shkurtit 2008, është po ashtu proporcional, ndër tjerash, sepse (i) është më pak kufizues në raport me të drejtën në pronë; dhe (ii) detyrimi i justifikimit të pasurisë për personat zyrtarë që kanë fituar pasurinë *“para kohës kur është formalizuar detyrimi për transaksione bankare”*, do të ishte barrë jo-proporcionale për personat zyrtarë që mund të kenë fituar pasurinë para 17 shkurtit 2008; për më tepër që (iii) një periudhë që do të shtrihej në një kohë aq të gjatë në mënyrë retroaktive, siç do të shtjellohet më tej, përfshirë bazuar në

Opinionet përkatëse të Komisionit të Venecias, nuk mund të jetë proporcionale me qëllimin e ndjekur. Megjithatë, Gjykata sqaron se ky vlerësim bëhet vetëm në kontekst të barazisë para ligjit dhe përjashtimit të atyre personave zyrtarë që mund të kenë fituar pasuri të pajustificueshme para 17 shkurtit 2008 dhe jo në kontekst të vlerësimit të aplikimit të parimit të retroaktivitetit në kontekst të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme dhe e cila ngrit edhe çështje të së drejtës në pronë të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, e cila do të vlerësohet ndaras në vazhdim të këtij Aktgjykimi.

### *Konkluzion*

235. Për pasojë dhe bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata konstaton që kufizimi i fushëveprimit të Ligjit të kontestuar (i) vetëm në personat zyrtarë dhe palët e treta, për dallim prej qytetarëve të tjerë të Republikës, të cilët nuk i nënshtrohen një verifikimi të tillë; dhe (ii) vetëm në personat zyrtarë dhe palët e treta, përkatësisht pasurinë e fituar pas 17 shkurtit 2008, përkundër faktit që përbën “*dallim në trajtim*”, është “*i përcaktuar me ligj*”, ndjek një “*qëllim legjitim*” dhe është “*proporcional*” me qëllimin e ndjekur, dhe rrjedhimisht nuk është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

### ***(ii) cenimi i parimit të sigurisë juridike si rezultat i aplikimit retroaktiv të Ligjit të kontestuar dhe barrës së të provuarit, të përcaktuara në pikën 2.1 të paragrafit 2 të nenit 2 dhe nenin 34 të Ligjit të kontestuar***

236. Gjykata fillimisht thekson që duke marrë parasysh ndërlidhjen e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe argumenteve dhe kundër-argumenteve të palëve para Gjykatës, kjo e fundit, aplikimin retroaktiv të Ligjit të kontestuar duke filluar që nga 17 shkurti 2008, do ta analizojë edhe në kontekst të barrës së provës të individit dhe konceptit të “*mundësive të arsyeshme dhe/ose objektive*” që i njëjti të ketë mundësinë të arsyetojë justifikueshmërinë e pasurisë përkatëse në mënyrë retroaktive përgjatë një periudhe kohore mbi pesëmbëdhjetë (15) vjet. Për këtë qëllim, Gjykata në vijim fillimisht, do të (a) analizojë aspektet që ndërlidhen me aplikimin retroaktiv të ligjit; (b) barrën e të provuarit sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar; dhe në fund (c) analizojë proporcionalitetin përkatës në mes të aplikimit retroaktiv të ligjit në kontekst të barrës së të provuarit.

### ***(a) aplikueshmëria retroaktive e ligjit, e përcaktuar në pikën 2.1. të paragrafit 2 të nenit 2 të Ligjit të kontestuar***

237. Gjykata në praktikën e saj gjyqësore ka theksuar se ndër vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutë, mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, është edhe “*sundimi i ligjit*” (shih, nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës si dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO219/19, të cituar më lart, paragrafi 209). Lista Kontrolluese për Sundimin e Ligjit, e miratuar nga Komisioni i Venecias në vitin 2016, gjithashtu specifikon aspektet e ndryshme të Sundimit të Ligjit siç janë: (a) ligjshmëria; (b) siguria juridike; (c) parandalimi i shpërdorimit të pushtetit; (d) barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi, si dhe (e) qasja në drejtësi (shih, Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, [CDL-AD \(2016\)007](#), 18 mars 2016, paragrafi 6). Tutje, ky dokument po ashtu përcakton elementet e secilës kategori të lartcekur, ku ndërlidhur me parimin e sigurisë juridike, parasheh se e njëjta përbëhet nga (i) qasshmëria në legjislacion dhe në vendime gjyqësore; (ii) parashikueshmëria e ligjeve; (iii) qëndrueshmëria dhe konsistenca e ligjeve;

(iv) pritjet legjitime; (v) ndalimi i retroaktivitetit; (vi) parimi *nullum crimen nulla poena sine lege*; dhe (vii) parimi *res judicata*.

238. Më saktësisht, në kontekst të efektit prapaveprues të ligjeve, Gjykata rikujton se Lista Kontrolluese e Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, ndër tjerash, sqaron se: “62. Njerëzit duhet të informohen paraprakisht për pasojat e sjelljes së tyre. Kjo nënkupton parashikueshmërinë (sipër II.B.3) dhe mosretroaktivitetin veçanërisht të legjislacionit penal. Në të drejtën civile dhe administrative, retroaktiviteti mund të ndikojë negativisht në të drejtat dhe interesat ligjore. Megjithatë, jashtë fushës penale, mund të lejohet një kufizim prapaveprues i të drejtave të individëve ose vendosja e detyrave të reja, por vetëm nëse është në interesin publik dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit (duke përfshirë përkohësisht). Ligjvënësi nuk duhet të ndërhyjë në zbatimin e legjislacionit ekzistues nga gjykatat”.
239. Gjykata gjithashtu vë në pah se çështjet që ndërlidhen me aplikimin retroaktiv të ligjit në çështje civile dhe/ose administrative, janë trajtuar specifikisht nga Komisioni i Venecias në përgjigjen *Amicus Curiae* për Gjykatën Kushtetuese të Armenisë dhe konkretisht, ndërlidhur me Ligjin për konfiskimin e pasurive me origjinë të paligjshme. Për më tepër, Gjykata rikujton që në kontekstin armen, Kushtetuta Armene në nenin 73 të saj, përmban edhe një ndalesë specifike për ligjet prapavepruese që përkeqësojnë situatën juridike të një personi. Komisioni i Venecias, (i) këtë rregull kushtetues e kishte cilësuar si: “[...] më i rreptë se rregullat e krahasueshme në sistemet e tjera ligjore”; dhe (ii) ndër tjerash, kishte rekomanduar që “[...] të bëhet dallimi midis llojeve të ndryshme të retroaktivitetit: ligjet që ndërhyjnë në ngjarjet e kaluara dhe ligjet që ndërhyjnë në situata të vazhdueshme që kanë filluar në të kaluarën, por janë ende në vazhdim. Ndërsa në skenarin e parë ndalimi i retroaktivitetit është më rigoroz, në skenarin e dytë duhet të jetë e mundur një qasje më fleksibile për sa kohë që ndërhyrja nuk është e tepruar.” (shih, *Amicus Curiae* të Komisionit të Venecias për Gjykatën Kushtetuese të Armenisë për disa çështje në lidhje me Ligjin për konfiskimin e pasurive me origjinë të paligjshme, [CDL-AD\(2022\)048](#), Opinion nr. 1108/2022, i miratuar nga Komisioni i Venecias, 16-17 dhjetor 2022, paragrafi 45).
240. Tutje, Komisioni i Venecias, në përgjigjen për Gjykatën Kushtetuese të Armenisë, po ashtu trajtoi edhe dy çështje relevante, përkatësisht (i) aplikimin retroaktiv të ligjit në kontekst të pasurisë së pajustificueshme dhe/ose të paligjshme; dhe (ii) barrën e të provuarit në këtë kontekst. Ndërlidhur me çështjen e parë, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, kishte theksuar se “për sa i përket konfiskimeve, përgjithësisht pranohet se lufta kundër korrupsionit e bën të domosdoshëm veprimin jo vetëm pro të ardhmes, por edhe me synimin për fitimin e paligjshëm të pronës në të kaluarën. Ligji në fjalë nuk ndërhyt ekskluzivisht në ngjarjet e kaluara, por me faktet në vazhdim: pronësia e pasurisë së paligjshme ka filluar në të kaluarën, por ajo ende vazhdon. Pritshmëria për të qenë në gjendje të mbajë pasuritë e blera në mënyrë të paligjshme nuk peshon shumë në krahasim me interesin e publikut për të “korrigjuar” pasurimin e pajustificuar. Në këtë sfond, zbatimi prapaveprues i ligjit për pronën e fituar në të kaluarën mund të konsiderohet proporcional dhe i pajtueshëm me Kushtetutën armene, e cila siguron mbrojtjen e pronës vetëm kur ajo është fituar në mënyrë të ligjshme (neni 60, paragrafi 1 i Kushtetutës). Është e diskutueshme se nuk mund të ketë një pritshmëri të vërtetë legjitime se një posedim i paligjshëm do të përfitonte mbrojtje kushtetuese. Ligji në fjalë sqaron procedurën për zbatimin e këtij parimi kushtetues”. Ndërsa, ndërlidhur me çështjen e dytë, përkatësisht barrën e të provuarit, ndër tjerash, Komisioni i Venecias kishte theksuar se (i) “ky mjet duhet të zbatohet brenda kufijve të arsyeshëm dhe të shoqërohet me garanci procedurale efektive. Për sa kohë që pronari i pronës ka një mundësi reale për të hedhur poshtë supozimin dhe mund të përcjellë “provat

e pa qasshme” ose mbrojtjen e pronësisë në mirëbesim, zgjidhja duket proporcionale.”; dhe (ii) “[...] efektet prapavepruese të Ligjit nuk janë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare, me kusht që detyra e të pandehurve për të dhënë shpjegime për origjinën e pasurisë mbetet e arsyeshme, dhe argumentet e mbrojtjes në këtë drejtim trajtohen në mënyrë të plotë nga gjykatat” (shih, *Amicus Curiae* të Komisionit të Venecias për Gjykatën Kushtetuese të Armenisë, cituar më lart, paragrafët 48, 50 dhe 61).

241. Përderisa në rastin e Malit të Zi, Komisioni i Venecias në kuptim të retroaktivitetit theksoi se: “do të ishte opsion i pranueshëm që të lejohej një marginë e vlerësimit nga gjykatat në këtë rast, me kushtin që gjykatat do të merrnin për bazë, si mundësinë aktuale të personit në fjalë që të dëshmojë origjinën e aseteve pas kalimit të një periudhe të gjatë, ashtu edhe të stabilitetit të sistemit të ekonomisë. Megjithatë, siguria juridike kërkon afate më të saktësuar kohore për të lehtësuar barrën e të provuarit të personit në fjalë që të dëshmojë ligjshmërinë e fitimit të pasurisë, dhe të parandalojë ndërhyrje joproporcionale në të drejtat pronësore të dikujt.” (shih, paragrafin 34 të Opinionit Urgjent për Malin e Zi).
242. Më tej, Gjykata gjithashtu rikujton që çështja e aplikimit retroaktiv të ligjit në kontekst të verifikimit të pasurisë së pajustificueshme/paligjshme, është trajtuar edhe përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese.
243. Më saktësisht dhe sa i përket praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje lejueshmërinë e parimit të retroaktivitetit, Gjykata vëren se i njëjti është vlerësuar nga GJEDNJ në kuadër të testit të proporcionalitetit për të drejtën në pronë të garantuar me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, respektivisht kriterit të parë të saj, “*përcaktueshmëria me ligj*” ose “*ligjshmëria e ndërhyrjes*”. Më specifikisht, në rastin *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë* i shtjelluar më sipër, sa i përket argumentit të ankuesve se ishte arbitrare të zgjerohet në mënyrë retroaktive objekti i mekanizmit të konfiskimit në pronën që ata kishin fituar përpara hyrjes në fuqi të amendamentit të 13 shkurtit 2004, GJEDNJ-ja, ndër tjerash, vlerësoi se (i) ligji i zbatuar në rastin konkret nuk ishte legjislacioni i parë në vend që kërkonte që zyrtarët publikë të mbaheshin përgjegjës për origjinën e pajustificueshme të pasurisë së tyre dhe se qysh prej vitit 1997, Ligji për Konfliktin e Interesit dhe Korrupsionin në Shërbimin Publik, kishte trajtuar tashmë çështje të tilla si veprat penale të korrupsionit dhe detyrimin e zyrtarëve publikë për të deklaruar dhe justifikuar origjinën e pasurisë së tyre dhe të rrethit të tyre të ngushtë, duke i bërë kështu subjekt ndaj përgjegjësisë së mundshme penale, administrative ose disiplinore, natyra e saktë e së cilës do të rregullohej me ligje të veçanta që rregullonin shkeljet e këtyre kërkesave kundër korrupsionit; dhe (ii) duke qenë kështu, është e qartë se amendamenti i kontestuar i 13 shkurtit 2004, thjeshtë rregulloi nga e para aspektet monetare të standardeve ekzistuese ligjore kundër korrupsionit. Për pasojë, siç është sqaruar më lart, GJEDNJ-ja konstatoi që kërkesa e “*ligjshmërisë*” e përfshirë në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, që konfiskimi i pasurisë së ankuesit në rastin në fjalë ishte kryer në pajtueshmëri me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, nr. [36862/05](#), Aktgjykim i 12 majit 2015, paragrafët 98-100).
244. Çështje të ngjashme ka shqyrtuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Sllovenisë, në rastin U-I-64/22-21 dhe U-I-65/22-23 të 17 nëntorit 2022 (Gazeta Zyrtare RS nr. 38/2022 dhe nr. 157/2022). Përmes këtij rasti, Gjykata e lartcekur, ndër tjerash, kishte përcaktuar që: (i) “*paragrafi i parë i nenit 155 të Kushtetutës ndalon efektin retroaktiv të akteve ligjore duke përcaktuar që ligjet, rregulloret e tjera, dhe aktet e përgjithshme nuk mund të kenë efekt retroaktiv. Qëllimi i kësaj ndalesë kushtetuese është që të sigurojë elementin thelbësor të sundimit të ligjit, d.m.th. sigurinë juridike, duke ruajtur dhe duke përforcuar, në këtë*



mënyrë, besimin në ligj; por megjithatë (ii) “ndalesa e përcaktuar me paragrafin e parë të nenit 155 të Kushtetutës nuk është absolute. Një përjashtim nga ajo është i përcaktuar me paragrafin e dytë të nenit 155 të Kushtetutës, sipas të cilit, vetëm ligji mund të përcaktojë që disa nga dispozitat e tij të kenë efekt retroaktiv, në qoftë se një gjë të tillë e kërkon interesi publik dhe me kusht që me këtë nuk shkelet asnjë e drejtë e fituar”.

245. Në kontekst të përjashtimeve, Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë, ndër tjerash, kishte theksuar që: (i) retroaktiviteti mund të përcaktohet vetëm me ligj; dhe (ii) vetëm disa nga dispozitat ligjore mund të kenë efekt retroaktiv, por vetëm po që se këtë e kërkon interesi publik dhe në qoftë se kjo nuk rezulton në cenimin e të drejtave të drejtave të fituara. Sipas Gjykatës së lartcekur, këto dy kritere duhet patjetër të plotësohen në mënyrë kumulative (shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese U-I-64/22-21 dhe U-I-65/22-23, paragrafi 30). Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë, gjithashtu, ndër tjerash, kishte theksuar që “*më tej, rregulloret nuk mund t'i rrisin detyrimet në mënyrë kumulative apo t'i riformulojnë ato (në bazë të fakteve të cilat kanë ndodhur në të kaluarën) apo, në përgjithësi, ta bëjnë më të vështirë për shfrytëzuesit e rregullave juridike që të kenë një qëndrim juridik në bazë të fakteve të cilat kanë ndodhur në të kaluarën, kur atyre të cilëve iu dedikohen këto rregulla juridike nuk kanë mundur ta dinë se ato fakte (në një pikë të caktuar të së ardhmes) do të prodhojnë efekt juridik – në bazë të rregullores e cila nuk ka ekzistuar në kohën kur kanë ndodhur ato.*” (shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese U-I-64/22-21 dhe U-I-65/22-23, paragrafi 26).
246. Bazuar në parimet e shtjelluara si më sipër, rezultojnë që përderisa parimi i ndalimit të aplikimit retroaktiv të ligjit është rregull shumë i rëndësishëm i parimit të sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit, në fushën civile dhe/ose administrative mund të ketë përjashtime nga ky parim, me kushtin që një përjashtim i tillë, të jetë në interesin publik. Për më tepër, në rrethana të tilla, një përjashtim i tillë, duhet të jetë (i) i “*përcaktuar me ligj*”; (ii) të ndjekë një “*qëllim legjitim*”, dhe në rrethana të ligjeve që përcaktojnë procedura që ndërlidhen me verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, si mekanizëm për luftimin e korrupsionit, një përjashtim i tillë, në parim, është vlerësuar që ndjek qëllimin legjitim të interesit publik; dhe (iii) duhet të jetë “*proporcional*”, përkatësisht të balancojë interesin publik dhe ndërhyrjen në të drejta dhe liri themelore, përfshirë në kontekst të parimeve që ndërlidhen me “*parashikueshmërinë*” dhe “*qartësinë*” e ligjit.
247. Sipas sqarimeve të mësipërme, në parim, aplikimi retroaktiv i ligjit në kontekst të interesit publik, përfshirë luftimin e korrupsionit, përmes ligjeve që verifikojnë dhe/ose konfiskojnë pasurinë e pajustificueshme, është i mundur, me kushtin që është balancuar interesi publik me të drejta dhe liri themelore. Në kontekst të verifikimit/konfiskimit të pasurisë, kur barra e provës kalon tek individ/zyrtari, ky i fundit duhet të ketë mundësi që të paraqesë dëshmi përkitazi me pasurinë e dyshuar si të pajustificueshme.
248. Në këtë aspekt është e rëndësishme gjithashtu që të theksohet se personat ndaj të cilëve zbatohet ligji retroaktivisht, (i) duhet të kenë pasur dijeni ose është dashur të ketë dijeni që pasuria e tyre duhet të justifikohet; ose (ii) duhet të kenë mekanizma të duhur që një gjë të tillë ta dëshmojnë ligjërisht, pa vendosur ndaj tyre një barrë të tepruar dhe/ose joproporcionale. Plotësimi i këtyre dy kushteve, mund të jetë i mjaftueshëm në mënyrë që detyrimi për të justifikuar pasurinë të aplikohet në mënyrë retroaktive, sepse (i) personat në fjalë e kanë ditur apo është dashur të dinë se duhet të deklarojnë apo dëshmojnë prejardhjen e pasurisë, në ndonjë mënyrë; ose (ii) kanë qasje në mekanizma të mjaftueshëm që të dëshmojnë pasurinë e tyre.

249. Për pasojë, në rrethanat e rastit konkret, nuk është kontestuese që aplikimi retroaktiv i ligjit që nga 17 shkurti 2008, në kontekst të verifikimit të pasurisë së pajustificueshme, përbën “ndërhyrje” në të drejtën në pronë të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Thënë këtë, gjithashtu nuk është kontestuese që një “ndërhyrje” e tillë, (i) është e “përcaktuar me ligj”, përkatësisht me nenin 2 (Fushëveprimi) dhe 22 (Periudha e Verifikimit të Pasurisë) të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) ndjek një “qëllim legjitim”, përkatësisht atë të interesit publik dhe luftimit të korrupsionit në Republikën e Kosovës. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më lart, në kontekst të balancimit në mes të interesit publik dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve të cilët hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, gjithashtu duhet të vlerësohet nëse një “ndërhyrje” e tillë është proporcionale. Në kontekst të vlerësimit nëse aplikimi retroaktiv i Ligjit të kontestuar është proporcional me qëllimin e ndjekur legjitim, Gjykata vlerëson që është relevante fillimisht të vlerësohet barra e të provuarit sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar, çështje kjo që do të shqyrtohet në vijim.

**(b) barra e të provuarit dhe koncepti i “vlerësimit të gjasave”, të përcaktuar në nenin 34 të Ligjit të kontestuar**

250. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht i referohet dispozitave të ndryshme të Ligjit të kontestuar të cilat rregullojnë standardin e të provuarit në procedurën e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme. Fillimisht, Gjykata rikujton që Ligji i kontestuar në (i) nënparagrafin 8 të paragrafit 1 të nenit 3 (Përkufizimet) të tij, ka përkufizuar termin “vlerësimi i gjasave” si “standard i të provuarit kur gjykata bazuar në prova, beson se një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur sesa jo”; (ii) nënparagrafin 7 të paragrafit 1 të po këtij neni, ka përcaktuar se “vlerësimi i pasurisë” nënkupton “vlerësimin e masës pasurore në raport me të hyrat e ligjshme”; ndërsa (iii) nënparagrafin 10 të tij ka përcaktuar që “pasuri e pajustificueshme” është “pjesa e pasurisë së personit në procedurë, e cila nuk është në përputhje me të hyrat e ligjshme dhe prejardhja e së cilës nuk mund të provohet si e ligjshme”.

251. Gjykata vëren se ky standard i të provuarit zbatohet në tërë procedurën e verifikimit të pasurisë, përfshirë edhe fazën e inicimit të procedurës, ku Byroja, pas pranimit të informatave nga institucionet e Republikës së Kosovës që posedojnë informata, dokumente, prova, dëshmi apo të dhëna në lidhje me pasurinë e pajustificueshme, inicion procedurën e verifikimit duke përmblusur probabilitetin e gjasave, të përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 18 (Inicimi i procedurës) të Ligjit të kontestuar. Sipas këtij ligji, po ashtu, Byroja shqyrton informatat e lartcekura për të përcaktuar nëse këto i referohen personit zyrtar që është subjekt sipas tij dhe nëse ato janë të besueshme. Më tej, paragrafi 5 i këtij neni përcakton se “[...] informatë kredibile dhe e besueshme nënkupton çdo informacion, dokument, provë, dëshmi apo e dhënë, e cila lë të kuptojë që ka mospërputhje në mes të hyrave të ligjshme dhe pasurisë së krijuar”.

252. Në kontekst të barrës së provës, Gjykata më tej i referohet paragrafit 1 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar, që përcakton se Byroja Shtetërore paraqet provat që i ka dorëzuar sipas nenit 30 (Paraqitja e propozimit për konfiskim) të Ligjit të kontestuar para gjykatës lidhur me përmblusjen e standardit civil të vlerësimit të gjasave, se pasuria që është objekt shqyrtimi është e pajustificueshme. Siç do të shtjellohet edhe më detajisht në vijim, bazuar në nenin 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar, procedura për propozimin e konfiskimit të pasurisë, fillon nëse zyrtari përkatës në Byro, vlerëson që ka shpërputhje në mes të hyrave dhe pasurisë që tejkalon vlerën prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro. Ligji i kontestuar në nenin 30 (Paraqitja e propozimit për konfiskim) të tij,

përcakton të dhënat se çka duhet të përmbajë propozimi për konfiskim siç janë: (i) emri i gjykatës; (ii) të dhënat e Byrosë; (iii) të dhënat e personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet; (iv) të dhënat e palës së tretë kur pasuria e verifikuar ka kaluar te ai person; (v) bazën ligjore; (vi) listën me secilën pasuri që propozohet të konfiskohet, duke specifikuar saktësisht llojin dhe lartësinë e vlerës; (vii) çdo e dhënë që ka shërbyer në verifikimin e pasurisë sipas nenit 19 (Mbledhja e dhënave me qëllim të verifikimit) të këtij ligji; dhe (viii) kërkesën për masë të sigurimit të pasurisë, nëse është e nevojshme, si dhe propozimit duhet t'i bashkëngjiten të gjitha provat që ajo i ka shqyrtuar për pasurinë që i nënshtrohet propozimit për konfiskim.

253. Është e rëndësishme të theksohet, më pas, bazuar në paragrafin e 2 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar, barra e të provuarit kalon nga Byroja te pala në procedurë, përkatësisht individi, ku saktësisht përcaktohet se: “2. Pas paraqitjes së propozimit në Gjykatë, pala në procedurë në seancën e shqyrtimit, duhet të provojë se pasuria që është objekt i propozimit, ka prejardhje të justifikueshme”. Ligji i kontestuar tutje në paragrafin 2 të nenit 35 (Seanca e shqyrtimit) të tij, parasheh se kur zyrtari i Byrosë nuk paraqitet në seancën e shqyrtimit pa arsye, konsiderohet se e ka tërhequr propozimin, ndërsa në paragrafin e 3 të po këtij neni, përcakton se nëse në seancën e shqyrtimit nuk paraqitet personi pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, edhe pse i thirrur rregullisht, seanca mbahet pa të. Më tej, ky nen, rregullon hapjen e seancës shqyrtuese nga ana e gjykatës nëse janë përmbushur kushtet dhe se pas hapjes së saj dhe procedurën që, gjyqtari së pari i kalon fjalën zyrtarit të Byrosë Shtetërore, i cili lexon propozimin për konfiskim dhe argumenton pse pasuria është e pajustificueshme, dhe më pas ia kalon fjalën personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet apo përfaqësuesit të tij, për t'u deklaruar lidhur me propozimin për konfiskim, me ç' rast këtyre iu lejohej të paraqesin prova.
254. Gjykata gjithashtu nënvizon dispozitat e Ligjit të kontestuar, gjegjësisht nenin 36 (Administrimi i provave) të Ligjit të kontestuar, të cilat rregullojnë fillimisht administrimin e provave të propozuara nga Byroja, dhe që sipas paragrafit 2 të këtij neni mund të kundërshtohen nga subjekti i verifikimit sa i përket (i) vërtetësisë së provës; (ii) pranueshmërisë së provës; si dhe (iii) besueshmërisë së provës. E njëjta ndodhë edhe kur subjekti i verifikimit paraqet prova, të cilat mund të kundërshtohen në të njëjta baza nga pala kundërshtarë. Gjykata më tej dhe siç është shtjelluar edhe më sipër, thekson se në paragrafin 2 të nenit 37 (Marrja në pyetje e palës, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet) të Ligjit të kontestuar, është përcaktuar mundësia që subjekti i verifikimit të mos përgjigjet në pyetjet e parashtruara. Në këtë procedurë gjyqësore, pas administrimit të provave, dhënies së dëshmive dhe marrjes në pyetje të subjektit të verifikimit, pason deklarimi përfundimtar, i cili rregullohet në nenin 38 (Deklarimi përfundimtar) të Ligjit të kontestuar, dhe fillimisht jepet nga (i) zyrtari i Byrosë Shtetërore që argumenton sipas vlerësimit të gjasave se pasuria ka prejardhje të pajustificueshme, më pas, (ii) përfaqësuesi i subjektit të verifikimit, i cili vijohet (iii) nga pala e tretë; dhe në fund, (iv) vetë subjekti i verifikimit. Gjykata vëren se Ligji i kontestuar në nenin 41 (Llojet e vendimeve) të tij, sërish i referohet standardit të vlerësimit të gjasave, atëherë kur vlerëson me aktgjykim nëse propozimi për konfiskim është (i) i bazuar; (ii) pjesërisht i bazuar; apo (iii) i pabazuar, duke konstatuar nëse pasuria është (a) e pajustificueshme; (b) pjesërisht e pajustificueshme; apo (c) e justifikueshme.
255. Bazuar në sqarimet e lartcekura dhe duke iu kthyer vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në lidhje me dispozitat ligjore të lartcekura që rregullojnë standardin e të provuarit, Gjykata në vijim do të rikujtojë parimet e përgjithshme në këtë

fushë që derivojnë nga e drejta ndërkombëtare, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së si dhe opinionet dhe përgjigjet e Komisionit të Venecias.

256. Së pari, Gjykata rithekson kapitullin specifik mbi konfiskimin e asetëve në Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit, përkatësisht paragrafin 8 të nenit 31 (Ngrirja, sekuestrimi dhe konfiskimi) të saj, ku përcaktohet se shtetet palë të kësaj konvente, duhet “[...] të marrin në konsideratë mundësinë për të kërkuar që një shkelës të tregojë origjinën e ligjshme të produkteve të tilla të supozuara të krimit ose pronës tjetër që mund të konfiskohet, në masën që një kërkesë e tillë është në përputhje me parimet themelore të ligjit të tyre të brendshëm dhe me natyrën të procedurave gjyqësore dhe të tjera.” Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu vëren që edhe Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimin e Terrorizmit në paragrafin 4 të nenit 3 (Masat e konfiskimit) të saj, përcakton se: “*Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për të kërkuar që, në lidhje me një shkelje të rëndë ose shkelje të përcaktuara nga ligji kombëtar, një shkelës të tregojë origjinën e të ardhurave të supozuara ose pronës tjetër që mund të konfiskohet në masën që kjo një kërkesë është në përputhje me parimet e së drejtës së saj të brendshme.*” Gjykata vë në pah, edhe versionin e fundit të rekomandimeve të FATF, të përditësuara në shkurt 2023, në lidhje me konfiskimin, ku të njëjtat, ndër të tjera, përcaktojnë si në vijim: “[...] *Vendet duhet të marrin në konsideratë marrjen e masave që lejojnë konfiskimin e këtyre të ardhurave ose instrumenteve pa kërkuar një dënim penal (konfiskim pa bazë dënimi), ose që kërkojnë nga shkelësi të demonstrojë origjinën e ligjshme të pronës që pretendohet se i nënshtrohet konfiskimit, në masën që një kërkesë e tillë është në përputhje me parimet e së drejtës së tyre të brendshme.*”
257. Së dyti, Gjykata i referohet edhe opinionëve dhe përgjigjeve të Komisionit të Venecias në lidhje me këtë çështje, e të cilat ne thelb siç është theksuar më lart në kapitullin e parimeve të përgjithshme të këtij Aktgjykimi, nënvizojnë se standardi i provës në konfiskimin civil konsiston në “*vlerësimin e gjasave*” dhe jo standardin penal të “*përtej dyshimit të arsyeshëm*”, për shkak se një standard më i ulët provash duhet t’i mundësojë shtetit që të marrë më lehtë konfiskimin e asetëve përkatëse dhe në këtë mënyrë të kufizojë financimin e aktiviteteve kriminale (shih, Komisioni i Venecias, Opinioni nr. 563/2009 mbi projekt-aktin e gjashtë të rishikuar për konfiskimin e asetëve të fituara nga veprimtaria kriminale ose shkelje administrative të Bullgarisë, 17-18 qershor 2011, [CDL-AD\[2011\]0123](#), paragrafi 50). Më specifikisht, Komisioni i Venecias duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konsideron se ky standard i “*vlerësimit të gjasave*”, i kombinuar me aftësinë e pronarit për të provuar të kundërtën, është i mjaftueshëm për qëllimet e testit të proporcionalitetit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.” (shih, Komisioni i Venecias, Përgjigje *Amicus Curia* për Gjykatën Kushtetuese të Armenisë për disa çështje në lidhje me Ligjin për konfiskimin e pasurive me origjinë të paligjshme, Strasburg, 16-17 dhjetor 2022, [CDL-AD\(2022\)048](#), paragrafi 23 si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 107).
258. Së treti, Gjykata rithekson rastin e GJEDNJ-së, *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, ku GJEDNJ kishte vlerësuar se procedura civile për konfiskim qartësisht përbën pjesë të një politike që synon parandalimin dhe çrrënjosjen e korrupsionit në sektorin publik dhe se shteteve palë të KEDNJ-së duhet t’u jepet një shkallë më e gjerë vlerësimi në lidhje me atë se çfarë që përbën mjetin e duhur të aplikimit të masave për të kontrolluar pronën, si konfiskimi i të gjitha llojeve të të ardhurave të krimit (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë](#), cituar më lart, paragrafët 107- 108).

259. Së katërtri dhe në fund, Gjykata gjithashtu rikujton edhe një herë versionet e mëhershme të Ligjit të kontestuar, respektivisht, i referohet rekomandimit të Komisionit të Venecias në Opinionin e parë drejtuar Republikës së Kosovës, ku në parim kishte kërkuar që të qartësohet se barra e provës i kalon palës në procedurë vetëm pasi organi kompetent, përkatësisht Byroja të ketë paraqitur një propozim të arsyetuar dhe prova që tregojnë se ekziston të paktën gjasave për përvetësim të paligjshëm të pasurisë, në bazë të standardit civil të provës të vlerësimit të gjasave (shih, Opinionin e parë të Venecias, CDL-AD(2022)014, cituar më lart, paragrafi 74). Në këtë kontekst, Komisioni i Venecias po ashtu vlerësoi se në lidhje me zhvendosjen e barrës së provës te pala në procedurë, për të mos u shkelur garancitë e një gjykimi të drejtë, Byroja si përfaqësues i shtetit, duhet të paktën të demonstrojë gjasën e përvetësimit të paligjshëm të pasurisë, mbi bazën e standardit civil të provës së vlerësimit të gjasave, sepse nëse barra e provës është shumë e lartë, mbi personin që duhet të provojë justifikueshmërinë e pronës së tij/saj, konfiskimi mund të shihet edhe si ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e pronës. Kurse, sa i përket specifikisht standardit të “*vlerësimit të gjasave*”, Komisioni i Venecias në Opinionin e parë të saj, kritikoi projektligjin përkatës për arsye që kishte përdorur dy shprehje, përkatësisht (i) “*e mundshme*”; dhe (ii) “*ka më shumë gjasa të jetë e mundshme sesa jo*”, për shkak se shprehja e parë është një prag shumë më i ulët se i dyti dhe kjo e bënte projektligjin për Byronë Shtetërore “*të paqartë*”, duke dhënë rekomandimin që kjo çështje duhej të qartësohej (Opinionin e parë i Komisionit të Venecias, CDL-AD(2022)014, cituar më lart, paragrafi 29). Gjykata megjithatë rithekson edhe të gjeturat e Komisionit të Venecias në Opinionin e dytë, ku u konstatua se janë qartësuar dispozitat në përcaktimin e barrës së provës, si dhe definicioni i “*vlerësimit të gjasave*” në përputhje me rekomandimet e Opinionit të parë, duke përcaktuar që Byroja Shtetërore duhet të paraqesë prova para gjykatës dhe të provojë, bazuar në vlerësimin e gjasave, se pronësia e pasurisë nuk mund të justifikohet dhe se pala në procedurë pastaj këtë mund ta provojë të kundërtën në seancë (shih, Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, CDL(202)053, cituar më lart, paragrafët 11 dhe 25).
260. Bazuar në parimet e lartcekura dhe duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata rikujton se Ligji i kontestuar e ka vënë barrën e provës fillimisht te Byroja Shtetërore, e cila sipas paragrafit 1 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar, i paraqet gjykatës propozimin për konfiskim së bashku me provat, duke e mbështetur këtë propozim bazuar në standardin e vlerësimit të gjasave se pasuria që është objekt shqyrtimi është e pajustificueshme, ndërsa pas këtij hapi, sipas paragrafit 2 të këtij neni, barra e të provuarit kalon nga Byroja te pala në procedurë, e cila në seancën e shqyrtimit, duhet të provojë se pasuria që është objekt i propozimit, ka prejardhje të justifikueshme. Për më tepër, Gjykata po ashtu ripërsërit edhe dispozitat e Ligjit të kontestuar, siç janë nenet 35 (Shqyrtimi në shkallën e parë), 36 (Administrimi i provave), 37 (Marrja në pyetje e palës, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet) dhe 38 (Deklarimi përfundimtar), të cilat garantojnë të drejtën e palëve në procedurë që të kundërshtojnë provat dhe deklaratat e njëri-tjetrit, si dhe detyrimin e gjykatës që sipas nenit 41 (Përfundimi i shqyrtimit dhe vendosja) të Ligjit të kontestuar, të vendosë me aktgjykim në lidhje me propozimin për konfiskim sipas vlerësimit të gjasave, të cilin standard të të provuarit, Komisioni i Venecias në Opinionin e tij të dytë e cilësoi si “*të qartë*”. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se ligjvënësi përmes dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar iu ka dhënë mundësi të arsyeshme palëve në procedurë për të paraqitur çështjen e tyre dhe se kjo procedurë nuk është e karakterizuar me arbitraritet të dukshëm, përkatësisht që zhvendosja e barrës së provës te subjekti i verifikimit të pasurisë në kushtet e mësipërme, në parim, nuk është në kundërshtim me garancitë procedurale për një gjykim të drejtë.

261. Thënë këtë, dhe sipas sqarimeve të mësipërme, Gjykata vlerëson që barra e të provuarit, duhet të vlerësohet në kontekst të aplikimit retroaktiv të Ligjit të kontestuar, dhe nëse Ligji i kontestuar, përcakton garancitë e nevojshme në mënyrë që subjektet e verifikimit, përkatësisht individët, të kenë “*mundësinë të arsyeshme*” për të kundërargumentuar para gjykatave pretendimet e shtetit, përkatësisht të Byrosë Shtetërore lidhur me pa/justifikueshmërinë e pasurisë përkatëse.

**(c) proporcionaliteti i aplikimit retroaktiv të ligjit në kontekst të barrës së të provuarit**

262. Gjykata, fillimisht rikujton që ajo tashmë ka sqaruar, që aplikimi retroaktiv i Ligjit të kontestuar, ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht atë të interesit publik për të luftuar korrupsionin në Republikën e Kosovës. Thënë këtë, sipas sqarimeve të lartcekura, ky qëllim legjitim, duhet gjithashtu të jetë proporcional me të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të verifikimit. Siç është sqaruar më sipër, nuk është kontestuese që konfiskimi i pasurisë, përbën “*ndërhyrje*” në të drejtat pronësore të garantuara përmes nenit 46 të Kushtetutës. Një “*ndërhyrje*” e tillë, duhet gjithashtu të jetë proporcionale me qëllimin e ndjekur. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson që përderisa aplikimi retroaktiv i Ligjit të kontestuar është i mundur për qëllime legjitime të luftimit të korrupsionit në sektorin publik, periudha kohore përgjatë së cilës ligji aplikohet retroaktivisht, gjithashtu duhet të jetë e arsyeshme në mënyrë që subjektet e verifikimit, ndër tjerash, bazuar në garancitë që ndërlidhen me barrën e të provuarit, të kenë “*mundësi të arsyeshme*” që të kundërargumentojë pretendimet e Byrosë Shtetërore ndërlidhur me pajustificueshmërinë e pasurisë, përkatësisht mospërputhjen në mes të të hyrave dhe pasurisë në vlerën prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro, sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar.
263. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në opinionet përkatëse të Komisionit të Venecias për Bullgarinë dhe Armeninë, sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, Komisioni i Venecias ka mbajtur qëndrimin, ndër të tjera, nëse një palë nuk mund të ofrojë prova përmes dokumentit të shkruar që i kërkohet, për shkak se i njëjti ka humbur apo është shkatërruar pa fajin e palës, apo nëse autoritetet kanë njoftuar se koha e detyrueshme për ruajtjen e dokumentit në fjalë veçse ka kaluar dhe ai dokument nuk ruhet më, pala nuk do të ketë nevojë të ofrojë “*provë*” se dokumenti është humbur apo është shkatërruar, përderisa mund të argumentojë “*mosekzistencën*” e dokumentin përkatës. Për më tepër, siç është paraqitur më sipër, Komisioni i Venecias ka trajtuar plot katër (4) herë ligjin përkatës të Bullgarisë që themeloi sistemin e konfiskimit administrativ-civil të pasurisë. Ndër çështjet procedurale të cilave Komisioni i Venecias u ka kushtuar më shumë vëmendje përgjatë këtyre opinionëve, ka qenë edhe çështja e barrës së provës, përfshirë në kontekst të standardit të të provuarit, pragut të të provuarit dhe lëvizjes së barrës së provës përgjatë procedurës. Për aq sa është relevante, Gjykata rikujton që (i) duke analizuar nenin 53 të ligjit bullgar në fjalë, Komisioni i Venecias ritheksoi rëndësinë e diskrecionit gjyqësor, duke vërejtur se dispozita në fjalë përcaktonte se nëse subjekti i hetimit dështon të provojë prejardhjen e ligjshme të pasurisë së tij/saj, atëherë gjykata duhet të nxjerrë urdher për konfiskim. Komisioni vërejtë se mund të ketë një varg arsyes se pse subjekti është në pamundësi të ofrojë provat dhe si rrjedhojë, gjykata duhet të ketë kompetencën e nevojshme që të refuzojë nxjerrjen e urdhrin për konfiskim nëse kjo është në interes të drejtësisë. Duke ju referuar vendimit të GJEDNJ-së në rastin *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Opinioni kishte theksuar që GJEDNJ-ja në këtë rast kishte theksuar kompetencën e një gjyqtari për të përdorur diskrecionin për të mos zbatuar prezumimet që konsideron se po që se u zbatuan, do të sillnin rrezik serioz për padrejtësi (shih, Opininionin për Bullgarinë CDL-AD(2010)010, paragrafi 76); (ii) Komisioni vlerësoi pozitivisht formulimin e ri të nenit 70

të këtij ligji, që saktësonte standardin e të provuarit për konfiskimin e pasurisë së fituar përmes aktivitetit kriminal ose shkeljeve administrative. Komisioni gjithashtu vërejti se “*periudha e ekzaminimit*” do të përcaktohej nga Komisioni për përcaktimin e pasurisë së fituar përmes aktivitetit kriminal ose shkeljeve administrative, duke shënuar se afati i parashkrimit ishte ndryshuar nga 20 në 15 vjet dhe duke theksuar që kjo vazhdon të mbetet periudhë e gjatë për ligj të kësaj natyre prapavepruese. Komisioni i Venecias theksoi se Komisioni përgjegjës do të mund të kushtëzohet të kufizojë ekzaminimin në periudha më të shkurta për shkak të efikasitetit dhe për arsye të proporcionalitetit (shih, Opinionin për Bullgarinë CDL-AD(2011)023, paragrafi 47); dhe (iii) pozitivisht u vlerësua nga Komisioni i Venecias edhe një dispozitë e re e ligjit përkatës që për dallim nga versionet paraprake, largonte kërkesën që të nxirreshin përfundime në rastin e subjektit të caktuar kur ai ose ajo nuk ka mundur të ofrojë një dokument të shkruar për shkak se ka skaduar afati për ruajtjen e atij dokumenti. Formulimi i ri i dispozitës në fjalë përcaktonte se në rrethanat kur si provë kërkohet një dokument i shkruar, nuk do të nxirren përfundime lidhur me fazën e provave në rast se dokumenti ka humbur ose është shkatërruar pa fajin e subjektit në fjalë. Autoritetet bullgare kishin sqaruar se kjo dispozitë do të zbatohet në rrethanat kur afati i detyrueshëm për ruajtjen e një dokumenti ka skaduar dhe dokumenti nuk është ruajtur. Komisioni Venecias vërejti se ky formulim, nuk përcaktonte obligimin që subjekti të dëshmojë humbjen ose shkatërrimin e dokumentit dhe se mjaftonte që subjekti të jepte argumente të arsyeshme se dokumenti nuk ekziston më. Rregullimin e këtillë ligjor Komisioni i Venecias e vlerësoi si shembull pozitiv në kontest të nevojës që gjykatave t’ju lejohet që lirshëm të vlerësojnë provat që u paraqesin palët.

264. Për më tepër, Gjykata rikujton që GJEDNJ ka trajtuar çështjen e barrës së provës në kontekst të një procedure civile, ndër tjerash, edhe në dy raste lidhur me procedurën e rivlerësimit kalimtar (vetingun) të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, përkatësisht në rastet [Xhoxhaj kundër Shqipërisë](#) [nr.15227/19, Aktgjykim i 31 majit 2021] dhe [Thanza kundër Shqipërisë](#) [nr. 41047/19, Aktgjykim i 4 korrikut 2023]. Për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, në rastin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GJEDNJ nuk gjeti shkelje të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës për sa i përket shkeljeve të pretenduara të parimit të sigurisë juridike, megjithatë GJEDNJ, shqyrtoi pretendimet e ngritura gjithashtu në dritën e nenit 32 të Ligjit nr. 84/2016 për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë (më tutje: Ligji për rivlerësimin kalimtar) që përcaktonte se: “(i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive; dhe (ii) “nëse subjekti i vlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme”. GJEDNJ kishte theksuar se kjo dispozitë e vendoste parashtruesen në pozitë të vështirë për të dëshmuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë për shkak të kalimit të kohës dhe potencialisht mungesës së dokumenteve mbështetëse. GJEDNJ, megjithatë, vërejti se neni 32 i Ligjit për rivlerësimin kalimtar ofronte garanci të mjaftueshme procedurale dhe se në rastin e kërkujes, ajo kishte dështuar të ofrojë dokumente mbështetëse për të dëshmuar pamundësinë objektive për të disponuar me dokumente që justifikonin prejardhjen e ligjshme të bashkëjetuesit të saj (shih, rastin e GJEDNJ-së *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafët 351 dhe 353). Në anën tjetër, në rastin *Thanza kundër Shqipërisë*, GJEDNJ-ja kishte gjetur shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës, ndër tjerash, ndërlidhur me atë se kërkuessit nuk i ishte dhënë mundësia e përshtatshme për të kundërshtuar gjetjet e institucioneve të

rivlerësimit dhe për të mbrojtur çështjen e tij në mënyrë efektive (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Thanza kundër Shqipërisë*, paragrafi 97). Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, GJEDNJ-ja vërejt se (i) afatet e parashkrimit mundësojnë siguri juridike; (ii) mbrojnë të pandehurit e mundshëm nga pretendimet e vjetra që vështirë mund të kundërshtohen; dhe (iii) parandalojnë çdo padrejtësi që mund të lind nëse gjykatave do t'u kërkohej të vendosnin lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën e largët në bazën e provave që mund të jenë bërë të pabesueshme dhe të paplota për shkak të kalimit të kohës (po aty, paragrafi 103). Në këtë kontekst, GJEDNJ sërish vuri theksin në nenin 32 të Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar, i cili përcaktonte rrethana lehtësuese në rast se subjekti i rivlerësimit ishte në pamundësi objektive për të ofruar dokumente mbështetëse (po aty, paragrafi 107).

265. Bazuar në sqarimet e lartcekura, dhe në vlerësimin e proporcionalitetit të aplikueshmërisë së retroaktive të Ligjit të kontestuar që nga 17 shkurti 2008, Gjykata duhet të merr parasysh ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, dhe të cilat mundësojnë justifikueshmërinë ose jo të pasurisë që i nënshtrohet verifikimit, propozimit për konfiskim dhe konfiskimit. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson që relevante, ndër tjerash, janë ligjet të cilat ndërlidhen me (i) tatimin në të ardhurat personale; (ii) sistemin pensional; (iii) detyrimin e qarkullimit të parasë përmes transaksioneve bankare; (iv) deklarimin e pasurisë; dhe (v) konfiskimin e pasurisë. Në vijim, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të shtjellojë ligjet e aplikueshme lidhur me secilën nga kategoritë e lartcekura, për të vlerësuar më tej nëse raporti në mes aplikimit retroaktiv të ligjit dhe barrës së të provuarit është proporcionale dhe balancon të drejtën dhe detyrimin e shtetit për luftuar korrupsionin, përfshirë përmes konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme dhe të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të verifikimit.

- *Tatimi në të Ardhurat Personale*

266. Gjykata vëren që detyrimi për t'ia nënshtrohet të ardhurat personale sistemit tatimor në Republikën e Kosovës ekziston që nga viti 2002. Në këtë vit, kishte hyrë në fuqi Rregullorja nr.2002/4 mbi të Ardhurat Personale në Kosovë, e cila kishte për qëllim caktimin e tatimit në të ardhurat personale në paga si një hap i parë drejt tatimit gjithëpërfshirës në të ardhura personale që mbulon të gjitha burimet e të ardhurave. Me anë të kësaj Rregullore, përmes nenit 2 (Të ardhurat e tatueshme) të saj, ishte përcaktuar se të ardhura të tatueshme janë të ardhurat e përgjithshme të tatimpaguesit gjatë periudhës tatimore të hequra nga zbritjet e lejueshme sipas kësaj Rregulloreje. Rregullorja e lartcekur ishte ndryshuar përmes Rregullores nr. 2003/3, ndërsa në vitin 2004, është shpallur Rregullorja nr.2004/52 mbi Tatimin në të Ardhurat Personale. Përmes nenit 3 (Objekt i tatimit) të kësaj të fundit, ishte përcaktuar se objekt për tatimpaguesin banor janë të ardhurat e tatueshme nga burimi i të ardhurave nga Kosova dhe burimi i të ardhurave nga jashtë, ndërsa për tatimpaguesin jo-banor janë të ardhurat e tatueshme nga të ardhurat që e kanë burimin në Kosovë.

267. Më tej, në vitin 2008, ishte miratuar Ligji Nr.03/L-115 për Tatimin në të Ardhurat Personale, ndërsa, i njëjti është shfuqizuar në vitin 2010, përmes miratimit të Ligjit Nr. 03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale. Për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, i njëjti në (i) nenin 4 (Objekti i tatimit) i tij, saktëson që objekti i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme nga burimi i të ardhurave nga Kosova dhe burimi i të ardhurave jashtë Kosovës, ndërsa për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme nga të ardhurat që e kanë burimin në Kosovë; (ii) nenin 5 (Të ardhurat e tatueshme) i tij, saktëson që të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme do të thotë ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës



tatimore dhe zbritjeve te lejueshme sipas këtij Ligji lidhur me të ardhurat e tilla bruto; ndërsa (iii) nenin 6 (Shkallët e tatimit) i tij, përcakton shkallët tatimore duke filluar nga 1 janari 2009. Më tej, ligji i lartcekur gjithashtu dhe ndër tjerash, saktëson (i) të ardhurat bruto në nenin 7 (Të ardhurat bruto); (ii) të ardhurat që përjashtohen në nenin 8 (Të ardhurat që përjashtohen); (iii) të ardhurat nga pagat në nenin 9 (Të ardhurat nga pagat); (iv) të ardhurat nga aktivitetet afariste në nenin 10 (Të ardhurat nga aktivitetet afariste); (v) të ardhurat nga qiratë në nenin 11 (Të ardhurat nga Qiratë); (vi) të ardhurat nga pasuria e paprekshme në nenin 12 (Të ardhurat nga pasuria e paprekshme); (vii) të ardhurat nga interesi në nenin 13 (Të ardhurat nga Interesi); (viii) të ardhurat nga dhuratat në nenin 14 (Të ardhurat tjera përfshirë dhuratat); (ix) të ardhurat nga fitimet kapitale në nenin 31 (Të ardhurat nga fitimet kapitale), sipas përcaktimeve të ligjit të lartcekur. Gjykata vëren që ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar përmes (i) Ligjit Nr. 04/L-104 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale; dhe (ii) Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale. Ky i fundit, (i) në nenin 6 (Shkallët e tatimit) të tij, përcakton shkallët përkatëse të tatimit; ndërsa (ii) në nenin 7 (Të ardhurat bruto) të tij, përcakton të gjitha kategoritë, përkatësisht burimet e ardhurave që i nënshtrohen tatimit, duke përfshirë por mos u kufizuar në paga, qira, përdorim të pasurisë së paprekshme; interesi, përveç interesit i cili është i lejuar sipas këtij ligji, të ardhurave zëvendësuese, fitimet kapitale që rezultojnë nga shitjet e pasurive kapitale, duke përfshirë pasurinë e tundshme, të patundshme dhe letrat me vlerë, pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës mbi Pensionet në Kosovë, veprimtaria afariste që është objekt i tatimit në të ardhura reale dhe çdo e ardhur tjetër e tatueshme që nuk është e përfshirë në këtë nen apo çdo e ardhur tjetër që do të përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri përkatës.

268. Për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i vitit 2010, më saktësisht, nënparagrafi 2.1 i paragrafit 2 të nenit 13 (Krijimi dhe mbajtja e regjistrave) të tij, ndër tjerash, përcakton që tatimpaguesit janë të detyruar të mbajnë librat dhe regjistrat në pajtim me legjislacionin tatimor për një periudhë prej së paku 6 (gjashtë) vjet pas përfundimit të periudhës tatimore kur ka lindur një detyrim i tillë tatimor përkatës. Ndërsa, Ligji Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, në nenin 6 (Krijimi dhe mbajtja e regjistrave) të tij, përcakton afate të ndryshme për ruajtjen e të dhënave, si për autoritetet, ashtu edhe për individët të cilat përfshijnë periudhën kohore prej 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) vite.

- *Sistemi Pensional*

269. Gjykata vëren që më 22 dhjetor 2001 është miratuar Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë. Bazuar në të njëjtën dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, sipas nenit 7 (Arkëtimi i kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale) të saj, çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në fondin e kursimet pensionale dhe obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit te punëdhënësi për punonjësit që kanë arritur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeçare. Për më tepër, për financimin e kursimeve pensionale (a) çdo punëdhënës paguan një shumë që është baras me 5% (pesë për qind) të rrogave të përgjithshme të të gjithë punonjësve; dhe (b) çdo punonjës paguan një shumë që është baras me 5% (pesë për qind) të rrogës së tërësishme të tij ose të saj. Gjykata vëren që Rregullorja e lartcekur është ndryshuar dhe shfuqizuar më tej, përmes (i) Ligjit Nr. 03/L-084 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës; (ii) Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës; (iii) Ligjit Nr.04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që

kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës; (iv) Ligjit Nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës; dhe (v) Ligjit Nr. 05/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës. Gjykata, për aq sa është relevante, vëren që bazuar në nenin 6 (Mbledhja e kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale) të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet: Nr.04/L-115, Nr. 04/L-168 dhe Nr. 05/L-116, çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale, ndërsa punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale dhe obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të punëdhënësit për punonjësit që kanë krijuar marrëdhënie pune dhe përfundojnë kur punonjësi arrin moshën e pensionit. Për më tepër që, për financimin e kursimeve pensionale (a) çdo punëdhënës paguan një shumë që është baras me 5% (pesë përqind) të rrogave të përgjithshme të të gjithë punonjësve; dhe (b) çdo punonjës paguan një shumë që është baras me 5% (pesë përqind) të rrogës së tërësishme të tij.

- *Qarkullimi i parasë përmes transaksioneve bankare*

270. Gjykata thekson që në bazë të Rregullores së UNMIKU-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale të datës 4 shkurt 2004, e cili ka hyrë në fuqi, parimisht më 1 mars 2004, në përjashtim të disa dispozitave që kanë hyrë në fuqi më 1 korrik 2004, janë vendosur, ndër tjerash, parimet që ndërlidhen (i) me detyrimet e individëve dhe institucioneve financiare lidhur me transaksionet bankare që tejkalojnë shumën të caktuar; dhe (ii) detyrimin e autoriteteve për të ruajtur të dhënat përkatëse për periudha të caktuara kohore. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, përderisa individët jodetyrimisht kanë qenë të detyruar që të kryejnë të gjitha transaksionet përmes bankave dhe/ose institucioneve financiare, (i) për çdo transaksion me vlerë mbi 10,000 (dhjetë mijë) euro, banka përkatëse ka qenë e detyruar që të mbajë të dhënat e nevojshme për personin përkatës; ndërsa (ii) çdo transaksion që ndërlidhet me pasuri të paluajtshme dhe që ka tejkaluar vlerën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro, i është nënshtruar detyrimit që të kryhet përmes bankës. Në anën tjetër, bazuar në rregulloren e lartcekur, bankat dhe/ose institucione financiare, i janë nënshtruar detyrimit që t'i ruajnë të dhënat përkatëse për një periudhë së paku pesë (5) vjeçare.
271. Në anën tjetër, Gjykata gjithashtu rikujton që Ligji Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financim të Terrorizmit, ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2010. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, bazuar në nenin 16 të ligjit të lartcekur, subjektet raportuese, ndër tjerash, kanë përfshirë (i) bankat; (ii) institucionet financiare; (iii) agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme; (iv) personat fizikë dhe ligjorë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej 10.000 (dhjetëmijë) euro ose më shumë; (v) avokatët dhe noterët (kontabilistët) kur përgatiten për, kryejnë ose përfshihen në transaksione për klientët e tyre, sipas përcaktimeve të ligjit, përshirë në ndërlidhje me blerjen dhe shitjen e pasurive të patundshme; dhe (vi) kontabilistët e certifikuar, auditorët e licencuar dhe këshilltarët tatimor, sipas përcaktimeve të ligjit. Gjykata gjithashtu thekson që sipas nenit 29 (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës - Detyrimi për të deklaruar) të ligjit të lartcekur, ndër tjerash, përcaktohet detyrimi që (i) secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) euro apo më shumë, duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës; dhe (ii) secili person i cili nga Kosova dërgon në një vend jashtë Kosovës ose i cili i pranon në Kosovë

nga një vend tjetër jashtë Kosovës, përmes postës apo kuririt komercial, mjete monetare në një vlerë e cila tejkalon shumë prej 10.000 (dhjetëmijë) euro apo më shumë duhet të deklarohet me shkrim shumë e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës. Në anën tjetër, Gjykata gjithashtu vëren që bazuar në neni 40 (Dispozitat kalimtare nga EULEX-i tek Kosova), të gjitha të dhënat e mbledhura nga Qendra Informative Financiare, sipas Rregullores së UNMIK- ut 2004/02, do të barten te NJIF-K-ja.

272. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vëren se Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizimit, i 15 qershorit 2016, aktualisht në fuqi, gjithashtu përcakton obligim që transaksionet në lartësi të caktuara të hollash, të kryhen si transaksione bankare. Më saktësisht, bazuar në (i) paragrafin 1 të nenit 32 (Detyrimet shtesë të transaksioneve për pasuritë e paluajtshme) të këtij ligji, *“Kur bartja e të drejtave mbi pronën e paluajtshme përfshin një transaksion ose transaksione në një vlerë monetare dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj, secili transaksion duhet të bëhet me anë të urdhërpagesës bankare ose transferit bankar.”*; ndërsa, bazuar (ii) në paragrafin 2 të nenit 20 (Mbajtja e shënimeve) të këtij ligji, *“Në rastin e transfereve elektronike, bankat dhe institucionet financiare që kryejnë aktivitete të tilla mbajnë një regjistër të të gjitha informatave përkatëse për sa i përket pagesit dhe që shoqërojnë një transfer, të gjitha informatat e marra për pagesin dhe të gjitha informatat që shoqërojnë një transfer kur ato veprojnë respektivisht si dërgues, ndërmjetës ose institucion përfitues për një periudhë prej pesë (5) vitesh nga data e ekzekutimit të transaksionit.”*
273. Është relevante gjithashtu të rikujtohet që procesi i fiskalizimit, ka filluar përmes Ligjit Nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i miratuar në vitin 2007 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë. Ky ligj në nenin 15 (pa titull) të tij, përcaktonte detyrimin për çdo person që i nënshtrohej çdo lloji tatimi, që të dorëzojë në ATK ose tek agjenti i saj një deklaratë tatimore, e cila përfshin: (i) numrin identifikues të tatimpaguesit, (ii) llogaritjen e detyrimit tatimor, dhe (iii) të gjitha informatat tjera sipas legjislacionit të zbatueshëm ose udhëzimeve administrative të lëshuara në përputhje me legjislacionin e tillë. Për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, pranimi i deklaratave tatimore nga bankat, sipas nenit 25 (pa titull) të po këtij ligji, ishte i kushtëzuar nga marrëveshja e ATK-së me Bankën dhe bankat tjera të licencuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave (tani BQK), e cila duhej të aprovohej nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave.
274. Ndërsa, ky ligj në vitin 2008 u ndryshua dhe plotësua nga Ligji Nr. 03/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me ç’rast, ndër të tjera, në nenin 7 (Numri Fiskal dhe pajisja me Certifikatë Fiskale) që ndryshonte paragrafin 1 të ligjit bazik, ishte përcaktuar se: *“ATK mund të lëshojë numër fiskal për çdo person që i nënshtrohen çfarëdo lloj tatimi të administruar në Republikën e Kosovës”*. Tutje, neni 9 (pa titull) i po këtij ligji, shtoi paragrafët në vijim të nenit 12 i ligjit bazik: *“12.4. Çdo tatimpagues pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrave të parapara me ligj, kërkohet të bëjë dhe mbajë regjistrimin e mallrave në stogë në fund të vitit kalendarik. Regjistrimet e parapara sipas këtij paragrafi duhet të jenë të gatshme më apo para 10 janarit të vitit vijues. [...] 12.7. Çdo transaksion mbi pesëqind (500) euro, i bërë në mes të personave të tatueshëm, pas 1 janarit të vitit 2009, pagesa kërkohet që të bëhet përmes llogarisë bankare.”*

275. Megjithatë, në vitin 2010, ligji i lartcekur u shfuqizua me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i vitit 2010 dhe, bazuar në nenin 11 (Numri Fiskal dhe pajisja me Certifikatë Fiskale) të tij, ishte përcaktuar ngjashëm, ndër tjerash, që çdo person i cili i nënshtrohet ndonjë lloj tatimi të administruar nga ATK do të regjistrohet në ATK dhe do të merrte një numër fiskal para se të angazhohet në ndonjë veprimtari ekonomike. Më tej, dhe bazuar në nenin 13 (Krijimi dhe mbajtja e regjistrave) të tij, ndër tjerash, përcaktohej që: (i) tatimpaguesit janë të detyruar të mbajnë librat dhe regjistrat në pajtim me legjislacionin tatimor; dhe (ii) çdo transaksion mbi 500 (pesëqind) euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, pas 1 janarit të vitit 2009 kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare.

276. Në anën tjetër, Ligji aktual në fuqi, përkatësisht, Ligji Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore i 12 janarit 2024, në nenin 4 (Numri Fiskal dhe pajisja me Certifikatë Fiskale) të tij, përcakton që çdo person i cili i nënshtrohet ndonjë lloj tatimi të administruar nga ATK, regjistrohet në ATK dhe pajiset me një numër fiskal para se të angazhohet në ndonjë veprimtari ekonomike. Për më tepër dhe sipas përcaktimeve të nenit 6 (Krijimi dhe mbajtja e regjistrave) të tij, ndër tjerash, saktësohet që (i) tatimpaguesi duhet të mbajë librat dhe regjistrat në pajtim me legjislacionin tatimor në fuqi; (ii) regjistrat që lidhen me shërbimet elektronike duhet të mbahen për një periudhë prej së paku 10 (dhjetë) vite pas përfundimit të periudhës tatimore kur janë ofruar shërbimet elektronike; (iii) çdo transaksion mbi 300 (treqind) euro i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare dhe/ose formave tjera të pagesës në mënyrë elektronike; dhe (iv) çdo transaksion mbi vlerën e përcaktuar me vendim nga Ministri, i bërë në mes të personit që zhvillon aktivitet ekonomik dhe personit fizik jo afarist, kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare dhe/ose formave tjera të pagesës në mënyrë elektronike.

- *Deklarimi i Pasurisë*

277. Gjykata vëren se më 12 maj 2005 përmes Rregullores Nr. 2005/26 ishte shpallur Ligji kundër Korrupsionit Nr. 2004/34, përmes të cilit ishte themeluar Agjencia kundër Korrupsionit. Kjo rregullore, për aq sa është relevante, (i) në nenin 2 të tij, përkufizonte personat zyrtarë që i nënshtrohen përcaktimeve të saj; (ii) në Kreun 4 përcaktonte ndalimin e pranimit të dhuratave mbi vlerën e përcaktuar me ligj dhe detyrimin e deklaramit të tyre në një katalog të veçantë; dhe (iii) në nenin 37 përcaktonte kompetencën e Agjencionit për mbikëqyrjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë. Në vitin 2010, u miratua Ligji Nr. 03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, (i) në nenin 3 (Përkufizimet) të tij, i njëjti përcakton listën e zyrtarëve publikë, përfshirë anëtarët e familjes, që i nënshtrohen detyrimit të deklaramit të pasurisë; (ii) në nenin 5 (Llojet e deklaramit të pasurisë) të tij, përcakton llojet e deklaramit, përfshirë, atë të rregullt vjetor, me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik, sipas kërkesës së Agjencisë dhe pas largimit nga funksioni; (iii) në nenin 10 (Pranimi i dhuratave) dhe 11 (Regjistrimi i dhuratave) të tij, saktëson deklaramin dhe regjistrimin e dhuratave; ndërsa (iv) në nenin 13 (Autoriteti Kompetent) të tij, përcakton afatin 10 (dhjetë) vjeçar, për arkivimin e informacioneve dhe deklaramive të paraqitura në Agjenci, nga paraqitja e tyre dhe nga përfundimi i punës në shërbimin publik. Në anën tjetër, Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë i vitit 2011, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, dhe përtej ndryshimeve që ndërliiden me zgjerimin e listës së zyrtarëve publikë që detyrohen të deklarojnë pasurinë, në nenin 14 (Autoriteti Kompetent) të tij, saktëson që

Agjencia i arkivon të dhënat e zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë në periudhën prej 10 (dhjetë) vitesh nga koha e mbarimit apo shkarkimit nga funksioni dhe që pas kalimit të këtij afati, Agjencia i shkatërron këto të dhëna.

278. Në fund, Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të vitit 2022, ndër tjerash, (i) në nenet 3 (Përkufizimet), 4 (Zyrtarët e lartë) dhe 5 (Zyrtarët publik) të tij, përcakton listën e zyrtarëve dhe anëtarëve përkatës të familjes që i nënshtrohen detyrimit të deklarimit të pasurisë; (ii) në nenin 7 (Rastet kur bëhet deklarimi i pasurisë) të tij, përcakton kategoritë e deklarimeve; (iii) në nenin 25 (Regjistrimi i dhuratave) të tij, mënyrën e regjistrimit të dhuratave sipas përcaktimeve të ligjit; ndërsa (iv) në nenin 11 (Deklarimi elektronik) të tij, përcakton deklarimin elektronik të pasurisë. Është me rëndësi të theksohet që, për dallim prej ligjeve paraprake, ligji i lartcekur, në (i) në nenin 12 (Publikimi i deklarimit të pasurisë të subjekteve deklaruese) të tij, saktëson që të dhënat e subjekteve deklaruese që janë të publikuara në platformën *online* do të mbeten të publikuara edhe për 3 (tre) vite pas përfundimit të obligimit ligjor për deklarim dhe më pas duhet të largohen nga platforma *online*; (ii) në nenin 25 (Regjistrimi i dhuratave), që institucionet e kanë detyrim ligjor t'i mbajnë regjistrat e dhuratave për 10 (dhjetë) vite; ndërsa (iii) në nenin 15 (Regjistri i Deklarimeve) të tij, që arkivimi i të dhënave të subjekteve deklaruese bëhet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për arkivat.

- *Konfiskimi i Pasurisë së përfitur me vepër penale*

279. Gjykata vëren që Ligji Nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale i vitit 2013, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, në nenin 1 (Qëllimi) dhe 2 (Fushëveprimi) të tij, saktëson që ky ligj përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale, kur procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale nuk janë të mjaftueshme dhe që dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasurinë e fituar nga personat të cilët kanë kryer vepër penale të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Në anën tjetër, në nenin 3 (Përkufizimet) të tij, ndër tjerash, saktëson që pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit është pasuria që është në pronësi të të pandehurit ose që mbahet në emër të të pandehurit, e cila i nënshtrohet urdhrit ndalues nga neni 265 (Urdhri ndalues) i Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kosovës ose e cila i nënshtrohet konfiskimit të përkohshëm nga neni 267 (Konfiskimi i përkohshëm) i po këtij kodi, të ndryshuar. Në anën tjetër, Ligji Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë i vitit 2018, në (i) nenin 1 (Qëllimi) të tij, saktëson që ky ligj përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë atëherë kur procedurat e detajuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës nuk janë të mjaftueshme; ndërsa (ii) në nenin 3 (Përkufizimet) të tij, ndër tjerash, saktëson që pasuria që mund t' i nënshtrohet konfiskimit, është pasuria e të pandehurit, përkatësisht çdo lloj prone, substanciale ose jo-substanciale, e luajtshme ose e paluajtshme, e preکشme ose e paprekshme, si dhe dokumente apo instrumente ligjore, sipas përcaktimeve të ligjit të lartcekur, por të cilat “*i pandehuri i ka fituar brenda dhjetë (10) viteve para ditës kur është iniciuar faza hetimore*” për veprën përkatëse penale.

280. Bazuar në sqarimet e lartcekura, e që ndër lidhen me ligjet aplikueshme relevante për justifikimin e pasurisë, përkatësisht raportit në mes të hyrave të ligjshme dhe vlerës së pasurisë, Gjykata fillimisht vëren që rregullimi i sistemit pensional dhe tatimit në të ardhurat personale, përkundër ndryshimeve ndër vite, daton që nga 2001 dhe 2002, respektivisht, fillimisht përmes rregulloreve të UNMIK-ut dhe më pas, përmes ligjeve të miratuara në Kuvendi i Kosovës. Bazuar në rregullativat/ligjet e aplikueshme si më sipër, të

ardhurat personale, mund të dokumentohen përmes kontributit pensional dhe tatimit në të ardhurat personale ndër vite. Për më tepër, duke filluar nga viti 2005, dhe përkundër ndryshimeve ndër vite, me theks në kategoritë të cilat detyrohen që të deklarojnë pasurinë, kategori të caktuara të zyrtarëve publik, janë detyruar që të deklarojnë pasurinë të paktën në baza vjetore sipas përcaktimeve të Agjencisë kundër/për parandalimin e Korrupsionit. Në anën tjetër, detyrimi për transaksione bankare që tejkalojnë shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) euro dhe/ose për deklarimin e çdo qarkullimi të mjeteve monetare në këtë shumë, ka ekzistuar që nga viti 2004, kur ishte miratuar Rregullorja e UNMIK-ut për Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale, dhe e cila më pas ishte zëvendësuar me ligjet e Republikës së Kosovës. Vlen të theksohet që duke filluar nga viti 2009, bazuar në Ligjin e aplikueshëm për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo transaksion mbi 500 (pesëqind) euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, është kërkuar që të bëhet përmes llogarisë bankare. Në fund, dhe me rëndësi, që nga viti 2013, me miratimin e Ligjit Nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfiturar me Vepër Penale, është mundësuar konfiskimi i zgjeruar i pasurisë, përtëj dispozitave të Kodit të Procedurës Penale atëherë kur të njëjtat nuk kanë qenë të mjaftueshme.

281. Thënë këtë, në kontekst të barrës së provës së individit për të dëshmuar justifikueshmërinë e pasurisë, konfiskimi i të cilës propozohet nga Byroja, përkatësisht detyrimin për të dëshmuar ligjshmërinë e kësaj pasurie në mënyrë retroaktive që nga 17 shkurti 2008, Gjykata vlerëson që është gjithashtu relevante të analizohen dispozitat përkatëse ligjore që mundësojnë sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për individin në mënyrë që i njëjti të ketë *“mundësi të arsyeshme/objektive”* për të justifikuar pasurinë përkatëse. Në këtë kontekst dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata së pari vëren që në kontekst të tatimit në të ardhurat personale, (i) ligji përkatës i vitit 2010, përcaktonte detyrimin e ruajtjes së këtyre të dhënave për një periudhë prej së paku 6 (gjashtë) vjet pas përfundimit të periudhës tatimore; ndërsa (ii) ligji përkatës i vitit 2024, saktëson detyrimin e ruajtjes së të dhënave për periudha kohore prej 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) vite, varësisht prej përcaktimeve të ligjit. Së dyti, në kontekst të transaksioneve bankare, sipas sqarimeve të lartcekura, afati ligjor bazuar në të cilin autoritetet përkatëse detyrohen të ruajnë të dhënat është 5 (pesë) vite. Së treti, Gjykata vëren që të dhënat që ndërlidhen me deklarimin e pasurisë, bazuar (i) në ligjin përkatës të vitit 2010, ruhen në afatin 10 (dhjetë) vjeçar nga paraqitja e tyre dhe nga përfundimi i punës në shërbimin publik; (ii) në ligjin përkatës të vitit 2011, ruhen në periudhën prej 10 (dhjetë) vitesh nga koha e mbarimit apo shkarkimit nga funksioni dhe, ligji i lartcekur specifikisht përcakton që pas kalimit të këtij afati, Agjencia i shkatërron këto të dhëna; ndërsa (iii) vetëm me miratimin e ligjit përkatës të vitit 2022, përcaktohet që ruajtja e këtyre të dhënave i nënshtrohet legjislacionin përkatës në fuqi për arkivat. Së katërti dhe fund, Gjykata vëren që në kontekst të konfiskimit të pasurisë së përfiturar nga vepra penale, Ligji nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, kufizon mundësinë e konfiskimit të së njëjtës në një periudhë retroaktive 10 (dhjetë) vjeçare, përkatësisht, 10 (dhjetë) vite para ditës kur është iniciuar faza hetimore për veprën përkatëse penale.
282. Në kontekst të ndërlidhjes të aplikueshmërisë retroaktive të ligjit që nga 17 shkurti 2008 dhe barrës së provës dhe e cila bazohet në vlerësimin e gjasave, përkatësisht sipas definicionit të ligjit, në besimin që *“një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur se sa jo”*, Gjykata rikujton që inicimi i procedurës, bëhet nga Byroja, nëse zyrtari përkatës i të njëjtës beson që ka shpërputhje në mes të hyrave dhe pasurisë që tejkalon vlerën prej 25,000 (njëzet e pesë) mijë euro. Informatat me qëllim të këtij verifikimi sipas nenit 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) të Ligjit të kontestuar, përfshijnë por nuk

kufizohen në (i) pasurinë, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerën; (ii) vlerën e pasurisë në kohën e përfitimit; (iii) vlerën e përfituar nga pasuria me rastin e transaksionit; (iv) transformimin e pasurisë; (v) të ardhurat e rregullta dhe jo të rregullta të palës në procedurë; (vi) shpenzimet për mbajtjen e personit fizik dhe të anëtarëve të familjes të palës në procedurë; (vii) shpenzime të tjera; (viii) detyrimet monetare; (ix) transaksionet me pasurinë të personat fizikë apo juridikë; (x) transaksionet në pasurinë e palës në procedurë; (xi) shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit nga pasuria e palës në procedurë; dhe (xii) masat e përkohshme dhe ngarkesat e vendosura ndaj pasurisë si dhe detyrimet e marra përsipër të natyrës civilo-juridike nga pala në procedurë.

283. Gjykata më tej thekson që në sigurimin e informatave të lartcekura, Byroja mbështetet nga tërë administrata shtetërore bazuar në nenin 20 (Detyrimi për bashkëpunim) të Ligjit të kontestuar. Thënë këtë, në momentin kur barra bie mbi individin, përkatësisht subjektin e verifikimit, për të vërtetuar justifikueshmërinë e pasurisë përkatëse, ky nuk është rasti, dhe bazuar në paragrafin 2 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar, është individ i ai që duhet të kundër-argumentojë bazuar në dokumente dhe prova kategoritë e të dhënave sipas nenit 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) të Ligjit të kontestuar, duke përfshirë por mos u kufizuar në (i) shpenzimet për mbajtjen e personit fizik dhe të anëtarëve të familjes së palës në procedurë; (ii) shpenzime të tjera; dhe (iii) shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit nga pasuria e palës në procedurë, të dhëna këto, të cilat, mund, në mënyrë të arsyeshme, të mos jenë lehtësisht të mundura për t'u siguruar/argumentuar në formë të provës dhe/ose dokumentacionit. Ndërsa, për qëllime të barrës së provës së individit për të justifikuar pasurinë përkatëse në mënyrë retroaktive, sigurimi i të dhënave/provave dhe/ose dokumentacionit që ndërlidhet me kategoritë tjera të të dhënave të saktësuara në nenin 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) të Ligjit të kontestuar, përfshirë (i) pasurinë, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerën; (ii) vlerën e pasurisë në kohën e përfitimit; (iii) vlerën e përfituar nga pasuria me rastin e transaksionit; (iv) transformimin e pasurisë; (v) të ardhurat e rregullta dhe jo të rregullta të palës në procedurë; (vi) detyrimet monetare; (vii) transaksionet me pasurinë të personat fizikë apo juridikë; (viii) transaksionet në pasurinë e palës në procedurë; dhe (ix) masat e përkohshme dhe ngarkesat e vendosura ndaj pasurisë si dhe detyrimet e marra përsipër të natyrës civilo-juridike nga pala në procedurë, mund të jetë i kushtëzuar nga afatet ligjore në ligjet e aplikueshme të sqaruara si më sipër që ndërlidhen me detyrimet për mbajtjen e regjistrave dhe/ose të dhënave përkatëse.
284. Bazuar në sqarimet e lartcekura, në parim, ligjet e aplikueshme, nuk përcaktojnë detyrime për ruajtjen e të dhënave për një periudhë kohore me të gjatë se dhjetë (10) vjeçare. Në anën tjetër, Ligji i kontestuar, në kontekst të barrës së të provuarit, nuk ngërthen asnjë garanci procedurale, bazuar në të cilën "*pamundësia objektive*" për të paraqitur dokumente dhe/ose prova, do të mund të shërbejë si arsye për justifikimin e pasurisë që është objekt verifikimi. Siç është sqaruar më lart, bazuar në Opinionet e Komisionit të Venecias por edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, barra e të provuarit do të ishte e arsyeshme, nëse subjekti i verifikimit do të kishte mundësinë që të argumentonte para gjykatës përkatëse për pamundësinë objektive për të prezentuar një dokument para gjykatës në mbështetje të justifikueshmërisë së pasurisë përkatëse, përfshirë në rrethana kur afatet ligjore për ruajtjen e të njëjtave kanë skaduar.
285. Marrë parasysh (i) që Ligji i kontestuar nuk ngërthen një garanci të tillë procedurale në kontekst të barrës së të provuarit; dhe (ii) aplikimin retroaktiv të Ligjit të kontestuar që nga 17 shkurti 2008, përkatësisht përgjatë një periudhë kohore që tejkalon, në parim, afatet ligjore ndërlidhur me detyrimet e autoriteteve, përfshirë individëve, për të ruajtur të dhënat

që janë relevante për të provuarit e justifikueshmërisë ose pa justifikueshmërisë së pasurisë, përkundër faktit që aplikimi retroaktiv i ligjit ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht atë të interesit publik, Gjykata vlerëson që Ligji i kontestuar nuk arrin këtë qëllim përmes mekanizmave proporcional me të drejtat dhe liritë themelore.

286. Më saktësisht, në rrethana të tilla, nuk ka një barspeshë të arsyeshme në mes shtetit dhe individit, sepse (i) periudha e aplikueshmërisë retroaktive të ligjit, në parim, tejkalon afatet ligjore në ligjet relevante të aplikueshme në kontekst të mbajtjes/ruajtjes së regjistrave dhe/ose të dhënave, (ii) në rrethana në të cilat, e tërë administrata shtetërore është e detyruar të bashkëpunojë me Byronë, ndërsa barra e provës rreth justifikueshmërisë së pasurisë kontestuese bie mbi individin, dhe (iii) i cili, nuk përfiton nga një garanci e arsyeshme procedurale, bazuar në të cilën, do të mund të argumentonte para gjykatës përkatës pamundësinë objektive për të siguruar dhe/ose paraqitur një provë që shkon në favor të justifikueshmërisë së pasurisë që është objekt verifikimi.
287. Për pasojë dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, përderisa Gjykata thekson që aplikimi retroaktiv i ligjit në kontekst të Ligjit të kontestuar, ndjek “*qëllimin legjitim*” të interesit publik, (i) përcaktimi i periudhës kohore në kontekst të aplikimit retroaktiv të Ligjit që nga 17 shkurti 2008, përkatësisht për një periudhë mbi pesëmbëdhjetë (15) vite e që, në parim, tejkalon detyrimet e përcaktuara me ligjet e aplikueshme për ruajtjen/qasjen në të dhëna përmes të cilave do të mund të dëshmohej retroaktivisht prejardhja e justifikueshme e pasurisë; dhe (ii) përfshirë në mungesë të garancisë procedurale në kontekst të barrës së provës që do t’i mundësonte subjekteve të verifikimit të argumentojnë para gjykatave përkatëse lidhur me “*pamundësinë objektive*” për të siguruar të të dhëna të tilla, në vlerësimin e Gjykatës, nuk balancon në mënyrën e duhur (i) qëllimin legjitim të interesit publik; dhe (ii) të drejtat dhe liritë themelore të individëve të afektuar.

#### *Konkluzion*

288. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që pika 2.1. e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me nenin 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar cenon parimin e sigurisë juridike të garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe të drejtën e pronës të garantuar përmes paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
289. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, në adresimin e shkeljes së kontestuar si më lart përmes ndryshimeve dhe/ose plotësimit të dispozitës së lartcekur, Kuvendi duhet të sigurohet që aplikimi retroaktiv i ligjit të jetë i balancuar dhe/ose proporcional me barrën e të provuarit, ose (i) duke përcaktuar periudha të arsyeshme retroaktive bazuar në analizën dhe vlerësimin e ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, përfshirë në kontekst të qasjes në të dhëna që janë relevante për vërtetimin e pa/justifikueshmërisë së pasurisë; dhe/ose (ii) përmes saktësimin të garancive procedurale në kontekst të barrës së të provuarit të individit, që do të i mundësonte këtij të fundit, që të argumentoj para gjykatave përkatëse ndërlidhur me pamundësinë objektive për të siguruar provat përkatëse.

#### ***(iii) cenimi i parimit të sigurisë juridike si rezultat i kolizionit të dispozitave ligjore në kontekst të kohëzgjatjes së zbatimit të ligjit pas përfundimit të funksionit të personit zyrtar***

290. Gjykata fillimisht i referohet fushëveprimin kohor të Ligjit të kontestuar, përkatësisht paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit të kontestuar, që përcakton se i njëjti zbatohet



ndaj pasurisë së pajustificueshme të fituar nga personat zyrtarë dhe palët e treta (i) përgjatë ushtrimit të funksionit të tij/saj, por jo për pasurinë e fituar më herët se 17 shkurti 2008; dhe (ii) brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur të njëjtit pushojnë së ushtruari funksionet e tyre. Në anën tjetër, neni 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) i Ligjit të kontestuar, përcakton periudhën e verifikimit të pasurisë, duke saktësuar se verifikimi bëhet ndaj pasurisë së fituar gjatë (i) periudhës së ushtrimit të funksionit publik, ndërsa mund të zgjerohet edhe për (ii) periudhën pasi zyrtari publik nuk ushtron më funksion publik, me kushtin që periudha kohore e verifikimit nuk mund të jetë më e gjatë se pesë (5) vite pasi zyrtari publik ka përfunduar së ushtruari funksionin e tij publik.

291. Më saktësisht, Gjykata, vëren se bazuar në nenin 2 (Fushëveprimi) të Ligjit të kontestuar, ky ligj zbatohet ndaj pasurisë së pajustificueshme, të fituar përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të personave zyrtarë, nga data 17 shkurt 2008 dhe brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur subjektet përkatëse pushojnë së ushtruari funksionin e tyre. Ndërsa, bazuar në nenin 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar, përkundër faktit që verifikimi i pasurisë bëhet për pasurinë e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar, përjashtimisht, kur Byroja vlerëson apo konstaton se pasuria e personit zyrtar, e fituar pas periudhës së ushtrimit të funksionit publik, është në masë të madhe më e lartë se të hyrat e ligjshme apo pasuria e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar, Byroja mund të zgjerojë verifikimin edhe për periudhën pasi zyrtari publik nuk ushtron më funksionin publik, periudhë kjo që nuk mund të jetë më e gjatë se pesë (5) vite pas përfundimit të funksionit publik të personit zyrtar.
292. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës përkitazi me kolizionin ligjor në mes të dy neneve të lartcekura, Gjykata fillimisht rikujton se konfiskimi i pasurisë përbën “*ndërhyrje*” në të drejtën për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Normat juridike të cilat kanë për pasojë “*ndërhyrje*” në të drejtën e pronës, si e drejtë kushtetuese, sipas parimeve të lartcekura, duhet të jenë të “*qarta*” dhe “*të parashikueshme*”. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, praktika e saj gjyqësore dhe Lista Kontrolluese e Sundimit të Ligjit e Komisionit të Venecias, sipas së cilave, parimi i sigurisë juridike, i cili është i mishëruar në konceptin e sundimit të ligjit, i garantuar me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, dhe në të gjitha nenet e KEDNJ-së, kërkon që të drejtat dhe detyrimet të jenë të “*përcaktuara me ligj*” dhe gjithashtu që dispozitat relevante të ligjit të jenë “*të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme*” (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, [Beyeler kundër Italisë](#), nr. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 109; [Hentrich kundër Francës](#), nr. 1361/88, Aktgjykim i 22 shtatorit 1994, paragrafi 42; dhe [Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; [9405/81](#), Aktgjykim i 8 korrikut 1986, paragrafi 110; dhe, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO100/22 dhe KO101/22](#), parashtruesit: *Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë, si dhe Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovë, Aktgjykim i 24 marsit 2023, paragrafi 347; dhe KO216/22 dhe KO220/22, parashtrues të kërkesës: *KO216/22, Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*; *KO220/22, Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 9, 12 46 dhe 99 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Aktgjykim i 2 gushtit 2023, paragrafi 227).

293. Bazuar në dy dispozitat e kontestuara dhe në ndërlidhje me të cilat pretendohet kolizioni, Gjykata vëren se (i) Ligji i kontestuar zbatohet ndaj pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme, qoftë drejtpërdrejtë ose tërthorazi, nga personat zyrtarë dhe palët e treta; ndërsa (ii) verifikimi i pasurisë bëhet për pasurinë e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar dhe përjashtimisht, edhe për periudhën pasi zyrtari publik nuk ushtron më funksionin publik. Përderisa, neni 2 i Ligjit të kontestuar, përcakton periudhën kohore brenda të cilës Byroja mund të verifikojë pasurinë e fituar gjatë ushtrimit të funksionit, përkatësisht brenda dhjetë (10) viteve pas përfundimit të tij, neni 22 i Ligjit të kontestuar, përcakton përjashtimin nga ky parim, duke mundësuar që përjashtimisht, verifikimit t'i nënshtrohet edhe pasuria e fituar pas përfundimit të funksionit të zyrtarit përkatës. Përjashtimi i nënshtrohet kushtit që pasuria e personit zyrtar, e fituar pas periudhës së ushtrimit të funksionit publik, të jetë në masë të madhe më e lartë se të hyrat e ligjshme apo pasuria e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar. Gjykata vëren, që ky përjashtim, përkatësisht “*ndërhyrje*” në të drejtat pronësore të subjektit përkatës, është “*i përcaktuar me ligj*” dhe ndjek një “*qëllim legjitim*” të interesit publik. Qëllimi i luftimit të korrupsionit në sektorin publik, justifikon të nënshtrohet ndaj kontrollit të Byrosë Shtetërore edhe të zyrtarëve publik pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, nën kriteret e përcaktuara në ligj. Thënë këtë, në balancimin në mes qëllimit legjitim dhe proporcionalitetit të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, Gjykata vë theks në parimet që ndërlidhen me sigurinë juridike, përfshirë në kontekst të “*qartësisë dhe parashikueshmërisë*” së nevojshme të ligjit të aplikueshëm.
294. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata vëren që paragrafi 2 i nenit 2 të Ligjit të kontestuar, saktëson që verifikimit i nënshtrohet pasuria e fituar përgjatë ushtrimit të mandatit dhe brenda 10 (dhjetë) viteve nga momenti kur zyrtarët përkatës pushojnë së ushtruar funksionin. Në anën tjetër, paragrafi 3 i nenit 22 të Ligjit të kontestuar, përcakton që periudha e cekur në paragrafin 2 të tij, përkatësisht periudha në kuadër të së cilës mund të zgjerohet verifikimi i pasurisë edhe për periudhën pasi që zyrtari publik nuk ushtron më funksionin publik, “*nuk mund të jetë më gjatë se pesë (5) vite pas përfundimit të funksionit publik të personit zyrtar*”. Thënë këtë, dispozitat e lartcekura, nuk saktësojnë me “*qartësi*”, e as me “*parashikueshmëri*” të mjaftueshme, njërën ndër çështjet më esenciale të Ligjit të kontestuar, përkatësisht periudhën kohore brenda të cilës mund t’i nënshtrohet verifikimit një pasuri e fituar. Më saktësisht, leximi i përbashkët i dy dispozitave të lartcekura, nuk qartëson (i) nëse verifikimit i nënshtrohet vetëm pasuria e fituar gjatë ushtrimit të funksionit dhe ky verifikim mund të bëhet deri në kalimin e periudhës 10 (dhjetë) vjeçare pas përfundimit të funksionit; ose (ii) nëse verifikimit i nënshtrohet pasuria e fituar gjatë funksionit dhe ajo e fituar edhe 10 (dhjetë) vite tjera pas përfundimit të funksionit. Për më tepër, dispozitat e lartcekura, nuk qartësojnë, nëse zgjerimi i verifikimit për pasurinë e zyrtarit përkatës pas përfundimit të ushtrimit të funksionit, (i) mund të përfshijë vetëm pasurinë e fituar brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare pas përfundimit të funksionit; (ii) mund të përfshijë vetëm pasurinë e lartcekur dhe procedura mund të iniciohet vetëm brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare pas përfundimit të funksionit; apo (iii) mund të përfshijë vetëm pasurinë e fituar brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare pas përfundimit të funksionit, por procedura mund të iniciohet brenda periudhës 10 (dhjetë) vjeçare sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të nenit 2 të Ligjit të kontestuar.
295. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata po ashtu në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar që duke marrë parasysh se parimet e lartcekura lidhur me “*parashikueshmërinë*” dhe “*qartësinë*” e ligjit dhe rëndësinë e këtij koncepti për parimin e sigurisë juridike, bazuar edhe në opinionet relevante të Komisionit të Venecias, në parim, “*të drejtat dhe detyrimet*” duhet

të jenë “*të përcaktuara me ligj*”, dispozitat e të cilit duhet të jenë “*të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme*”, për t'i mundësuar pushtetit ekzekutiv/autoriteteve publike të ushtrojë diskrecion vetëm në fushat ku është deleguar një kompetencë të tillë, e jo thjeshtë sepse ligji është i pasigurt ose i paqartë, por edhe për t'i mundësuar subjekteve juridike që përshtatshmërisht të rregullojnë sjelljen dhe pritshmëritë përkatëse (shih, rastin e Gjykatës KO216/22 dhe KO220/22, parashtrues të kërkesës: KO216/22, *Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*; KO220/22, *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, i cituar më lart, paragrafi 227).

296. Në rastin e Ligjit të kontestuar, mungesa e një qartësie të tillë, u mundëson autoriteteve publike, përfshirë Byrosë Shtetërore, që të interpretojë afatet e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 2 dhe paragrafin 3 të nenit 22 të Ligjit të kontestuar në diskrecion të plotë, në cenim të parimit të sigurisë juridike dhe cenimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit, përfshirë duke u pamundësuar atyre që përshtatshmërisht të rregullojnë sjelljen dhe pritshmëritë përkatëse.
297. “*Paqartësia*” që ngërthen paragrafi 2 i nenit 2 dhe paragrafi 3 i nenit 22 të Ligjit të kontestuar, (i) në njërën anë rrit diskrecionin e plotë vendimmarrës të autoriteteve publike ndërlidhur me periudhat e aplikueshme kohore për zgjerimin e periudhës së verifikimit të pasurisë së zyrtarëve pas përfundimit të funksionit; ndërsa (ii) në anën tjetër, cenon “*qartësinë*” dhe “*parashikueshmërinë*” e nevojshme në kontekst të sigurisë së të drejtave dhe lirive themelore.

#### *Konkluzion*

298. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që pika 2.2. e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 3 të nenit 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës.
299. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, në adresimin e shkeljes së kontestuar si më lart, Kuvendi, përmes ndryshimeve dhe/ose plotësimit të dispozitës së lartcekur, duhet të sigurohet që normat të cilat përcaktojnë periudhat kohore brenda të cilave Byroja mund të verifikojë pasurinë e fituar përgjatë dhe pas ushtrimit të funksionit, përfshirë ato brenda të cilave mund të iniciohen hetimet dhe procedurat përkatëse, duhet të jenë plotësisht “*të qarta*” dhe “*parashikueshme*”.

## **2. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 20 dhe 23 të Ligjit të kontestuar**

### **A. Thelbi i pretendimeve/argumenteve dhe kundër-argumenteve të palëve**

300. Siç është shtjelluar detajisht në pjesën e këtij Aktgjykimi që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, këta të fundit, në esencë, pretendojnë se nenet 18 (Inicimi i procedurës), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit), 20 (Detyrimi për bashkëpunim), 23 (Procedura në Byro) dhe 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar, janë në kundërshtim me nenin 31 [E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së si dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës, në esencë, pretendojnë se (i) detyrimi i institucioneve shtetërore, personave juridikë dhe fizikë, përfshirë subjektin të verifikimit, për të bashkëpunuar me Byronë, nën kërcënimin e

kallëzimit penal te Prokurori i Shtetit për veprën penale “*mosekzekutim i vendimeve gjyqësore*” sipas përcaktimeve të Kodit Penal, është në kundërshtim me të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për të mos inkriminuar veten dhe anëtarët e familjes; ndërsa (ii) standardi i të provuarit mbi bazën e “*vlerësimit të gjasave*”, nuk është i mjaftueshëm për të arsyetuar fillimin dhe zhvillimin e procedurës së verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë. Për më tepër, pretendojnë se procedura nuk ngërthen garanci të mjaftueshme procedurale, përfshirë ato që ndërlidhen me parimin e barazisë së armëve, përkatësisht të drejtën në qasjen në dokumente dhe të drejtën për t’u dëgjuar, si dhe të drejtën në mjet efektiv juridik.

301. Në anën tjetër, Ministria e Drejtësisë, ndër tjerash, kundër-argumenton që Byroja ka të drejtë vetëm të mbledhë dhe të verifikojë informacione në lidhje me pasurinë e subjektit të verifikimit, dhe se vendimi përfundimtar për konfiskim, merret nga gjykata, duke theksuar gjithashtu se Ligji i kontestuar, ngërthen të gjitha garancitë e nevojshme procedurale, përfshirë faktin që të gjitha informacionet do të jenë të qasshme për palën e cila është subjekt i procedurës së verifikimit, përveç në rastet kur këto informacione “*do të rrezikojnë procedurën e verifikimit, do t’i dëmtonin provat, si dhe mund ta cenonin interesin publik*”. Në kontekst të standardit të të provuarit, Ministria e Drejtësisë, ndër të tjerash, thekson që standard është konfirmuar edhe nga Komisioni i Venecias si standard i të provuarit në procedurë civile si në Opinionin e parë edhe në Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias për Projektligjin për Byronë Shtetërore, ku e vlerësoi rregullimin e çështjes së barrës së provës në mënyrë të kënaqshme.

## **B. Vlerësimi i Gjykatës**

302. Gjykata fillimisht thekson se kapitulli V (Verifikimi i pasurisë së pajustificuar) i Ligjit të kontestuar, rregullon procedurën e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme brenda Byrosë. Më saktësisht, ky kapitull përmban nenet si në vijim: 18 (Inicimi i procedurës), 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit), 20 (Detyrimi për bashkëpunim), 21 (Drejta për përfaqësues), 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) dhe 23 (Procedura në Byro). Në anën tjetër, neni 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) është pjesë e kapitullit VIII (Seanca e shqyrtimit të propozimit për konfiskim) të Ligjit të kontestuar, dhe i cili ndërlidhet kryesisht, më barrën e provës, përkatësisht standardin civil të vlerësimit të gjasave dhe të cilin Gjykata tashmë e ka shtjelluar dhe vlerësuar në pjesën paraprak të këtij Aktgjykimi.
303. Në kontekst të këtyre dispozitave, Gjykata fillimisht vëren se bazuar në paragrafin 1 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, Byroja inicion procedurën e verifikimit mbi bazën e informatave “*kredibile dhe të besueshme*” lidhur me pasurinë e pajustificueshme, përkatësisht “*çdo informacion, dokument, provë, dëshmi apo e dhënë, e cila lë të kuptojë që ka mospërputhje në mes të hyrave të ligjshme dhe pasurisë së krijuar*”, në rastet kur: (i) pranon informacion, dokument, provë, dëshmi apo të dhëna nga burime të ndryshme, përfshirë personat fizikë dhe juridikë; (ii) pranon informacion, dokument, provë, dëshmi apo të dhëna nga institucionet e Republikës së Kosovës ose të huaja; si dhe (iii) ka qasje në informacion, dokument, provë, dëshmi apo të dhëna, por që nuk i pranon zyrtarisht dhe të njëjtat janë publike ose të qasshme në çfarëdo forme. Po ashtu, ky nen, në paragrafët 2 dhe 3 të tij, detyron institucionet e Republikës së Kosovës, duke përfshirë por mos u kufizuar në (i) Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit; (ii) Administratën Tatimore të Kosovës; (iii) Doganën e Kosovës; (iv) Bankën Qendrore të Kosovës; (v) Njësinë për Inteligjencë Financiare; dhe (vi) Noterët dhe Përmbauesit Privatë, që sipas kërkesës nga Byroja, “*në mënyrë aktive t’i ofrojnë pa vonesë informatat e kërkuara*”, si dhe që kurdo që posedojnë ose bien në posedim të çfarëdo informacioni, dokumenti, prove, dëshmie ose të dhëne që

përmban informata kredibile dhe të besueshme në lidhje me pasurinë e pajustificueshme, të përcjellin të njëjtat te Byroja Shtetërore pa vonesë.

304. Gjykata po ashtu nënvizon se Byroja shqyrton nëse informatat e mbledhura i referohen personit zyrtar që është subjekt i Ligjit të kontestuar, si dhe nëse të njëjtat janë të besueshme. Në përputhje me paragrafët 6, 7 dhe 8 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë vlerëson në pamje të parë lartësinë e mospërputhjes në mes të pasurisë dhe të hyrave të ligjshme, duke i dhënë prioritet rasteve nga vlera më e lartë e mospërputhjes deri tek pragu i përcaktuar më këtë ligj, dhe nxjerrë vendim të arsyetuar për fillimin e procedurës së verifikimit ose vendosë për mos fillimin e procedurës kur nuk janë përmbushur kushtet ligjore. Ligjvënësi ka përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni, edhe të drejtën e palës që është subjekt i verifikimit që të ketë qasje në të gjitha informatat e pranuar dhe trajtuara nga Byroja, përveç në rastet kur këto informacione “*do ta rrezikonin procedurën e verifikimit, do t'i dëmtonin provat, si dhe mund ta cenonin interesin publik*”, kufizim për të cilin gjykata nxjerr vendim me shkrim. Gjykata thekson se neni 19 i Ligjit të kontestuar përmban një listë jo-shteruese të informatave të cilat Byroja Shtetërore i mbledh gjatë procedurës së verifikimit dhe përcakton që të dhënat personale do të trajtohen dhe përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
305. Në anën tjetër, neni 20 i Ligjit të kontestuar rregullon më tej detyrimin për bashkëpunim të (i) institucioneve të Republikës së Kosovës; (ii) personave fizikë apo juridikë vendorë që ushtrojnë autorizime publike; si dhe (iii) personave tjerë fizikë dhe juridikë vendorë, bashkëpunim ky që shtrihet deri në masën sa “*nuk cenohet e drejta në privatësi dhe e drejta për mosinkriminim*”, si dhe që ndihmën, informacionin dhe dokumentet e kërkuara, duhet t’ja sigurojnë Byrosë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e kërkesës, me përjashtim të informacionit që sigurohet sipas një procedure të veçantë. Gjykata gjithashtu vëren se paragrafët 3 deri 7 të nenit 20 të Ligjit të kontestuar, përcaktojnë procedurën dhe pasojat në rast të mos bashkëpunimit. Nëse subjektet e lartpërmendura nuk i përgjigjen kërkesës së Byrosë Shtetërore, e njëjta mund t’i kërkojë gjykatës përkatëse që ndaj këtij subjekti, të marrë aktvendim për dorëzimin e informacionit dhe dokumenteve sipas kërkesës së Byrosë. Në rast se subjekti në fjalë nuk e zbaton këtë aktvendim në afat jo më të gjatë se 5 (pesë) ditë, atëherë, Byroja Shtetërore paraqet ndaj subjektit që nuk ka bashkëpunuar kallëzim penal te Prokurori i Shtetit për veprën penale “*mos ekzekutim i vendimit gjyqësor*”, sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Në fund, Gjykata po ashtu thekson se neni 61 (Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera) i Ligjit të kontestuar, përcakton se për çështjet procedurale gjyqësore të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit përkatës për procedurën kontestimore.
306. Për më tepër, Gjykata rikujton që neni 23 (Procedura në Byro) i Ligjit të kontestuar, rregullon procedurën e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme brenda Byrosë, respektivisht para dërgimit të propozimit për konfiskim në gjykatën përkatëse. Më saktësisht, ky nen në paragrafin 1 të tij përcakton se Drejtori i Përgjithshëm vendosë për fillimin e procedurës në pajtim me nenin 18 (Inicimi i procedurës) të këtij ligji, dhe së pari (i) kërkon, mbledhë informata dhe analizon informatat e tjera relevante për rastin në përputhje me nenin 19 (Mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit) të Ligjit të kontestuar dhe kërkon ndihmë nga institucionet e Republikës së Kosovë në pajtim me legjislacionin në fuqi; (ii) kërkon informatat nga pala në procedurë dhe subjektet e përcaktuara në nenin 20 (Detyrimi për bashkëpunim) të këtij ligji; (iii) ekzaminon rrethanat që kanë lidhje me rastin; dhe (iv) mund të ftojë palën në procedurë për të dhënë dëshmi, me qëllim të identifikimit të pasurive të tjera apo sqarimit të dyshimeve mbi pasurinë në verifikim. Procedura zhvillohet nga zyrtari i Byrosë, të cilit i caktohet lënda me vendim të

Drejtorit të Përgjithshëm dhe të gjitha informatat e dokumentet mblidhen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Tutje, zyrtari i Byrosë Shtetërore mund të kërkojë nga Drejtori i Përgjithshëm që vendimi për verifikim të zgjerohet ndaj palës së tretë kur vërehet se pasuria është bartur te ajo palë. Më tej dhe pas listimit të pasurisë, Gjykata vëren që bazuar në nenin e lartcekur, Byroja fton palën në procedurë që të ofrojë prova dhe të dhëna për të justifikuar prejardhjen e pasurisë së listuar në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, dhe (i) nëse zyrtari i Byrosë vëren se nuk ka shpërputhje në mes të hyrave dhe pasurisë, apo që vlera e shpërputhjes nuk tejkalon vlerën prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro, atëherë ai propozon mbylljen e rastit dhe një propozim i arsyetuar i dorëzohet Drejtorit të Përgjithshëm, i cili më pas me vendim mbyll rastin; ndërsa (ii) nëse bazuar në vlerësimin e gjasave shpërputhja e lartcekur arrihet, zyrtari i Byrosë Shtetërore i propozon Drejtorit të Përgjithshëm konfiskimin e pasurisë, i cili më pas dorëzon në gjykatë propozimin për konfiskim, së bashku me dosjen e lëndës dhe provat ofruara nga pala në procedurë, nëse ka të tilla. Më tej dhe sipas paragrafit 9 të nenit 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar, në rast se pala në procedurë nuk i përgjigjet ftesës së Byrosë, dhe vlera e mospërputhjes është mbi 25,000 (njëzet e pese mijë) euro si dhe është përmbushur standardi i “vlerësimin të gjasave”, atëherë, supozohet se pasuria është fituar në mënyrë të pajustificueshme dhe pason propozimi për konfiskim i saj si në procedurën më lart. Po ashtu, paragrafi 11 i këtij neni parasheh se kurdo gjatë procedurës së verifikimit, Byroja mund të paraqes para gjykatës kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë në verifikim sipas nenit 24 (Masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë) të këtij ligji. Tutje, Ligji i kontestuar përcakton se Byroja Shtetërore duhet ta përfundojë procedurën e verifikimit brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh, dhe apo kur çështja është e komplikuar, zyrtari i Byrosë Shtetërore mund të kërkojë periudhë shtesë jo më të gjatë se dyzet e pesë (45) ditë. Përbashimisht, procedura e verifikimit të pasurisë në Byro mund të zgjasë deri në 1 (një) vit kur procedura është e varur nga kërkesa për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

307. Në fund, dhe bazuar në nenin 34 të Ligjit të kontestuar, (i) së pari Byroja paraqet provat para gjykatës përkatëse lidhur me përmbushjen e standardit civil të vlerësimin të gjasave, se pasuria që është objekt shqyrtimi është e pajustificueshme; ndërsa (ii) pala në procedurë, përkatësisht subjekti, pasuria e të cilit pretendohet të jetë e pajustificueshme nga Byroja, duhet të provojë të kundërtën para gjykatës përkatëse.
308. Në kontekstin e sqarimeve të lartcekura, Gjykata rikujton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në parim, ndërlidhen me (i) detyrimin për bashkëpunimin me Byronë në raport me të drejtën për t’u mos vetë--inkriminuar; dhe (ii) të drejtën e palës për t’u njoftuar për të gjitha procedurat e zhvilluara në kontekst të verifikimit të pasurisë, përfshirë ndërlidhur me vendosjen e masave të sigurisë në pasurinë kontestuese si dhe të drejtën për mjet juridik; si dhe (iii) parimin e sigurisë juridike, pretendime këto, të cilat, Gjykata do t’i vlerësojë në vijim.

***(i) detyrimi për bashkëpunim në raport me të drejtën për t’u mos vetë-inkriminuar***

309. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht u referohet edhe një herë neneve 18 dhe 20 të Ligjit të kontestuar, dispozita këto që përmbajnë detyrimin për bashkëpunim me Byronë për (i) institucionet shtetërore; (ii) personat fizikë dhe juridikë me autorizime publike; dhe (iii) personat e tjerë fizikë dhe juridikë, dhe të cilët, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, detyrohen t’i sigurojnë Byrosë të dhënat sipas kërkesës. Siç u shtjellua më sipër, në rast të refuzimit për të bashkëpunuar, me kërkesë të Byrosë, gjykata përkatëse nxjerr aktvendim për detyrimin e ofrimit të informatave, në rast të moszbatimit të të cilit, në afat prej 5 (pesë)

ditëve, Byroja parashtroi kallëzim penal te Prokurori i Shtetit ndaj subjektit përkatës për veprën penale “*mosekzekutim i vendimit gjyqësor*”, sipas përcaktimeve të Kodit Penal.

310. Nga ky detyrim i bashkëpunimit nën kërcënimin e ndjekjes penale, Ligji i kontestuar përcakton edhe përjashtime, aplikimi i të cilave i është lënë gjykatës përkatëse. Më saktësisht, (i) bazuar në paragrafin 8 të nenit 20 të Ligjit të kontestuar, aktvendimi për dorëzimin e dokumentit dhe informacionit ndaj subjekteve të verifikimit, nxirret nga gjykata nëse ajo vlerëson se “*kërkesa e Byrosë është e bazuar dhe arsyetuar*”; (ii) bazuar në paragrafin 6 të nenit 20 të Ligjit të kontestuar, gjykata nuk do të marrë aktvendim për nxjerrjen e informatave dhe dokumenteve sipas kërkesës së Byrosë, kur ajo kërkesë i është dërguar Prokurorit të Shtetit dhe kur Prokurori i Shtetit njofton se ofrimi i informatave dhe dokumenteve të tilla do të cenonte hetimin e çështjeve penale që janë në procedurë; dhe (iii) në rast se gjykata vlerëson nga përgjigja e subjektit se informatat apo dokumentet e kërkuara, nuk janë të disponueshme për ndonjë institucion tjetër, atëherë do të marrë aktvendim për nxjerrjen e informatave dhe dokumenteve “*deri në masën që nuk cenojnë sigurinë e vendit apo nuk shkelin drejtpërdrejt një të drejtë kushtetuese të njeriut, me qëllim për të mundësuar verifikimin e pasurisë*”, ndërsa çdo informatë apo dokument i nxjerrë përmes kësaj procedure, nuk publikohet dhe askush nuk mund të ketë qasje në të, përveç në procedurën gjyqësore.
311. Është me rëndësi të theksohet që çdo vlerësim i gjykatës kompetente ndërlidhur me nxjerrjen e aktvendimit përmes të cilit subjekti përkatës detyrohet për të bashkëpunuar me Byronë Shtetërore, duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e paragrafit 1 të nenit 20 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, “*detyrimi për bashkëpunim për personat fizik dhe juridik vendor shtrihet deri në atë masë sa nuk cenohet e drejta për privatësi dhe të drejtën për mos inkriminim*”.
312. Gjykata më tej gjithashtu sqaron që vepra penale e lartcekur, përkatësisht “*mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore*”, është e sanksionuar në nenin 394 (Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor) të Kodit nr. 06/074 Penal të Republikës së Kosovës, i cili në paragrafin 1 të tij, përcakton se: “*1. Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili refuzon të ekzekutoj urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm të ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës apo i cili nuk e ekzekuton vendimin brenda afatit ligjor apo afatit të caktuar me vendim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.*” Bazuar në përkufizimet e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 113 (Përkufizimet) të Kodit të lartcekur penal, këtë veprë penale mund ta kryejë (i) personi zyrtar; apo (ii) personi përgjegjës. I pari, përkatësisht “*personi zyrtar*”, sipas Kodit të lartcekur, nënkupton: (i) personin i cili në organin shtetëror kryen punët zyrtare; (ii) personin e zgjedhur, të emëruar ose të caktuar në organin shtetëror, në organin e pushtetit lokal ose personin që përherë ose përkohësisht kryen detyrat zyrtare ose funksione zyrtare në ato organe; (iii) personin në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendosë për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizikë apo juridikë ose për interesin publik; (iv) personin të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve; dhe (v) personin ushtarak, përpos kur janë në pyetje dispozitat e Kreut XXXIII (Veprat penale kundër detyrave zyrtare) të këtij Kodi. Ndërsa i dyti, përkatësisht, “*personi përgjegjës*”, definohet si person fizik në kuadër të personit juridik, të cilit i janë besuar detyra të caktuara, ose i cili është i autorizuar për të vepruar në emër të personit juridik si dhe ekziston bazueshmëria e lartë se është i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik.
313. Bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata thekson se detyrimi për bashkëpunim, i përcaktuar në nenin 20 të Ligjit të kontestuar, që në rast të refuzimit, rezultoi me

mundësinë për ndjekje penale për veprën penale të lartcekur, nuk vlen për subjektin e verifikimit, por për (i) institucionet shtetërore; (ii) personat fizikë dhe juridikë me autorizime publike; dhe (iii) personat e tjerë fizikë dhe juridikë, subjekte të cilat për nga përkufizimi, përkojnë me “*personin zyrtar*” dhe “*personin përgjegjës*” nga paragrafët 3 dhe 5 të nenit 113 (Përkufizimet) të Kodit Penal. Për më tepër, çdo detyrim për bashkëpunim, është në vlerësimin e gjykatës përkatëse, e cila çdo kërkesë të Byrosë për nxjerrjen e aktvendimit përmes të cilit detyrohen subjektet përkatëse të bashkëpunojnë, përkatësisht personat fizikë dhe juridikë, duhet ta vlerësojë në dritën e (i) të drejtës në privatësi; dhe (ii) të drejtës për mos vetë-inkriminim, dhe të cilat, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, duhet të interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

314. Gjykata gjithashtu thekson që mbrojtja e të drejtës për privatësi, siç është e garantuar përmes nenit 36 [E drejta e privatësisë] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, është tejet e rëndësishme në kontekst të konfiskimit civil të pasurisë, përfshirë detyrimin për bashkëpunim me Byronë. Parimet themelore që burojnë nga nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, janë shtjelluar në rastet e Gjykatës dhe të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në rastet [KO55/23](#) (me parashtrues *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të referuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 2 mars 2023, përmes shkresës nr. 8/3509/Do/1493/1, Aktgjykim, i 22 dhjetorit 2022, paragrafët 415-440); [KI56/18](#) (me parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 83) dhe [KI113/21](#) (me parashtruese *Bukurije Xhonbalaj*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafi 71). Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 1 i nenit 20 të Ligjit të kontestuar, kushtëzon detyrimin për bashkëpunimin të subjekteve përkatëse në mbrojtjen e të drejtës së privatësisë, vlerësim ky i cili i takon gjykatës përkatëse, në përputhje me detyrimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.
315. Për më tepër dhe përtej garancisë së lartcekur, Gjykata vëren që Ligji i kontestuar ngërthen edhe disa dispozita të tjera specifike në lidhje me sigurimin e kësaj të drejte. Më saktësisht, (i) sipas nenit 19 të Ligjit të kontestuar, ku rregullohet mbledhja e informatave me qëllim të verifikimit, përcaktohet që “*të dhënat personale do të trajtohen edhe përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi*”; ndërsa (ii) sipas paragrafit 11 të nenit 20 të Ligjit të kontestuar, i cili rregullon detyrimin për bashkëpunim për institucionet e Republikës së Kosovës, për personat fizikë dhe juridikë me autorizime publike dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë, theksohet edhe aplikimi i “*ligjit përkatës për mbrojtjen e të dhënave*”.
316. Në kontekstin e lartcekur dhe më specifikisht të detyrimit të subjekteve të saktësuara në Ligjin e kontestuar për të bashkëpunuar me Byronë Shtetërore, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. E njëjta në disa raste ka vlerësuar obligimin e operatorëve të telefonisë mobile, ofruesve të shërbimeve të internetit, bankave, atletëve elitare, dhe spitaleve që t’ju ofrojnë autoriteteve të dhënat personale që i kanë në dispozicion, sipas kërkesës së ligjit apo ndonjë urdhri të lëshuar nga autoritetet. Për shembull dhe ndër tjerash, në rastin e GJEDNJ-së, *Breyer kundër Gjermanisë*, detyrimi ligjor i operatorëve të telefonisë mobile për të regjistruar të dhënat personale të përdoruesve të kartave SIM me parapagesë dhe për t’i vënë ato në dispozicion të autoriteteve, në përputhje me Aktin e Telekomunikacionit, i cili autorizoi autoritete të ndryshme publike për të kërkuar marrjen dhe komunikimi i të dhënave të tilla pa asnjë nevojë për një vendim gjyqësor ose njoftim të personave të interesuar, nuk u konsiderua në kundërshtim me nenin 8 (E drejta e privatësisë) të KEDNJ-së. Ndërsa, në rastin tjetër, *Sommer kundër Gjermanisë*, inspektimi i llogarisë bankare të një avokati, kishte rezultuar në shkelje të nenit 8 (E drejta e privatësisë)



të KEDNJ-së, duke pasur parasysh pragun e ulët për inspektimin e llogarisë bankare të parashtruesit, respektivisht avokatit, shtrirjen e gjerë të kërkesave për informacionin, zbulimin e mëvonshëm dhe ruajtjen e vazhdueshme të informacionit personal të parashtruesit dhe pamjaftueshmërinë e masave mbrojtëse procedurale (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Breyer kundër Gjermanisë](#), nr. 50001/12, Aktgjykim i 30 janarit 2020, dhe [Sommer kundër Gjermanisë](#), nr. 73607/13, Aktgjykim i 27 prillit 2017). Rastet e lartcekura, ndër tjerash dhe në parim, saktësojnë që detyrimi për bashkëpunim, bazuar në ligjet e aplikueshme, nuk është në kundërshtim me dispozitat përkatëse të KEDNJ-së, për aq sa ka një balancë/proporcion të duhur në mes të interesit publik dhe të drejtave dhe lirive themelore, përfshirë të drejtën e privatësisë.

317. Në anën tjetër dhe ndërlidhur me të drejtën për të heshtur dhe për të mos u vet-inkriminuar, Gjykata rithekson se parimet e përgjithshme në lidhje me garancinë procedurale të mos inkriminimit të vetës dhe anëtarëve të familjes, vlejné (i) në procedurën penale, si e drejtë kushtetuese e të akuzuarit, e përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës; si dhe (ii) në procedurën civile, si e drejtë e dëshmitarit, e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 343 (pa titull) të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK). Më saktësisht, Gjykata rikujton se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke përfshirë edhe të drejtat e të akuzuarit, siç garantohen me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, siguron disa garanci minimale për çdo person të akuzuar për një vepër penale, e që bazuar në paragrafin 6 të nenit 30 të Kushtetutës, përfshinë edhe të drejtën për të mos inkriminuar veten (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës, [KI110/19](#), parashtrues *Fisnik Bahtijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetor 2019, paragrafi 47 dhe rastet e GJEDNJ-së, [Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 19187/91, paragrafët 68 dhe 69, Aktgjykim i 17 dhjetorit 1996, si dhe [John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar \[DHM\]](#), nr. 18731/91, paragrafi 45, Aktgjykim i 8 shkurtit 1996). Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, edhe pse nuk përmendet në mënyrë specifike në nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta për të heshtur dhe privilegji kundër vetë-inkriminimit, janë standarde ndërkombëtare të njohura përgjithësisht, të cilat qëndrojnë në qendër të nocionit të një procedure të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së (shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM]*, cituar më lart, paragrafi 45; dhe [Bykov kundër Ruisë \[DHM\]](#), nr. 4378/02, Aktgjykim i 10 marsit 2009, paragrafi 92). Gjykata, më tej, gjithashtu rikujton që e drejta e mos vetë-inkriminimit nuk i akordohet vetëm të akuzuarit në procedurë penale, siç përcaktohet në paragrafin 6 të nenit 30 të Kushtetutës, mirëpo, kjo garanci procedurale vlen edhe për dëshmitarët në procedurën civile. Në këtë kontekst, Gjykata vë në dukje paragrafin 1 të nenit 343 (pa titull) të LPK-së, sipas të cilit, “*dëshmitari mund të refuzojë përgjigjen në pyetjet e caktuara, në qoftë se për këtë ekzistojnë arsye të rëndësishme, e sidomos në qoftë se me përgjigjen në këto pyetje, do t’ia ekspozonte përgjegjësisë penale vetës, apo të afërmit e tij të gjinisë së gjakut në vijë vertikale deri në cilëndo shkallë, e në vijë horizontale deri në shkallën të tretë përfundimisht, bashkëshortin e vet, ose të afërmit e gjinisë së krushqisë deri në shkallë të dytë përfundimisht, edhe po që se ka pushuar martesë, personin me të cilin jeton në bashkësi jashtëmartesore, apo kujdestarin e vet, ose personin nën kujdestarinë e tij, adoptuesin apo të adoptuarin e vet.*”, për të cilën të drejtë, gjykata përkatëse ka për detyrë ta njoftojë dëshmitarin.
318. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe paragrafit 5 të nenit 62 (Efekti i procedurave të tjera në zbatimin e dispozitave të këtij ligji) të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se “*Deklaratat e dhëna si dhe dokumentet e ofruara nga kushdo në kuadër të procedurës së verifikimit dhe konfiskimit sipas këtij ligji të njëjtat nuk mund të përdoren si prova në procedurë penale*”. Po ashtu, Gjykata i referohet edhe paragrafit 1 të nenit 20 të Ligjit të kontestuar që

përmban një garanci procedurale specifike për kategorinë e personave të tjerë fizikë dhe juridikë, për të cilët detyrimi për bashkëpunim shtrihet në masën që nuk cenohet e drejta e tyre në privatësi dhe mos vetë-inkriminim. Në anën tjetër, (i) paragrafi 7 i nenit 36 (Administrimi i provave) të Ligjit të kontestuar, dëshmitarit, gjatë procedurës gjyqësore, i ka akorduar edhe të drejtën për të refuzuar dhënien e dëshmisë në përputhje me ligjin përkatës për procedurën kontestimore, gjegjësisht, siç është cekur më lart, aktualisht me nenin 343 të LPK-së; ndërsa, sipas (ii) paragrafit 2 të nenit 37 (Marrja në pyetje e palës, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet) të Ligjit të kontestuar, gjatë marrjes në pyetje të palës, të cilës propozohet që t'i konfiskohet pasuria, pala ka të drejtë të mos përgjigjet në pyetjet e parashtruara.

319. Në kontekst të së drejtës për t'u mos u vet-inkriminuar, Gjykata gjithashtu vë në pah të gjeturat e Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, ku theksohet se *"[...] aq sa obligimi për bashkëpunim ka të bëjë me subjektet shtetërore, kjo nuk është problematike. Në anën tjetër, kur bëhet fjalë për "personat fizikë dhe juridikë vendor", të drejtat e tyre të njeriut, veçanërisht e drejta në privatësi dhe e drejta për të mos u detyruar të vetë-inkriminohen, janë të rëndësishme në këtë kontekst. Këto të drejta të njeriut duket se nuk janë adresuar në mënyre adekuate. Ashtu si në procedure penale, mund të ekzistojë edhe e drejta për të mos dëshmuar, p.sh. kundër anëtarëve të familjes. Rregullimi sipas paragrafit 7, sipas së cilit në rastet e mosbashkëpunimit të personave fizikë ose juridikë, Byroja mund t'i drejtohet gjykatës për t'i detyruar ata, mund të mos jetë në përputhje me këto kërkesa, andaj duhet të rishikohet."* (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, CDL-AD(2022)014, cituar më lart, paragrafi 48). Tutje, në Opinionin e dytë të tij, Komisioni i Venecias duke përmendur ndryshimet në draftin e ri të Projektligjit për Byronë Shtetërore, ndër të tjera, detyrimin e personave të tjerë, përfshirë personat fizikë, që të ofrojnë informata dhe dokumente përkatëse, por pa e shkelur të drejtën në privatësi dhe të drejtën për mos vet-inkriminim dhe përcaktimin që Gjykata mund të lëshojë urdhër për ofrimin e informatave dhe dokumenteve të tilla, por jo në atë masë që do të cenonte sigurinë kombëtare ose të drejtat kushtetuese të njeriut, ose do të ndikonte në një hetim penal, të njëjtat i vlerëson si ndryshime *"shumë pozitive"* (shih, Opinionin e Dytë të Komisionit të Venecias, CDL(2022)053, cituar më lart, paragrafi 23). Ndërsa, në informacionin përcjellës të Komisionit të Venecias, të komunikuar më 14 mars 2023 lidhur me versionin e fundit të Projektligjit për Byronë Shtetërore, i njëjti vlerëson se *"[...] shumica e problemeve më serioze të identifikuara në opinionin e Komisionit të Venecias të qershorit 2022, ishin adresuar, ndër të tjera në lidhje me përcaktimin më të saktë të parakushteve për iniciimin e procedurës së verifikimit dhe përmirësimin e garancive të të drejtave të njeriut të atyre që janë të përfshirë në procedurë"*.

#### *Konkluzion*

320. Bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar, (i) ngërthen garancinë bazuar në të cilën, për personat fizikë, përfshirë subjektin e verifikimit, detyrimi për bashkëpunim shtrihet deri në masën sa *"nuk cenohet e drejta në privatësi dhe e drejta për mos vetëinkriminim"* dhe që vlerësimi i një proporcioni të tillë është në kompetencën e gjykatës kompetente; për më tepër që (ii) pasoja e refuzimit për bashkëpunim, përkatësisht mundësia për kallëzim penal për veprën penale *"mos ekzekutim i vendimit gjyqësor"*, sipas përcaktimeve të Kodit Penal, nuk shtrihet ndaj personit fizik, por vetëm ndaj autoriteteve publike dhe/ose personave fizikë dhe juridikë me autorizime publike.

**(ii) të drejtat e palës për t'u njoftuar për të gjitha procedurat e zhvilluara në kontekst të verifikimit të pasurisë, përfshirë ndërlidhur me vendosjen e masave të sigurisë në pasurinë kontestuese, si dhe të drejtën për mjet juridik**

321. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e garancive procedurale të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së përkitazi me njoftimin e palës për procedurat e zhvilluara ndaj tij/saj dhe të drejtës në mjet efektiv juridik të përcaktuar përmes nenit 32 [E Drejta në Mjet Juridik] të Kushtetutës, Gjykata, rikujton që pretendimet lidhur me të parën, ndërlidhen kryesisht me të drejtën për të pasur qasje në dokumente dhe dosjen e lëndës, përkatësisht parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, ndërsa lidhur me të dytën, ndërlidhen kryesisht më të drejtën në mjet juridik, përkatësisht të drejtën për të kundërshtuar fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, dhe të cilat çështje, Gjykata do t' i trajtojë në vijim.

**(a) Barazia e armëve dhe parimi i kontradiktoritetit**

322. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës, ekziston detyrimi i autoriteteve administrative që t'u lejojnë qasje ankuesve në dokumentet përkatëse që posedojnë autoritetet administrative, nëse është e nevojshme edhe nëpërmjet një procedure për zbulimin e dokumenteve (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [McGinley dhe Egan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 10/1997/794/995-996, Aktgjykim i 1 qershorit 1998, paragrafët 86 dhe 90). Për më tepër, sipas praktikës së lartcekur gjyqësore, mohimi i kësaj të drejte, pa ndonjë arsye të mirë, do të kishte si pasojë mohimin e të drejtës në gjykim të drejtë, respektivisht, shkeljen e paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, e drejta për zbulimin e provave përkatëse, nuk është absolute. Në raste të caktuara, interesat kombëtare mbizotëruese janë paraqitur për t'i mohuar një pale të drejtën në qasje të plotë të provave, përfshirë ndërlidhur me konsiderata të sigurisë kombëtare (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Regner kundër Republikës Çeke \[DHM\]](#), nr. 35289/11, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017 - krahasuar me [Corneschi kundër Rumanisë](#), nr. 21609/16, Aktgjykim i 11 janarit 2022, [Mirjana Petrova kundër Bullgarisë](#), nr. 27148/08, Aktgjykim i 21 korrikut 2016, paragrafët 39-40), ose nevoja për të mbajtur sekret disa metoda të hetimit/vëzhgimit policor ([Adomaitis kundër Lituaniës](#), nr. 14833/18, Aktgjykim i 18 janarit 2022, paragrafi 68).

323. Në kontekst të parimeve të përmbledhura më sipër, Gjykata fillimisht vë në pah paragrafin 10 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se: *“Të gjitha informacionet e pranuar dhe të trajtuara nga Byroja, do të jenë të qasshme për palën e cila është subjekt i procedurës së verifikimit, përveç në rastet kur këto informacione do ta rrezikojnë procedurën e verifikimit, do t'i dëmtonin provat, si dhe mund ta cenonin interesin publik. Kufizimin e dokumenteve Byroja duhet ta kërkoj zyrtarisht në Gjykatë, për të cilën kërkesë Gjykata nxjerr vendim me shkrim.”*

324. Më saktësisht, bazuar në dispozitën e lartcekur, pala që është subjekt i procedurës së verifikimit, do të ketë qasje në të gjitha dokumentet dhe informacionet që janë në posedim të Byrosë, me përjashtimin nëse një qasje e tillë është e kufizuar nga gjykata përkatëse, me arsyetimin e (i) rrezikimit të procedurës së verifikimit; (ii) dëmtimit të provave; ose (iii) interesit publik.

325. Për më tepër, një vendim i tillë gjyqësor, i nënshtrohet të drejtës për mjet juridik. Kjo duhet ndodhur përkundër faktit që Ligji i kontestuar nuk ka përcaktuar mjet ankese dhe i njëjti

gjithashtu nuk përjashton specifiku të drejtën e ankesës. Më saktësisht, bazuar në paragrafin 1 të nenit 53 (Ankesa kundër aktvendimit) të Ligjit të kontestuar, “*kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankimi, në qoftë se në këtë ligj nuk është përcaktuar që ankimi nuk lejohet.*” Ndërlidhur me aktvendimin që ndërlidhet me kufizimin e qasjes në informacionin/dokumentacionin përkatës, nuk është përjashtuar ankesa përmes Ligjit të kontestuar dhe për pasojë, ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë për t’ia kufizuar subjektit të verifikimit qasjen në informatat që i pranon dhe trajton Byroja, lejohet ankesa, respektivisht, subjekti i verifikimit në rastin konkret, ka qasje në mjet juridik.

### *Konkluzion*

326. Për pasojë dhe bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata konsideron se paragrafi 10 i nenit 18 të Ligjit të kontestuar, në parim, ofron mjaftueshëm garanci në kuadër të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi i mundëson subjektit të verifikimit qasje në informacionet e pranuar dhe të trajtuara, ndërsa kufizimi në qasjen e tyre, mund të përcaktohet vetëm nga gjykata kompetente, vendim ky i cili mund të ankimohet nga subjekti përkatës. Për më tepër dhe ashtu siç është theksuar edhe më lart, në nxjerrjen e një vendimi të tillë, gjykata përkatëse është e detyruar të veprojë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas përcaktimeve të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

### **(b) e drejta në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave**

327. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vete Gjykatës, e drejta në mjet juridik efektiv ndaj cילו akt të autoritetit publik që mund të ketë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit të përcaktuara me ligj dhe/ose Kushtetutë, në parim, nuk mund të kufizohet përveç nëse kufizimi/ndërrhyrja është (i) “*i përcaktuar në ligj*”; (ii) ka ndjekur “*një qëllim legjitim*”; dhe (iii) masa e ndërmarrë ka qenë “*proporcionale*” me qëllimin që është synuar të realizohet (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës, KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 337; KI214/21, me parashtrues *Avni Kastrati*, cituar më lart, paragrafi 124, KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, paragrafët 385-387).
328. Thënë këtë dhe siç është shtjelluar më lart, bazuar në dispozitat e Ligjit të kontestuar, gjatë procedurës së verifikimit të pasurisë së një subjekti, ekziston qasja në mjete juridike dhe kjo vlen në situatat si në vijim: (i) kur subjekti i verifikimit kërkon qasje në informatat dhe dokumentet e pranuar dhe trajtuara nga Byroja, kufizim të cilin mund ta bëjë vetëm gjykata e shkallës së parë me vendim me shkrim në procedurë gjyqësore ndaj të cilit vendim, bazuar në paragrafin 1 të nenit 53 (Ankesa kundër aktvendimit) të Ligjit të kontestuar, subjekti i verifikimit mund të ushtrojë ankesë; si dhe (ii) kur subjektet e detyruara për bashkëpunim, respektivisht, ofrim të informatave, të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 20 (Detyrimi për bashkëpunim) të Ligjit të kontestuar, refuzojnë bashkëpunimin, për vlerësimin e të cilit detyrim për ndarje të informatave vendosë gjykata e shkallës së parë me aktvendim deri në masën që (a) nuk shkel të drejtat dhe liritë themelore; (b) dëmton provat në procedurë penale; apo (c) cenon sigurinë e vendit bazuar në paragrafët 4 dhe 6 të nenit 20 (Detyrimi për bashkëpunim) të Ligjit të kontestuar, procedura gjyqësore këto ndaj cilave po ashtu bazuar në paragrafin 1 të nenit 53 (Ankesa kundër aktvendimit) të Ligjit të kontestuar, ekziston e drejta për ankesë.
329. Për më tepër, Gjykata po ashtu vëren se përmes paragrafit 7 të nenit 18 (Inicimi i procedurës) të Ligjit të kontestuar, Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë Shtetërore, autorizohet

që të nxjerrë vendim të arsyetuar për fillimin e procedurës së verifikimit. Lidhur me këtë, Gjykata vë në pah edhe konstatimin e Komisionit të Venecias, i cili në Opinionin e parë të tij thekson se Drejtori i Përgjithshëm nxjerrë një vendim të arsyetuar për fillimin ose jo të procedurës së verifikimit por që dispozitat e propozuara ligjore nuk përcaktojnë nëse vendimi duhet t'i komunikohet personit në fjalë dhe t'i nënshtrohet mjeteve të mundshme juridike, për të cilin Komisioni i Venecias mban qëndrim se duhet të jetë publik ose të paktën duhet t'i komunikohet personit në fjalë përveç nëse ka arsye të justifikuara për të pasur frikë se procedura do të pengojë nëse veprohet ashtu (shih, Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, CDL(2022)014, cituar më lart, paragrafi 47). Në anën tjetër, Gjykata vëren se edhe në Opinionin e tij të dytë, Komisioni i Venecias, rithekson se "[...] nuk duket se ka mjet të veçantë juridik kundër fillimit të procedurës" (shih, Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias, CDL(2022)053, cituar më lart, paragrafi 26). Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se edhe versioni aktual i Ligjit të kontestuar nuk parasheh dispozita me të cilat, ky vendim i komunikohet palës apo që e udhëzon atë në mjet juridik, përveç dispozitave që kërkon informata nga ajo përmes nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të nenit 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar.

330. Megjithatë, duke pasur parasysh edhe kompetencat e Byrosë të përcaktuara në nenin 8 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Byrosë) të Ligjit të kontestuar, veçanërisht, atyre të përshkruara në nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3., dhe 1.4 të nenit të lartcekur, Gjykata vlerëson se Byroja Shtetërore, deri në fazën e parashtrimit të propozimit për konfiskim merr informata nga palët në procedurë, përfshirë ato subjekte që janë të detyruara sipas Ligjit të kontestuar të bashkëpunojnë, por pa i detyruar ato që të ndajnë këto informata apo të ndërmarrin veprime të caktuara, dhe se në rast se ekzistojnë detyrimet e tilla të përcaktuara me ligj, siç është cekur më lart, në situatat e tilla, është gjykata e rregullt ajo që vendosë për dorëzimin e informacionit dhe dokumenteve sipas kërkesës së Byrosë Shtetërore, apo edhe për vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë në procedurën e verifikimit në përputhje me nenin 24 (Masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar, pasi që paragrafi 11 i nenit 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar, përcakton që Byroja mund ta kërkojë nga gjykata vendosjen e kësaj mase kurdo gjatë procedurës së verifikimit.
331. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton se paragrafi 1 i nenit 24 (Masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar përcakton që: *"1. Kurdo përpara ose pas paraqitjes së propozimit për konfiskim, me propozimin e zyrtarit të Byrosë, Gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë, pa njoftim dhe dëgjim paraprak të palës në procedurë, po që se Byroja e bënë të besueshëm pretendimin për ekzistimin e pasurisë së pajustificueshme dhe se masa e përkohshme është e bazuar në prova të mbledhura në procedurën e verifikimit dhe është urgjente dhe se me veprim ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personi."* Në vijim të këtij përcaktimi përmes Ligjit të kontestuar, Gjykata rikujton edhe Opinionin e parë të Komisionit të Venecias për Kosovën ku thuhet *"Në Kapitullin VI që ka të bëjë me masat e përkohshme të sigurimit, neni 22 parashikon se gjykata cakton masën e propozuar të përkohshme të sigurimit të pasurisë kur gjen se masa e përkohshme të sigurimit ndaj pasurisë është "e bazuar dhe urgjente dhe se duke vepruar ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet ose ndryshe nuk do të jetë në dispozicion të atij personi" (paragrafi 1.1). Për më tepër, gjykata mund ta refuzojë propozimin vetëm në rast se nuk e ka bërë "të besueshëm pretendimin se asetet mund të tjetërsohen, të disponohen ose ndryshe nuk do të jenë në dispozicion të atij personi" (paragrafi 1.2). Kjo duket se sugjeron që masat e përkohshme të propozuara duhet të vendosen edhe nëse nuk ka prova ose dyshime të arsyeshme për pasuri të pajustificuara. Një rregullim i tillë mund të përbëjë*

ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës (neni 1, Protokollin 1 i KEDNJ) dhe duhet të ndryshohet duke vendosur një prag adekuat të provës.” (paragrafi 53 i Opinionit të parë i Komisionit të Venecias). Si rezultat i plotësimit të kësaj dispozite bazuar në gjetjet e Komisionit të Venecias, ky i fundit përmes Opinionit të dytë të tij theksoi se: “Pas rekomandimeve të Opinionit të Komisionit të Venecias në lidhje me masat e përkohshme janë përmirësuar disa afate kohore shumë të shkurtra (p.sh. ankesa brenda 48 orësh në vend të 24 orëve; kundërshtimi ndaj vendosjes së masave të përkohshme brenda 15 ditësh në vend të 5 ditëve). Tashmë parakushtet për masat e përkohshme të sigurisë janë të përcaktuara qartë në nenin 23: “Kurdo përpara ose pas paraqitjes së propozimit për konfiskim, me propozimin e zyrtarit të Byrosë, Gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë, pa njoftim dhe dëgjim paraprak të palës në procedurë, nëse Byroja paraqet pretendim të besueshëm për ekzistimin e pasurisë së pajustificueshme dhe se masa e përkohshme është e bazuar në provat e mbledhura në procedurën e verifikimit dhe është urgjente dhe se me veprim ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, shkatërrohet ose në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personi.” (shih, paragrafin 31 të Opinionit të dytë të Komisionit të Venecias për Kosovën).

332. Në vijim të kësaj, dhe bazuar në paragrafin 1 të nenit 24 të Ligjit të kontestuar, rezulton që vendosja e masës së sigurisë *ex parte*, pa njoftim dhe dëgjim të palëve, është e mundur dhe kjo me qëllimin që të parandalohet që “pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personi.” Në lidhje me këtë, Gjykata vëren që ky përcaktim është i rregulluar edhe përmes Direktivës së Parlamentit Evropian dhe Këshillit për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumentaliteteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian (Direktiva 2014/42/BE). Një procedurë e ngjashme është e përcaktuar edhe në Ligjin e Bullgarisë për konfiskimin e pasurive, të fituara përmes aktivitetit kriminal dhe shkeljeve administrative, në të cilin rast ngjashëm si në Opinionet e tij për Kosovën, Komisioni i Venecias edhe në Opinionet e tij në lidhje me të njëjtin ligj të Bullgarisë e pranon këtë si standard. Thënë këtë, ky i fundit në Opinionin e tij në lidhje me draftin e gjashtë të ndryshuar të Ligjit të Bullgarisë kishte theksuar se: “Siç u përmend më lart, procedurat e shqyrtimit para CEACAV-it dhe kërkesat në gjykatë për një urdhër ndalimi bëhen *ex parte*. Pas caktimit të një mase paraprake, autoritetet e CEACAV-it do ta “ftojë” personin në fjalë të paraqesë deklaratë me shkrim me qëllim të kundërshtimit të provave të paraqitura nga CEACAV në kërkesën e saj për urdhër ndalimi (neni 65 paragrafi 1). I padituri nuk është i detyruar të paraqesë një deklaratë të tillë dhe nuk mban përgjegjësi në rast se ai ose ajo vendos të mos e paraqesë atë. Për më tepër, neni 67 parashikon shprehimisht se mosparaqitja e një deklaratë nga ana e të paditurit “nuk mund të jetë bazë për të nxjerrë konkluzione kundër personit dhe anëtarëve të familjes së tij/saj”. Sipas mendimit të Komisionit të Venecias, kjo dispozitë i drejtohet si CEACAV ashtu edhe Gjykatës; do të ishte e dobishme nëse kjo shprehet qartë në nenin e përmendur.” (shih, paragrafin 44 të Opinionit CDL-AD(2011)023, të 17-18 qershorit 2011).
333. Për më tepër dhe në kuptim të procedurës civile të përcaktuar me dispozitat e LPK-së, Gjykata i referohet neneve 305 dhe 306 të LPK-së, respektivisht. Përmes nenit 305 të LPK-së përcaktohet që (i) “Përveçse në rastet e përcaktuara me këtë ligj, masa e sigurimit nuk mund të caktohet po që se kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundësinë që të deklarohet për propozimin e caktimit të saj”; dhe (ii) “Propozimin për caktimin e masave të sigurimit gjykata, bashkë me shkresat që i janë bashkangjitur, ia dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftim se mund të paraqesë përgjigje të shkruar brenda afatit shtatë (7) ditor.” Megjithatë, Gjykata vëren se neni 306 i LPK-së në kontekst të përjashtimit të specifikuar me paragrafin 1 të nenit 305 i LPK-së “përveçse në rastet e përcaktuara me këtë ligj [...]” përcakton që: (i) “me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur me

*propozim për caktimin e masës së sigurimit, gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit; (ii) “vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni gjykata ia dërgon kundërshtarit të sigurimit menjëherë. Kundërshtari i sigurimit brenda afatit prej tre (3) ditësh në përgjigjen e tij mund t’i kontestojë shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e pas kësaj gjykata duhet të caktojë seancë në tri ditët e ardhshme. Përgjigja e kundërshtarit të sigurimit duhet të përmbajë pjesën arsyetuese”; dhe (iii) “pas mbajtjes së seancës nga paragrafi 2 e këtij neni gjykata me aktvendim të veçantë e anulon aktvendimin me të cilin e ka caktuar masën e përkohshme ose e zëvendëson me një tjetër aktvendim mbi caktimin e masës së sigurimit në pajtim me nenin 307 të këtij ligji. Kundër aktvendimit të ri për caktimin e masës së sigurimit lejohet ankimi.”*

334. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjukata thekson që vendosja e një mase të përkohshme/sigurie edhe pa njoftimin e palës është e mundur bazuar në ligjin e aplikueshëm për procedurën kontestimore, por edhe standardeve që burojnë nga e drejta e BE-së dhe Komisioni i Venecias. Thënë këtë dhe sipas sqarimeve të dhëna, një mundësi e tillë e përcaktuar në Ligjin e kontestuar, përdoret vetëm përjashtimisht dhe në plotësimin e saktë të kriterëve të përcaktuara në ligj dhe standardeve që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në kontekst të plotësimit të kriterëve të nevojshme që mundësojnë ndërhyrjen e justifikueshme dhe proporcionale në të drejtat pronësore të individit.
335. Gjukata po ashtu rithekson se procedura e gjyqësore e verifikimit të pasurisë është civile, dhe jo administrative, ndër të tjera, bazuar edhe në nenin 61 (Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera) të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se për çështjet procedurale gjyqësore të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj zbatohen përshtatshëm dispoziat e ligjit përkatës për procedurën kontestimore. Po ashtu, nga dispozitat e Ligjit të kontestuar, nuk rezulton se Byroja mund të detyrojë subjektet e verifikimit për bashkëpunim pas nxjerrjes së vendimit për fillimin e procedurës së verifikimit, pra, përveç kërkesës për informata, dhënia e së cilës është në diskrecionin e subjektit të verifikimit si palë në procedurë, rrjedhimisht, nuk cenohen të drejtat ose interesat e tij/saj në mënyrën e përcaktuar me ligj.
336. Për më tepër, Gjukata rikujton që (i) Kapitulli VI (Masa e Përkohshme dhe e Sigurimit); (ii) Kapitulli VII (Propozimi për konfiskim); (iii) Kapitulli VIII (Seanca e Shqyrtimit të Propozimit për Konfiskim); (iv) Kapitulli IX (Procedura sipas ankesës); dhe (v) Kapitulli X (Procedura sipas Mjeteve të Jashtëzakonshme Juridike) i Ligjit të kontestuar, përcaktojnë procedura të detajuara që ndërliken, ndër tjerash, me (i) mundësinë e vendosjes së masës së përkohshme dhe të sigurimit mbi pasurinë kontestuese; (ii) propozimin e konfiskimit të pasurisë dhe vendimmarrjen gjyqësore ndërlihur me të njëjtin; dhe (iii) mjetet juridike përkatëse, duke përcaktuar garancitë e nevojshme për barazinë e palëve në procedurë.

#### *Konkluzion*

337. Më saktësisht dhe në kontekst të mjetit juridik, Gjukata thekson që Ligji i kontestuar parasheh ose nuk përjashton të drejtën në mjet juridik në të gjitha fazat e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme, duke përfshirë (i) kundërshtimin e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë sipas përcaktimeve të nenit 26 të Ligjit të kontestuar; (ii) ankesën kundër aktvendimit ndërlihur me masën e sigurisë sipas përcaktimeve të nenit 28 të Ligjit të kontestuar; (iii) kundërshtimin ndaj propozimit për konfiskim sipas përcaktimeve të nenit 31 të Ligjit të kontestuar; (iv) ankesën kundër aktgjykimit sipas përcaktimeve të nenit

45 të Ligjit të kontestuar; (v) ankesën kundër aktvendimit sipas përcaktimeve të nenit 53 të Ligjit të kontestuar; si dhe (vi) mjetet e jashtëzakonshme juridike sipas përcaktimeve të nenit 55 të Ligjit të kontestuar. Për pasojë dhe bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata konsideron se, në parim, subjektet që i nënshtrohen verifikimit të pasurisë, kanë qasje në mjet juridik përgjatë gjithë procedurës. Bazuar në parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, pala duhet të jetë e njoftuar përgjatë gjithë procesit, përfshirë në kontekst të procedurave të ndjekura përkitazi me vendosjen e masave të sigurisë mbi pasurinë kontestuese, dhe që vendosja e një mase të sigurisë pa njoftimin paraprak të palës, është e mundur vetëm përjashtimisht nën garancitë e rrepta që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.

### **(c) në lidhje me parimin e sigurisë juridike**

338. Gjykata në fund vëren se ligjvënësi në paragrafin 17 të nenit 23 (Procedura në Byro) të Ligjit të kontestuar, ka paraparë se procedura e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme përcaktohet me akt nënligjor. Një formulim i tillë, i cili përcakton mundësinë e përcaktimit të procedurës së verifikimit të pasurisë në nivel të aktit nënligjor, ngërthen çështje të përputhshmërisë me kriteret e qartësisë dhe parashikueshmërisë së normës, dhe të cilat burojnë nga parimi i sundimit të ligjit, përkatësisht sigurisë juridike, të mishëruar në paragrafët 1 të neneve 3 [Barazia para Ligjit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës.
339. Lidhur me parimin e sigurisë juridike, Gjykata rikujton parimet e përgjithshme të lartcekura në këtë Aktgjykim e që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, praktika e saj gjyqësore dhe Lista Kontrolluese e Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, respektivisht në lidhje me kriterin e “përcaktueshmërisë me ligj”, “qartësisë” dhe “parashikueshmërisë” së një norme juridike.
340. Ngjashëm, Gjykata vëren se paragrafi 17 i nenit 23 të Ligjit të kontestuar nuk përcakton saktësisht se çka do të jetë objekt i përcaktimit me akt nënligjor, por vetëm në mënyrë të përgjithësuar i referohet rregullimit me akt nënligjor të procedurës së verifikimit të pasurisë së pajustificueshme.
341. Gjykata, gjithashtu rikujton Opinionin e parë të Komisionit të Venecias, ku në lidhje me këtë dispozitë ishte theksuar si në vijim: *“Nuk është e qartë se për çfarë çështjesh të mëtejme procedurale të paspecifikuara në projektligj bëhet fjalë; fushëveprimi i kësaj dispozite duhet të sqarohet. Kjo duhet t’i referohet vetëm çështjeve të procedurës së brendshme, pasi që akte të tilla nënligjore nuk mund të krijojnë detyrime për personat privatë.”* (shih, paragrafin 51 të Opinionit të Parë të Komisionit të Venecias).
342. Rrjedhimisht, marrë parasysh parimin e sigurisë juridike, përfshirë detyrimin që normat e aplikueshme të jenë të “qarta” dhe të “parashikueshme”, siç është përcaktuar në parimet e përmendura më lart dhe të përcaktuara në Listën e Kontrollit të Komisionit të Venecias për Sundimin e Ligjit, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurë duhet të jenë të përcaktuara me ligj dhe jo përmes akteve nënligjore.

## **3. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 10, 15 dhe 69 të Ligjit të kontestuar**

### **A. Thelbi i pretendimeve/argumenteve dhe kundër-argumenteve të palëve**

343. Siç është shtjelluar detajisht në pjesën e këtij Aktgjykimi që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, këta të fundit, në esencë, pretendojnë se nenet 4 (Themelimi), 10



(Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi), 15 (Procedura e Zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) dhe 69 (Funksionalizimi i Byrosë) të Ligjit të kontestuar, janë në kundërshtim me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës. Më saktësisht, parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, pretendojnë që Ligji i kontestuar e themelon Byronë si “*organ të pavarur dhe të specializuar publik*” në kundërshtim me kriteret e nenit 142 të Kushtetutës dhe Ligjin Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke argumentuar, në esencë, që (i) Byroja nuk është një institucion që i shërben Kuvendit për ushtrimin e mbikëqyrjes/kontrollit parlamentar, ngase nga aspekti i kompetencave, ka funksion prokurorial dhe rrjedhimisht, nuk mund të rregullohet jashtë kapitullit VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës; (ii) transferimi i kompetencës për mbikëqyrje të Kuvendit në një Komision Mbikëqyrës, është në kundërshtim me nenin 142 të Kushtetutës, ndërlidhur me mënyrën e funksionimit të agjencive të pavarura në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe cenon kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit, në kundërshtim me paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe për pasojë, gjithashtu cenon nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, ndërlidhur me ndarjen dhe balancimin e pushteteve; (iii) pjesëmarrja e një zëvendësi të Avokatit të Popullit në Komisionin Mbikëqyrës është në kundërshtim me kompetencat e Avokatit të Popullit, sipas përcaktimeve të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës dhe pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese; (iv) procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë, cenon kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht “*përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, sundimit të ligjit dhe kompetencës zgjedhore të Kuvendit për këtë pozitë*”; dhe (v) përcaktimi i kompetencave administrative për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsioni në mbështetje të Byrosë Shtetërore deri në funksionalizimin e saj është në kundërshtim me pavarësinë e Agjencive të pavarura sipas përcaktimeve të nenit 142 të Kushtetutës. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në esencë, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit, me theks në përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës, respektivisht përfshirjen e një zëvendësi të Avokatit të Popullit, të cilën e konsideron në kundërshtim me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës dhe Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

344. Në anën tjetër, Ministria e Drejtësisë kundër-argumenton, ndër tjerash, që (i) Byroja Shtetërore në aspektin e kompetencave ka funksion prokurorial, “*për faktin se institucioni i Prokurorit të Shtetit ka kompetencat kushtetuese të hetimit të veprave penale dhe kryerësve të veprave penale, siç, përcaktohet në nenin 109 të Kushtetutës, ndërsa, Byroja bënë verifikimin e pasurisë në aspektin civil, pa ndërhyrë në aspektin e hetimit penal*”; (ii) Byroja, si organ i themeluar nga Kuvendi, nuk cenon nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, për shkak se përmbushen elementet bazë të këtij neni, përkatësisht (a) themelimi me Ligj nga Kuvendi; (b) realizimi i funksionit të pavarur dhe pa ndikim; (c) garancitë e pavarësisë përmes buxhetit të veçantë; dhe (d) garancitë kushtetuese që organet tjera shtetërore të bashkëpunojnë dhe t’ju përgjigjen kërkesave të Byrosë; (ii) caktimi në përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës i një zëvendësi të Avokatit të Popullit duhet të kuptohet si “*ushtrim i veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit ngase zëvendësi do të shërbejë ex-officio në këtë Komision Mbikëqyrës*”, dhe rrjedhimisht, është në përputhshmëri me paragrafin 2 të neni 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; dhe (iii) kalimi i kompetencës për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm nga Kuvendi në Komisionin Mbikëqyrës, si mekanizëm de-blokimi në rast se procedura e zgjedhjes së Drejtorit dështon dy herë radhazi në Kuvend, është zgjidhje në përputhje me

rekomandimet e Komisionit të Venecias. Argumentet e Ministrisë së Drejtësisë mbështeten edhe nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!

## **B. Vlerësimi i Gjykatës**

345. Gjykata fillimisht rikujton që themelimi, statusi, kompetencat, mbikëqyrja, çështjet që ndërlidhen me Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë dhe funksionalizimi i kësaj të fundit, janë të saktësuara në kapitujt II (Themelimi, statusi juridik, kompetencat dhe organizimi i Byrosë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme), III (Mbikëqyrja e Byrosë), IV (Zgjedhja, mandati dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë) dhe XIII (Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtare) të Ligjit të kontestuar. Janë tri çështje esenciale që burojnë nga dispozitat e kapitujve të lartcekur, përkatësisht (i) statusi dhe pavarësia e Byrosë; (ii) mbikëqyrja e Byrosë dhe kompetencat e Komisionit Mbikëqyrës; dhe (iii) çështjet që ndërlidhen me Drejtorin e Përgjithshëm dhe kompetencat e tij/saj.
346. Ndërlidhur me çështjen e parë, përkatësisht statusin e Byrosë, Gjykata rikujton se bazuar në nenet 4 (Themelimi), 6 (Statusi juridik dhe struktura organizative) dhe 9 (Statusi dhe Pavarësia) të Ligjit të kontestuar, Byroja themelohet si “*organ i pavarur dhe i specializuar për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme*” dhe “*institucion publik i pavarur që ka statusin e personit juridik*”, (i) struktura organizative e të cilës përcaktohet me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, të cilën e miraton Komisioni Mbikëqyrës; dhe (ii) zyrtarët e të cilës konsiderohen zyrtarë publikë, në pajtim me Ligjin përkatës për Zyrtarët Publikë dhe gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, “*gëzojnë pavarësi të plotë dhe mbrojtje*”.
347. Ndërlidhur me çështjen e dytë, përkatësisht mbikëqyrjen e Byrosë, relevante janë nenet 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi), 11 (Mbledhja, Kuorumi dhe vendimmarrja në Komision) dhe 12 (Kompetencat e Komisionit) të Ligjit të kontestuar. Më saktësisht dhe bazuar në këto dispozita, Ligji i kontestuar themelon një Komision Mbikëqyrës të përbërë nga pesë (5) anëtarë që përfshijnë (i) një gjyqtar të Gjykatës Supreme të Kosovës, të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, i cili është edhe kryesues i Komisionit; (ii) Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës; (iii) Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; (iv) një zëvendës të Avokatit të Popullit, i caktuar nga Avokati i Popullit; dhe (v) Drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare. Ky Komision merr vendime me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij, me kushtin që të jetë plotësuar kuorumi i nevojshëm vendimmarrës, i cili përbëhet nga katër (4) anëtarë të Komisionit. Ky i fundit është përgjegjës për (i) mbikëqyrjen e punës dhe veprimtarisë së Byrosë; (ii) zhvillimin e procedurës së rekrutimit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe për t’i propozuar Kuvendit emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm; (iii) vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm; (iv) miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm; (v) shqyrtimin e raporteve të punës të Drejtorit të Përgjithshëm; si dhe (vi) kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
348. Marrë parasysh kompetencat e lartcekura të Komisionit Mbikëqyrës, përfshirë faktin që i njëjti është gjithashtu përgjegjës për (i) mbikëqyrjen e punës dhe veprimtarisë së Byrosë; dhe (ii) mbikëqyrjen e punës dhe vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm, në kontekst të kompetencave të Komisionit Mbikëqyrës, janë relevante edhe nenet 8 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Byrosë) dhe 16 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, ndërlidhur me (i) kompetencat dhe përgjegjësitë e Byrosë; dhe (ii) kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm. Më saktësisht, bazuar në nenin 8 të Ligjit të kontestuar, Byroja, ndër tjerash, ka përgjegjësi si në vijim: (i) fillimin dhe zhvillimin e procedurës për verifikimin e pasurisë; (ii) parashtrimin e

propozimit për konfiskimin e pasurisë; (iii) kërkimin e ndihmës, informacionit dhe dokumenteve relevante nga të gjitha institucionet relevante dhe personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë autorizime publike dhe analizimin e këtij dokumentacioni/informacioni; dhe (iv) raportimin Kuvendit të Kosovës një (1) herë në vit. Ndërsa, bazuar në nenin 16 të Ligjit të kontestuar, Drejtori i Përgjithshëm (i) udhëheqë dhe organizon punën e Byrosë; (ii) mbikëqyrë punën e zyrtarëve të Byrosë; (iii) përfaqëson Byronë brenda dhe jashtë vendit; (iv) menaxhon buxhetin e Byrosë dhe është përgjegjës për mënyrën e shpenzimit të tij, në pajtim me legjislacionin përkatës; (v) nxjerrë vendime konform mandatit dhe kompetencave të Byrosë; (vi) harton dhe miraton planin vjetor të punës brenda mandatit të Byrosë; (vii) lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, në pajtim me legjislacionin në fuqi; (viii) për rastet specifike dhe kur ka mungesë të ekspertizës brenda Byrosë, vendosë për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, në pajtim me legjislacionin në fuqi; dhe (ix) ushtron edhe detyra të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

349. Gjykata gjithashtu vë në pah edhe dy kompetenca të Komisionit Mbikëqyrës, të përcaktuara me nenet 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) dhe 17 (Përfundimi i mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, përkatësisht: (i) menaxhimin e konkursit për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, propozimin përkatës Kuvendit të Kosovës, dhe në rrethanat e caktuara, kur Kuvendi dështon të zgjedhë Drejtorin e Përgjithshëm, kompetencën për të zgjedhur vet Drejtorin e Përgjithshëm; dhe (ii) propozimin për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, përfshirë për shkak të (a) mospërmbushjes së detyrave dhe përgjegjësiive të punës; (b) vlerësimit të dobët të performancës; (c) shkeljes së rëndë të detyrave të punës; ose (d) cenimit të integritetit personal apo të institucionit. Gjykata në fund thekson se bazuar në paragrafin 2 të nenit 12 (Kompetencat e Kuvendit) të Ligjit të kontestuar, Komisioni nuk ka të drejtë të ndërhyjë në rastet të cilat gjenden në procedurën e verifikimit në Byro.
350. Në fund dhe ndërlidhur me çështjen e tretë, përkatësisht zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe kompetencat e tij/saj, relevante janë nenet: 13 (Drejtori i Përgjithshëm), 14 (Kriteret për Zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm), 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) dhe 17 (Përfundimi i mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, sipas të cilave e për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, (i) Byroja udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili zgjidhet për një mandat shtatë (7) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje; dhe (ii) Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet dhe shkarkohet me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë. Më saktësisht dhe në kontekst të kësaj të fundit, nenet 15 dhe 17 të Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, përcaktojnë që Komisioni Mbikëqyrës, e shpallë konkursin për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe menaxhon të gjitha aspektet e konkursit, sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar, duke përfshirë propozimin e dorëzuar Kuvendit, i cili nuk mund të përmbajë më pak se dy (2) apo më tepër se pesë (5) kandidatë të propozuar për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm. Kuvendi më pas, me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë deputeteve të pranishëm dhe që votojnë, zgjedhë Drejtorin e Përgjithshëm. Nëse Drejtori përkatës nuk zgjidhet në dy (2) raunde votimi në Kuvend, konkursi përsëritet duke e ndjekur procedurën e njëjtë, ndërsa nëse edhe pas përsëritjes së konkursit dhe pas dy (2) rraundeve të votimit në Kuvend, Drejtori përkatës nuk zgjidhet, atëherë konkursi përsëritet sërish, por kësaj radhe, kompetenca për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, kalon nga Kuvendi në kompetencën e Komisionit Mbikëqyrës. Kompetenca për shkarkimin e Drejtorit, i mbetet gjithnjë Kuvendit, por i cili vepron vetëm në bazë të propozimit të Komisionit Mbikëqyrës dhe vendosë me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë.

351. Bazuar në sqarimet e lartcekura dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe argumentet e kundër-argumentet e palëve, Gjykata vëren se janë katër çështje thelbësore që duhet të trajtohen në kontekst të kushtetutshmërisë së dispozitave të kontestuara, përkatësisht: (i) përputhshmëria e statusit të Byrosë me përcaktimet e neneve 65 dhe 142 të Kushtetutës, respektivisht; (ii) përputhshmëria e përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës me nenin 142 dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve; (iii) përputhshmëria e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm me nenin 142 të Kushtetutës; por edhe (iv) përputhshmëria e mënyrës së funksionalizimit të Byrosë me përcaktimet e nenit 142 të Kushtetutës, çështje këto të cilat Gjykata do të i trajtojë në vijim.

**(i) përputhshmëria e Statusit të Byrosë me përcaktimet e neneve 65 dhe 142 të Kushtetutës**

352. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, Kosova është Republikë demokratike, e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me Kushtetutë. Parimet që burojnë nga neni i lartcekur i Kushtetutës, përkatësisht ndarja dhe ndërveprimi i pushteteve, si vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, Gjykata i ka shtjelluar, ndër viteve, përmes aktgjykimeve që përfshijnë, por nuk kufizohen në (i) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO73/16](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata e kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO73/16); (ii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO171/18](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata e kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO171/18); (iii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO203/19](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO203/19); (iv) Aktgjykimin në rastin [KO219/19](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO219/19); (v) Aktgjykimin në rastin [KO127/21](#), me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-29 të Kuvendit të Republikës së Kosovës të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO127/21); (vi) Aktgjykimin në rastin e Gjykatës [KO100/22 dhe KO101/22](#), me parashtrues të kërkesës KO100/22, *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*; dhe të kërkesës KO101/22, *Arben Gashi dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO100/22 dhe KO101/22); (vii) Aktgjykimin në rastin e Gjykatës [KO216/22 dhe KO220/22](#), me parashtrues të kërkesës KO216/22, *Isak Shabani dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*; dhe të kërkesës KO220/22, *Arben Gashi dhe 9 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, kishte vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO216/22 dhe KO220/22); dhe (viii) Aktgjykimin në rastin e Gjykatës [KO79/23](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, lidhur me vlerësimin e vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO79/23).

353. Në rrethanat e rastit konkret, relevante janë parimet që ndërlidhen me (i) kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit; dhe (ii) agjencitë e pavarura.
354. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata rikujton që bazuar në nenin 4 të Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ, ndërsa bazuar në nenin 65 të Kushtetutës, ndër të tjerash, Kuvendi i Republikës së Kosovës, (i) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme; (ii) mbikëqyrë punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit; dhe (iii) vendosë për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj. Për më tepër, bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, Kuvendi, themelon Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës, në bazë të ligjeve përkatëse të miratuara sipas paragrafit 1 të nenit 65 të Kushtetutës.
355. Më saktësisht, bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës (i) janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre; (ii) kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës; (iii) kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj; dhe (iv) secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'ju përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligjin.
356. Gjykata rikujton që neni 142 është pjesë e Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës, por për dallim nga institucionet tjera kushtetuese të përcaktuara në kapitullin e lartcekur dhe të cilat janë të themeluara me Kushtetutë, Agjencitë e Pavarura të përcaktuara përmes nenit 142 të Kushtetutës, themelohen përmes ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Më saktësisht, kapitulli i XII i Kushtetutës, themelon (i) Avokatin e Popullit; (ii) Auditorin e Përgjithshëm; (iii) Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; (iv) Bankën Qendrore të Kosovës; dhe (v) Komisionin e Pavarur të Medieve, si institucione të pavarura kushtetuese, ndërsa i delegon Kuvendin kompetencën për të themeluar agjenci të pavarura kushtetuese përmes nenit 142 të Kushtetutës, nën kriteret e përcaktuara në të. Dallimin dhe/ose raportin në mes institucioneve të pavarura dhe agjencive të pavarura, Gjykata e ka trajtuar edhe përmes praktikës së saj gjyqësore, përfshirë përmes Aktgjykimit në rastin KO203/19, përmes të cilit ka sqaruar që Agjencitë e Pavarura, megjithëse themelohen bazuar në nenin 142 të Kushtetutës që përfshihet në Kapitullin XII të Kushtetutës, nuk kanë statusin e njëjtë me atë të institucioneve të pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kjo pasi themelimi, roli dhe statusi i institucioneve të pavarura kushtetuese është i rregulluar qartë me Kapitullin XII të Kushtetutës, ndërsa Agjencitë e Pavarura “*janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilët rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre*”. Pra, për dallim nga fakti që Kuvendi mund të krijojë dhe të shuajë “*me ligj*” Agjenci të Pavarura, Kuvendi nuk mund të shuajë asnjëherë “*me ligj*” ndonjë nga pesë institucionet e pavarura të lartpërmendura (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO203/19, paragrafi 117).
357. Për më tepër dhe në kontekst të raportit në mes të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, përkatësisht kompetencës mbikëqyrëse të Kuvendit, Gjykata thekson që paragrafi 9 i nenit 65 të Kushtetutës, përcakton që Kuvendi mbikëqyr (i) punën e Qeverisë; dhe (ii) të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit. Në kontekst të institucioneve publike, rrjedhimisht, Kuvendi ushtron kompetencën mbikëqyrëse ndaj atyre institucioneve që i raportojnë Kuvendit në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve. Neni 142 i Kushtetutës, në anën tjetër, në kontekst të Agjencive të Pavarura, nuk përcakton që të njëjtat i raportojnë

Kuvendit dhe rrjedhimisht, as nuk përcakton kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit në raport me to, duke përcaktuar vetëm që është në kompetencë të Kuvendit që përmes ligjeve të miratuara bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës, të përcaktojë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Prandaj, bazuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës, për atë që detyrimi për t'i raportuar Kuvendit nuk është përcaktuar me Kushtetutë, Kuvendi ka kompetencën për të përcaktuar vetë detyrimin e raportimit të institucionit përkatës dhe rrjedhimisht edhe kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit, përmes ligjeve të miratuara nga vet Kuvendi.

358. Në kontekst të Byrosë, Gjykata rikujton që e njëjta është themeluar si institucion i pavarur, përkatësisht agjenci e pavarur në kontekst të nenit 142 të Kushtetutës. E njëjta (i) është themeluar përmes ligjit të miratuar të Kuvendit sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 142 të Kushtetutës; (ii) ka pavarësi në kontekst të administrimit të buxhetit të saj, sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të nenit 142 të Kushtetutës; dhe (iii) është pajisur me autoritetin sipas të cilit, secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'ju përgjigjet kërkesave të saj gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj, sipas përcaktimeve të paragrafit 3 të nenit 142 të Kushtetutës. Marrë parasysh që neni 142 i Kushtetutës nuk përcakton detyrimin e raportimit të Agjencive të Pavarura Kuvendit dhe as kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit ndaj tyre, duke e lënë këtë çështje për t'u rregulluar në nivel ligji, përmes Ligjit të kontestuar, Kuvendi i ka përcaktuar kompetencën e mbikëqyrjes së Byrosë Komisionit Mbikëqyrës të saktësuar përmes nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dh Kompensimi) të Ligjit të kontestuar.
359. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu i referohet Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, i cili në nenin 38 (Themelimi i Agjencive të Pavarura) të tij, përcakton që (i) Agjencitë e Pavarura themelohen me ligj në bazë të nenit 142 të Kushtetutës; (ii) një agjenci e pavarur mund të themelohet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, për të kryer kompetenca, që së bashku plotësojnë këto kushte: (a) nuk janë pjesë e kompetencave të pushtetit ekzekutiv të Qeverisë sipas Kushtetutës, dhe (b) i shërbejnë Kuvendit për ushtrimin e mbikëqyrjes/kontrollit parlamentar të specializuar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative; dhe (iii) ligji për themelimin e një agjencie të pavarur rregullon organizimin, funksionimin dhe kompetencat e agjencisë së pavarur.
360. Gjykata vëren se neni 38 i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në parim, përfshinë mbikëqyrjen dhe kontrollin parlamentar të specializuar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative, në frymën e paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës. Megjithatë, paragrafi 1 i nenit 43 (Mbikëqyrja dhe performanca e agjencive të pavarura) i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, përcakton që: *“Përveç kur parashihet ndryshe me ligj, agjencitë e pavarura i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.”* Rrjedhimisht dhe marrë parasysh ndërveprimin e dispozitave kushtetuese, përfshirë dispozitat e lartcekura Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, rezulton që Kuvendi, mund të përjashtojë mbikëqyrjen dhe kontrollin parlamentar, përmes ligjit të miratuar nga ana e tij. Ky është rasti ndërlidhur me Ligjin e kontestuar, përmes të cilit, Kuvendi, (i) mbikëqyrjen e një institucioni/agjencie të pavarur, e ka përcaktuar në kompetencë të një Komisioni Mbikëqyrës, të themeluar sipas përcaktimeve të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar; megjithatë, (ii) ka përcaktuar detyrimin e Byrosë t'i raportojë Kuvendit një (1) herë në vit, përfshirë të drejtën e këtij të

fundit për të kërkuar raporte më të shpeshta; dhe (iii) ka përcaktuar kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur dhe shkarkuar Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë, bazuar në propozimin e Komisionit Mbikëqyrës.

#### *Konkluzion*

361. Për pasojë dhe bazuar në sqarimet e dhëna si më lart, Gjykata konstaton që (i) Byroja është institucion/agjenci e pavarur e themeluar me ligj, ashtu siç përcaktohet me nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës; dhe (ii) paragrafi 9 i nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës ndërlidhur me nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, i përcaktojnë Kuvendit kompetencën që përmes miratimit të ligjit përkatës, të rregullojnë çështjen e raportimit dhe/ose mbikëqyrjes së Kuvendit në raport me Agjencinë e Pavarur përkatëse, përfshirë mundësinë e përjashtimit të kompetencës mbikëqyrëse të Kuvendit nëse ashtu përcakton vet Kuvendi sipas miratimit të ligjit përkatës bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës.

#### ***(ii) përputhshmëria e përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës me nenin 142 dhe ndarjen dhe ndërveprimin e pushteteve***

362. Gjykata rikujton që Ligji i kontestuar, funksionin mbikëqyrës të Byrosë, ia ka përcaktuar një Komisioni Mbikëqyrës të saktësuar përmes nenit 10 të Ligjit të kontestuar. Siç është sqaruar më lart, përkundër faktit që funksioni mbikëqyrës i një institucioni/agjencie të pavarur, në parim, ushtrohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, paragrafi 9 i nenit 65 të Kushtetutës, neni 142 i Kushtetutës dhe Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, përjashtimisht, mundësojnë që funksioni mbikëqyrës të ushtrohet nga një mekanizëm tjetër sipas përcaktimeve të vet Kuvendit, bazuar në ligjet e miratuara përmes paragrafit 1 të nenit 65 të Kushtetutës.

363. Në kontekst të Byrosë, ky funksion i është përcaktuar një Komisioni të përbërë nga (i) një gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, i caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, i cili është edhe kryesues i Komisionit; (ii) Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës; (iii) Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; (iv) një zëvendës i Avokatit të Popullit, i caktuar nga Avokati i Popullit; dhe (v) Drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare. Kompetencat mbikëqyrëse të tij, siç është shtjelluar më lart, janë saktësuar në nenin 12 (Kompetencat e Komisionit) të Ligjit të kontestuar, ndërsa janë gjithashtu të ndërlidhura me kompetencat e vet Byrosë, të saktësuara në nenin 8 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Byrosë) dhe kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm, të saktësuara në nenin 16 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar.

364. Gjykata gjithashtu duhet të rikujtojë që ashtu siç është shtjelluar në pjesën e këtij Aktgjykimi që ndërlidhet me faktet dhe procedurën e miratimit të Ligjit të kontestuar, Komisioni i Venecias, ka miratuar dy (2) Opinione ndërlidhur me përmbajtjen e drafteve përkatëse të Ligjit të kontestuar, përmes të cilave gjithashtu ka trajtuar mënyrën dhe mekanizmin e mbikëqyrjes së Byrosë.

365. Në Opinionin e parë, Komisioni i Venecias, shqyrtoi projektligjin në të cilin funksioni i mbikëqyrjes së Byrosë, ishte paraparë të ushtrohej nga një Komision i Kuvendit. Në këtë drejtim dhe ndër tjerash, Komisioni i Venecias ngriti çështjen e kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me rolin thelbësor të kompetencave të Komisionit Mbikëqyrës të Kuvendit në zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm (paragrafi 38 i Opinionit të Parë). Në këtë drejtim dhe ndër të tjerash, Komisioni vuri në dukje që (i) këto procedura parashohin një

sistem shumë të politizuar të zgjedhjes, pa paraqitur nevojën për ndonjë kontribut teknik të jashtëm; dhe gjithashtu theksoi se (ii) “*garanci të forta rreth pavarësisë do të jenë të nevojshme për t’i mundësuar Byrosë t’i rezistojë çdo presioni të mundshëm politik*”. Në këtë drejtim dhe në lidhje me zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, Komisioni i Venecias rekomandoi përfshirjen e konsultimit të detyrueshëm të ekspertëve të pavarur në këtë proces, duke vënë në dukje se “*do të ishte e këshillueshme që Drejtori i Përgjithshëm ose të zgjedhet nga një komision i jashtëm i përbërë nga institucione dhe ekspertë të pavarur, ose që kandidatët të për zgjidhen nga një komision i tillë i pavarur dhe t’i propozohen Kuvendit për votim*” (paragrafi 39 i Opinionit të Parë). Një rekomandim i ngjashëm ishte dhënë edhe lidhur me procedurën e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm (paragrafi 40 i Opinionit të Parë). Në fund, po ashtu u vu në dukje se “*Krijimi i një organi drejtues kolegjal dhe pluralist të Byrosë, anëtarët e të cilit mund të delegohen nga institucione të pavarura, mund të jetë një alternativë tjetër.*” (paragrafi 39 i Opinionit të Parë).

366. Gjithashtu, i njëjti Opinioni vuri në dukje se “*përderisa mbikëqyrja e duhur e Byrosë është qartazi e nevojshme, duke pasur parasysh se Komisioni Mbikëqyrës është organ i vete Kuvendit, projektligji përfaqëson një shkallë të fortë të kontrollit politik nga politikanët mbi Byronë*”, dhe se “*është gjithashtu e diskutueshme nëse roli i rëndësishëm i Komisionit Mbikëqyrës është në përputhje me përkufizimin e Byrosë si organ i “pavarur” (neni 4)*”, prandaj Komisioni i Venecias rekomandoi që kjo strukturë institucionale të rishikohet. Në këtë drejtim, Opinioni vuri në dukje se përderisa “*Byroja duhet t’i përgjigjet Kuvendit deri në një masë*”, por “*duhet të përcaktohet qartë se kjo është e kufizuar për sa i përket raportimit*”, duke rekomanduar gjithashtu që “*vlerësimi i performancës, me pasoja të mundshme për karrierën e Drejtorit të Përgjithshëm, duhet të përjashtohet; nëse konsiderohet e nevojshme, një vlerësim i tillë duhet t’i besohet një komisioni të pavarur ekspertësh.*” (paragrafi 42 i Opinionit të Parë).
367. Në anën tjetër, në Opinionin e dytë, Komisioni i Venecias shqyrtoi versionin e ri të projektligjit, në të cilin funksioni mbikëqyrës i Byrosë, ishte paraparë të ushtrohej nga një Komision Mbikëqyrës. Opinioni i Dytë theksoi se sa i përket përbërjes së re të Komisionit Mbikëqyrës, “*kjo duket të jetë një zgjidhje e përshtatshme.*” (paragrafi 15 i Opinionit të Dytë). Gjithashtu, shtoi se (i) “*përbërja e organit të ri të propozuar në projektligj ofron një garanci më të mirë për pavarësi, pasi të gjithë anëtarët e Komisionit vijnë nga jashtë sferës politike*” (paragrafi 15 i Opinionit të dytë); dhe (ii) “*përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe roli i tij në përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, ndër të tjerash, përbëjnë një përmirësim të dukshëm në krahasim me draftin e mëparshëm.*” (paragrafi 18 i Opinionit të Dytë).
368. Bazuar në vlerësimet e Komisionit të Venecias në dy Opinionet e lartcekura, Gjykata vëren se, në parim, funksioni mbikëqyrës i Kuvendit ishte trajtuar në kontekst të zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe kompetencave të tij në udhëheqjen e Byrosë, duke rekomanduar përfshirjen e ekspertëve të pavarur në zgjedhjen përkatëse. Thënë këtë, duke theksuar që një rol mbikëqyrës i Kuvendit do të mund të ishte i nevojshëm, Komisioni i Venecias gjithashtu kishte rekomanduar si alternativë krijimin e një mekanizimi të pavarur, anëtarët e të cilit do të delegoheshin nga institucionet e pavarura.
369. Komisioni i Venecias, çështjen e ushtrimit të funksionit mbikëqyrës, e kishte trajtuar edhe në Opinionin e tij ndërlidhur me projektligjin për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme të Bullgarisë. Në mënyrë të vazhdueshme, Komisioni i Venecias, kishte vënë theks në dy çështje, përkatësisht (i) që Komisioni përkatës do të duhej të mbikëqyrej nga Asambleja Nacionale, në kuptim të mbikëqyrjes së përgjithshme të funksionimit të



Komisionit përkatës; dhe (ii) që zgjedhja e anëtarëve përkatës të Komisionit të bëhet me dy të tretat (2/3) e Asamblesë Nacionale dhe pa marrë parasysh që Kushtetuta përcaktonte që vendimet në Asambleshë përkatëse merren me shumicë të thjeshtë, duke përfshirë nëse është e nevojshme me kushtin e ndryshimeve kushtetuese (shih, paragrafët 16, 17, 18, 19, 21 dhe 62 të Opinionit CDL-AD(2011)023 dhe gjithashtu Opinionet CDL(2011)036, CDL(2010)103, CDL-AD (2010)019, CDL(2010)041, CDL-AD(2010)010 dhe CDL(2010)027).

370. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata rithekson që përderisa bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, Kuvendi ka kompetencën e plotë për të rregulluar themelimin, funksionimin dhe kompetencat e Agjencive të Pavarura përfshirë mënyrën e mbikëqyrjes së tyre dhe rrjedhimisht, edhe të Byrosë, themelimi, funksionimi dhe kompetencat e saj, duhet të jenë në përputhje edhe me dispozitat tjera kushtetuese. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe argumenteve dhe kundër-argumenteve të palëve para Gjykatës në këtë rast, kontestuese para Gjykatës është nëse përbërja e Komisionit Mbikëqyrës është në përputhje me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve të saktësuara me nenin 4 të Kushtetutës. Marrë parasysh përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës, përkatësisht pjesëmarrjen e (i) një gjyqtari të Gjykatës Supreme të Kosovës, i caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, i cili është edhe kryesues i Komisionit; (ii) Auditorit të Përgjithshëm i Republikës së Kosovës; (iii) Drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; (iv) një zëvendësi të Avokatit të Popullit, të caktuar nga Avokati i Popullit; dhe (v) Drejtorit të Njësisë së Inteligjencës Financiare, rezulton të jetë kontestuese pjesëmarrja e (i) zëvendësit të Avokatit të Popullit; (ii) Auditorit të Përgjithshëm; dhe (iii) Gjykatës Supreme, kompetencat, funksionet, përfshirë papajtueshmëria e funksioneve përkatëse, janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
371. Në rrethana të tilla, dhe duke pasur parasysh konstatimin e mësipërm që bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, Kuvendi përmes ligjeve përkatëse mund edhe të përcaktoj/delegoj mbikëqyrjen përmes mekanizmave të përcaktuar me ligj, megjithatë marrë parasysh përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës sipas përcaktimeve të nenit 10 të Ligjit të kontestuar, duhet të vlerësohet nëse i njëjti është në përputhje me (i) funksionin dhe kompetencat kushtetuese të Avokatit të Popullit, siç janë saktësuar në nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; (ii) funksionin dhe kompetencat kushtetuese të Auditorit të Përgjithshëm, siç janë saktësuar në nenet 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës; dhe (iii) papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit, siç është saktësuar në nenin 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës. Vlerësimi i përputhshmërisë/pajtueshmërisë së funksioneve të tyre si anëtarë të Komisionit Mbikëqyrës dhe funksioneve dhe kompetencave kushtetuese siç janë saktësuar në nenet e lartcekura të Kushtetutës, duhet të bëhet gjithashtu duke marrë parasysh vetë kompetencat e Komisionit Mbikëqyrës, siç janë të përcaktuara në nenin 12 (Kompetencat e Komisionit) të Ligjit të kontestuar, por që ndërliidhen edhe me kompetencat e Byrosë të saktësuara në nenin 8 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Byrosë) dhe kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të saktësuara në nenin 16 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar.
372. Bazuar në sqarimet e lartcekura, dhe duke ritheksuar që (i) bazuar në nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës, kjo e fundit është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës, me të cilën duhet të jenë në pajtim ligjet dhe aktet e tjera juridike dhe nga e cila buron pushteti qeverisës; dhe (ii) Kushtetuta përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës dhe se normat e parapara me Kushtetutë, duhet të lexohen dhe interpretohen në

ndërlidhje me njëra tjetrën dhe bazuar në vlerat kushtetuese të Republikës së Kosovës, përfshirë ndarjen dhe balancimin e pushteteve, Gjykata duke vënë gjithashtu theks në faktin që përbërja e Komisionit Mbikëqyrës duhet të sigurojë pavarësinë e Byrosë në ushtrimin e kompetencave të saj të përcaktuara me ligj, njëkohësisht duke respektuar dhe mos cenuar pajtueshmërinë e funksioneve kushtetuese të anëtarëve të tij, në vijim do të vlerësojë (a) pajtueshmërinë e funksionit të Avokatit të Popullit, përkatësisht zëvendësit të Avokatit të Popullit, si anëtar i Komisionit Mbikëqyrës me rolin dhe kompetencat e tij/saj të përcaktuara në nenin 132 të Kushtetutës; (b) pajtueshmërinë e funksionit të Auditorit të Përgjithshëm si anëtar i Komisionit Mbikëqyrës me rolin dhe kompetencat e tij/saj të përcaktuara në nenet 136 dhe 137 të Kushtetutës, respektivisht; dhe (c) pajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit si anëtar i Komisionit Mbikëqyrës me rolin në raport me kufizimet që përcakton neni 106 të Kushtetutës, që saktëson papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit.

### **(a) Zëvendës Avokati i Popullit**

373. Në kontekst të përfshirjes së një zëvendësi të Avokatit të Popullit në Komisionin Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, Gjykata rikujton që Opinioni i dytë i Komisionit të Venecias, e kishte vlerësuar përbërjen e propozuar të Komisionit të lartcekur, si një zgjidhje *”të përshtatshme”* dhe një *“garanci më të mirë për pavarësinë e Komisionit duke marrë parasysh që të gjithë anëtarët e tij vijnë nga jashtë fushës politike”* (shih, paragrafët 15 dhe 16 të Opinionit të dytë), përkundër faktit që nuk ishte trajtuar pjesëmarrja e Zëvendës Avokatit të Popullit në Komisionin Mbikëqyrës dhe as papajtueshmëria e funksioneve kushtetuese të Institucionit të Avokatit të Popullit, respektivisht, zëvendës Avokatit të Popullit në raport me kompetencat e Byrosë Shtetërore të përcaktuara në Ligjin e kontestuar në veçanti. Gjykata gjithashtu rikujton që në Opinionin e parë të Komisionit të Venecias ndërlidhur me vlerësimin e projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Komisioni i Venecias, kishte marrë edhe Avokatin e Popullit si një shembull të një institucioni që mund të jetë i përfaqësuar në këshillat prokurorial (shih, Opinionin Nr. 1063/2021, [CDL-AD\(2021\)051](#) mbi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, miratuar në seancën plenare të 129-të të Komisionit të Venecias, 10-11 dhjetor 2021, paragrafi 32), megjithatë në Opinionin e dytë të Komisionit të Venecias lidhur me projektligjin e lartcekur, Komisioni gjithashtu kishte tërhequr vëmendjen që *“është e rëndësishme që përfshirja e Avokatit të Popullit të mos e dëmtojë aftësinë e tij ose të saj që të bëjë përcaktime të pavarura lidhur me çështjet që ndërlidhen me KPK-në”* (shih, Opinioni CDL-AD(2022)006, paragrafi 12).
374. Për më tepër, Komisioni i Venecias, kishte trajtuar papajtueshmërinë e funksionit të Avokatit të Popullit me kryerjen e funksioneve tjera të caktuara publike edhe në të paktën dy opinione tjera, siç është paraqitur në Përmbledhjen e Opinioneve të Komisionit të Venecias lidhur me rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në këtë kontekst, Komisioni i Venecias, ndër tjerash, kishte theksuar që *“funksioni i Avokatit Publik është i papajtueshëm me kryerjen e një funksioni tjetër publik dhe profesioni ose me të qenë anëtar i një partie politike. Funksioni i Avokatit Publik nuk duhet të jetë në përputhje me një funksion apo profesion tjetër, publik ose private, as me përkatësi të partive politike apo sindikatave. Ai përfundimisht mund të jetë i pajtueshëm me ligjërata, por edhe në atë rast veprimtaria duhet të ushtrohet pa kompensim.”* (shih, Përmbledhjen CDL-PI(2022)22, fq. 13). Gjithashtu, Komisioni i Venecias kishte theksuar se *“[...] hartuesit mund të mendojnë të lejojnë Avokatin e Popullit [dhe] zëvendësit e tij ose të saj të ndjekin veprimtaritë mësimdhënëse. Megjithatë do të ishte e preferueshme që lista e funksioneve publike, të cilat nuk mund të ushtrohen nga një Avokat i Popullit, të zëvendësohej me një dispozitë më gjithëpërfshirëse që thekson se Avokati i Popullit nuk do të ushtrojë asnjë funksion që është*

*i papajtueshëm me kryerjen e mirëfilltë të detyrave të tij/saj zyrtare ose me paanshmërinë e tij/saj dhe besimin e publikut në to.” (shih, po aty).*

375. Përtej sqarimeve të lartcekura, Gjykata rikujton që rolin e Avokatit të Popullit në rendin juridik të Republikës së Kosovës, ajo e ka trajtuar, ndër vite, në një numër aktgjykimesh, përfshirë por pa u kufizuar në Aktgjykimet e Gjykatës, në rastet [KO29/12 dhe KO48/12](#), [KO73/16](#), [KO171/18](#), [KO203/19](#), [KO219/19](#) dhe [KO 79/23](#). Ndërsa, specifikisht, çështjen e përfshirjes së Avokatit të Popullit në institucione tjera të Republikës së Kosovës, e ka trajtuar në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, përmes Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO100/22 dhe KO101/22 (shih, Aktgjykimi në rastin KO100/22 dhe KO101/22, paragrafët 239-267). Më saktësisht dhe në kontekst të rolit të Avokatit të Popullit për të “*caktuar/emëruar*” një anëtar jo-prokuror të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Gjykata kishte konstatuar shkelje të paragrafit 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafit 10 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës. Në këtë Aktgjykim, Gjykata, ndër të tjerash, kishte vënë në pah, që kushtetutshmëria e Ligjit të kontestuar, në kontekst të përcaktimit të kompetencës së Avokatit të Popullit, për të “*caktuar/zgjedhur*” një anëtar jo-prokuror në Këshillin Prokurorial të Kosovës, duhet të vlerësohet në kontekst të (i) paragrafit 10 të nenit 65 të Kushtetutës, sipas të cilit e ndër tjerash, Kuvendi zgjedh anëtarët e Këshillit Prokurorial; (ii) kompetencave kushtetuese të Kuvendit për të zgjedhur bartësit e funksioneve të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në Kapitujt VII dhe XII të Kushtetutës, respektivisht; dhe (iii) nenit 132 të Kushtetutës, sipas të cilit, dhe ndër tjerash, Avokati i Popullit, ka kompetenca për të mbikëqyrur të gjitha autoritetet publike, përfshirë Këshillin Prokurorial, në kontekst të veprimeve e mosveprimeve të paligjshme lidhur me të drejtat dhe liritë themelore. Përderisa, (i) dy çështjet e para nuk ndërliidhen me rrethanat e rastit konkret, sepse përderisa Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur kushtetues dhe i rregulluar në nivel kushtetute, përkatësisht kapitullin VII të saj, ndërsa vetë Kushtetuta ka saktësuar kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur anëtarët e Këshillit Prokurorial, Byroja Shtetërore themelohet përmes ligjit të miratuar nga Kuvendi si Agjenci e Pavarur, (ii) çështja e tretë, përkatësisht kompetenca mbikëqyrëse e Avokatit të Popullit në kontekst të të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës siç është përcaktuar në nenin 132 të Kushtetutës, është relevante edhe në rrethanat e rastit konkret.
376. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht rikujton që roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit janë të saktësuar me nenet 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 133 [Zyra e Avokatit të Popullit], 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] dhe 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës. Bazuar në dispozitat e lartcekura dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Avokati i Popullit, në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, ka katër (4) karakteristika kyçe. Së pari, mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Së dyti, është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Së treti, çdo organ, institucion ose autoritet tjetër që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj. Ndërsa, së katërti, Avokati i Popullit (i) paraqet para Kuvendit të Republikës së Kosovës raport vjetor; (ii) ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore; dhe (iii) ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.

377. Gjykata vëren që kontestuese në rrethanat e rastit konkret është papajtueshmëria e funksionit të zëvendës Avokatit të Popullit me funksionin në një institucion tjetër shtetëror, përkatësisht anëtarin e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore. Në kontekstin e lartcekur, është e rëndësishme të përcaktohet (i) roli i Zëvendës Avokatit të Popullit në Institucionin e Avokatit të Popullit; dhe (ii) pajtueshmëria e funksioneve paralele shtetërore, përkatësisht funksionit të Avokatit të Popullit dhe anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, vlerësim ky që duhet të bëhet në kontekst të kompetencave dhe funksioneve të Avokatit të Popullit dhe kompetencave dhe funksioneve të anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, respektivisht.
378. Në kontekst të rolit të zëvendës Avokatit të Popullit në Institucionin e Avokatit të Popullit, Gjykata thekson që zëvendës Avokati i Popullit është kategori kushtetuese i saktësuar në (i) nenin 133 [Zyra e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, në kontekst të Zyrës së Avokatit të Popullit; dhe (ii) nenin 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, në kontekst të kualifikimit, zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit. Më tej dhe sipas nenit 133 [Zyra e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i zëvendës Avokatëve të Popullit, rregullohet me Ligjin për Avokatin e Popullit. Ky i fundit, në nenin 5 (Përbërja e Institucionit të Avokatit të Popullit) të tij, përcakton që institucioni i Avokatit të Popullit, përbëhet nga (i) Avokati i Popullit; (ii) pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit; dhe (iii) personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit. Neni 10 (Procedura për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të popullit) i Ligjit për Avokatin e Popullit, saktëson që zëvendësit e Avokatit të Popullit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, pas propozimit të Avokati i Popullit në bazë të konkurrencës së hapur dhe transparente. Në anën tjetër, neni 13 (Shkarkimi nga funksioni i Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj) i Ligjit për Avokatin e Popullit, saktëson që Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj mund të shkarkohen për shkak të (i) paaftësisë fizike apo mendore që shkakton pamundësinë e tij për kryerjen e funksioneve të tij; (ii) kryerjes së veprës penale të dënueshme me legjislacionin e Republikës së Kosovës me gjashtë (6) apo më tepër muaj burgim në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë; dhe (iii) kryerjes së veprimeve në kundërshtim me nën-paragrafin 5 të paragrafit 1 të nenit 6 dhe paragrafi 2 të nenit 7 të këtij ligji, përkatësisht (a) ushtrimit të funksionit në parti politike, deputetit në legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e zgjedhë atë apo anëtarit të kabinetit qeveritar dhe (b) pjesëmarrjes në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare. Sipas përcaktimeve të nenit të lartcekur, zëvendës Avokatin e Popullit e shkarkon Kuvendi, me votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit, pas kërkesës së Avokatit të Popullit. Gjykata gjithashtu vëren që bazuar në nenin 14 (Përfundimi i funksionit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj) të Ligjit për Avokatin e Popullit, në rast mungese, vdekje, paaftësie të përhershme ose të përkohshme, dorëheqjes ose shkarkimit, Avokati i Popullit zëvendësohet nga zëvendësi kryesor apo zëvendësit e tjerë.
379. Gjykata vëren që Kushtetuta dhe Ligji për Avokatin e Popullit, nuk saktësojnë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisive në mes të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj. Thënë këtë, Gjykata thekson që në kontekst të papajtueshmërisë së funksioneve përkatëse, Kushtetuta nuk bën dallimin në mes Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj. Më saktësisht, përderisa nenet kushtetuese që rregullojnë statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit jo detyrimisht i referohen edhe zëvendës Avokatëve, e vetmja dispozitë kushtetuese që trajton në mënyrë identike Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e tij/saj, është pikërisht ajo që ndërlidhet me papajtueshmërinë e funksionit. Ky është paragrafi 3 i nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës dhe i cili

barazon dhe/ose trajton në mënyrë identike Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e tij/saj, duke përcaktuar që të njëjtit nuk mund të (i) jenë anëtarë të asnjë partie politike; (ii) as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale; dhe (iii) as të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare. Më tej, Ligji për Avokatin e Popullit, gjithashtu trajton Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e tij/saj në mënyrë identike në kontekst të papajtueshmërisë së funksioneve. Më saktësisht, neni 7 (Papajtueshmëria) i Ligjit për Avokatin e Popullit, përcakton që Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj (i) nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike e as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale; (ii) nuk marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare; (iii) nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë; ndërsa (iv) mund të merren me veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre dhe me legjislacionin në fuqi. Për më tepër, është gjithashtu me rëndësi të theksohet që dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit, të cilat saktësojnë bazat e shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe/ose zëvendësve të tij, përcaktojnë edhe papajtueshmërinë e funksionit si një ndër arsyet mbi bazën e të cilës mund të iniciohet shkarkimi i Avokatit të Popullit dhe/ose zëvendësve të tij/saj.

380. Në kontekstin e lartcekur, dhe duke marrë parasysh që në kontekst të papajtueshmërisë së funksionit, Kushtetuta dhe Ligji për Avokatin e Popullit, trajtojnë Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e tij/saj në mënyrë identike, Gjykata nuk mund të bëjë dallimin e pajtueshmërisë së funksionit në mes Avokatit të Popullit dhe/ose zëvendësve të tij/saj. Kushtetuta përcakton që rregullat e njëjta ndërlidhur me papajtueshmërinë e funksioneve vlejné si për Avokatin e Popullit ashtu edhe për zëvendësit e tij/saj dhe për pasojë, Gjykata në vijim, do të vlerësojë pajtueshmërinë e funksionit të zëvendës Avokatit të Popullit dhe funksionit paralel të anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, duke marrë parasysh kompetencat kushtetuese të Avokatit të Popullit siç janë të përcaktuara në dispozitat e lartcekura kushtetuese.
381. Në këtë kontekst, Gjykata përsërit dispozitën kushtetuese e cila përcakton papajtueshmërinë e funksionit të Avokatit të Popullit dhe sipas të cilës, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Avokati i Popullit dhe zëvendësit e saj/tij nuk mund të ushtrojnë veprimtari tjera shtetërore. Bazuar në këtë dispozitë kushtetuese, Gjykata duhet të vlerësojë (i) nëse ushtrimi i funksioneve në institucione tjera shtetërore mund të kualifikohet si ushtrim i veprimtarisë tjetër shtetërore për qëllime të papajtueshmërisë së funksionit sipas përcaktimeve të nenit 134 të Kushtetutës; dhe (ii) nëse ushtrimi i një veprimtarie të tillë, cenon kompetencën e Avokatit të Popullit për të mbikëqyrur dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, sipas përcaktimeve të nenit 132 të Kushtetutës.
382. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata vëren që ushtrimi i funksionit në një institucion shtetëror, funksion ky i cili është i plotë, përfshirë pa kufizime në kontekst të periudhës kohore përgjatë të cilit ushtrohet, më përjashtim të faktit që ndërlidhet me mandatin e vet zëvendës Avokatit përkatës të Popullit, nuk mund të mos kualifikohet si ushtrim i veprimtarisë shtetërore. Megjithatë, Gjykata vëren që ushtrimi i një veprimtarie të tillë, është përcaktuar përmes Ligjit të kontestuar, ndërsa sipas paragrafit 5 të nenit 7 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit mund të ushtrojë funksione tjera me autorizim të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Bazuar në dispozitën e lartcekur, nuk është kontestuese që Kuvendi përmes ligjeve, mund të caktojë funksione dhe kompetenca shtesë për Avokatin e Popullit dhe/ose zëvendësit e tij/saj. Kjo, për aq sa, ashtu siç është theksuar edhe përmes

Opinioneve të lartcekura të Komisionit të Venecias, funksionet dhe/ose kompetenca të tilla, nuk cenojnë dhe/ose kufizojnë pavarësinë e Avokatit të Popullit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese të tij. Në rrethanat e rastit konkret, për pasojë, duhet të vlerësohet nëse ushtrimi i funksioneve paralele të Avokatit të Popullit, në kontekst të kompetencave të tij, është i pajtueshëm me ushtrimin e funksionit të anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, në kontekst të kompetencave të këtij anëtar.

383. Gjykata rikthekson kompetencën kushtetuese esenciale të Avokatit të Popullit për të mbikëqyr dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Autoritet publik në Republikën e Kosovës është edhe Byroja Shtetërore, dhe rrjedhimisht Avokati i Popullit ka kompetencën kushtetuese për të mbikëqyrur Byronë Shtetërore, përkatësisht veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të saj që mund të cenojnë të drejta dhe liri individuale.
384. Kompetencat mbikëqyrëse të Avokatit të Popullit janë më tej të saktësuara në Ligjin për Avokatin e Popullit dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, bazuar në nenet 16 (Kompetencat) dhe 18 (Përgjegjësitë) të Ligjit për Avokatin të Popullit, përfshijnë kompetenca/përgjegjësi (i) për të t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pretendimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me KEDNJ, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit; (ii) të bëjë hetime, qoftë për t'ju përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (*ex officio*), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve, janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; (iii) të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme, të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla; dhe (iv) të ndërmarr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas paragrafit 1 të nenit 16 të Ligjit për Avokatin e Popullit, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme të caktuar nga Avokati i Popullit.
385. Gjykata vëren që paralelisht me ushtrimin e kompetencave të lartcekura, rrjedhimisht kompetencën për të mbikëqyrur Byronë Shtetërore, ndër tjerash, në kontekst të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individëve, përkatësisht subjekteve të verifikimit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të saj, zëvendës Avokati i Popullit, përcaktohet gjithashtu si anëtarë i Komisionit Mbikëqyrës të vet Byrosë Shtetërore, dhe në këtë rol, bazuar në Ligjin e kontestuar, ndër tjerash, është përgjegjës për vendimmarrjen ndërlidhur me (i) mbikëqyrjen e punës dhe veprimtarisë së Byrosë; (ii) zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe propozimin Kuvendit lidhur me emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm; (iii) vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm; (iv) miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm; dhe (v) shqyrtimin e raporteve të punës së Drejtorit të Përgjithshëm. Për më tepër, këto kompetenca të anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës, përfshirë zëvendës Avokatin e Popullit, duhet gjithashtu të trajtohen edhe në kontekst të kompetencave dhe përgjegjësisë të Byrosë Shtetërore, dhe të cilat, ndër tjerash, përfshijnë (i) fillimin dhe zhvillimin e procedurës për verifikimin e pasurisë, për përcaktimin nëse pasuria e personit zyrtar është pasuri e pajustificueshme; dhe (ii) parashtrimin e propozimit për konfiskim të pasurisë në gjykatën përkatëse.

386. Ky funksion, përkatësisht roli vendimmarrës dhe mbikëqyrës në një institucion shtetëror që, ndër tjerash, do të jetë përgjegjës për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme dhe propozimin për konfiskimin e saj në procedurë civile, e cila, përfshirë sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të shtjelluar në këtë Aktgjykim, por edhe Raportit të Këshillit të Evropës për Konfiskimin Civil, ngërthen çështje thelbësore kushtetuese, përfshirë në balancimin në mes interesit publik dhe të drejtave dhe lirive themelore, ngritë çështje serioze të pajtueshmërisë me mandatin kushtetues të Avokatit të Popullit për të mbikëqyrur dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, përfshirë të vet Byrosë Shtetërore. Në fakt, ushtrimi i kompetencës mbikëqyrëse të Avokatit të Popullit sipas përcaktimeve të nenit 132 të Kushtetutës, do të përfshinte një autoritet publik vendimmarrja e së cilit është bërë me pjesëmarrjen e vet Avokatit të Popullit, përkatësisht zëvendësit të tij/saj.
387. Në këtë kontekst, Gjykata thekson që vendimmarrja e zëvendës Avokatit të Popullit, përkatësisht Zyrës së Avokatit të Popullit, në ushtrimin e kompetencave të Byrosë Shtetërore, do të cenonte detyrat kushtetuese të Avokatit të Popullit, për të (i) mbikëqyrur dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, përfshirë veprimet ose mosveprimet e Byrosë, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 132 të Kushtetutës; (ii) bërë rekomandime dhe për të propozuar masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore, përfshirë ndaj Byrosë, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; dhe (iii) për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit, përfshirë në kontekst të hetimit të ankesave të pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pretendimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit, përfshirë nga ana e Byrosë.
388. Gjykata rikujton që është pikërisht kompetenca kushtetuese “mbikëqyrëse” e Avokatit të Popullit në kontekst të të drejtave dhe lirive themelore dhe detyrimi i çdo organi, institucioni ose autoriteti tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, për t’ju përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit dhe për t’i paraqitur atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj siç është përcaktuar në nenin 132 të Kushtetutës, që ka rezultuar edhe në dispozitën vijuese kushtetuese, referuar papajtueshmërisë së funksionit të tij/saj me, ndër tjera, ushtrimin e çdo veprimtarie tjetër shtetërore, sipas përcaktimeve të nenit 134 të Kushtetutës.
389. Bazuar në shtjellimin si më sipër, përkatësisht dispozitave të Ligjit të kontestuar që ndërlidhen me kompetencat e Komisionit Mbikëqyrës dhe marrë për bazë normat kushtetuese që përcaktojnë rolin dhe kompetencat, përfshirë mbikëqyrëse të Avokatit të Popullit ndaj të gjitha autoriteteve publike në kontekst të të drejtave dhe lirive themelore dhe standardet ndërkombëtare që i referohen pavarësisë së funksionit të Avokatit të Popullit, rezulton që përcaktimi i Ligjit të kontestuar për të përfshirë njërin nga zëvendësit e Avokatit të Popullit, të caktuar nga vetë ky i fundit, në Komisionin Mbikëqyrës të Byrosë, i pamundëson të njëjtit që të ushtrojë në mënyrë të pavarur rolin kushtetues të mbikëqyrjes së të drejtave dhe lirive themelore në raport me funksionin dhe kompetencat e Byrosë Shtetërore.

## Konkluzion

390. Rrjedhimisht, marrë parasysh (i) nenin 16 të Kushtetutës, bazuar në të cilin Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Republikën e Kosovës dhe sipas të cilit ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutë; (ii) nenin 134 të Kushtetutës dhe i cili trajton Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e saj/tij në mënyrë identike në kontekst të kriterëve për papajtueshmërinë e funksionit të tyre; (iii) nenet 132, 134 dhe 135 të Kushtetutës, ndërlidhur me kompetencat kushtetuese të Avokatit të Popullit, përfshirë funksionin e tij mbikëqyrës ndaj autoriteteve publike, përkatësisht edhe ndaj vet Byronë Shtetërore, Gjykata konstaton që roli i zëvendësit të Avokatit të Popullit, përkatësisht Zyrës së Avokatit të Popullit, si anëtar i Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë, përcaktuar përmes pikës 1.4 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe paragrafin 3 të nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës.

### **(b) Auditori i Përgjithshëm**

391. Në kontekst të përfshirjes së Auditorit të Përgjithshëm në Komisionin Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, Gjykata rikujton që Opinioni i dytë i Komisionit të Venecias, e kishte vlerësuar përbërjen e propozuar të Komisionit të lartcekur, si një zgjidhje *”të përshtatshme”* dhe një *“garanci më të mirë për pavarësinë e Komisionit duke marrë parasysh që të gjithë anëtarët e tij vijnë nga jashtë fushës politike”* (shih, paragrafët 15 dhe 16 të Opinionit të dytë), përkundër faktit që nuk ishte trajtuar pjesëmarrja e Auditorit të Përgjithshëm në Komisionin Mbikëqyrës dhe as papajtueshmëria e funksioneve kushtetuese të Auditorit të Përgjithshëm në raport me kompetencat e Byrosë Shtetërore të përcaktuara në Ligjin e kontestuar, në veçanti. Megjithatë, në lidhje me caktimin *ex lege* të anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës, përfshirë edhe Auditorin e Përgjithshëm, kishte specifikuar se: *“duke qenë se edhe Auditori i Përgjithshëm është anëtar, kjo i përgjigjet vërejtjes se Komisionit të Venecias se Auditori i Përgjithshëm duhet të përfshihet në kontrollin e buxhetit të Byrosë.”* (shih, paragrafin 15 të Opinionit të dytë).
392. Thënë këtë, nuk është kontestuese që çdo institucion i Republikës së Kosovës, përfshirë Byronë Shtetërore, i nënshtrohet kontrollit të Auditorit të Përgjithshëm. Një çështje e tillë është e përcaktuar me Kushtetutë, përkatësisht përmes nenit 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës, përmes të cilit, ndër tjerash, saktësohet që Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon (i) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë; dhe (ii) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal. Rrjedhimisht, kompetenca e Auditorit të Përgjithshëm për të kontrolluar veprimtarinë e autoriteteve publike dhe përdorimin e fondeve publike, nuk varet nga përcaktimet e ligjeve dhe as përbërja e trupave vendimmarrëse, sepse është çështje që është e rregulluar në nivel të Kushtetutës dhe e cila, aplikohet për të gjitha autoritetet publike në Republikën e Kosovës, pa përjashtim.
393. Për më tepër, Gjykata rikujton që rolin e Auditorit të Përgjithshëm në rendin juridik të Republikës së Kosovës, ajo e ka trajtuar, ndër vite, nga një numër aktgjykimesh të Gjykatës, përfshirë por duke mos u kufizuar në Aktgjykimet e Gjykatës, në rastet KO29/12 dhe KO48/12, KO73/16, KO171/18, KO203/19, KO219/19 dhe [KO 79/23](#).



394. Përtej parimeve të saktësuar në aktgjykimet e lartcekura, Gjykata gjithashtu rikujton që roli dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm janë të saktësuar me nenin 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] dhe 138 [Raportimi i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës.
395. Bazuar në dispozitat e lartcekura dhe për atë që është relevante në rrethanat e rastit konkret, Auditori i Përgjithshëm, në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, ka tri (3) karakteristika kyçe. Së pari, është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Kosovës. Së dyti, kontrollon (i) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë; dhe (ii) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal. Ndërsa, së treti, Kuvendit i paraqet (i) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit; (ii) mendimin për raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar paraparak, para se të miratohet nga Kuvendi; dhe (iii) informacione për rezultatet e kontroleve, sa herë që i kërkohet nga Kuvendi.
396. Në anën tjetër, kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm janë më tej të saktësuar në Ligjin nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm. Për atë që është relevante në rrethanat e rastit konkret, bazuar në nenin 4 (Auditori i Përgjithshëm) të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm, (i) Auditori i Përgjithshëm është i pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative dhe nuk i nënshtrohet urdhrimit ose ndikimit nga cilindo person apo institucion tjetër; dhe (ii) pozita e Auditorit të Përgjithshëm është punë me orar të plotë dhe i njëjti nuk mund të jetë i punësuar me pagesë në ndonjë vend tjetër pune gjatë kohës gjersa shërben si Auditor i Përgjithshëm. Për më tepër, bazuar në paragrafin 5 të nenit 9 (Menaxhmenti) të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm, Auditori i Përgjithshëm dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, nuk mund të marrin pjesë në, apo të marrin ndonjë vendim për, auditimin e institucionit në të cilin kanë qenë anëtarë të menaxhmentit gjatë tre (3) viteve të mëparshme. Në fund dhe për qëllime të ushtrimit të pavarur të aktiviteteve të lartcekura, neni 17 (Mospërputhshmëritë) i Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm, ndër tjerash, përcakton që punonjësit e Auditorit të Përgjithshëm, nuk ushtrojnë funksione apo aktivitete, ose mbajnë pozita, të cilat përbëjnë konflikt interesi me detyrat e zyrtare dhe nuk mbajnë ndonjë funksion tjetër në cilindo nivel të sektorit publik.
397. Për më tepër, bazuar në nenin 18 (Mandati i auditimit) të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm, Zyra Kombëtare e Auditimit (i) ka të drejtë t'i auditojë të gjitha aktivitetet financiare, administrative dhe të tjera, programe dhe projekte të menaxhuara nga një apo më shumë institucione; dhe (ii) është e obliguar që në baza vjetore të kryej auditimin e detyrueshëm të rregullsisë të të gjitha organizatave buxhetore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë pranuar një buxhet përmes Ligjit vjetor të Buxhetit dhe janë të obliguara të hartojnë Pasqyra Vjetore Financiare. Më tej dhe bazuar në nenin 25 (E drejta për të mbledhur informata) të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm, Auditori i Përgjithshëm (i) mund të hyjë dhe të qëndrojë në çdo kohë të arsyeshme në institucion ose në entitet që i nënshtrohet auditimit; (ii) ka qasje të lirë dhe të plotë të auditojë, në çdo kohë të arsyeshme, prona ose dokumente qoftë në letër qoftë në formë elektronike; dhe (iii) mund të ekzaminojë, bëjë kopje, ose të marrë ekstrakte nga çdo dokument.
398. Në kontekst të sqarimeve të lartcekura ndërlidhur me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Auditorit të Përgjithshëm, Gjykata vëren që kontestuese në rrethanat e rastit konkret, është nëse roli i Auditorit të Përgjithshëm në Komisionin Mbikëqyrës të Byrosë, të themeluar nga Kuvendi sipas përcaktimeve të nenit 142 të Kushtetutës, është në pajtueshmëri me funksionin dhe kompetencat e tij, siç janë përcaktuar në nenin 136 të Kushtetutës. Gjykata thekson që pajtueshmëria në mes kompetencave dhe funksioneve

kushtetuese të Auditorit të Përgjithshëm dhe rolit të këtij të fundit në Komisionin Mbikëqyrës të Byrosë, duhet të vlerësohet edhe në kontekst të kompetencave të Komisionit të lartcekur.

399. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që bazuar në nenin 12 (Kompetencat e Komisionit) të Ligjit të kontestuar, Komisioni Mbikëqyrës, anëtar i të cilit është edhe Auditori i Përgjithshëm, ndër tjerash, është përgjegjës për (i) zhvillimin e procedurës dhe propozimin tek Kuvendi për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm; (ii) vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm; dhe (iii) shqyrtimin e raporteve të punës të Drejtorit të Përgjithshëm. Gjykata rikujton që bazuar në nenin 16 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, Drejtori i Përgjithshëm, performanca e të cilit mbikëqyret dhe vlerësohet nga Komisioni Mbikëqyrës, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm, ndër tjerash, menaxhon buxhetin e Byrosë dhe është përgjegjës për mënyrën e shpenzimit të tij, në pajtim me legjislacionin përkatës.
400. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata vëren që roli i Auditorit të Përgjithshëm në mbikëqyrjen dhe vendimmarrjen përkitazi me funksionet e Byrosë Shtetërore, përfshirë në kontekst të vlerësimit të Drejtorit të Përgjithshëm ndërlidhur me menaxhimin dhe mënyrën e shpenzimit të buxhetit të Byrosë, ngritë çështje thelbësore kushtetuese ndërlidhur me ushtrimin e funksionit të pavarur kushtetues të Auditorit të Përgjithshëm në kontekst të kontrollit ekonomik dhe financiar të të gjitha institucioneve publike në Republikën e Kosovës, përfshirë vetë Byronë Shtetërore.
401. Në këtë kontekst, Gjykata thekson që vendimmarrja e Auditorit të Përgjithshëm në cilësinë e anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës ndërlidhur me çështjet buxhetore të Byrosë, do të cenonte detyrën kushtetuese të Auditorit të Përgjithshëm për të kontrolluar veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë, përfshirë Byronë, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 137 të Kushtetutës. Gjykata rikujton që është pikërisht roli i Auditorit të Përgjithshëm si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Kosovës, siç është përcaktuar në nenin 136 të Kushtetutës, që ka rezultuar edhe në dispozitat e saktësuara me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm, dhe sipas të cilave, punonjësit e Auditorit të Përgjithshëm, nuk mund të mbajnë ndonjë funksion tjetër në cilindo nivel të sektorit publik.
402. Bazuar në shtjellimin e lartcekur, përkatësisht të dispozitave të Ligjit të kontestuar që ndërlidhen me kompetencat e Komisionit Mbikëqyrës dhe marrë për bazë normat kushtetuese që përcaktojnë rolin dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm, rezulton që përcaktimi i Ligjit të kontestuar për të përfshirë Auditorin e Përgjithshëm në Komisionin Mbikëqyrës, i pamundëson të njëjtit që të ushtrojë në mënyrë të pavarur rolin kushtetues të kontrollit të pavarur ekonomik dhe financiar të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfshirë të Byrosë Shtetërore.

### *Konkluzion*

403. Prandaj, marrë parasysh (i) nenin 16 të Kushtetutës, bazuar në të cilin Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Republikën e Kosovës dhe sipas të cilit ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutë; dhe (ii) nenet 136 të Kushtetutës, ndërlidhur me kompetencat kushtetuese të Auditorit të Përgjithshëm, përfshirë funksionin mbikëqyrës financiar ndaj autoriteteve publike, përkatësisht edhe ndaj vetë Byronë Shtetërore, Gjykata konstaton që roli i Auditorit të Përgjithshëm, si anëtar i Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, përcaktuar përmes pikës 1.2 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe

Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] të Kushtetutës.

### **(c) Gjyqtari i Gjykatës Supreme**

404. Në kontekst të përfshirjes së një gjyqtari të Gjykatës Supreme të Kosovës të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, në cilësi të kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, Gjykata rikujton që Opinioni i dytë i Komisionit të Venecias, e kishte vlerësuar përbërjen e propozuar të Komisionit të lartcekur, si një zgjidhje “*të përshtatshme*” dhe një “*garanci më të mirë për pavarësinë e Komisionit duke marrë parasysh që të gjithë anëtarët e tij vijnë nga jashtë fushës politike*” (shih, paragrafët 15 dhe 16 të Opinionit të dytë), përkundër faktit që nuk ishte trajtuar pjesëmarrja e gjyqtarit të Gjykatës Supreme në cilësinë e kryesuesit në Komisionin Mbikëqyrës dhe as papajtueshmëria e funksioneve kushtetuese të gjyqtarit në raport me kompetencat e Byrosë Shtetërore të përcaktuara në Ligjin e kontestuar në veçanti.
405. Thënë këtë, Gjykata rikujton që rolin pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe gjyqtarëve në rendin juridik të Republikës së Kosovës, Gjykata e ka trajtuar, ndër vite, nga një numër aktgjykimesh të Gjykatës, përfshirë por duke mos u kufizuar në Aktgjykimet e Gjykatës, në rastet KO29/12 dhe KO48/12, KO73/16, KO171/18, KO203/19, KO219/19, KO100/22 dhe KO101/22, KO55/23 dhe [KO 79/23](#). Në kontekst të normave kushtetuese si dhe parimeve që burojnë nga praktika e lartcekur gjyqësore, kontestuese në rrethanat e rastit konkret, është nëse roli dhe pjesëmarrja e një gjyqtari të Gjykatës Supreme në Komisionin Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, të themeluar nga Kuvendi sipas përcaktimeve të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, është në pajtueshmëri me funksionin dhe kompetencat e një gjyqtari sipas përcaktimeve të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës.
406. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat, ndërsa sipas nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, ndër tjerash, (i) pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat; (ii) pushteti gjyqësor është unik, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata; dhe (iii) gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Për më tepër, bazuar në (i) nenin 103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave] të Kushtetutës, saktësohet që Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor; ndërsa (ii) nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve dhe siguron pavarësinë dhe paanshësinë e sistemit gjyqësor. Në fund, Gjykata rikujton nenin 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës, bazuar në të cilin, (i) gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj; dhe (ii) gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanshësisë së rolit të gjyqtarit.
407. Gjykata gjithashtu vë në pah se përmbajtja e paragrafit 1 të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës në versionin e gjuhës serbe ndryshon nga përmbajtja e versionit në gjuhën shqipe, pasi që në versionin e gjuhës serbe mungon togfjalëshi “*jashtë gjyqësorit*” pas fjalisë “*Gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore, [...]*”. Në këtë kontekst, Gjykata sqaron se në analizën e mëposhtme, ka marrë për bazë përmbajtjen e kësaj

dispozite të Kushtetutës në versionin shqip, duke qenë se përmbajtja e paragrafit 1 të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës në gjuhën shqipe është identike edhe me versionin e së njëjtës në gjuhën angleze të Kushtetutës.

408. Gjykata thekson që bazuar në nenin 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës, është përcaktuar papajtueshmëria me funksionin e gjyqtarit dhe në paragrafin e parë të tij është qartësuar specifikisht që gjyqtari (i) nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit; (ii) të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik; ose (iii) të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj. Ndërsa në paragrafin e dytë të tij, është qartësuar që gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit.
409. Gjykata më tej thekson që papajtueshmëria e funksionit të gjyqtarit me funksione tjera është specifikuar më tej, përmes Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, dhe cili përcakton në mënyrë të detajuar se në çfarë veprimtari/aktivitete mund të përfshihen gjyqtarët. Në këtë kuptim, neni 38 (Veprimtaritë profesionale) i Ligjit për Gjykatat përcakton që (i) gjyqtarët me aprovimin paraprak të Këshillit, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve; (ii) gjyqtarët me aprovimin e Kryetarëve të Gjykatave dhe Kryetarët me aprovim të Këshillit, vetëm jashtë orarit të punës, mund të marrin pjesë në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe Sjelljen profesionale të gjyqtarëve; (iii) në pajtim me dispozitat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve, gjyqtarët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve gjyqësore gjatë apo pas përfundimit të funksionit gjyqësor, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor, të lëshuar nga Këshilli; dhe (iv) gjyqtarët, për aktivitetet e parapara në këtë nen pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej 25% (njëzetepesë për qind) të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim gjyqtarët e njoftojnë Kryetarin e Gjykatës kurse Kryetarët e Gjykatave e njoftojnë Këshillin.
410. Gjykata gjithashtu vëren që Ligji për Gjykatat udhëzon tek Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarë (Nr. 01/238, i 17 gushtit 2016), dhe i cili, ndër tjerash, përcakton që: *“Gjyqtari, vetëm me vendim të Këshillit dhe pas orarit të punës, mund të marrë pjesë në aktivitete të cilat nuk ndërlidhen me funksionin e tij gjyqësor nëse këto aktivitete jo-gjyqësore nuk e vënë në pikëpyetje efikasitetin, performancën si dhe ushtrimin e rregullt dhe të drejtë të funksionit të gjyqtarit. Angazhimet e tilla brenda orarit të punës nuk janë të lejuara, me përjashtimin të rasteve kur me ligje të posaçme me qellim të funksionimit të sistemit, parashihen edhe angazhime gjatë orarit të punës, p.sh: mbajtja e ligjëratave në IGJK për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, pastaj marrja pjesë nëpër komisione për hartimin e draft ligjeve. Për qëllime të këtij rregulli, aktivitetet jo-gjyqësor nënkupton aktivitetet ku gjyqtari mund të flasë, shkruajë, ligjërojë dhe të marrë pjesë në aktivitete shkencore dhe profesionale të ndërlidhura me ligjin, sistemin juridik dhe administrimin e drejtësisë.”*
411. Në kontekstin e lartcekur, është e qartë që bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, gjyqtarët në parim, janë të lejuar që të marrin pjesë në veprimtari shkencore, akademike, përfshirë pjesëmarrjen në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve, me kushtin e aprovimit paraprak të Këshillit ose Kryetarëve të Gjykatave dhe që për këto aktivitete, mund të pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej 25% (njëzetepesë për qind) të pagës bazë, me kushtin që është njoftuar Këshilli dhe Kryetarët e Gjykatave. Thënë këtë, në

rrethanat e rastit konkret, kontestuese është nëse funksioni i një gjyqtari është i pajtueshëm me kryesimin e një institucioni tjetër të pavarur shtetërore, përkatësisht Byronë Shtetërore.

412. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që janë dy specifika të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës dhe të cilat duhet të vlerësohen në kontekst të pajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Supreme dhe funksionit paralel të të njëjtit në cilësi të kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore. E para, ndërlidhet me paragrafin e parë të nenit 106 të Kushtetutës dhe sipas të cilit, gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore “*jashtë gjyqësorit*” dhe për pasojë, ngërthen detyrimin e vlerësimit nëse Byroja Shtetërore është institucion shtetëror “*jashtë gjyqësorit*” ose brenda fushëveprimit të tij. Ndërsa e dyta, ndërlidhet me paragrafin e dytë të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës dhe sipas të cilit, gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit dhe që për pasojë, ngërthen detyrimin e vlerësimit nëse ushtrimi i funksionit në Komisionin Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, marrë parasysh natyrën dhe kompetencat e Byrosë të përcaktuara në Ligjin e kontestuar, mund të jetë në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit.
413. Për këtë qëllim dhe në vijim, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do t’u referohet (i) parimeve dhe standardeve ndërkombëtare që ndërlidhen me pavarësinë dhe paanshmërinë e funksionit të gjyqtarit dhe papajtueshmërinë e ushtrimit të funksioneve tjera jashtë sistemit gjyqësor, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në Parimet Bangalore të miratuara në nivel të Kombeve të Bashkuara, rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, opinionet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian dhe Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias; (ii) analizës krahasimore të Kushtetutave në kontekst të rregullimit të papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit me funksione tjera shtetërore; dhe (iii) praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese ndërlidhur me interpretimin e papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit.
- *Parimet që ndërlidhen me papajtueshmërinë e funksionit në nivel të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës*
414. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata u referohet *Parimeve Bangalore* ndërlidhur me sjelljen e gjyqësorit të miratuara në nivel të Kombeve të Bashkuara, dhe të cilat, ndër tjerash, saktësojnë që (i) “*parimi i pavarësisë gjyqësore është parakusht për sundimin e ligjit dhe garanci themelore për gjykim të drejtë. Prandaj, gjyqtari duhet të mbështesë dhe të japë shembullin e pavarësisë gjyqësore si në aspektin individual ashtu edhe në atë institucional*” (Vlera 1 (Pavarësia e Parimeve)); (ii) “*paanshmëria është thelbësore për kryerjen e detyrës gjyqësore*” (Vlera 2 (Paanshmëria) e Parimeve)); dhe (iii) “*një gjyqtar duhet që veprimtarinë profesionale të gjyqtarit t’ia kushtojë detyrave gjyqësore, të cilat përfshijnë jo vetëm kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi gjyqësore në gjykatë dhe marrjen e vendimeve, por edhe detyra të tjera që lidhen me funksionin gjyqësor ose veprimtarinë e gjykatës*” (Vlera 6 (Kompetenca dhe kujdesi)).
415. Më tej, Gjykata vëren që sipas Rekomandimit [CM/REC \(2010\)12](#) për gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësia, i miratuar më 17 nëntor 2010 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, përcaktohet që: “*gjyqtarët mund të angazhohen në aktivitete jashtë funksioneve të tyre zyrtare. Për të shmangur konfliktet aktuale ose të perceptuara të interesit, pjesëmarrja e tyre duhet të kufizohet në aktivitete që përputhen me*

paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre.” (shih, pikën 21 të Rekomandimit). Përderisa Memorandumi shpjegues i këtij rekomandimi specifikon që: “[...] Çdo shtet anëtar duhet të përcaktojë se cilat aktivitete janë të papajtueshme me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve. Për shembull, janë identifikuar aktivitete të papajtueshme, si mandati elektoral, profesioni i avokatit, përmbaruesit, noterit, funksionet kishtarë ose ushtarake, ushtrimi i disa funksioneve gjyqësore, etj. Duke pasur parasysh domosdoshmërinë e shmangies së konflikteve aktuale ose të perceptuara të interesit Shtetet anëtare mund të marrin në konsideratë vënien në dispozicion të informacionit për publikun mbi aktivitetet shtesë, për shembull në formën e regjistrave të interesave. Për më tepër, për të siguruar që gjyqtarët të kenë kohë për të kryer funksionin e tyre parësor, domethënë të gjykojnë, duhet të kufizohet pluraliteti i mandateve në komisione të ndryshme dhe rastet në të cilat ligji parashikon që gjyqtarët të marrin pjesë në një komision, këshill etj., duhet të jetë i kufizuar.” (shih, paragrafin 29 të Memorandumit). Në anën tjetër, Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) (2002) për “Pavarësinë dhe aktivitetet tjera profesionale të gjyqtarëve”, i 19 nëntorit 2002, ka specifikuar që “natyra specifike e funksionit gjyqësor dhe nevoja për të ruajtur dinjitetin e zyrës dhe për të mbrojtur gjyqtarët nga të gjitha llojet e presioneve do të thotë se gjyqtarët duhet të sillen në mënyrë të tillë që të shmangin konfliktet e interesit apo abuzimet me pushtetin. Kjo kërkon që gjyqtarët të përmbahen nga çdo veprimtari profesionale që mund t'i largojë ata nga përgjegjësitë e tyre gjyqësore ose t'i bëjë ata t'i ushtrojnë këto përgjegjësi në mënyrë të pjesshme. Në disa shtete, papajtueshmëritë me funksionin e gjyqtarit përcaktohen qartë nga statuti i gjyqtarëve dhe anëtarëve të gjyqësorit u ndalohet të kryejnë ndonjë aktivitet profesional apo të paguar. Përjashtime bëhen për veprimtari arsimore, kërkimore, shkencore, letrare apo artistike.” (shih, pikën 27 të Opinioneve).

416. Gjykata gjithashtu i referohet Raportit [[CDL-AD \(2010\)004](#)] të Komisionit të Venecias për pavarësinë e sistemit gjyqësor, Pjesa e parë: pavarësia e gjyqtarëve, i miratuar më 12-13 mars 2010, i cili përveç parimeve që ndërliidhen me emërimin e gjyqtarëve, kriterëve për emërimin e tyre dhe kompensimin, përfshinë edhe të drejtën e tyre për të ushtruar apo jo funksion tjetër jashtë sistemit gjyqësor. Thënë këtë, ky Raport, ndër tjerash i referohet edhe [Opinionit nr. 1 \(2001\)](#) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, i miratuar më 23 nëntor 2001, i cili në paragrafin 161 si rezultat i rekomandimeve të [Kartës Evropiane](#) për Statusin e Gjyqtarëve (i Këshillit të Evropës, i 8-10 korrikut 2010), specifikon që “parimet fundamentale të statutit të gjyqtarëve janë të përcaktuara në norma të brendshme të nivelit më të lartë, dhe të rregullave dhe normave të së paku nivelit legjislativ.” Kjo qasje përmes këtij raporti është miratuar edhe nga ana e Komisionit të Venecias (paragrafi 22 i Raportit [CDL-AD \(2010\)004](#)), përmes të cilit specifikohet që parimet bazë të pavarësisë së gjyqësorit duhet që të përcaktohen me Kushtetutë apo tekste ekuivalente. Në vijim të kësaj, po në këtë raport, Komisioni i Venecias thekson se: “Për më tepër, gjyqtarët nuk duhet që të vënë veten e tyre në atë pozitë kur pavarësia ose paanshmëria e tyre mund të vihet në pikëpyetje. Kjo justifikon rregullat vendore për papajtueshmërinë e funksionit gjyqësor me funksione të tjera dhe kjo është arsye që shumë vende kufizojnë edhe aktivitetet politike.” (paragrafi 62 i Raportit [CDL-AD \(2010\)004](#)).
417. Bazuar në parimet e lartcekura, në parim, rezulton që (i) pavarësia dhe paanshmëria e funksionit të gjyqtarit dhe gjykatave, kërkon që të përcaktohen kufizime në kuptim të papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit me funksione dhe aktivitete tjera; (ii) gjyqtarët mund të angazhohen në aktivitete jashtë funksioneve të tyre zyrtare, por për të shmangur konfliktet aktuale ose të perceptuara të interesit, pjesëmarrja e tyre duhet të kufizohet në aktivitete që përputhen me paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre; dhe (iii) për të siguruar që gjyqtarët të kenë kohë për të kryer funksionin e tyre parësor, domethënë të gjykojnë, duhet

të kufizohet pluraliteti i mandateve në komisione të ndryshme dhe rastet në të cilat ligji parashikon që gjyqtarët të marrin pjesë në një komision, këshill etj., duhet të jetë i kufizuar.

- *Papajtueshmëria e funksionit të gjyqtarit sipas Kushtetutave të vendeve tjera*

418. Gjykata thekson që çështja e papajtueshmërisë së funksionit me funksione dhe/ose veprimtari tjera, është çështje esenciale që ndërlidhen me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve si dhe pavarësinë e paanësinë e gjyqtarit dhe pushtetit gjyqësor. Për pasojë, shumica e Kushtetutave të vendeve tjera këtë çështje e rregullojnë në nivel të Kushtetutës, me raste duke specifikuar detajet e mëtejme përmes ligjeve të aplikueshme. Shembuj të Kushtetutave që rregullojnë papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit me funksione dhe/ose aktivitete tjera, përfshijnë, ndër tjerash, si në vijim (i) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 143 të saj, përcakton që të qenet gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit; (ii) Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut, në nenin 111 dhe amendamentet XXVII dhe XXVIII të saj, ndër të tjera, përcakton që një funksion gjyqësor është i papajtueshëm me anëtarësinë në parti politike ose ndonjë funksion publik ose profesion sipas përcaktimeve të ligjit; (iii) Kushtetuta e Malit të Zi, në nenin 123 të saj, përcakton që një gjyqtar nuk mund të ushtroj funksionin në Parlament dhe detyra tjera publike ose që profesionalisht të ushtrojë ndonjë aktivitet tjetër; (iv) Kushtetuta e Sllovenisë, në nenin 133 të saj, përcakton që funksioni gjyqësor nuk është i pajtueshëm me detyra në organe tjera shtetërore, në nivel lokal dhe parti politike si dhe me funksione dhe aktivitete tjera sipas përcaktimeve të ligjit; (v) Kushtetuta e Kroacisë, në nenin 120 të saj, ndër të tjera, përcakton që një gjyqtar nuk mund të mbajë një pozitë ose të ushtroj veprimtari e cila sipas ligjit është e papajtueshme me funksionin e gjyqtarit; (vi) Kushtetuta e Republikës së Rumanisë, në nenin 125 të saj, përcakton që pozita e gjyqtarit është e papajtueshme me çdo funksion tjetër publik ose privat, me përjashtim të pozitave mësimdhënëse në edukimin e lartë; (vii) Kushtetuta e Polonisë, në nenin 178 të saj, ndër tjera, përcakton që gjyqtarët nuk mund të jenë pjesë e partive politike, sindikatave ose të ushtrojnë aktivitete që janë të papajtueshme me parimet e pavarësisë së gjyqtarëve dhe gjykatave; (viii) Kushtetuta e Çekisë, në nenin 82 të saj, ndër të tjera, përcakton që funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me funksionin e Presidentit të Republikës, anëtarit të Kuvendit dhe çdo funksion tjetër në administratën publike; ligji do të specifikojë aktivitete tjera të cilat janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit; (ix) Kushtetuta e Ukrainës, në nenin 127 të saj, ndër të tjera, përcakton që, gjyqtarët nuk mund të jenë pjesë e partive politike, organizatave, marrin pjesë në ndonjë aktivitet politik, mbajnë mandate përfaqësuese, mbajnë çfarë funksioni tjetër me pagesë, dhe të përfshihen në çfarëdo pune tjetër me pagesë, përpos aktiviteteve akademike, mësimdhënëse dhe kreative; (x) Kushtetuta e Portugalisë, në nenin 216 të saj, ndër të tjera, përcakton, që (a) gjyqtarët nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion tjetër privat ose publik, përpos mësimdhënien dhe hulumtimet pa pagesë sipas përcaktimeve në ligj; (b) gjyqtarët në detyrë nuk mund të emërohen në funksione gjyqësore që nuk janë të ndërlidhura me funksionin e gjykatave pa autorizimin paraprak të Këshillit Suprem; dhe (c) ligji mund të përcaktojë papajtueshmëri tjera lidhur me të ushtroarit e funksionit gjyqësor; ndërsa (xi) Kushtetuta e Belgjikës, në nenin 155 të saj, ndër të tjera, përcakton që një gjyqtar nuk mund të pranojë një pozitë nga Qeveria dhe e cila kompensohet, përpos nëse një pozicion i tillë ushtrohet pa pagesë, dhe edhe atëherë, një pozitë e tillë nuk mund të jetë e papajtueshme me funksionin e gjyqtarit sipas përcaktimeve të ligjit.

419. Gjykata vëren që bazuar në rregullimet e lartcekura kushtetuese rezulton që (i) një numër Kushtetutash përcaktimet e papajtueshmërisë së funksionit i kanë të kategorizuara në nivel të Kushtetutës, ndërsa një pjesë e delegojnë përcaktueshmërinë e specifikave të papajtueshmërisë së funksionit edhe në nivel të ligjit; (ii) në parim, aktivitetet që janë të ndërlidhura me mësimdhënien dhe veprimtarinë shkencore dhe akademike janë të lejuara; (iii) një pjesë e Kushtetutave e përcaktojnë ndalesën e të ushtruarit të çdo funksioni tjetër në organet tjera shtetërore, por duke u referuar në përcaktimet e ligjeve të aplikueshme; ndërsa, (iv) një pjesë tjetër, përfshirë Kushtetutën e Shqipërisë dhe Portugalisë, mundësojnë ushtrimin e funksioneve bazuar në delegimin pranë institucioneve të drejtësisë sipas përcaktimeve të ligjit ose emërimin në funksione gjyqësore që nuk janë të ndërlidhura me funksionin e gjykatave, vetëm me autorizimin paraprak të Këshillit Suprem.

• *Praktika gjyqësore e Gjykatave tjera Kushtetuese*

420. Çështjen e papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit me detyra tjera në institucione shtetërore, e kanë vlerësuar edhe një numër Gjykatës Kushtetuese, përfshirë (i) Gjykatën Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë; (ii) Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut; (iii) Gjykatën Kushtetuese të Armenisë; dhe (iv) Gjykatën Kushtetuese të Republikës Çeke.

421. Fillimisht, Gjykata i referohet Vendimit [Nr. 14], të 22 majit 2006 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese vlerësoi kushtetutshmërinë e dispozitave të një ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përmes të cilit, ndër tjerash, propozohet që gjyqtarët e emëruar nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (tani me emërtimin e ri: Këshilli i Lartë Gjyqësor), i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, duhet të zgjidhnin një nga detyrat si (i) gjyqtar në detyrë; apo (ii) anëtarë me kohë të plotë në këtë institucion, si dhe në rast të zgjedhjes së kësaj të fundit, pas mbarimit të mandatit të tyre, nuk mund të ktheheshin si anëtar të Gjykatës së Lartë, për dallim nga gjyqtarët e emëruar nga radhët e gjykatave të tjera në Shqipëri. Në vendimin e lartcekur, kjo Gjykatë konstatoi se detyrimi i anëtarit të Gjykatës së Lartë për të zgjedhur një nga detyrat, pra ose gjyqtar në detyrë ose anëtar me kohë të plotë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, si edhe përjashtimi i tyre nga e drejta për t'u kthyer si anëtar i Gjykatës së Lartë, ishte në kundërshtim me përmbajtjen e disa dispozitave kushtetuese. Më saktësisht, në Vendimin e lartcekur, Gjykata Kushtetuese, ndër tjerash, theksoi që (i) përbërja e Këshillit të Lartë ishte e përcaktuar me Kushtetutë, dhe e cila në përbërjen e saj përfshinte edhe gjyqtarë të të gjithave niveleve që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe që për anëtarët e Këshillit të Lartë, përfshirë anëtarët gjyqtar, Kushtetuta nuk kishte përcaktuar kufizime në kontekst të papajtueshmërisë së funksionit; dhe që (ii) vet Kushtetuta ka bërë përjashtim për sa i përket veprimtarisë jo permanente të gjyqtarëve në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në të cilin ata përfaqësojnë trupën e gjyqtarëve që i ka zgjedhur në këtë organ kushtetues, dhe për pasojë, ligji nuk mund të kufizojë një të drejtë që është përcaktuar në nivel kushtetute (shih, Vendimin [Nr. 14](#), të 22 majit 2006 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë).

422. Tutje, Gjykata vëren se edhe Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut në vendimin e saj [Nr.U.216/96] të 23 tetorit 1996, kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e paragrafit 3 të nenit 9 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, ku përcaktohej, ndër të tjera se, Kryetari i Komisionit Zgjedhor emërohet nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave komunale, përkatësisht gjykatave të shkallës së parë. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese, vlerësoi nëse funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me funksionin në Komisionin Zgjedhor, dhe papajtueshmërinë e



funkcionit e kufizoi kryesisht në kontekst të vendimmarrjes gjyqësore, përkatësisht pamundësisë së një gjyqtari për të vendosur për të njëjtën çështje në shkallë të parë dhe të dytë, duke konstatuar kështu që nuk kishte papajtueshmëri të funksionit në mes të ushtruarit të funksionit të gjyqtarit me emërimin në një organ tjetër shtetërorë, sic është Komisioni Zgjedhor. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut, gjithashtu theksoi që dispozita kushtetuese që përcakton papajtueshmërinë e funksionit, gjithashtu i referohet rregullimeve ligjore dhe që në esencë, ushtrimi i funksionit të Kryetarit të Komisionit Zgjedhor ishte i përcaktuar në ligjin e kontestuar (shih, Vendimin [Nr. U.216/96](#), të 23 tetorit 1996 të Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut).

423. Në anën tjetër, çështja e pjesëmarrjes së gjyqtareve në Komisionin Qendror Zgjedhor, u trajtua edhe nga Gjykata Kushtetuese e Armenisë, por e cila, kishte arritur në konstatimin e kundërt. Më saktësisht, përmes vendimit [DCC-664] të 7 nëntorit 2006, të Gjykatës Kushtetuese të Armenisë, u vlerësua kushtetutshmëria e disa dispozitave të Kodit Zgjedhor, sipas të cilave përcaktohej se pas zgjedhjeve parlamentare, autoriteti për të emëruar anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do t'i jepej Këshillit të Kryetarëve të Gjykatave Armene, i cili këshill përbëhej nga gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe një gjyqtar nga Gjykata e Kasacionit të emëruar nga Gjykata e Kasacionit. Kjo Gjykatë, duke iu referuar dispozitave të Kushtetutës Armene, vendosi që funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me funksionin në një organ tjetër shtetëror, përkatësisht Komisionin Qendror Zgjedhor. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese, ndër tjerash, theksoi që (i) zgjidhjet e përcaktuara përmes ligjeve nuk mund të tejkalojnë kufizimet kushtetuese të saktësuara përmes Kushtetutës në kontekst të papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit; dhe (ii) marrë parasysh specifikat e ligjit të aplikueshëm armen, nuk është e përshtatshme përfshirja e gjyqtarëve në komisionet zgjedhore, kjo për shkak se do të binte ndesh me administrimin e drejtësisë dhe pavarësinë e gjyqësorit, si dhe mund të rezultojë gjithashtu në konflikt interesi ndërmjet gjyqtarëve dhe ta bëjë të vështirë për gjyqtarët dhe gjykatat të qëndrojnë të paanshëm gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore (shih, Vendimin [DCC-664](#), e 7 nëntorit 2006, të Gjykatës Kushtetuese të Armenisë).
424. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet edhe Vendimit [Pl. ÚS 39/08] të 6 tetorit 2010, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke, e cila në këtë vendim, ndër të tjera, shqyrtoi kushtetutshmërinë e rregullimit ligjor të caktimit të përkohshëm të gjyqtarëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Akademinë e Drejtësisë sipas nenit 68 të Ligjit për Gjykatat dhe Gjyqtarët. Në kontekst të papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit, Gjykata përkatëse, ndër të tjerash, vuri theks në faktin që (i) ushtrimi i funksioneve të gjyqtarit në organe tjera shtetërore nuk është në përputhje me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve si dhe pavarësinë e gjyqtarit; (ii) nuk mund të konstruktohet dualiteti në funksion të një gjyqtari dhe në të njëjtën kohë zyrtari të administratës shtetërore; dhe (iii) që në ushtrimin e funksioneve tjera shtetërore, kontaktet personale dhe jashtë-gjyqësore që shpërfaqen në ushtrimin e aktiviteteve të tilla, pa mëdyshje rrisin gjasat për konflikte të mundshme të interesit, dhe rrjedhimisht e nënshtrajnë pavarësinë e gjyqtarit ndaj dyshimeve (shih, Vendimin [Pl. ÚS 39/08](#), e 6 tetorit 2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke).
425. Nga praktika e lartcekur gjyqësore dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht vëren që Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë nuk kishte vlerësuar që funksionet paralele të gjyqtarit dhe anëtarit të Këshillit të Lartë janë të papajtueshme. Megjithatë, konstatimet e lartcekura, duhet të analizohen në kontekstin e rregullimeve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Gjykata vëren që në rastin e Shqipërisë, kontestuese ishte nëse funksioni i gjyqtarit është i pajtueshëm me funksionin e anëtarit në Këshillin e Lartë, përkatësisht institucionin kushtetues përgjegjës për të siguruar

organizimin dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Rrjedhimisht, përtej faktit që pjesëmarrjen e gjyqtarëve në Këshillin e Lartë e përcakton vet Kushtetuta e Shqipërisë, që të dy funksionet, përkatësisht ajo e gjyqtarit dhe e anëtarit të Këshillit të Lartë, ishin brenda fushëveprimit të pushtetit gjyqësor. Për më tepër, duhet të ritheksohet që Kushtetuta e Shqipërisë, në kontekst të papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit, specifikisht parasheh mundësinë e delegimit të gjyqtarëve në funksione pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë sipas përcaktimeve ligjore.

426. Në anën tjetër, Gjykatat Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut dhe të Armenisë, gjithnjë në kontekst të rregullimeve përkatëse kushtetuese, kishin ardhur në konstatime të kundërta lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në Komisione Zgjedhore. Përderisa, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut, kishte kufizuar pajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit me funksione tjera shtetërore vetëm në kontekst të vendimmarrjes gjyqësore, përkatësisht dhe ndër tjerash, faktit që gjyqtarët që ushtrojnë funksione në Komisionet Zgjedhore nuk janë gjithashtu përgjegjës për vendimmarrjen lidhur me kontestet zgjedhore para gjykatave, Gjykata Kushtetuese e Armenisë, kishte vlerësuar ushtrimin e këtyre dy funksioneve si të papajtueshme me Kushtetutën dhe konceptin e pavarësisë dhe paanësisë së gjykatave. Ndërsa, Gjykata Kushtetuese e Çekisë, gjithashtu kishte vlerësuar papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit të një rëndësie primare për parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke vlerësuar që ushtrimi i funksioneve të gjyqtarit paralelisht me funksione tjera në administratën shtetërore, cenon parimet e lartcekura.
427. Në rrethanat e Ligjit të kontestuar dhe siç është shtjelluar më sipër, kontestuese është nëse ushtrimi i funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Supreme është i pajtueshëm me ushtrimin e funksionit të kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore. Në këtë aspekt, Gjykata thekson që në kontekst të papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit, neni 106 i Kushtetutës, është specifik, dhe saktësisht përcakton (i) që gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit; dhe (ii) gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit. Gjykata gjithashtu thekson që bazuar në analizën e mësipërme të Kushtetutave tjera në kontekst të papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit, përderisa shumica prej tyre kanë ndalesa në kontekst të ushtrimit të funksioneve tjera në institucione shtetërore për gjyqtarët, Kushtetuta e Kosovës, specifikisht përmban ndalesën e ushtrimit të ndonjë funksioni në institucionet shtetërorë jashtë gjyqësorit.
428. Për pasojë dhe në kontekstin e lartcekur, është e rëndësishme të përcaktohet nëse ushtrimi i funksionit të kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, është ushtrim funksioni “*jashtë gjyqësorit*”, ndalesë kjo specifike në paragrafin 1 të nenit 106 të Kushtetutës. Në vlerësimin nëse Byroja Shtetërore mund të kualifikohet si institucion ose ushtrim funksioni “*brenda gjyqësorit*” për qëllime të përcaktimit të pajtueshmërisë së funksionit përkatës, relevante janë (i) natyra institucionale e Byrosë Shtetërore dhe raporti i Byrosë me gjykatat, përkatësisht pushtetin gjyqësor; dhe (ii) natyra e kompetencave që ushtron kryesuesi i Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë, përkatësisht gjyqtari i Gjykatës Supreme.
429. Në kontekst të çështjes së parë, Gjykata rikujton që Byroja Shtetërore është e themeluar si agjenci e pavarur bazuar në nenin 142 të Kapitullit XII të Kushtetutës ndërlidhur me Institucionet e Pavarura. Vendimmarrja e agjencive të pavarura, në parim, i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor, ndërsa, vendimmarrja e Byrosë Shtetërore, specifikisht i nënshtrohet kontrollit të gjykatave, sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar. Rrjedhimisht,

dhe përtej faktit që Byroja Shtetërore është e themeluar si agjenci e pavarur në kontekst të Kapitullit XII të Kushtetutës dhe rrjedhimisht nuk është institucion që mund të kualifikohet si institucion dhe/ose organ brenda gjyqësorit sipas përcaktimeve të Kapitullit VII të Kushtetutës, raporti në mes Byrosë Shtetërore dhe pushtetit gjyqësor, sipas Ligjit të kontestuar, është i natyrës mbikëqyrëse, përkatësisht vendimmarrja e Byrosë në kontekst të verifikimit dhe propozimit për konfiskimin e pasurisë, i nënshtrohet gjithnjë kontrollit dhe vendimmarrjes së pushtetit gjyqësor. Për pasojë, nuk është kontestuese që ushtrimi i funksionit të gjyqtarit në Komisionin Mbikëqyrës në Byronë Shtetërore, nuk mund të cilësohet si ushtrim funksioni në institucionet shtetërore brenda fushëveprimit të gjyqësorit sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 106 të Kushtetutës, por ushtrim funksioni në institucionet shtetërore “*jashtë gjyqësorit*”, dhe i cili siç është sqaruar më lart, është specifikisht i ndaluar me nenin 106 të Kushtetutës.

430. Gjykata rikujton që përtej ndalesës së përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 106 të Kushtetutës, lidhur me pamundësinë e gjyqtarit që të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, paragrafi 2 i nenit 106 të Kushtetutës, saktëson më tej, që gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit. Vlerësimi i papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit në kontekst të nenit 106 të Kushtetutës, duhet vlerësohet edhe në kontekst të kompetencave që ndërthhen funksioni përkatës i gjyqtarit në cilësi të kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore.
431. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton natyrën e kompetencave të Komisionit Mbikëqyrës i cili udhëhiqet nga gjyqtari i Gjykatës Supreme. Më saktësisht dhe siç është sqaruar më lart, Gjykata rikujton që bazuar në nenin 12 (Kompetencat e Komisionit) të Ligjit të kontestuar, Komisioni është përgjegjës për (i) mbikëqyrjen e punës dhe veprimtarisë së Byrosë; (ii) zhvillimin e procedurës dhe i propozon Kuvendit emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm; (iii) vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm; (iv) miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm; (v) shqyrtimin e raporteve të punës së Drejtorit të Përgjithshëm; dhe (vi) kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Marrë parasysh që Komisioni mbikëqyrës, vlerëson dhe mund të propozoj edhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, relevante janë edhe kompetencat e tij/saj, sipas përcaktimeve të nenit 16 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm), përkatësisht (i) udhëheqja dhe organizimi i punës së Byrosë; (ii) mbikëqyrja e punës së zyrtarëve të Byrosë; (iii) përfaqësimi i Byrosë brenda dhe jashtë vendit; (iv) menaxhimi i buxhetit të Byrosë dhe mënyra e shpenzimit të tij; (v) hartimi dhe miratimi i planit vjetor të punës brenda mandatit të Byrosë; dhe (vi) lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Për më tepër, është relevante gjithashtu të theksohet që bazuar në nenin 8 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e Byrosë) të Ligjit të kontestuar, Byroja, ndër tjerash, është përgjegjëse për (i) fillimin dhe zhvillimin e procedurës për verifikimin e pasurisë dhe për përcaktimin nëse pasuria e personit zyrtar është pasuri e pajustificueshme; dhe (ii) parashtrimin e propozimin për konfiskimin e pasurisë në Gjykatë.
432. Gjykata thekson që natyra e kompetencave të ushtruara nga Komisioni Mbikëqyrës sipas përcaktimeve të neneve 8, 12 dhe 16 të Ligjit të kontestuar, është ekzekutive dhe ndërlidhet në mënyrë përmbajtësore me gjithë funksionin e Byrosë Shtetërore dhe e cila, bazuar në nenin 10 të Ligjit të kontestuar, në esencë do të udhëhiqet nga një gjyqtar i Gjykatës Supreme në cilësinë e kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës. Përkundër faktit që gjyqtari përkatës do të përjashtohet nga vendimmarrja bazuar në nenin 67 të LPK-së, atëherë kur Gjykata Supreme do të vendoste sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike të saktësuara në

kapitullin X (Procedura sipas Mjeteve të Jashtëzakonshme Juridike) të Ligjit të kontestuar, fakti që Kryetari i Gjykatës Supreme, përkatësisht autoritetit më të lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës sipas nenit 103 [Organizimi dhe Juridiksi i Gjykatave] të Kushtetutës, do të caktonte kryesuesin e Komisionit Mbikëqyrës të një institucioni tjetër shtetëror jashtë gjyqësorit, përkatësisht Byrosë Shtetërore, vendimmarrja e të cilit, i nënshtrohet përfundimisht kontrollit të pushtetit gjyqësor, gjithashtu ndërlihet me kufizimet e saktësuara në paragrafin 2 të nenit 106 të Kushtetutës dhe sipas të cilit, gjyqtarëve nuk u lejohej të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit. Gjykata vë theks në shprehjen “*në çfarëdo mënyre*” të këtij paragrafi dhe i cili reflekton qëllimin e ndalesës së ushtrimit të çfarëdo lloj funksioni të gjyqtarëve dhe i cili do të mund të dukej se cenon parimin e pavarësisë dhe paanësisë të pushtetit gjyqësor si vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

433. Gjykata, thekson që Kushtetuta, vet ka përcaktuar funksione shtesë për gjyqtarët, përmes nenit 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës, në kontekst të përbërjes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe përmes nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës, në kontekst të kryesimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përtej këtyre përcaktimeve kushtetuese, neni 106 [Papajtueshmëria] i Kushtetutës, gjithashtu mundëson funksione shtesë për gjyqtarët, për aq sa të njëjtat janë të pajtueshme me kushtet që përcakton ky nen. Përmes paragrafit 2 të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës, kjo e fundit mundëson marrjen e përgjegjësisë dhe bartjen e funksioneve dhe të cilat në çfarëdo mënyre, nuk do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit. Pajtueshmëria e këtyre funksioneve me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit, duhet të vlerësohet gjithnjë në kontekst të funksionit përkatës, përfshirë natyrës së kompetencave që ngërthen i njëjti. Megjithatë, neni 106 i Kushtetutës, ngërthen tri ndalesa specifike në kontekst të pajtueshmërisë së funksioneve shtesë për gjyqtarë. Së pari, në mënyrë të qartë ndalon përfshirjen në ndonjë aktivitet politik. Së dyti, i delegon ligjit, mundësinë për të ndaluar aktivitete shtesë për gjyqtarët. Dhe së treti, specifikisht ndalon ushtrimin e ndonjë funksioni në institucionet shtetërore “*jashtë gjyqësorit*”. Përderisa, përcaktimi nëse një funksion në një institucion shtetëror mund të kualifikohet si brenda apo jashtë gjyqësorit, është çështje që duhet të interpretohet varësisht nga natyra e institucionit dhe funksionit përkatës, në rrethanat të Byrosë Shtetërore, dhe marrë parasysh, (i) kompetencat e Kryesuesit të Byrosë, përkatësisht gjyqtarit të Gjykatës Supreme bazuar në dispozitat e shtjelluara të Ligjit të kontestuar; (ii) funksionet dhe kompetencat e Byrosë; dhe (iii) ndërveprimin në mes Byrosë dhe pushtetit gjyqësor bazuar në vet dispozitat e Ligjit të kontestuar, Gjykata vlerëson që nuk është kontestuese që Byroja Shtetërore është institucion shtetëror “*jashtë gjyqësorit*” për qëllime të papajtueshmërisë së funksionit sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 106 të Kushtetutës.

#### *Konkluzion*

434. Për pasojë dhe bazuar në elaborimin si më sipër, dhe marrë parasysh (i) faktin që bazuar në nenin 106 të Kushtetutës, gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore “*jashtë gjyqësorit*”, ndërsa ushtrimi i funksionit në një institucion që i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor sipas përcaktimeve të vete Ligjit të kontestuar në kontekst të vendimmarrjes për propozimin e konfiskimit të pasurisë, nuk mund konsiderohet si ushtrim funksioni brenda fushëveprimit të gjyqësorit; dhe (ii) faktin që një gjyqtar i Gjykatës Supreme i caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme si institucioni më lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës, do të udhëhiqte Komisionin Mbikëqyrës të një institucioni shtetëror “*jashtë gjyqësorit*”, me kompetenca përmbajtësore dhe ekzekutive në

ndërlidhje me Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, gjithashtu ngritë çështje që ndërlidhen me ushtrimin e funksioneve të cilat do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit, Gjykata konstaton që roli i gjyqtarit të Gjykatës Supreme të caktuar si kryesues i Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore nga ana e Kryetarit të Gjykatës Supreme, të përcaktuar përmes pikës 1.1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me kufizimet e saktësuara në nenin 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës.

435. Në fund dhe në kontekstin e lartcekur, Gjykata vëren rëndësinë e pavarësisë së përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, përfshirë rëndësinë e pavarësisë së anëtarëve të saj siç është theksuar edhe nga Opinionet relevante të Komisionit të Venecias për Kosovën. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu thekson që kjo përbërje nuk mund të cenoj norma tjera kushtetuese e që në rastin konkret ndërlidhen me (i) rregullimin specifik kushtetues përkitazi me papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit, përkatësisht ndalesën kushtetuese që gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit; dhe/ose (ii) kompetencat mbikëqyrëse të institucioneve të pavarura kushtetuese në ndërlidhje me të gjitha autoritetet publike në Republikën e Kosovës, përfshirë Byronë Shtetërore, siç janë Avokati i Popullit në kontekst të mbikëqyrjes së mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore apo Auditori i Përgjithshëm në kontekst të kontrollit financiar. Gjykata thekson që është detyrë e të gjitha autoriteteve publike në Republikën e Kosovës që të zbatojnë normat kushtetuese, dhe që i takon Kuvendit, për aq sa nuk e ushtron vet funksionin mbikëqyrës, që të përcaktojë përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, në atë mënyrë që respektohen të gjitha garancitë e nevojshme për pavarësinë e këtij institucioni, duke mos cenuar në të njëjtën kohë dispozitat kushtetuese që ndërlidhen me papajtueshmërinë e funksioneve dhe/ose kompetencat mbikëqyrëse të institucioneve të pavarura kushtetuese.

***(ii) Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë dhe mekanizmi deblokues***

436. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në paragrafin 13 të nenit 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, Kuvendi ka kompetencën që të zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm, me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Bazuar në paragrafët pasues, përkatësisht paragrafin 14 dhe 15 të nenit të lartcekur, nëse Kuvendi nuk arrin që të zgjedhë Drejtorin në dy raunde votimi, atëherë konkursi rishpallet brenda shtatë (7) ditësh. Më tej dhe bazuar në paragrafin 16 të nenit 15 të Ligjit të kontestuar, në rast se Kuvendi dështon në zgjedhjen e Drejtorit në dy raunde edhe në konkursin e rishpallur, atëherë kompetenca për të zgjedhur Drejtorin e Përgjithshëm, i kalon Komisionit Mbikëqyrës, i cili zgjedh në këtë pozitë kandidatin me më së shumti pikë.
437. Gjykata në vijim rikujton që Komisioni i Venecias, në Opinionin e parë rreth Ligjit të kontestuar, kishte tërhequr vërejtjen se mandati i Byrosë për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë, është një çështje e ndjeshme politikisht, duke theksuar gjithashtu që garancitë për pavarësinë e Byrosë janë të domosdoshme që kjo e fundit të mund t'i bëjë ballë presionit politik. Duke qenë se versioni i Ligjit të kontestuar që i ishte nënshtruar vlerësimit të Komisionit të Venecias me rastin e Opinionit të parë, parashihte zgjedhjen e Drejtorit nga një Komision parlamentar i përbërë vetëm nga deputetë të Kuvendit, Komisioni i Venecias kishte vlerësuar se kjo përbërje procedurë tejet të politizuar të zgjedhjes dhe për pasojë, ndër tjerash, kishte propozuar (i) zgjedhjen e Drejtorit përmes një shumice të kualifikuar

prej dy të tretash (2/3) në Kuvend, duke përfshirë një mekanizëm deblokues; (ii) zgjedhjen e Drejtorit përmes përfshirjes së një komisioni të pavarur ekspertësh, i cili ose do ta zgjidhte drejtpërdrejtë Drejtorin, ose do të delegonte/nominonte kandidatët për pozitën e Drejtorit; ose (iii) themelimin e një organi titullar kolegjal të Byrosë, me përbërje pluraliste dhe me anëtarë të deleguar nga institucionet e pavarura (shih, paragrafin 39 të Opinionit të Parë).

438. Gjykata gjithashtu vëren se paragrafi 16 i nenit 15 të Ligjit të kontestuar, që përcakton kalimin e kompetencës për zgjedhjen e Drejtorit tek Komisioni Mbikëqyrës në rast të dështimit të deputetëve të Kuvendit për të zgjedhur Drejtorin në raundin e dytë të konkursit të rishpallur për të dytën herë, është shtuar pasi drafti i Projektligjit për Byronë Shtetërore i është nënshtruar analizës nga Komisioni i Venecias, e që ka rezultuar në Opinionin e dytë. Në fakt, drafti i Projektligjit për Byronë Shtetërore, i përcjellë për opinionin të dytë në Komisionin e Venecias, në paragrafët 14 dhe 15 të nenit 14 (Procedura për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm) të tij, përcaktonte që: (i) nëse në raundin e parë, Kuvendi nuk e zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm, atëherë zhvillohet raundi i dytë i votimit mes dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota; dhe (ii) nëse Drejtori i Përgjithshëm nuk zgjidhet as në raundin e dytë të votimit nga Kuvendi, konkursi për Drejtor të Përgjithshëm përsëritet. Si rezultat i këtij ndryshimi në draftin e dytë të Projektligjit, Komisioni i Venecias në Opinion e tij të dytë kishte theksuar se: *“Kriteret për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm janë përcaktuar në nenin 13 të Projektligjit dhe rekomandohen se paku dy dhe jo më shumë se pesë kandidatë. Për tu rekomanduar një kandidat duhet të kualifikohet në të tre titujt e integritetit, kompetencës dhe aftësisë menaxheriale. Ndonëse nuk thuhet shprehimisht se rezultatet e vlerësimit duhet të publikohen, megjithatë duhet të deklarohen arsyet për përparësinë që i është dhënë secilit kandidat nga Komisioni, gjë që duket se ka efekt të ngjashëm. Me pas Kuvendi zgjedh një kandidat me shumicë votash në një votim të fshehtë. Megjithatë si një zgjidhje me e mire mund të ishte sigurimi i një mekanizmi me të detajuar kundër-bllokim i cili do të ishte opsioni i parë i Komisionit sa i përket emërimit në qoftë se pragu nuk arrihet. Një zgjidhje e mundshme mund të jetë shumica e kualifikuar, megjithatë, siç tregohet në opinionet e mëparshme të Komisionit të Venecias, numri i rasteve në të cilat Kuvendi mund të votojë me shumicë të kualifikuar është shumë i kufizuar bazuar në nenin 65 të Kushtetutës.”*
439. Në vijim, pas miratimit të Opinionit të dytë të Komisionit të Venecias, Kuvendi në versionin e radhës, i cili ka rezultuar në miratimin e Ligjit të kontestuar, në nenin 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të tij ka shtuar paragrafin 16, i cili përfshin edhe një mekanizëm deblokues, përkatësisht: *“Në rast se edhe pas përsëritjes së konkursit, Kuvendi dështon në zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm në dy raunde, atëherë Komisioni shpallë konkursin dhe zhvillon procedurat sipas këtij neni me përjashtimin e vetëm se Komisioni në fund të procesit zgjedh kandidatin me më së shumti pikë si Drejtor të Përgjithshëm.”* Si e tillë, kjo dispozitë që në thelb paraqet një mekanizëm de-bllokues në rast se Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Drejtorin, nuk i është nënshtruar vlerësimit nga Komisioni i Venecias. Megjithatë, si rrjedhojë e miratimit të Ligjit të kontestuar në Kuvendi, Komisioni i Venecias në Informatën e tij Përcjellëse në lidhje me Ligjin e kontestuar, të 14 marsit 2023, kishte njoftuar se versioni i fundit, i plotësuar dhe ndryshuar, ka adresuar rekomandimet Komisionit në Opinionin tij të e dytë, të cilat ndër to përfshijnë edhe *“përcaktimin e një mekanizmi kundërbllokimi për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm.”*
440. Bazuar në sqarimet e lartcekura dhe marrë parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe argumentet e kundër-argumentet e palëve të interesuara, Gjykata vlerëson që në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 15 të Ligjit të kontestuar dhe specifikisht mekanizmit de-bllokues sipas të cilit, kompetenca e Kuvendit për të zgjedhur

Drejtorin e Përgjithshëm të një institucioni/agjencie të pavarur, i kalon vet Komisionit Mbikëqyrës, relevante është ndërlidhja e neneve 65 [Kompetencat e Kuvendit], 80 [Miratimi i Ligjeve] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

441. Në kontekstin e lartcekur dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme, ndërsa bazuar në nenin 80 të Kushtetutës, ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë. Në anën tjetër, bazuar në paragrafin 1 të nenit 142 të Kushtetutës, Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës, janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre.
442. Dispozitat e lartcekura, rezultojnë në dy çështje relevante ndërlidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 15 të Ligjit të kontestuar, ndërlidhur me zgjedhjen e Drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë, përkatësisht (i) nëse delegimi i zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm nga Kuvendi në Komisionin Mbikëqyrës cenon kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur Drejtorin e një Agjencie të Pavarur të themeluar përmes nenit 142 të Kushtetutës; dhe (ii) zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.
443. Lidhur me çështjen e parë, Gjykata thekson që as neni 65 dhe as neni 142 i Kushtetutës, nuk përcaktojnë kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur titullarët dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese të Agjencive të Pavarura. Në fakt dhe siç është shtjelluar më sipër, sipas nenit 142 të Kushtetutës, Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës, janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Në anën tjetër, kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur funksionarët e lartcekur nuk e saktëson as Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Ky i fundit, (i) në nenin 38 (Themelimi i agjencive të pavarura) të tij, përcakton që është ligji për themelimin e një agjencie të pavarur që rregullon organizimin, funksionimin dhe kompetencat e agjencisë së pavarur; ndërsa (ii) në nenin 46 (Kushtet dhe procedura për emërimin e titullarit apo anëtarit të organit drejtues), përcakton që (a) kushtet për emërimin e titullarit apo anëtarit të organit drejtues të një agjencie të pavarur, përcaktohen me ligjin e themelimit të agjencisë; dhe (b) procedura e zgjedhjes, miratimit apo dhënies së pëlqimit për titullarin dhe anëtarin e organit drejtues përcaktohet me ligjin e themelimit dhe Rregulloren e Kuvendit. Bazuar në dispozitat e shtjelluara më sipër, rezulton që në kontekst të nenit 142 të Kushtetutës, është në diskrecionin e Kuvendit që në bazë të ligjeve përkatëse, të përcaktojë themelimin, funksionimin dhe kompetencat dhe mënyrën e emërimit/zgjedhjes/shkarkimit të titullarëve dhe/ose anëtarëve të organeve drejtuese të tyre.
444. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata gjithashtu rikujton analizën dhe të gjeturat në Aktgjykimin e saj në rastin KO100/22 dhe KO101/22. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit e konkret, në kontekst të kompetencës së Avokatit të Popullit për të “*caktuar/zgjedhur*” një anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës që, ndër tjerash, është shqyrtuar në Aktgjykimin e lartcekur, Gjykata, kishte vënë theks në (i) kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur anëtarët e Këshillit Prokurorial sipas përcaktimeve të paragrafit 10 të nenit 65 të Kushtetutës, duke theksuar që një kompetencë e tillë e përcaktuar me Kushtetutë nuk mund të delegohej në nivel ligji; dhe (ii) kompetencat kushtetuese të Kuvendit për të zgjedhur bartësit e funksioneve të institucioneve të pavarura kushtetuese të

përcaktuara në Kapitujt VII dhe XII të Kushtetutës, respektivisht. Në kontekst të institucioneve të pavarura kushtetuese të saktësuara në kapitullin XII të Kushtetutës, Gjykata, ndër tjerash, kishte vënë theks në faktin që “*me përjashtim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përbërjen e të cilit e përcakton Kushtetuta dhe Agjencive të Pavarura, të cilat janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre*”, në rastin e katër (4) institucioneve tjera të pavarura, Kushtetuta ose përcakton kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur bartësit/titullarët e tyre ose e delegon këtë çështje në nivel të rregullimit ligjor, por që edhe kur Kushtetuta ka deleguar zgjedhjen e bartësve/titullarëve të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në kapitullin XII në nivel ligji, të gjitha ligjet përkatëse që rregullojnë institucionet e pavarura kushtetuese, saktësojnë kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur titullarët/bartësit e funksioneve të tyre.

445. Megjithatë, ashtu siç është theksuar edhe në Aktgjykimin e lartcekur, Agjencitë e Pavarura kushtetuese nuk janë ekuivalente me Institucionet e Pavarura kushtetuese të përcaktuara në kapitullin XII të Kushtetutës dhe bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, themelimi, funksionimi, përfshirë edhe mënyra e zgjedhjes së titullarëve/bartësve të Agjencive të Pavarura përcaktohet përmes ligjeve respektive të miratuara nga vet Kuvendi. Ky i fundit, në kontekst të themelimit të Agjencive të Pavarura kushtetuese, ka diskrecion, për aq sa janë respektuar dispozitat kushtetuese, përfshirë garancitë e nenit 142 të Kushtetutës, që ndërlidhen me (i) ushtrimin e pavarur të funksionet të Agjencive të Pavarura; (ii) administrimin e pavarur të buxhetit; dhe (iii) detyrimin e secilit organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, që të bashkëpunojë dhe t’u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.
446. Për pasojë dhe bazuar në sqarimet e lartcekura dhe marrë parasysh që mënyra e zgjedhjes së titullarëve/anëtarëve të Agjencive të Pavarura nuk është e saktësuar me dispozita kushtetuese, Gjykata vlerëson që përcaktimi i mënyrës së zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 142 të Kushtetutës, është në kompetencë të Kuvendit të Republikë së Kosovës. Megjithatë, ndërlidhur me këtë konstatim, Gjykata rikujton praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, bazuar në të cilën, në të gjitha rastet kur një Ligj i Kuvendit kontestohet para Gjykatës nga palët e autorizuar, fokusi i vlerësimit është gjithmonë respektimi i normave kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive të njeriut – e asnjëherë vlerësimi i përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një Ligji të caktuar (shih, rastet e Gjykatës KO73/16, parashtrues Avokati i Popullit, Aktgjykim i 16 nëntorit 2016, paragrafi 52; rastin KO72/20, cituar më lart, paragrafi 357; KO12/18, parashtrues Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 29 majit 2018, paragrafi 117; KO219/19, cituar më lart, paragrafi 259; dhe KO216/22\_KO220/22, parashtrues: për kërkesën KO216/22 - *Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë*, dhe për KO220/22 *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Aktgjykim i 2 gushtit 2023, paragrafi 312).
447. Ndërsa lidhur me çështjen e dytë, përkatësisht, zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, Gjykata rikujton paragrafin 1 të nenit 80 të Kushtetutës, bazuar në të cilin ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë. Këto përjashtime, Kushtetuta i përcakton në mënyrë specifike, duke i ndarë në dy (2) kategori,



përkatësisht (i) rastet kur kërkohet shumicë që dallon nga e thjeshta; dhe (ii) rastet kur vendimmarrja është kushtëzuar edhe me shumicën e caktuar të komuniteteve jo-shumicë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe të cilat janë shtjelluar detajisht në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO100/22 dhe KO101/22 (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafët 275-277). Marrë parasysh që Kushtetuta nuk ka përcaktuar ndryshe, zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore bie në kuadër të nenit 80 të Kushtetutës, përkatësisht zgjedhjes me shumicë të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Për pasojë dhe marrë parasysh (i) paragrafin 1 të nenit 80 të Kushtetutës, sipas të cilit, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë; dhe (ii) faktin që ky nuk është rasti përkitazi me themelimin e funksionimit e Agjencive të Pavarura sipas nenit 142 të Kushtetutës, zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë në dy raundet e para të votimit dhe para se të delegohet kjo kompetencë në Komisionin Mbikëqyrës në rast të dështimit të zgjedhjes nga Kuvendi, nuk është në kundërshtim me nenet e lartcekura.

448. Thënë këtë dhe marrë parasysh rëndësinë e pavarësisë së Byrosë Shtetërore, Gjykata rikujton konstatimet e saj në Aktgjykimin KO100/22 dhe KO101/22, përmes të cilit kishte theksuar që pa marrë parasysh nenin 80 të Kushtetutës, pushteti legjislativ, ka përcaktuar edhe shumica më të larta për zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të pavarura përmes ligjeve të miratuara ndër vite. Siç është sqaruar në Aktgjykimin e lartcekur, ky ka qenë rasti ndërlidhur me (i) zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial nga Kuvendi sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; (ii) zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga Kuvendi sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; dhe (iii) shkarkimin e zëvendësve të Avokatit të Popullit sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (nenet 13 dhe 14 të tij). Për më tepër dhe në të njëjtin kontekst, Gjykata gjithashtu rikujton qëndrimin e Komisionit të Venecias në rastin e Bullgarisë në këtë aspekt, përfshirë në kontekst të zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit përkatës përgjegjës për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, përmes të cilit kishte kundërgumentuar pretendimin e autoriteteve bullgare se nuk mund të kërkohet që zëvendëskryetari dhe dy anëtarë të tjerë, të zgjidhen me një shumicë të kualifikuar, përkatësisht me dy të tretat (2/3) e Asamblesë Kombëtare, pasi Kushtetuta parashikonte se vendimet e Asamblesë Kombëtare, kanë nevojë vetëm për "*një shumicë më shumë se gjysma e anëtarëve të parlamentit të pranishëm, përveç rastit kur një shumicë e kualifikuar kërkohet nga Kushtetuta*", duke theksuar, ndër tjerash, që ekzistonte mundësia që Gjykata Kushtetuese Bullgare të shpallte shumicën e kualifikuar me dy të tretat (2/3) si jokushtetuese. Komisioni i Venecias, në fakt, theksoi se një Gjykatë Kushtetuese kombëtare, ndërhyjnë përgjithësisht kur mungon garancia dhe jo kur ligji i zakonshëm paraqet një garanci më të lartë si kjo në rastin konkret, e cila do të forconte pavarësinë dhe karakterin përfaqësues të Komisionit, ku ishte kërkuar që të parashihet kërkesa për votim me shumicë të kualifikuar, duke shtuar se është e rëndësishme që në kryerjen e veprimtarisë së tij, Komisioni të jetë dhe të shihet si i paanshëm (shih, paragrafët 16-19 të Opinionit të katërt në rastin e Bullgarisë).

#### *Konkluzion*

449. Thënë këtë dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konstaton që paragrafi 16 i nenit 15 (Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm) të Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me paragrafët 1 të neneve 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

### ***(iii) Funkcionalizimi i Byrosë Shtetërore***

450. Gjykata së pari sqaron që bazuar në nenin 71 (Hyrja në Fuqi) të Ligjit të kontestuar, ky i fundit hyn në fuqi gjashtë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa bazuar në nenin 70 (Aktet nënligjore) të Ligjit të kontestuar, saktësohet që aktet nënligjore të përcaktuara përmes tij, nxirren brenda gjashtë (6) muajsh, pas hyrjes në fuqi të tij.
451. Në anën tjetër, neni 69 (Funkcionalizimi i Byrosë) i Ligjit të kontestuar, përcakton fazat e funksionalizimit të Byrosë, duke saktësuar që (i) Kryetari i Gjykatës Supreme cakton gjyqtarin nga radhët e Gjykatës Supreme si anëtar të Komisionit të Byrosë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Ligji; (ii) konstituimi i Komisionit bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Ligji; (iii) Komisioni fillon procedurën e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e konstituimit; (iv) pas konstituimit dhe deri në funksionalizimin e plotë të Byrosë, Komisioni mbledhet rregullisht dhe miraton aktet e nevojshme nënligjore në drejtim të funksionalizimit të plotë të Byrosë; (v) vetëm pas funksionalizimit të plotë të Byrosë, por jo më vonë se një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, Byroja fillon së zbatuari dispozitat e këtij Ligji në funksion të verifikimit të pasurisë së pajustificueshme; (vi) funksionalizimi i Byrosë, nënkupton emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm, rekrutimin e stafit dhe pajisjen e zyrës me resurset e nevojshme për punë; (vii) deri në funksionalizimin e Byrosë, funksionin administrativ e ushtron Agjencia për Parandalim të Korrupsionit, të cilës i ndahen mjete buxhetore shtesë për kryerjen e këtij funksioni; dhe (viii) Drejtori i Përgjithshëm obligohet që në afat prej gjashtë (6) muajsh nga zgjedhja e tij ta kompletojë stafin dhe të funksionalizojë Byronë.
452. Në kontekst të sqarimit të mësipërm, Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në paragrafin 1 të nenit 142 të Kushtetutës, Agjencitë e Pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, kontestuese është nëse Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mund të ushtrojë funksione administrative në mbështetje të Byrosë Shtetërore deri në funksionalizimin e saj. Thënë këtë, neni i lartcekur, definon konceptin/domethënien e funksionalizimit të Byrosë në paragrafin 6 të tij, duke theksuar që funksionalizimi i Byrosë, nënkupton emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm, rekrutimin e stafit dhe pajisjen e zyrës me resurset e nevojshme për punë, ndërsa bazuar në paragrafin 5 të nenit të lartcekur, Byroja fillon së zbatuari dispozitat e këtij Ligji në funksion të verifikimit të pasurisë së pajustificueshme, vetëm pas funksionalizimit të plotë të saj. Për pasojë, përkundër që paragrafi 7 i nenit 69 të Ligjit të kontestuar, përcakton që deri në funksionalizimin e Byrosë, funksionet administrative të saj i kryen Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, zbatimi i dispozitave të Ligjit të kontestuar ndërlihdur me verifikimin e pasurisë është i kushtëzuar në funksionalizimin e vet Byrosë Shtetërore, me funksionalizimin e të cilës, pushon çdo mbështetje administrative e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

### ***Konkluzion***

453. Rrjedhimisht, bazuar në elaborimin dhe vlerësimin si më sipër, rezulton që kryerja e funksionit administrativ nga ana e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit brenda periudhës së lartcekur kalimtare deri në funksionalizimin e plotë të Byrosë Shtetërore, nuk është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

## V. Efekti i Aktgjykimit

454. Bazuar në shtjellimin e këtij Aktgjykimi, Gjykata ka konstatuar që (i) pika 2.1 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 2 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (ii) pika 2.2 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 3 të nenit 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (iii) pika 1.1 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me nenin 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës; (iv) pika 1.2 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës; (v) pika 1.4 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe paragrafin 3 të nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; (vi) të shpallë të pavlefshëm, në tërësinë e tij, Ligjin Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme; si dhe (vii) të refuzojë kërkesën për masën e përkohshme.
455. Sipas sqarimeve të lartcekura, në esencë, Gjykata ka konstatuar që Ligji i kontestuar, cenon parimet kushtetuese në tri aspekte, përkatësisht (i) lidhur me fushëveprimin e Ligjit të kontestuar të saktësuar përmes nenit 2 (Fushëveprimi) në ndërlidhje me nenin 34 (Procedura në shkallën e parë) të tij dhe më saktësisht, në kontekst të aplikimit retroaktiv të ligjit që nga 17 shkurti 2008 në raport me garancitë e nevojshme ndërlidhur me barrën e të provuarit të individit, përkatësisht subjektit të verifikimit, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim; (ii) lidhur me periudhën e verifikimit të pasurisë të saktësuar përmes nenit 2 (Fushëveprimi) në ndërlidhje me nenin 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar, në kontekst të “qartësisë” dhe “parashikueshmërisë” së normës që përcakton kompetencën e Byrosë Shtetërore për verifikimin e pasurisë së zyrtarit publik të fituar përgjatë dhe pas përfundimit të ushtrimit të funksioneve shtetërore; dhe (iii) lidhur me përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore të saktësuar përmes nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar dhe më saktësisht, përkitazi me papajtueshmërinë e funksioneve kushtetuese të një gjyqtari të Gjykatës Supreme, Auditorit të Përgjithshëm dhe zëvendës Avokatit të Popullit me ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të mbikëqyrjes së Byrosë Shtetërore, përfshirë në kontekst të natyrës së kompetencave të kësaj të fundit.
456. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, në adresimin e shkeljeve kushtetuese të kontestuara si më lart përmes ndryshimeve dhe/ose plotësimeve të dispozitave të lartcekura, Kuvendi duhet të sigurohet që (i) aplikimi retroaktiv i ligjit të jetë i balancuar dhe proporcional me barrën e të provuarit, ose (a) duke përcaktuar periudha të arsyeshme retroaktive bazuar në analizën dhe vlerësimin e ligjeve të aplikueshme të Republikës së

Kosovës, përfshirë në kontekst të qasjes në të dhëna që janë relevante për vërtetimin e pa/justifikueshmërisë së pasurisë që i nënshtrohet verifikimit; dhe/ose (b) përmes saktësisht të garancive procedurale në kontekst të barrës së të provuarit të individit, përkatësisht subjektit të verifikimit, që do t'i mundësonte këtij të fundit, që të argumentojë para gjykatave përkatëse ndërlidhur me pamundësinë objektive për të siguruar provat përkatëse; (ii) normat të cilat përcaktojnë periudhat kohore brenda të cilave Byroja mund të verifikojë pasurinë e fituar përgjatë dhe pas ushtrimit të funksionit, përfshirë afatet brenda të cilave mund të iniciohen hetimet dhe procedurat përkatëse, duhet të jenë plotësisht të “qarta” dhe “parashikueshme”, në përputhje me parimin e sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit; dhe (iii) për atë që nuk e ushtron funksionin mbikëqyrës vet, të përcaktojë përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës në atë mënyrë që i njëjti të ketë pavarësinë që garanton edhe neni 142 i Kushtetutës, duke u siguruar në të njëjtën kohë që përcaktimi i mundshëm i anëtarëve të institucioneve të pavarura në këtë komision të jetë në përputhje dhe/ose e pajtueshme me funksionet e tyre kushtetuese dhe/ose kompetencat mbikëqyrëse të institucioneve të pavarura kushtetuese.

457. Gjykata më tej thekson që përkundër faktit që në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, ajo ka vlerësuar si në kundërshtim me Kushtetutën vetëm pjesë të saktësuar të neneve të lartcekura të Ligjit të kontestuar, marrë parasysh natyrën dhe rëndësinë e tyre dhe faktin që pa ndryshimin dhe plotësimin e të njëjtave, Ligji i kontestuar është i pazbatueshëm, Gjykata nuk mund ta dërgojë te Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës Ligjin e kontestuar për shpallje sipas përcaktimeve të nenit 43 (Afati) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, por duhet që të njëjtin ta kthej në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që i njëjti t'i plotësojë dhe/ose ndryshojë nenet 2 (Fushëveprimi), 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi); 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) dhe 34 (Procedura në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar në pajtim me Kushtetutën dhe konstatimet e këtij Aktgjykimi.
458. Në mbështetje të konstatimit të lartcekur, Gjykata rikujton që kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë parashtruar në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Kjo kategori e kërkesave ka efekt suspenziv sepse bazuar në nenin 43 (Afati) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ligji i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarrjes së Gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës për rastin e kontestuar. Gjykata rikujton që marrë parasysh parimin e sigurisë juridike, bazuar në praktikën e saj gjyqësore ndërlidhur me kategorinë e kërkesave me karakter suspenziv të parashtruara sipas përcaktimeve të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, përcaktimi nëse Ligji i kontestuar shpallet i pavlefshëm në tërësinë e tij apo shpallen të pavlefshme vetëm dispozitat e saktësuar të Ligjit të kontestuar duke referuar pjesën tjetër të Ligjit të kontestuar për dekretim të Presidenti/ja i Republikës, varet nga natyra e shkeljeve të evidentuara, përkatësisht nëse Ligji i kontestuar mund të zbatohet pa dispozitat të cilat janë të shpallura si në kundërshtim me Kushtetutën. Në rrethana në të cilat, natyra e dispozitave të cilat janë shpallur në kundërshtim me Kushtetutën e bëjnë të pazbatueshëm pjesën tjetër të Ligjit të kontestuar, Gjykata, nuk mund ta referoj për dekretim, përkatësisht për hyrje në fuqi, një ligj që nuk është i zbatueshëm.
459. Sipas sqarimeve si më sipër, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në rast të konstatimit që dispozita të caktuara të ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe që pjesa tjetër e ligjit përkatës mund të zbatohet edhe pa të njëjtat, Gjykata, ka shpallur të pavlefshme vetëm dispozitat e vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën, ndërsa pjesën tjetër të ligjit e ka dërguar te Presidenti për shpallje në pajtim me modalitetet

e Aktgjykimit të Gjykatës, siç është rasti me Aktgjykimet e Gjykatës në rastet (i) KO01/17, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; (ii) KO108/13, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 04/L-209 për Amnisti; (iii) KO216/22 dhe KO220/22, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë; dhe (iv) [KO79/23](#) lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Ndërsa, në rast të vlerësimit që dispozitat e shpallura në kundërshtim me Kushtetutën janë të rëndësishme thelbësore për ligjin në fjalë dhe pavarësisht shpalljes apo hyrjes në fuqi e tij, ligji përkatës do të ishte i pazbatueshëm, Gjykata ka shfuqizuar ligjin përkatës në tërësinë e tij, siç është rasti me Aktgjykimin e Gjykatës në rastet (i) KO43/19 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë; (ii) [KO100/22](#) dhe [KO101/22](#), lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; dhe (iii) KO173/22, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg.

460. Në rrethanat e Ligjit të kontestuar, dhe siç është sqaruar më sipër, Gjykata ka konstatuar që dispozita esenciale të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht (i) ato që ndërlidhen me vet fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, përfshirë në aspekt të aplikimit retroaktiv të tij në raport me barrën e provës ndërlidhur me pa/justifikueshmërinë e pasurisë; (ii) periudhën e verifikimit të pasurisë së paluajtshme gjatë ushtrimit dhe pas përfundimit të funksioneve të zyrarëve përkatës; dhe (iii) ato që përcaktojnë përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës, dhe i cili, sipas sqarimeve të dhëna, përtej kompetencës mbikëqyrëse, ka edhe kompetenca thelbësore dhe të cilat ndërlidhen me vet themelimin e Byrosë Shtetërore, përfshirë zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të saj. Sipas sqarimeve të dhëna, asnjë dispozitë tjetër e Ligjit të kontestuar nuk mund të zbatohet pa përcaktimin e përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës nga ushtrimi i funksionit të të cilit varet themelimi i Byrosë Shtetërore dhe për më tepër, asnjë procedurë e verifikimit të pasurisë nuk mund të fillojë, pa përcaktimin e saktë të fushëveprimit të Ligjit të kontestuar dhe periudhave kohore në kuadër të të cilave pasuria mund t'i nënshtrohet verifikimit. Për pasojë, dhe marrë parasysh që Ligji i kontestuar, pa dispozitat e shpallura në kundërshtim me Kushtetutën, nuk mund të jetë i zbatueshëm dhe rrjedhimisht, nuk mund t'i dërgohet Presidentit/es të Republikës së dekretim dhe hyrje në fuqi dhe marrë parasysh parimin e sigurisë juridike dhe praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore në këtë kontekst, Gjykata ka konstatuar që Ligji i kontestuar duhet të shpallet i pavlefshëm në tërësinë e tij.

## V. Kërkesa për Masën e Përkohshme

461. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesave kanë kërkuar nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, për të pezulluar hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Ligjit të kontestuar, deri në vendosjen përfundimtare për kërkesën përkatëse.
462. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se paragrafi 2 i nenit 43 (Afati) të Ligjit, përcakton efektin suspenziv të hyrjes në fuqi të ligjeve që kontestohen sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duke theksuar se “*në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar*”.

463. Bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata më 21 shkurt 2023, kishte kërkuar nga Presidentja, Kryetari dhe Sekretari i Kuvendit që të marrin parasysh kërkesat e paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit.
464. Andaj, duke marrë parasysh që bazuar në paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit, Ligji i kontestuar sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte juridike pa nxjerrjen e vendimit nga Gjykata, si dhe në pajtim me nenin 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet (shih, ndër tjerash, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 411).

### **PËR KËTO ARSYE**


Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113 (5) dhe 116 (2) të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 45, 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 20 qershor 2024:

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, se pika 2.1 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 2 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, se pika 2.2 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 3 të nenit 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës;
- IV. TË KONSTATOJË, me gjashtë (6) vota për dhe tre (3) kundër, se pika 1.1 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me nenin 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës;
- V. TË KONSTATOJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, se pika 1.2 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës;


- VI. TË KONSTATOJË, me gjashtë (6) vota për dhe tre (3) kundër, se pika 1.4 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe paragrafin 3 të nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës;
- VII. TË SHPALLË, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, të pavlefshëm, në tërësinë e tij, Ligjin nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme;
- VIII. TË REFUZOJË njëzëri, kërkesën për masën e përkohshme;
- IX. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- X. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (5) të Ligjit.

**Gjyqtari raportues**

  
Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka-Nimani